



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Raporti Përfundimtar i Auditimit Performancës **“PERFORMANCA E UNIVERSITETEVE PUBLIKE** **GJATË PERIUDHËS SË PANDEMISË”**



PËRMBAJTJA

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT	4
1.1 Konteksti i problemit social.....	4
1.2 Rëndësia e auditimit të performancës.....	4
2. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM	6
2.1 Hyrje në subjektet nën auditim	6
2.2 Baza ligjore dhe kriteret që rregullojnë çështjet nën auditim	9
2.3 Rëndësia e produkteve të subjektit	9
2.4 Pesha në buxhet	10
2.5 Përkufizimet dhe terminologjia	18
2.6 Skema e analizës së programit.....	20
2.7 Feedback-u i subjektit përgjatë gjithë auditimit.....	20
3. DETAJET E AUDITIMIT	24
3.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit	24
3.2 Objektivat e auditimit.....	25
3.3 Pyetjet e auditimit	26
3.4 Fushëveprimi i auditimit	27
4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE	27
4.1.Nënpyetja e parë me komponentët e saj.....	27
5. PËRMBLEDHJA	106

✂ LISTA E SHKURTIMEVE

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
BE	Bashkimi Evropian
3E	Ekonomiciteti, Eficienca, Efektiviteti
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (The International Organisation of Supreme Audit Institutions)
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (International Standards of Supreme Audit Institutions)
MASR	Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë
UPT	Universiteti Politeknik i Tiranës
UE	Universitetit “Aleksandër Xhuvani” Elbasan
UNIKO	Universiteti “Fan S Noli” Korçë
UGJ	Universiteti “Eqerem Çabej” Gjirokastrë
UNIVLORA	Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë
AL	Arsim i Lartë
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
SKZHI II	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale
OZHQ	Objektiva e Zhvillimit të Qendrueshëm
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
UNESCO	Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara
MASR	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
HEAL	Hapësira Europiane e Arsimit të Lartë
ECTS	Sistemi European i Transferimit dhe Akumulimit të Kredive
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
S ËOT	Pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
AKFAL	Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë

1. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

1.1 KONTEKSTI I PROBLEMIT SOCIAL

Arsimi është një dhuratë që gjenerata e tanishme duhet t'i paguajë të ardhmes.
- George Peabody

Arsimi i lartë në Shqipëri është mes sektorëve me historikun e polemikave të shumta përgjatë viteve si në aspektin social por dhe politik, me reformime të vazhdueshme, me kërkesa të herëpashershme të studentëve, stafit akademik të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL në vijim), stafit administrativ, etj. dhe interesit të lartë publik për një arsim cilësor dhe që t'u përgjigjet nevojave të tregut, ekonomisë dhe zhvillimit strategjik të vendit. Është e nevojshme që të krijohen balanca të rëndësishme, duke garantuar ekuilibër të qendrueshëm mes ndërhyrjes ligjore të shtetit në zbatimin e politikave të arsimit e autonomisë universitare në katër fushat e kësaj autonomie: në atë financiare; organizative; akademike dhe atë të personelit, veçanërisht vetëfinancimit nga burimet e veta. Parë në këtë kuadër dhe në një linjë kronologjike të ecurisë së kësaj shtylle në vend të paktën në dekadën e fundit, pandemia e COVID-19 e gjeti arsimin e lartë në Shqipëri të papërgatitur në financa, infrastrukturë si në hapësira por dhe në teknologjinë informative në auditor dhe jashtë saj, metodikë mësimdhënie e ofrim shërbimesh për këtë situatë fatkeqësie. Në këtë punim kemi marrë në shqyrtim disa prej aspekteve kyçe që lipset të gjejnë zgjidhje afatgjatë, meqenëse janë rrënjët e disa prej problematikave më të mëdha që u evidentuan përgjatë kësaj periudhe pandemie (Mars 2020-Mars 2021), me kalimin e mësimin universitar online, me platforma të ndryshme të pa unifikuara, të cilat ende nuk kanë gjetur zgjidhje. Në metodologji kemi kryer kryesisht hulumtim në tavolinë (desk research) dhe kontakt me studentë, stafin akademik e palë interesi (OJF) për të bërë një panoramë sa më objektive të situatës.

Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, jep një përcaktim të qartë mbi autonominë universitare, ku institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Roli i shtetit në arsimin e lartë, ushtrohet nëpërmjet organeve dhe strukturave përgjegjëse të tij, ku në çdo rast garanton autonominë dhe lirinë akademike dhe vë në dispozicion fonde publike për mbështetjen e programeve të studimit ose fushave të caktuara të kërkimit shkencor në përputhje me përparësitë e zhvillimit dhe interesave strategjikë të vendit. Këto parime thelbësore të përcaktuara nga ligji i sipërcituar, në disa raste bien ndesh me disa nene dhe me disa vendime të ndryshme të nxjerra nga Këshilli i Ministrave në disa drejtime që prekin atë të organizimit të mësimdhënies dhe të menaxhimit të fondeve publike.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) shpalli gjendjen e jashtëzakonshme të shkaktuar nga epidemia e COVID-19 më 30 janar 2020, si dhe pandeminë me 11 mars 2020, datë kjo ku dhe Qeveria shqiptare shpalli gjendjen e epidemisë nga infeksioni COVID-19, dhe më 24 mars 2020 shpalli gjendjen e fatkeqësisë natyrore në të gjithë territorin e vendit, me qëllim të luftimit dhe përballimit të epidemisë së shfaqur.

Situata pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme për shkak të situatës pandemike, e detyroi qeverinë të merrte masa urgjente për nxjerrjen e akteve nënligjore, për mënyrën se si duhej proceduar për vazhdimin pa ndërprerje të procesit mësimor, duke ndryshuar qasjen tradicionale pedagogjike të mësimdhënies në auditorët e Universiteteve, duke e kaluar tërësisht mësimdhënien online nëpërmjet platformave të ndryshme të krijuara e administruar si të reja të teknologjisë informatike, por të pa unifikuara për të gjithë IAL-et.

Vendimarrjet e menjëhershme të Bordeve dhe Senateve të Universiteteve në përputhje me zbatimin e rregullores së nxjerrë nga Komiteti i Eksperteve i ngritur pranë MSHMS, krijimi i platformave të veçanta për mësimin online pa kontaktet fizike, përvojë kjo që u muar dhe nga Universitetet e BE dhe ato rajonal, bëri që mësimi të zhvillohej, por sigurisht jo me rezultatet e pritshmëritë e duhura, por u shfaqën dhe mangësi e probleme si të procesit të mësimdhënies, por dhe mungesës së infrastrukturës informatike si Laptop, kompjutera dhe internet kryesisht për studentët që ishin në zona rurale dhe atyre që ishin me mungesa financiare, ku familjet e tyre trajtohen me ndihmë ekonomike\nevojë dhe atyre me aftësi të kufizuara, etj.

1.2 RËNDËSIA E AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare veprojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm. Gjatë dekadës së fundit, KLSH i ka kushtuar gjithmonë e më shumë rëndësi auditimeve të performancës, shtimit të numrit dhe cilësisë së tyre. Misioni i KLSH si një institucion i pavarur kushtetues, është t'i shërbejë qytetarit shqiptar, duke qenë "agjent" i Kuvendit dhe palëve të interesit, duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.¹

Kontrolli i Lartë i Shtetit, këshillon dhe ndihmon drejtuesit, realizimit të auditimeve të performancës, synon dhe jep informacion shumë më të gjerë dhe të thelluar mbi ecurinë e qeverisjes së vendit, projektet, programet dhe shërbimet që kryejnë institucionet publike që ka objekt KLSH, gjatë dhe pas procesit auditues stafin administrativ/akademik dhe personelin e institucioneve/enteteve publike për përmirësimin e proceseve të punës, sidomos aty ku efienca është e vështirë për tu matur, duke i nxitur e orientuar për një produkt që u përgjigjet nevojave të publikut.

Auditimi i Universiteteve Publike është i rëndësishëm pasi synon që të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) veçanërisht në kushtet e situatave të emergjencave civile si në pandemi mjeksore apo dhe fatkeqësi natyrore, etj., duke rritur shkallën e përgjegjshmërisë për përballimin e tyre, por dhe përdorimin sa më me efektivitet, ekonomicitetet dhe efienca të fondeve, burimeve finaciare dhe njerëzore që kanë IAL-et. Menaxhimi i mirë i situatave të jashtëzakonshme përveç përkushtimit, kërkon ndërgjegjësimin dhe zbatimin rigoroz dhe efektiv të gjitha burimeve dhe mundësive që kanë IAL-et në dispozicion krijimin e kushteve sa më efikase për zhvillimin e mësimi si në auditor dhe me metodat alternative në distancë, digjitale, dhe platforma online. Në kushtet e përfshirjes së Shqipërisë në zhvillimet globale, rritjes së kërkesave të tregut shqiptar për të rinj të shkolluar me nivele bashkëkohore dhe aderimi në organizatat europiane të arsimit, përfshirja në katastrofa apo situata fatkeqësish natyrore e pandemike, bashkëpunimi me të gjithë faktorët e përfshirë me përgjegjësitë e tyre institucionale dhe ligjore, do të kontribuojë në rritjen e interesit publik për cilësinë e mësimi dhe kërkimin shkencor në IAL-e.

Politikat arsimore në vendet e Bashkimit Evropian janë një pikë e rëndësishme reference për vendet kandidate në BE. Reformat arsimore në Shqipëri bazohen në disa nga parimet kryesore të rekomandimeve sociale dhe ekonomike mbarë-evropiane, duke përfshirë ato të Bashkimit Evropian, Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës, si dhe të disa organizatave dypalëshe dhe shumëpalëshe, përfshirë UNESCO-n. Përveç kësaj, megjithëse Shqipëria nuk është shtet anëtar i OECD-së, Programi i OECD-së për Vlerësimin Ndërkombëtar të Studentëve (PISA) është bërë gjithashtu një pikë e rëndësishme referimi për hartimin e politikave në vend. Përtej Evropës, kuadrot globale të tilla si "Arsimi për të Gjithë" dhe "Objektivat për Zhvillimin e Mijëvjeçarit" kanë qenë një pikë e rëndësishme referimi për zhvillimin e politikës arsimore në Shqipëri. Implikimet e politikës për arsimin e Programit të vitit 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, duke përfshirë OZHQ4-Arsimi 2030 me synimin e përbashkët të OZHQ4 për "Garantimin e arsimit cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë, si dhe të krijojë e konsolidojë shanse për të mësuarit gjatë të gjithë jetës për këdo" është më gjithëpërfshirës në objektin e tij, sesa programet e mëparshme të arsimit ndërkombëtar që janë fokusuar kryesisht në aksesin në arsimin bazë, duke ofruar një kuadër më të zgjeruar normativ për reformat e vazhdueshme arsimore në Shqipëri.²

1.3 AUDITIME TË MËPARSHME APO AKTUALE NË KËTË FUSHË

KLSH ka kryer auditime performance në Universitetin "Fan S. Noli" Korçë 2018, për periudhën e auditimit 01.01.2017 deri me 31.12.2018 në bazë të programit të auditimit nr.750/7, datë 18.10.2018, ku janë trajtuar disa probleme në lidhje me "Cilësia dhe tarifimi i Shërbimeve Studentore pranë IAL-eve publike".

¹ Vendim i Kryetarit të KLSH nr.229, datë 31.12.2017 "Për miratimin e strategjisë së zhvillimit të KLSH- së për periudhën 2018 – 2022"

² Analiza e Politikës Arsimore Shqipëria faqe 29 UNESCO viti 2020

2. SUBJEKTI/ET NËN AUDITIM

2.1 HYRJE NË SUBJEKTET NËN AUDITIM

Subjekte të këtij auditimi janë institucionet përgjegjëse në menaxhimin dhe administrimin e IAL-ve, ku rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara ndaj studentëve dhe përballimi i situatave pandemike siç është pandemia Covid 19, përbën një ndër avantazhet e IAL-ve, në shfrytëzimin e autonomisë që garanton ligji i arsimit të lartë. Shërbimet studentore përbëjnë një nga aktivitetet më të qenësishme për sistemin e arsimit të lartë, të cilat kanë nevojë dhe domosdoshmëri të vlerësohen në aspektin e efikasitetit dhe efektivitetit që ofrojnë në përballimin e situatave, që i përkasin emergjencave civile dhe situatave pandemike, etj.

Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) janë persona juridikë, publikë ose privatë, që gëzojnë pavarësi ligjore nga shteti, të drejtat dhe detyrimet e të cilëve përcaktohen në aktin e krijimit të tyre, dhe ofrojnë arsimim, kualifikim profesional dhe kërkim shkencor, pas maturës shtetërore, organizimi dhe funksionimi i të cilave bëhet në pajtim me ligjin për arsimin e lartë dhe legjislacionin në fuqi.

Arsimi i lartë duhet t'u përgjigjet, t'u përshtatet dhe t'u paraprijë ndryshimeve në tregun e punës dhe në zhvillimin e vendit. Qëllimi i reformimit është të krijojë premiset për një arsim të lartë cilësor, që t'u përgjigjet nevojave të tregut të punës, si dhe drejtimeve të zhvillimit strategjik të vendit. Është shumë e rëndësishme të mendohet për një sistem të njëjësuar dhe të standardizuar të arsimit të lartë në Shqipëri, ku të krijohen mundësitë për një arsim të lartë, të bashkëmatshëm dhe konkurrues me "tregjet" rajonale dhe ato evropiane. Krijimi i një sistemi të njëjësuar mbetet qëllimi afatgjatë i strategjisë qeverisëse të vendit dhe stafeve akademike të IAL-ve.

Subjekte të këtij auditimi janë institucionet përgjegjëse në menaxhimin dhe administrimin e IAL-ve, ku rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara ndaj studentëve dhe përballimi i situatave pandemike siç është pandemia Covid 19, përbën një nga avantazhet e IAL-ve, në shfrytëzimin e autonomisë që ju ka garantuar ligji i arsimit të lartë.

Institucionet e Arsimit të Lartë përfshijnë pikësepari institucionet universitare, ku pasqyrohet se:

- Universiteti është institucion i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale;
- Universiteti përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit. Ai ka në përbërje së paku tre fakultete;
- Universiteti ofron arsimim të lartë, zhvillim të dijeve, të shkencës, të inovacionit dhe të profesioneve;
- Universiteti zhvillon kërkim shkencor bazë e të zbatuar, veprimtari krijuese, ofron shërbime dhe ushtron veprimtari të tjera, në përputhje me fushat e programeve të studimit, me këtë ligj dhe me statutin e tij, si dhe mbështet aftësimin e personelit akademik në funksion të misionit të tij;
- Universiteti ofron programe studimi në të gjitha ciklet e studimeve të arsimit të lartë, si edhe programe studimi me karakter profesional³.

Ministria e Arsimit dhe e Sportit (MAS), si "Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë, është institucioni që realizon programin qeverisës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"⁴. Kjo ministri ka kompetencë të hartojë politika në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor, si dhe të miratojë planin strategjik në këtë fushë. Po ashtu MAS harton dhe propozon bazën ligjore në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe propozon në Këshillin e Ministrave modelin e financimit të buxhetit për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, sipas përcaktimeve të ligjit "Për arsimin e lartë" dhe akteve të tjera, ligjore e nënligjore, në fuqi. Ky dikaster propozon në Këshillin e Ministrave marrjen e vendimit për hapjen, bashkimin e një institucioni të arsimit të lartë me një institucion tjetër dhe mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë, lejon fillimin e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë, miraton hapjen e programeve të reja të studimit, riorganizimin, pezullimin e veprimtarisë akademike dhe mbylljen e tyre, kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, auditon, së paku një herë në tre vjet, përdorimin e fondeve publike në

³ Ligji Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 18, paragrafët 1, 2, 3, 4, 5.

⁴ Ligji Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 7, paragrafi 1.

institucionet e arsimit të lartë etj.

Nisur nga rëndësia që ka tema e trajtimit të auditimit të performancës “*Performanca e universiteteve publike gjatë periudhës së pandemisë*” në periudhën 2020-2021, nga sistemi i arsimit të lartë subjektet në fokus auditimi, janë pesë universitetet publike të mëposhtme:

Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT), është krijuar si Instituti i Lartë Politeknik (ILP), në vitin akademik 1951. Kjo datë shënon njëkohësisht edhe zanafillën e arsimit të lartë në Shqipëri. UPT dhe të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) “gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi”⁵. Në vitin 2007, si rezultat i reformës që ndërmoi qeveria shqiptare për reformimin e kërimit shkencor në Shqipëri, ndryshoi struktura përbërëse e Universitetit Politeknik të Tiranës, i cili aktualisht ka në përbërjen e tij shtatë fakultete: Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Inxhinierisë së Ndërtimit, Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, Inxhinierisë Mekanike, Inxhinierisë Elektrike, Teknologjisë së Informacionit, Gjeologjisë dhe Minierave dhe Instituti i Gjeoshkencave të Ujit dhe Mjedisit. Programet e studimit në UPT, në fushat inxhinierike të gjeologjisë, burimeve minerare, naftës&gazit, mekanike, materiale, tekstil dhe konfeksione, energjitikë, automatizim industrie, mekatronike, elektronike, telekomunikacion, inxhinieri informatike, inxhinieri matematike, inxhinieri fizike, ndërtim, mjedis, hidroteknikë, gjeodezi dhe në ato të arkitekturës dhe urbanistikës

Universitetit Politeknik i Tiranës për vitin akademik 2019-2020 ka patur 14983 studentë, për vitin akademik 2020-2021 ka patur 14316 studentë dhe për vitin vitin akademik 2021-2022 ka 15285 studentë.

Universiteti “Fan S. Noli” i Korçës (UNIKO), në të gjithë veprimtarinë e tij ka për mision kryesor të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, kërimit shkencor dhe shërbimeve”⁶. Këtë mision. UNIKO e realizon përmes këtyre synimeve, të përgatitjes profesionalisht të specialistëve të lartë në fushat që mbulon në të gjitha programet e studimit, nëpërmjet mësimdhënies dhe praktikave profesionale, duke përmblusur të gjitha detyrat që rrjedhin nga nënshkrimi i Deklaratës së Bolonjës në vitin 2003. Po ashtu UNIKO, synon të formojë shkencëtarë të rinj në fusha të ndryshme parësore, duke marrë parasysh drejtimit kryesor të zhvillimit të rajonit, nëpërmjet kërimit shkencor dhe veprimtarisë botuese dhe si promotor i formës më të lartë të arsimit, synon edhe përvetësimin e kompetencave specifike dhe saktësinë metodologjike për ta bërë individin jo vetëm specialist kompetent, por dhe një qytetar të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë. Gjithashtu, ka objekt të kryerjen e studimeve shkencore për të zhvilluar programet e studimit të shkencave që lëvron dhe të ofrojë shërbime për zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme që ka rajoni i Korçës dhe më gjerë.

Ky mision realizohet nëpërmjet ofrimit të programeve në fushat e ekonomisë, bujqësisë, edukimit, shkencave humane dhe natyrore, sipas artikullimit të tij në katër fakultete, përkatësisht atë të Bujqësisë, Fakulteti të Ekonomisë, Fakulteti të Edukimit dhe Filologjisë, Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Fakultetit të Shkencave Humane.

UNIKO kontribuon në zhvillimin rajonal e më gjerë, nëpërmjet përgatitjes së specialistëve në fushat e mësimdhënies, duke integruar më së miri kërkimin shkencor, edukimin dhe shërbimin ndaj publikut dhe ofron edukim cilësor dhe nxit përgatitjen profesionale dhe personale për çdo student që kërkon të ndërtojë një karrierë produktive dhe të ketë përgjegjësi sociale

Fillimi i veprimtarisë së Universitetit “Fan S. Noli” daton në vitin 1971. UNIKO për vitin akademik 2019-2020 ka patur 3620 studentë, për vitin akademik 2020-2021 ka patur 3327 studentë dhe për vitin vitin akademik 2021-2022.

Universiteti “Eqrem Çabej” i Gjirokastrës (UGJ) është krijuar me VKM Nr. 414, datë 12.11.1991, mbi bazën e fillesave të Institutit të Lartë Pedagogjik, që ishte çelur më 1971. Ai është institucioni më i rëndësishëm arsimor, shkencor e kulturor i Rajonit Jugor të Shqipërisë. Me Vendimin Nr. 823, datë 05.12.2007 të Këshillit të Ministrave, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Fakulteti i Edukimit, janë bashkuar dhe është krijuar Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.

Me Urdhër të MASR Nr. 126, datë 20.03.2017, është krijuar Fakulteti Ekonomik.

⁵ Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, paragrafi 1.

⁶ Statuti i Universitetit “Fan S. Noli” Korçë miratuar me Urdhër nr. 56, datë 08.02.2018, të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, neni 2.

Aktualisht Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë ka në përbërje e tij tre fakultete: Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Fakultetin Ekonomik. Universiteti “E. Çabej” UNIKO për vitin akademik 2019-2020 ka patur 1501 studentë, për vitin akademik 2020-2021 ka patur 1489 studentë dhe për vitin vitin akademik 2021-2022 ka 1324 studentë të regjistruar.

Universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës (UNIVLORA), si të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) “gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë u hap në 10 Tetor 1994. Fillimisht mësimi filloi si Universiteti Teknologjik i Vlorës “Ismail Qemali”, me tri fakultete: Fakulteti i Tregëtisë, Fakulteti i Inxhinierisë Detare dhe Fakulteti i Infermierisë.


Ky universitet aktualisht ka në përbërjen e tij katër fakultete dhe përkatësisht: Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, Fakulteti i Shkencave Humane dhe i Drejtësisë, Fakulteti i Shëndetit, Fakulteti i Ekonomisë. Universiteti “I. Qemali” për vitin akademik 2019-2020 ka patur 4941 studentë, për vitin akademik 2020-2021 ka patur 4522 studentë dhe për vitin vitin akademik 2021-2022 ka 3926 studentë të regjistruar për vitin akademik 2021-2022.

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit (UE), i themeluar në vitin 1991, është institucion i rëndësishëm arsimor e shkencor në Republikën e Shqipërisë, një nga universitetet e orjentuar në përgatitjen e mësuesve, të specialistëve dhe studiuesve të rinj në fusha të ndryshme të studimeve. Universiteti është ngritur mbi një traditë të pasur në këtë drejtim. Pa dyshim kjo traditë është e lidhur ngushtë me Shkollën Normale, të çelur më 1909, e cila luajti për shumë kohë rolin e një universiteti të vërtetë.

Ky universitet aktualisht ka në përbërjen e tij katër fakultete dhe përkatësisht: Fakulteti i Shkencave Humane, Fakulteti i Shkencave Natyrës, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Fakulteti i Ekonomik, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike me për vitin akademik 2019-2020 ka patur 13 905 studentë, për vitin akademik 2020-2021 ka patur 11500 studentë dhe për vitin vitin akademik 2021-2022 12600 studentë të regjistruar.

Në vijim të këtij parashtrimi Grupi i Auditimit është përpjekur të skematizojë spektrin e subjekteve në fokus të auditimit, duke e përfutur si rezultante të organigramës së pjesëshme të MASR dhe pesë universiteteve publike të përzgjedhura, në respekt të hirarkive brenda institucionit, hirarkive ndër-institucionale, si dhe autonomive akademike, organizative dhe financiare të IAL – ve.

Skema e subjekteve ne auditim



Skema 1: Struktura funksionale e Arsimit të Lartë në Shqipëri
Përpunoi: Grupi i auditimit

2.2 BAZA LIGJORE QË RREGULLON ÇËSHTJEN NËN AUDITIM

Subjektet në auditim e bazojnë aktivitetin e tyre për menaxhimin dhe zbatimin e politikave mbi Arsimin e Lartë në Shqipëri në Ligjin nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet të tjera ligjore e nënligjore që i shërbejnë rritjes së nivelit të AL dhe mirëmenaxhimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë, etj. Këto ligje dhe akte nënligjore e administrative, kanë për qëllim që të rrisin zhvillimin e arsimit të lartë sipas nevojave që ka tregu në Shqipëri dhe të krijojë kushte sa më efektive për zhvillimin e procesit arsimor me studentët në kushte optimale e veçanërisht në përshtatjen e këtij procesi mësimor në kushte pandemie, siç ishte Covid 19 në periudhën 2020-2021. Listojmë një pjesë të këtyre akteve:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji Nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”;
- Ligji Nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.99/2018, datë 3.12.2018, “Për buxhetin e vitit 2019”;
- Ligji Nr.88/2019, datë 18.12.2019, “Për buxhetin e vitit 2020”;
- Ligji Nr.137/2020, datë 16.11.2020, “Për buxhetin e vitit 2021”;

- Ligji Nr. 9936, datë 29.06.2018 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligi Nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
- Ligji Nr. 80/2015, datë 22.7.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 45/2019, datë 18.7.2019, “Për Mbrojtjen Civile”;
- Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022;
- VKM Nr. 243, datë 24.03.2020 “ Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”;
- VKM Nr.709, datë 29.10.2014, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për periudhën 2014-2020”;
- VKM Nr. 621, datë 22.10.2021 “ Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin e 2021–2026 dhe të Planit të Veprimit për Zbatimin e Saj”;
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 Tiranë, tetor 2021;
- VKM Nr. 989, datë 9.12.2015 “Për organizimin, funksionimin, kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë dhe shpërblimin e anëtarëve të këshillit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”;
- VKM-së Nr. 511, datë 24.10.2002, i ndryshuar me VKM-në Nr. 463, datë 16.06.2011 dhe VKM-në Nr. 867, datë 11.11.2020 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar;
- VKM Nr. 607, datë 31.08.2016 “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të kërkimit shkencor dhe inovacionit” (AKKSHI);
- VKM Nr. 66, datë 03.02.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”;
- VKM Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë së sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë e të bordit të akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”;
- VKM Nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”.
- VKM nr. 370, datë 26.04.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e kolegjit profesional të lartë”;
- VKM Nr. 397, datë 03.05.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të financimit të arsimit të lartë” (AKFAL)” bn;
- VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”;
- VKM Nr. 424, datë 10.05.2017 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës së përzgjedhjes e të emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare”;
- VKM Nr. 710, datë 01.12.2017 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin, 2017-2022”;
- VKM Nr. 88, datë 14.02.2018 “Për krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH)”;
- VKM Nr. 75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”;
- VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave Nr. 30 Datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, etj.

URDHËRA, UDHËZIME TË MASR, MSHMS, ISHP

- Udhëzim Nr. 8, datë 13.03.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”;
- Udhëzim Nr. 5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”;
- Udhëzim Nr. 1, datë 02.02.2018 “Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr.25 datë 10.11.2017 për

regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe të certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”;

- Udhëzim Nr. 15, datë 16.04.2018 “Për disa ndryshime në Udhëzimin Nr. 17, datë 03.08.2016 “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar, jashtë vendit”, i ndryshuar, etj.
- Urdhër i MSHMS, me Nr. 135, datë 09.03.2020 “Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së Covid 19”;
- Urdhër Nr. 91, datë 09.03.2020 i MASR “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jo publike”;
- Urdhër i MASR, Nr. 104, datë 30.04.2020, “Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020 nga institucionet e arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e Covid – 19;
- Urdhër i MASR me Nr. 175, datë 30.06.2020, “Për zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet e Arsimit të Lartë”;
- Urdhër i MSHMS, me Nr. 289, datë 04.05.2020, “Për miratimin e udhëzuesit për masat ndaj Covid-19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore”.

URDHËRA TË KRYEMINISTRIT

- ✓ Urdhër “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, përfunduar dhe miratuar;
- ✓ Urdhër “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë” përfunduar dhe miratuar;
- ✓ Urdhër “Për emërimin e kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Akreditimit” përfunduar dhe miratuar.
- ✓ Urdhër i Kryeministrit Nr. 44, datë 11.04.2017 “Për emërimin e Drejtorit të Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë”.

RREGULLORE, VENDIME DHE KËRKESA TË ORGANEVE TË IAL - ve

- Rregullore e MASR Nr. 2459/1 prot., datë 15.03.2016 “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Kërkesë për vënien në dispozicion të stafit mjekësor të nevojshëm për zbatimin e masave që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore, drejtuar Drejtorive Rajonale të Shëndetësisë, Korçë (bazuar në Urdhër Nr. 289, datë 04.05.2020 të MSHMS “Për miratimin e udhëzuesit për masat ndaj Covid-19);
- Plani i veprimit për përfundimin e vitit akademik 2019-2020, 11 Maj 2020, hartuar dhe përgatitur nga Rektorati, mbi propozimet e secilës njësi kryesore;
- Plani i masave paraprake mbi zhvillimin e procesit të mësimdhënies, pranisë së studentëve dhe personelit, për vitin akademik 2020-2021”;
- Plani i masave për fillimin e vitit akademik 2020-2021” (bazuar në shkresën Nr. 5529 prot, datë 30.09.2020, të MASR “Mbi fillimin e vitit akademik 2020 – 2021”, etj.;
- Çdo Urdhër i Rektorit, Urdhër i Administratorit, Vendime të Senatit apo Vendime të Bordit të Administrimit të IAL – ve objekt auditimi, që lidhet me fokusin e auditimit.

2.3 RËNDËSIA E PRODUKTEVE TË SUBJEKTIT

Arsimi i Lartë në Shqipëri, ashtu si në vendet e zhvilluara, konsiderohet një shërbim publik dhe e mirë publike, pavarësisht nga forma e pronësisë. Si një nga sektorët më shpesh të reformuar në vendin tonë, gjithnjë në rastet e këtyre nismave ndryshuese, është synuar që të ruhen të pacënuar parimet bazë të këtij arsimi si:

- cilësi sipas standardeve të HEAL-së;

- mundësi të barabarta, pa diskriminim dhe mbështetje për shtresat në nevojë;
- konkurrencë e lirë mes institucioneve të arsimit të lartë, personelit akademik dhe studentëve;
- mundësi për të gjithë mbi bazën e meritës;
- mbështetje të përparësive strategjike të zhvillimit të vendit nëpërmjet kërkimit shkencor.

Edhe miratimi i ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” synon përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë në dy drejtimet kryesore: mësimdhënie dhe punë kërkimore-shkencore.

2.4 PESHA NË BUXHET

Në vitin 2019-2020 bazuar në ligjin nr. 99/2018 për vitin 2019 është akorduar një grant prej 40,007,043 mijë lekë në total për arsimin, nga kjo Arsimi i Lartë është financuar në vlerën 7,830,000 mijë lekë 19.6%, në vitin 2020-2021 bazuar në ligjin⁷ “Për buxhetin e shtetit të vitit 2020” të miratuar, janë financuar IAL-et e vendit në formë Granti me vlerë 9,730,000 mijë lekë ose 23% nga totali i shumës 41,979,763 mijë lekë të akorduar për arsimin dhe për vitin 2021 shuma e financuar në formë Granti ka vlerën prej 10,096,000 mijë lekë, ose 24% nga shuma totale 42,214,076 mijë lekë, të akorduara për arsimin në Shqipëri sipas ligjit⁸ përkatës për buxhetin e vitit 2021.

Një nga qëllimet e reformës arsimore që kryhet në Shqipëri, është të vendosë arsimin e lartë mbi baza financiare të qëndrueshme për t’u bërë ballë ndryshimeve dhe cikleve ekonomike. Në këtë prizëm, larmia e financimit dhe autonomia institucionale e iAL-ve janë shumë të rëndësishme për maksimalizimin e të gjitha burimeve të financimit të arsimit të lartë që ekzistojnë në shoqëri.

1. Universiteti “Fan S Noli” Korçë për periudhën në vitet 2020-2021 në kushtet e periudhës së pandemisë Covid 19 dhe konstatohet se nga struktura administrative dhe akademike.

Në vitin 2020-2021, ky institucion ka patur në dispozicion një buxhet "Grant i Buxhetit" & "Të ardhurat e krijuara" në vlerë totale 910,687 mijë lekë, nga kjo: vlera 807,702 mijë lekë nga buxheti i shtetit dhe vlera 102,985 mijë lekë të ardhura nga pagesat e studentëve, rezulton se të ardhurat e veta zënë 11.3%, si tarifa studimi dhe të tjera. Realizimi i buxhetit për këto dy vite është përkatësisht në vitin 2020 masën 93% dhe në vitin 2021 masën 95%. Nuk ka patur asnjë shtesë financimi nga buxheti i shtetit, gjë kjo që tregon për një qasje jo mbështetëse nga Qeveria në këtë Universitet. Sipas pasqyrës përmbledhëse të përgatitur, shikohet se përdorimi i buxhetit në dy vitet e pandemisë nuk është përmbushur në 2-3zëra, konkretisht në vitin 2020 kemi dy zëra shpenzimesh në llogarinë 602 e 606 në masë 37% dhe 76 %, pra siç shikohet me situatën pandemike janë ndaluar shërbimet e panevojshme imediate dhe në vitin 2021 kemi dy zëra shpenzimesh në llogarinë 602 e 606 në masë 62% dhe 86 %, ndërkohë që buxheti në vitin 2019 është realizuar 100 %. Sipas pasqyrës plani i vitit 2020 ka qenë në vlerën 416,889 mijë lekë dhe realizuar në fakt 388,097 mijë lekë ose 93%, ndërsa në vitin 2021 nga 434,397 mijë lekë që ka qenë plani janë përdorur 413,605 mijë lekë ose realizuar buxheti në masën 95 % të grantit të dhënë nga Qeveria.

Për zërin “Investime” në llogarinë 231, në të dy vitet 2020-2021 kanë përdorur vlerën 31,349 mijë lekë, nga kjo: në vitin 2020 për iAL vlerën 19,731 mijë lekë dhe 11,618 mijë lekë për Kërkimin shkencor.

Tabela 1 Pasqyra e planifikimit dhe realizimit të ardhurave për periudhën 2019-2021

000| lekë

Nr.	Përshkrimi i të ardhurave	Totali 2019			Totali 2020			Totali 2021		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
	Realizimi	120,319	69,099	57%	90,319	74,984	83	122,747	70,736	58

Burimi: UNIV Korçë dhe grupi i auditimit të KLSH.

Pra, mungesa e ardhjes së studentëve të planifikuar me kuotat e caktuar, ka sjellur mungesën e realizimit të ardhurave, por mungesa ka ardhur dhe nga mos shtimi i projekteve dhe kërkimit shkencor, pasi ka një numër të kufizuar për një Universitet me traditë. Të ardhurat financiare janë realizuar 83 % në vitin 2020 dhe në masën 58% në vitin 2021 me diferencë në vlerë -52,011 mijë lekë, pra konstatohet se në kemi

⁷ Ligji i buxhetit nr.88, datw 18.12.2019

⁸ Ligji i buxhetit nr.137, datw 16.12.2020

një mosrealizim me planit të ardhurave

Shpenzimet e kryera në vitin 2019 (për metodologji krahasimi) dhe dy vitet me situatë pandemike 2020-2021 (Analizë e hollësishme do bëhet në auditimin pas miratimit të Programit të auditimit), konkretisht:

Table 2: Pasqyra e shpenzimeve për periudhën 2019-2021(lekë)

EM ËRTIMI	Vlera në vitin 2019	Vlera në vitin 2020	Vlera në vitin 2021
A Shpenzime nga Buxheti	391,653,666	388,097,346	413,605,398
SHUMA	391,653,666	388,097,346	413,605,398
B Shpenzime nga t ë ardhurat	54,534,857	47,942,786	56,936,182
SHUMA B	54,534,857	47,942,786	56,936,182
C Garanci të vitit t ë trashëguara	3,113,819.89		
TOTALI I SHPENZ.(A+B)	449,302,343	436,040,132	470,541,580

Burimi: Univ. Korçë dhe Grupi i auditimit të KLSH

Shpenzimet gjatë periudhës së pandemisë Mars 2019- Dhjetor 2021 për mbrojtjen higjeno-sanitare dhe për ndryshimin e sistemit të mësimdhënies nga auditori në online, janë si më poshtë:

Tabela 3 Pasqyra e shpenzimeve higjeno sanitare për periudhën Mars 2020-Dhjetor 2021(lekë)

Nr.	Objekti i shpenzimit	Urdh ër Prokurimi		Urdhër Shpenzimi		Vlera Lekë
		Nr	Datë	Nr	Datë	
1	Të tjera materiale e shërbime speciale	183	19.03.2020	94	29.04.2020	442,680
2	Shërbim Denzif. dhe higjenizim për Covid 19	391	31.08.2020	271	07.12.2020	60,000
3	Shërbim Denzif. dhe higjenizim për Covid 19			242	10.11.2020	60,000
4	Shërbim Denzif. dhe higjenizim për Covid 19			53	09.03.2021	60,000
5	Ëeb camera(platform online) për zhvillimin e proc. mësimor online	680	17.12.2020	14	27.01.2021	41,880
6	Shërbim Denzif. dhe higjenizim për Covid 19	219	12.05.2020	140	07.07.2020	160,966
7	Shërbim Denzif. dhe higjenizim për Covid 19			186	09.09.2020	42,794
8	Mat. e pajisje sh ërbimi (rifillimi i mësimi)	222	12.05.2020	123	16.06.2020	95,760
Totali						964,080

Për periudhën e pandemisë Mars 2020-Dhjetor 2021 nga Universiteti “Fan S.Noli” Korçë, nuk është kërkuar dhe kryer rialokim i fondeve për arsye se shpenzimet e kryera për përballimin e situatës së krijuar nga Covid-19 janë mbuluar me fondet e planifikuara sipas periudhës përkatëse.

Përdorimi i këtyre materialeve higjeno sanitare ka qenë plotësisht në funksion të studentëve dhe stafit akademik e administrativ të IAL.

2. Universiteti i Elbasanit “Aleksndër Xhuvani” për ushtrimin e aktivitetit për periudhën 2020-2021 ky institucion i Arsimit të Lartë, ka përdorur fondet publike me burim financimi:

Tabela 4 Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2020(mijë/lekë)

EM ËRTIMI	Vlera në vitin 2019	Vlera në vitin 2020	Vlera në vitin 2021
A Shpenzime nga Buxheti	620,687	669,018	703,606
SHUMA	620,687	669,018	703,606
B Shpenzime nga t ë ardhurat	226,487	82,859	73,969
SHUMA B	226,487	226,487	73,969
C Garanci të vitit të trashëguara	-	1,643	397
TOTALI I SHPENZ.(A+B)	847,174	751,877	777,575

Sipas burimit të financimit paraqitet si më poshtë:

Tabela 5 Pasqyra e burimit financimit

				mijë lekë
Ërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2019	Financimi viti 2020	Buxheti viti 2020	
Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transfertat)	43,307	836,752	880,060	

	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	7,558	15,432	22,990
	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuara	217,969	153,476	371,444
TOTALI		268,834	1,005,660	1,274,494

Për vitin 2020, Universiteti “A.Xhuvani” Elbasan ka përdorur një buxhet total në vlerën 1,274,494 mijë lekë, nga të cilat:

- Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transfera) 880,060 mijë lekë.
- Granti konkurrues, kërkimi shkencor nga buxheti) 880,060 mijë lekë.
- Projekte të huaja 22,990 mijë lekë.

Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga një vit më parë) 371,444 mijë lekë, nga të cilat 3,999,743 lekë janë disbursim projekt i huaj nga Komisioni Evropian.

Për vitin 2021 financimet paraqiten:

Tabela 6 Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2021-Fakti (mijë/lekë)

Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2020	Financimi viti 2021	Buxheti viti 2021
1	Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transfera)	168,500	914,814	1,083,314
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	11,359	6,256	17,615
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuara	288,585	147,091	435,675
TOTALI		468,444	1,068,161	1,536,605

Burimi: U Elbasan dhe grupi i auditimit të KLSH

Efektet nga shpenzimet e kryera për periudhën e pandemisë Covid19 dhe pezullimi i aktivitetit në mjediset e dhëna me qira, si rezultat i mbylljes së procesit akademik në auditor, janë 10,597,350 lekë nga e cila:

-Shpenzimet e kontraktuara për shërbim dezinfektimi dhe blerje materiale për mbrojtjen personale në vlerën 9,604,794 lekë, nga të cilat janë likuiduar furnizimet e kryera dhe shërbimet në vlerën 8,000,385 lekë, mbeten për tu realizuar shërbime e materiale në vlerën 1,604,410 lekë.

-Të ardhura të paarkëtuara nga pezullimit i aktivitetit të mjedisëve të dhëna me qira në vlerën 807,679 lekë; për vitin 2020 në vlerën 454,575 lekë, për vitin 2021 janë në vlerën 353,104 mijë lekë.

- Shpenzimet e Universitetit të Elbasanit - së:

Gjatë gjithsej janë realizuar sipas pasqyrës mëposhtme:

Plan buxheti i vitit 2020 i çelur për përdorim (Plan Thesari) në vlerën 1,136,019 mijë lekë është realizuar në vlerën 806,032 mijë lekë, ose 71.0 %

-Të ardhura dhe shpenzime viti 2021

Për vitin 2021 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën 1,536,605 mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit paraqitur në pasqyrën e mësipërme. Fondet e kushtëzuara – të ardhurat e UE - së:

Të ardhurat e disponueshme janë realizuar në vlerën 435,675 mijë lekë ose 89 % të krahasuara me planin vjetor të tyre, ndërsa të ardhurat për tu grumbulluar në vitin 2021 janë realizuar në vlerën 147,091 mijë lekë ose 73 % të krahasuara me planin vjetor të tyre.

Shpenzimet e UE - së: Gjatë të vitit 2021 shpenzimet gjithsej janë realizuar 59 % e financimit vjetor.

Planbuxheti i çelur për përdorim (Plan Thesari) në vlerën 1,406,692 mijë lekë është realizuar në vlerën 820,902 mijë lekë, ose 58 %

Tabela 7 Shpenzime për materiale e shërbime Covid19 Mars 2020 - Dhjetor 2021

në lekë

Nr	Objekti i Prokurimit	Vlera faturave (lekë)	Shërbimi dhe dalje
1	Blerje bandera në 5 godina në adezive COVID-19	395,000	Sipas kontratës
2	Materiale për mbrojtje personale ndaj COVID-19	2,676,600	Sipas plan shpërndarje
3	Shërbime të dezinfektimit të mjedisëve (COVID-19)	4,869,275	Sipas kontratës
4	Shpenzime për platformën "Abonime Office 365"	59,510	Sipas kontratës
Totali		8,000,385	

Burimi: UE dhe grupi i auditimit KLSH

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” gjatë periudhës së pandemisë, si për mbrojtjen higjeno-

sanitare dhe për ndryshimin e sistemit të mësimdhënies nga auditori në online për periudhën e pandemisë Mars 2020-Dhjetor 2021, ka kryer rialokime të fondeve nga granti për shpenzime korente brenda zërave buxhetor të planifikuar në fillim të vitit 2020 dhe planifikimin e tyre për vitin 2021.

Për nevoja e situatës pandemike në kushtet konkrete si; shpërndarja e godinave, stafit akademik, stafit administrativ dhe studenteve që do të jenë prezent në auditorë nga data 01.06.2020 deri në 30.10.2020.

Tabela 8 Shpenzimet përperiudhën e pandemisë Covid 19

Nr	Emërtimi	Fondi
1	Shërbime të dezinfektimit të mjediseve Covid19	1,884,000
2	Blerje materiale të nevojshme për mbrojtjen personale	3,066,000
Totali		4,950,000

Tabela 8.1 Fondi i rialokuar për periudhën e pandemisë Mars 2020-Dhjetor 2021

lekë

Nr	Vendime Bordin	Emërtimi	Vlera
1	VBA nr. 12, datë 20.05.2020	Shërbime të dezinfektimit të mjediseve, COVID-19	1,884,000
2	VBA nr. 12, datë 20.05.2020	Blerje materiale të nevojshme për mbrojtjen personale	3,066,000
3	VBA nr. 23, datë 26.09.2020	"Shërbime për aksesimin online të produktit të Covid19 të Microsoft 'Office 365 A1 for Education'"	120,000
4	VBA nr. 46, datë 24.10.2020	"Shërbime të dezinfektimit të mjediseve, COVID-19"	8,000,000
5	VBA nr. 09, datë 06.03.2021	"Materiale për mbrojtje personale ndaj COVID-19"	2,514,040
Shuma			15,584,040

Fonde këto që janë shpenzuar për periudhën e pandemisë janë 4,950 mijë lekë.

3. Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë ka përdorur fonde publike :

Universiteti "Eqrem Çabej" për ushtrimin e aktivitetit për periudhën 2020-2021 ky institucion i Arsimit të Lartë, ka përdorur fondet publike me burim financimi:

Tabela 9 Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2019-2021(mijë/lekë)

EM ËRTIMI	Vlera në vitin 2019	Vlera në vitin 2020	Vlera në vitin 2021
A Shpenzime nga Buxheti	202,653	215,508	188,053
SHUMA	202,653	215,508	188,053
B Shpenzime nga të ardhurat	75,256	68,095	74,896
SHUMAB	75,256	68,095	74,896
C Garanci të vitit të trashëguara	299	699	700
TOTALI I SHPENZ.(A+B)	277,909	283,603	262,949

- Për vitin 2020 financimet paraqiten:

Tabela 10 Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2020 (mijë/lekë)

Emërtimi i projektit	Mbartur nga vitin 2019 (1)	Financimi viti 2020 (2)	Buxheti viti 2020 3(1+2)
Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta)	12,113	207,039	219,152
Disbursimet nga projektet me financim të huaj	2,610	19,592	22,202
Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuara	63,086	33,299	96,385
TOTALI	77,809	259,930	337,739

Për vitin 2020 Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastrë ka përdorur një buxhet total në vlerën 337,739 mijë lekë, nga të cilat:

- Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie,
 - Granti konkurrues 198,695 mijë lekë, kërkimi shkencor 8,344 mijë lekë, Nga buxheti në total 207,039 mijë lekë.
 - Projekte të huaja 22,202 mijë lekë,
 - Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga një vit më parë) 96,385 mijë lekë,
- **Të ardhura dhe shpenzime viti 2020**

Për vitin 2020 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën 337,739 mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

a. Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie, Granti konkurrues, kërkimi shkencor nga buxheti) 219,152 mijë lekë.

b. Projekte të huaja 22.202 mijë lekë.

c. Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga një vit më parë) 96,385 mijë lekë.

Fondet të kushtëzuar – të ardhurat e UGJ-së: Të ardhurat e disponueshme janë realizuar në vlerën 96,385 mijë lekë ose 28 % të krahasuara me planin vjetor, ndërsa të ardhurat për tu grumbulluar në vitin 2020 janë realizuar në vlerën 33,299 mijë lekë ose 48.6 % të krahasuara me planin vjetor të tyre. (Plani 68,480 dhe fakti 33,299). Këto të ardhura janë grumbulluar gjatë vitit 2020.

Tabela 10.1 Të Ardhurat për vitin 2020 – fakti(mijë/lekë)

Nr	Emërtimi	Plan	Fakt	%
A	Të ardhura të vitit	68,480	33,299	48,6
B	Të ardhura të trashëguara	63,086	63,086	100
C	Trashëguar nga viti 2019	63,086	63,086	100
Totali		131,566	96,385	73,26

Realizimi prej 48.6 % është rezultat i grumbullimi i një pjese të tarifave të shkollimit të planifikuara për vitin 2020 në tetor–dhjetor 2019. Një pjesë e këtyre të ardhurave janë përdorur për shpenzimet e planifikuara për tu realizuar në vitin 2019. Pjesa e papërdorur ka kaluar si të ardhura të trashëguara për vitin 2020.

Shpenzimet e UGJ-së: Gjatë të vitit 2020 shpenzimet gjithsej janë realizuar 88.8 % e financimit vjetor. Plan buxheti i çelur për përdorim është në vlerën 332.767 lekë. Është realizuar në vlerën 295.568 mijë lekë, ose 88.8 %.

- Për vitin 2021 financimet paraqiten:

Tabela 11 Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2021(mijë/lekë)

Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2020	Financimi viti 2021	Buxheti viti 2021
1	Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta)	3,645	190,472	194,117
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	10,236	9,553	19,789
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	28,290	47,300	75,590
TOTALI		42,171	247,325	289,496

Burimi: U Gjrokastër dhe grupi i auditimit të KLSH

Për vitin 2021 Universiteti “Eqrem Çabej” Gjrokastër një buxhet total në vlerën **289,496** mijë lekë, nga të cilat:

a. Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie, Granti konkurrues 183,647 mijë lekë, kërkimi shkencor 4,070 mijë lekë, rimbursim i tvsh 2,755 mijë lekë nga buxheti). Në total buxheti 194,117 mijë lekë.

b. Projekte të huaja 19,789 mijë lekë.

Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga një vitet e mëparëshme) 75,590 mijë lekë, (nga të cilat 1.814.672 lekë janë disbursim nga projekti me financim të huaj).

Efektet nga shpenzimet e kryera për pandeminë Covid19, janë 2,647,455 lekë.

▪ Të ardhura dhe shpenzime viti 2021

Për vitin 2021 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën 289,496 mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

Tabela 11.1 Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2021(mijë/lekë)

Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2020	Financimi viti 2021	Buxheti viti 2021
----	----------------------	-----------------------	---------------------	-------------------

1	Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferata)	3,645	190,472	194,117
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	10,236	9,553	19,789
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	28,290	47,300	75,590
TOTALI		42,171	247,325	289,496

- a. Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferata), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie, Granti konkurrues, kërkimi shkencor nga buxheti) 194,117 mijë lekë.
- b. Projekte të huaja 19,789 mijë lekë.
- c. Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga një vitet e mëparëshme) 75.590 mijë lekë. nga të cilat 1.814.672 lekë janë nga projektet me financim të huaj.

Tabela 11.2 Ardhurat për 12- mujorin viti 2021 – fakti (mijë lekë)

Nr	Emërtimi	Plan	Fakt	%
A	Të ardhura të vitit	40,072	47,300	118
B	Të ardhura të trashguara	28,290	28,290	100
1	Trashëguar nga viti 2020	28,290	28,290	100
Totali		68,362	75,590	110

Planbuxheti i çelur për përdorim është në vlerën **289,496 mijë lekë**, realizuar në vlerën **278,181 mijë lekë**, ose 96 %.

Gjatë periudhës së pandemisë, si për mbrojtjen higjieno-sanitare dhe për ndryshimin e sistemit të mësimdhënies nga auditori në online për periudhën e pandemisë Mars 2020-Dhjetor 2021 ka kryer rialokime të fondeve vetëm nga të ardhurat për shpenzime korente brenda zërave buxhetor të planifikuar në fillim të vitit 2020 dhe planifikimin e tyre për vitin 2021. Në materialet e pastrimit në vlerën prej 555.600 lek si dhe materiale higjieno sanitare në vlerën prej 872,400 lekë.

4. Universiteti Politeknik i Tiranës ka përdorur fonde publike për periudhëvitin 2020, si më poshtë: Për ushtrimin e aktivitetit për periudhën 2020-2021 ky institucion i Arsimit të Lartë, ka përdorur fondet publike me burim financimi:

Tabela 12. Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura

		(mijë/lekë)		
EM ËRTIMI	Vlera në vitin 2019	Vlera në vitin 2020	Vlera në vitin 2021	
A Shpenzime nga Buxheti	1,124,532	1,072,536	1,164,601	
SHUMA A	1,124,532	1,072,536	1,164,601	
B Shpenzime nga të ardhurat	254,874	151,566	283,123	
SHUMA B	254,874	151,566	283,123	
C Garanci të vitit të trashëguara	5,845	54,745	15,158	
TOTALI I SHPENZ.(A+B)	1,379,406	1,224,102	1,447,724	

Për vitin 2020 Universiteti Politeknik i Tiranës ka përdorur një buxhet total në vlerën 1,888,282 mijë lekë, nga të cilat:

- Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferata), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie, Granti konkurrues, Kërkim shkencor nga buxheti) 1,235,282 mijë lekë;
- Projekte të huaja 71,806 mijë lekë;

Të ardhura të UPT (të vitit dhe të trashëguara nga një vit më parë) 220,284 mijë lekë.

Tabela 12.1 Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2020(mijë/lekë)

Nr	Emërtimi	Mbartur nga viti 2019	Financimi viti 2020	Buxheti viti 2020
1	Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferata)	40,942	1,194,340	1,235,282
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	3,381	68,425	71,806
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	220,284	360,910	581,194
TOTALI		264,607	1,623,675	1,888,282

Burimi:UP Tiranë dhe grupi i auditimit të KLSH

1. Për vitin 2021 financimet paraqiten:

Universiteti Politeknik i Tiranës ka përdorur për vitin 2021 një buxhet total në vlerën 2,219,833 mijë lekë, nga të cilat:

- Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie, Granti konkurrues, kërkimi shkencor nga buxheti) 1,337,213 mijë lekë;
- Projekte të huaja 95,842 mijë lekë;

Të ardhura të UPT (të vitit dhe të trashëguara nga një vit më parë) 786,778 mijë lekë.

Tabela 12.2: Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2021(mijë/lekë)

Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2020	Financimi viti 2021	Buxheti viti 2021
1	Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta)	134,164	1,203,048	1,337,213
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	28,009	67,833	95,842
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuara	429,629	357,149	786,778
TOTALI		591,802	1,628,030	2,219,833

Burimi: UPT dhe grupi i auditimit të KLSH

Shpenzimet dhe të ardhurat e vitit 2020 sipas realizimeve përkatëse treguesit e këtij buxheti janë më poshtë:

Tabela 12.3 Plan- Realizim i përdorimit të fondeve për vitin 2020 (mijë/lekë)

Nr	Emërtimi	Fonde nga granti (MASR, AKKSHI)		Fonde nga të ardhurat		Detyrime nga vitin 2020	Totali i fondeve		Në%
		Plan	Fakt	Plan	Fakt		Plan	Fakt	
	Totali	1.235.282	1.072.536	653.000	204.645	208.503	1.888.282	1.485.684	79

Të ardhurat e disponueshme janë realizuar në vlerën 360,910 mijë lekë ose 115 % të krahasuara me planin vjetor të tyre, ndërsa nga viti 2019 janë trashëguar 220.284 mijë lekë. Pjesa e papërdorur ka kaluar si të ardhura të trashëguara për vitin 2021.

Për vitin 2021 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën 2,219,833 mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Ndarë në artikuj dhe sipas realizimeve përkatëse treguesit e këtij buxheti janë në pasqyrat: “Të Ardhurat për viti 2021 - fakti”, “Realizimi i Buxhetit për vitin 2021 – Fakti”.

Tabela 12.4 Plan- Realizim i fondeve për vitin 2021 (mijë/ lekë)

Nr.	EMËRTIMI	Fonde nga Granti		Fonde nga të Ardhurat Dytësore		Detyrime nga viti 2021	Totali i Fondeve		Në %
		Plan	Fakt	Plan	Fakt		Plan	Fakt	
Totali		1,337,213	1,164,598	850,683	315,061	10,512	2,187,896	1,490,171	69

Të ardhurat e disponueshme për vitin 2021 janë realizuar në vlerën 357,154 mijë lekë ose 108 % të krahasuara me planin vjetor të tyre, ndërsa nga viti 2020 janë trashëguar 220.284 mijë lekë.

Universiteti Politeknik i Tiranës gjatë periudhës së pandemisë, si për mbrojtjen higjeno-sanitare dhe për ndryshimin e sistemit të mësimdhënies nga auditori në online për periudhën e pandemisë Mars 2020-Dhjetor 2021 ka kryer shpenzime sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 12.5 Shpenzime për materiale e shërbime Covid 19 Mars 2020 - Dhjetor 2021

Nr	Objekti i Prokurimit	Lloji i procedurës së prokurimit /Minikontratë në kuadër të marrëveshjes kuadër/Amendament kontrate për nevojat e fillim viti	Vlera e kontratës së nënshkruar (lekë)
----	----------------------	---	--

1	Blerje materiale dhe shërbim dezinfektimi për mbrojtje nga COVID - 19	Negocim pa shpallje Akti normativ nr.14, date 11.04.2020	4,939,920
2	F.V. Paisje Kompjuterike për nevoja të njesive UPT (Tabela, laptopë dhe Touch Pad)për pedagogët dhe studentët në auditor	Tender i Hapur	16,392,000
3	Printim materiale informuese për COVID - 19	Prokurim me vlerë të vogël	40,800
4	Platforme për mësimin online për konferencën në FIN	Prokurim me vlerë të vogël	240,000
5	F.V. e xhamave/ pexiglas për sekretarite në Godinat e UPT	Prokurim me vlerë të vogël	197,280
6	Blerje kamera e të tjera materiale për procesin e mësimin në distancë në UPT	Prokurim me vlerë të vogël	224,400
7	Shërbim dezinfektimi covid – 19	Pverbal emergjence (formulari standartart nr.4)	360,000
8	Blerje termometër infrared	Blerje nën vlerën 100 000 lekë	100,000
SHUMA 2020			22,494,400
1	Shërbim dezinfektimi për mbrojtje nga covid – 19, për njesitë e UPT	Kërkesë për propozim	2,028,600
2	Blerje materiale për pastrim, dezinfikim, njesive të UPT	Prokurim me vlerë të vogël	599,951
3	Blerje materiale për pastrim, dezinfikim, për njesitë e UPT	Prokurim me vlerë të vogël	353,400
SHUMA 2021			2,981,951

Burimi: UPT dhe grupi i auditimit KLSH

5. Universiteti “Ismail Qemali ”Vlorë për ushtrimin e aktivitetit për periudhën 2020-2021 institucion ka përdorur fondet publike me burim financimi si më poshtë:

Tabela 13. Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2020(mijë/lekë)

EM ËRTIMI	Vlera në vitin 2019 (/000 lekë)	Vlera në vitin 2020 (/000 lekë)	Vlera në vitin 2021 (/000 lekë)
A Shpenzime nga Buxheti	402,153	459,496	466,714
SHUMA	402,153	459,496	466,714
B Shpenzime nga të ardhurat	171,010	95,666	104,258
SHUMA B	171,010	95,666	114,199
C Garanci të vitit të trashëguara	2,770	3,496	1,235
TOTALI I SHPENZ.(A+B)	573,163	555,162	580,914

- Për vitin 2020 financimet paraqiten:

Është përdorur një buxhet total në vlerën 555,163 mijë lekë, nga plani që ka qenë në vlerën 627,684 mijë lekë ose përdorur buxheti në masë 88.4 % nga të cilat:

- a.Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferata), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie në vlerën 454,553 mijë lekë nga buxheti i planifikuar në vlerë 475,195 mijë lekë ose realizuar 95.6 % me një diferencë mosrealizimi -20,642 mijë lekë.
- b.Të ardhura të institucionit të vitit 2020 janë përdorur në vlerën 100,610 mijë lekë nga plani në fillim të vitit në vlerë 152,489 mijë lekë ose realizimi i përdorimit të ardhurave në masën 66%, nga kjo të ardhura të trashëguara nga një vit më parë 2019) vlera 98,312 mijë lekë.

- Për vitin 2021 financimet paraqiten:

Është përdorur një buxhet total në vlerën 580,914 mijë lekë, nga plani që ka qenë në vlerën 784,342 mijë lekë ose përdorur buxheti në masë 74.5 % ose pa përdorur vlera – 203,408 mijë lekë, nga të cilat:

- a.Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferata), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie në vlerën 462,757 mijë lekë nga buxheti i planifikuar në vlerë 538,323 mijë lekë ose realizuar 85 % me një diferencë mosrealizimi -75,566 mijë lekë.
- b.Të ardhura të institucionit të vitit 2020 janë përdorur në vlerën 118,157 mijë lekë nga plani në fillim të vitit në vlerë 210,730 mijë lekë ose realizimi i përdorimit të ardhurave në masën 56%, nga kjo të ardhura të trashëguara nga një vit më parë 2020) vlera 120,755 mijë lekë.

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë gjatë periudhës së pandemisë, për mbrojtjen higjeno-sanitare dhe përndryshimin e sistemit të mësimdhënies nga auditori në online për periudhën e pandemisë Mars 2020-Dhjetor 2021 ka përdorur një fond prej 2,299,882 lekë, përkatësisht:

Tabela 13.1 Pasqyra e shpenzimeve për pandeminë Viti 2020-2021

në lekë

U Shpenz. nr	Data	Vlera lekë	Përshkrimi
450	18.06.2020	115,000	Disinfektim

498	02.07.2020	75,360	Materiale për marrjen e masave ndaj Covid
568	20.07.2020	490,000	Material për pastrim disinfektim
594	03.08.2020	623,070	Pagesë trajnim Anti Covid
597	03.08.2020	78,905	Pagesë trajnim Anticovid
929	11.12.2020	101,547	Disinfektim I ambjenteve të UV
Totali viti 2020		1,483,882	
568	20.07.2021	312,000	Material për pastrim disinfektim
734	18.08.2021	240,000	Disinfektim dhe deratizim i ambjenteve të UV
883	27.10.2021	240,000	Disinfektim dhe deratizim i ambjenteve të UV
Totali viti 2021		816,000	
Totali 2020-2021		2,299,882	

Burimi: Universiteti Vlorë dhe grupi i auditimit.

2.5 PËRKUFIZIMET DHE TERMINOLOGJIA

“Akreditimi” është procesi i pavarur për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, i cili përcakton nëse institucioni i arsimit të lartë dhe/ose programet e studimit, që ai ofron, përmbushin standardet e caktuara të cilësisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

“Arsimi i lartë” është arsimimi që ofrohet pas arsimit të mesëm nga institucionet e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve të tjera nënligjore.

“Dokumenti i prioriteteve” është dokumenti që përcakton strukturën e shpenzimit të fondit publik për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në përputhje me prioritetet e vendit.

“Institucionet e arsimit të lartë” (IAL) janë personat juridikë që ofrojnë arsimim të lartë ose kualifikim profesional pas arsimit të mesëm dhe, sipas llojit të institucionit, edhe kërkim shkencor, si pjesë e sistemit të arsimit të lartë, të krijuar, dhe që ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

“Karrierë akademike” është veprimtaria mësimore dhe kërkimore-shkencore e personelit akademik të institucionit të arsimit të lartë.

“Kërkimi shkencor bazë” është veprimtaria kërkimore-shkencore, që ka për qëllim kryesor zgjerimin, thellimin, rikonceptimin dhe riintegrimin e njohurive shkencore mbi fenomenet e studiuara dhe të kuptuarit teorik të ndërveprimit midis aktorëve të ndryshëm dhe vetë procesit ku ato ndikojnë.

“Kërkimi shkencor i zbatuar” është veprimtaria kërkimore-shkencore, që ka për qëllim të gjejë zgjidhje praktike dhe specifike me objektiv kryesor shfrytëzimin e njohurive teorike, me qëllim zbatimin e tyre në praktikë.

“Kodi i cilësisë” është përmbledhje e standardeve dhe udhëzimeve për sigurimin e brendshëm e të jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë.

“Në kategorinë “Profesorë” përfshihen titujt akademikë: “Profesor”, “Profesor i asociuar”, “Profesor emeritus”, si dhe titujt “Akademik i asociuar” dhe “Akademik”, të njohura sipas kuadrit ligjor në fuqi.

“Plani buxhetor afatmesëm” është parashikimi i specifikuar i aktivitetit financiar të një institucioni të arsimit të lartë, që pritet të kryhet në një periudhë trevjeçare.

“Plani buxhetor njëvjeçar” është parashikimi i specifikuar i aktivitetit financiar të një institucioni të arsimit të lartë, që pritet të kryhet në një periudhë njëvjeçare.

“Plani strategjik i zhvillimit të institucionit” është dokumenti ku përcaktohen objektivat e institucionit të arsimit të lartë apo të njësive përbërëse të tij, si dhe mjetet e mënyrat e realizimit të tyre.

“Programi i studimit” është një tërësi veprimtarish akademike dhe/ose kërkimore shkencore, përfundimi me sukses i të cilave i jep të drejtën studentit të pajiset me një certifikatë, diplomë ose gradë shkencore prej institucionit të arsimit të lartë që e ofron atë, në varësi të llojit të programit të studimit.

“Riorganizimi i institucionit të arsimit të lartë” është ndryshimi i strukturës dhe mënyrës së funksionimit të institucionit të arsimit të lartë.

“Sigurimi i brendshëm i cilësisë” është procesi i vazhdueshëm i monitorimit, vlerësimit, garantimit, ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë në institucionet e arsimit të lartë, që zhvillohet nga vetë institucionet.

“Sistemi i studimeve me kohë të plotë” përfshin organizimin e programeve të studimit me ngarkesë akademike normale 60 kredite ECTS në një vit akademik.

“Emergjencë civile” është situata e papritur me pasoja negative për komunitetin dhe që

cenon sigurinë e tij, e cila shkaktohet nga fatkeqësitë që sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisore.

"Fatkeqësi" është ndërprerja serioze e çfarëdolloj shkalle e funksionimit të një komuniteti ose shoqërie për shkak të ngjarjeve të rrezikshme që ndërveprojnë me kushtet e ekspozimit, cenueshmërisë dhe kapacitetit përballues, duke çuar në humbje të mundshme njerëzore, materiale, ekonomike dhe mjedisore.

"Impakti i fatkeqësisë" është efekti total, duke përfshirë efektet negative (p.sh. humbjet ekonomike) dhe efektet pozitive (p.sh. fitimet ekonomike), të një ngjarjeje të rrezikshme ose të një fatkeqësie. Termi përfshin impaktet ekonomike, njerëzore e mjedisore dhe mund të përfshijë vdekje, plagosje, sëmundje e efekte të tjera negative për shëndetin fizik, mendor dhe mirëqenien sociale të njeriut.

"Ndërgjegjësimi publik" është përhapja e njohurive, në lidhje me risqet nga fatkeqësitë, e faktorëve që çojnë në fatkeqësi dhe e veprimeve që mund të ndërmerren individualisht dhe kolektivisht për të zvogëluar ekspozimin e cenueshmërinë ndaj rreziqeve.

"Rrezik" është një proces, fenomen ose aktivitet njerëzor, që mund të shkaktojë humbje të jetës, plagosje apo impakte të tjera shëndetësore, dëmtim të pronës, ndërprerje të veprimtarisë sociale dhe ekonomike ose degradim mjedisor.

"Vlerësim rreziku" kuptohet analiza sasiore e cilësore e natyrës dhe e rrethanave të tjera për ndodhinë e pritshme nga fatkeqësia natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.

"Sistemi i monitorimit dhe i njoftimit" është sistem i veçantë që parashikon dhe monitoron dukuri të ndryshme natyrore dhe të veprimtarisë njerëzore, i cili krijon kushte për një komunikim të shpejtë me strukturat përkatëse dhe komunitetin, lidhur me kërcënimin e afërt nga një rrezik i evidentuar, që në përgjithësi përmban dhe elementet e këshillave për veprimet në vijim.

"Emergjencë civile" kuptohet një situatë e shkaktuar nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, veprime terroriste, veprime ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin.

"Emergjencë civile kombëtare" kuptohet një situatë kritike urgjente e një natyre të përkohshme, që dëmton seriozisht jetën, shëndetin dhe sigurinë e shtetasve të Republikës së Shqipërisë, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, në një masë e natyrë të tillë që kalon mundësinë ose autoritetin e organeve të qeverisjes vendore për ta përballuar atë, ose kërcënon seriozisht mundësinë e Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për të ruajtur sovranitetin, sigurinë dhe integritetin territorial të vendit.

"Fatkeqësi" kuptohet një ngjarje, pasojat e së cilës janë shkaktuar nga forca natyrore të pakontrolluara ose nga arsye të tjera të parashikuara në këtë ligj, të cilat kërcënojnë ose dëmtojnë jetën dhe shëndetin e popullatës, të gjësë së gjallë, pasurinë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, në një masë të tillë, që kërkojnë marrjen e masave të veçanta dhe përdorimin e burimeve të veçanta njerëzore e materiale-teknike.

"Fatkeqësi natyrore" kuptohen tërmetet, përmbytjet, thatësira atmosferike të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta, zjarret në pyje dhe në mjediset e banuara, sëmundjet infektive masive, pasojat e të cilave prekin popullatën, gjënë e gjallë, pronën, mjedisin, si dhe ngjarje të tjera të shkaktuara nga dukuri natyrore.

"Masa mbrojtëse" kuptohen masat organizative, teknike dhe çdo masë tjetër për mbrojtjen e menjëhershme individuale dhe kolektive të njerëzve, gjësë së gjallë, pasurisë, institucioneve, trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, kundër pasojave të fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera.

"Parandalim" kuptohet një kuadër masash që merren para ndodhjes së një ngjarjeje për shmangien ose për zvogëlimin e dëmeve që mund të vijnë nga ngjarja.

"Planëzim e përballim të emergjencave civile" kuptohet përgatitja e autoriteteve publike, e institucioneve dhe organeve të qeverisjes qendrore e vendore, e personave juridikë, publikë ose privatë, e organizatave publike dhe e popullatës për një emergjencë civile, si dhe për rastet e një fatkeqësie natyrore, duke përcaktuar marrjen e masave për parandalimin dhe për

riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga veprimi i rrethanave emergjente. "Shërbim të emergjencave civile" kuptohet shërbimi i bashkërenduar i Policisë së Shtetit dhe të gjitha policive të tjera, shërbimi i shpëtimit dhe i mbrojtjes nga zjarri dhe i urgjencës mjekësore.

2.6 SKEMA E ANALIZËS SË PROGRAMIT

Në këtë auditim do të përqendrohemi në analizën e efektivitetit të veprimtarisë së institucioneve të Arsimit të Lartë subjekt auditimi dhe politikave që synojnë në mirëmenaxhimin e tyre në situata pandemie e fatkeqësish natyrore dhe rritjen e shërbimit të mësimdhënies dhe shërbimeve të tjera për studentët dhe krijimin e kushteve optimale e të shëndetshme të stafit akademik dhe administrativ. Periudha kryesore objekt auditimi do të jetë Mars 2019 – Dhjetor 2021. Fokusi i auditimit krahas shqyrtimit në tërësi të zbatimit të politikave qeveritare lidhur me efektivitetin e menaxhimit të IAL-ve dhe përdorimin e fondeve publike në situatë pandemie, do të jetë veçanërisht në masat e marra në kuadrin ligjor dhe ekonomik, ashtu dhe në politikat dhe aktivitetet e ndjekura nga institucionet përgjegjëse në menaxhimin me efektivitet të IAL-ve, përdorimit të fondeve publike. Realizimi i misionit dhe objektivave të tyre (specifikisht sipas universiteteve dhe vendimarrjeve të Bordeve të Administrimit dhe Senateve) në situatën pandemike Covid 19 në periudhën objekt auditimi.

Skema 3: Analiza e Programit

NEVOJAT

- Dokumente politike dhe administartive (Vendimet e BDA dhe Senatit)
- Burime njerëzore
- Infrastruktura e nevojshme
- Procesi i mësimdhënies dhe kërkimi shkencor
- Mjetet e komunikimit për informimin publik dhe transparencë.
- Grupet e interesit brenda IAL-ve dhe jashtë OJQ

OBJEKTIVAT

- Intensifikimi i procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar për Arsimin e Lartë me atë të BE-së si vend kandidat.
- Krijimi, zhvillimi, mbrojtja dhe transmetimi i njohurive.
- Pergatitja e studenteve për studime të mëtejshme – Mundësia për gjithëpërfshirje.
- Koordinimi dhe bashkëpunimi për të përmirësuar, ndarjen e përgjegjësisë lidhur me masat paraprake që duhet të merren për përballimin e fatkeqësive globale, kombëtare e vendore.
- Plotësimi, përafrimi dhe zbatimi i standardeve bashkëhore të mësimdhënies në auditore dhe online të studentëve dhe personelit akademik për një cilësi sa më të lartë konkurruese në tregun e sotëm dhe zhvillimin e kërkimit shkencor në përshtatje me kërkesat e tregut dhe strategjisë së zhvillimit të vendit.
- Stafet akademike të IAL-ve të punojnë për një sistem të njësuar dhe të standardizuar të arsimit të lartë në Shqipëri, ku të krijohen mundësitë për një arsim të lartë, të bashkëmatshëm dhe konkurrues me “tregjet” rajonale dhe ato evropiane.

INPUTET

- Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”;
- Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022;
- VKM Nr.243,datë 24.03.2020 “ Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”;
- VKM Nr.709,datë 29.10.2014, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për periudhën 2014-2020”;
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026 Tiranë, tetor 2021;-VKM Nr. 989, datë 9.12.2015 “Për organizimin, funksionimin, kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë dhe shpërblimin e anëtarëve të këshillit të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”.
- VKM Nr. 66, datë 03.02.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”.

PROCESI

- Zbatimi i kuadrit rregullator të IAL-ve dhe autonomia financiare.
- Zbatimi i standardeve të mësimdhënies në kushtet e pandemisë dhe ato normale
- Mbrojtja e shëndetit të studentëve dhe stafit akademik.
- Trajnim i stafit administrativ dhe atij akademik për menaxhimin sa më efikas të situatave pandemike dhe fatkeqësive të natyrës.
- Masa mbi rritjen e ndërgjegjësimit dhe krijimi i burimeve financiare për situatat e fatkeqësive.
- Fondet publike të përdorura për mbrojtjen e shëndetit të studentëve dhe stafit akademik nga buxheti i shtetit (grantet) dhe përdorimi i të ardhurave të veta.

REZULTATET

- Qasje më të integruar në menaxhimin e situatave pandemike dhe fatkeqësive të tjera natyrore, etj., sigurimi i një infrastrukture sa më efektive e gjithëpërfshirëse tek studentët dhe stafet akademike. Krijimi i kushteve sa më optimale të mësimdhënies në auditor apo jashtë saj, nëpërmjet koordinimit të përmirësuar të ministrisë përgjegjëse dhe gjithë aktorëve përkatës pranë IAL-ve, për të rritur cilësinë kushteve të studentëve në auditore dhe impaktit të lartë social tek qytetarët.
- Rritja e rolit të institucioneve në menaxhimin e IAL-ve dhe cilësisë së mësimdhënies e produktit universitar, kërkimit shkencor në kushte fatkeqësish dhe ato normale.

OUTPUTET

- Studime dhe analiza mbi masat e marra dhe përvoja e krijuar në situatën pandemike Covid 19
- Rritja e kapaciteteve menaxhuese nëpërmjet trajnimeve dhe krijimi i burimeve financiare të nevojshme për situatat e fatkeqësive.
- Bashkëpunimi me grupet e interesit dhe implementimi i propozimeve që kanë si në drejtim të masave të marra, por dhe në rritjen e të ardhurave nga biznesi në projekte kërkimore shkencore.
- Bashkëveprim ndër-institucional.
- Komunikim, publikim, transparencë dhe ndërgjegjësim qytetar.

2.7 FEEDBACK-U I SUBJEKTIT NË FAZËN STUDIMORE

Sa i përket, bashkëpunimit të subjekteve në auditim me grupin e auditimit për vënien në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm për fazën studimore, ka rezultuar se nga të gjitha subjektet: Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT), Universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit (UE), Universiteti “Ismael Qemali”, i Vlorës (UNIVLORA). Universiteti “Eqerem Çabej”, i Gjirokastrës (UGJ), Universiteti “Fan S. Noli”, i Korçës (UNIKO), ka patur bashkëpunim korrekt me dhënien e dokumentacionit të kërkuar, duke iu përgjigjur në kohë nevojave të punës së grupit të auditimit.

3. DETAJET E AUDITIMIT

3.1 VLERËSIMI I RISQVEVE TË AKTIVITETEVE TË SUBJEKTIT

Nëpërmjet evidentimit të pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve subjekt auditimi, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, “brenda kontrollit menaxherial” dhe “jashtë kontrollit menaxherial”. Këto risqe janë analizuar, evidentuar dhe klasifikuar sipas analizës S ËOT, në faktorë të brendshëm (pikat e forta dhe të dobëta) dhe faktorë të jashtëm (mundësitë dhe kërcënimet). Në vijim është bërë edhe kategorizimi i risqeve në strategjik, financiar, juridik dhe operacional, për të adresuar përgjegjësitë vendim-marrëse, të “inputit”, “procesit” apo “outputit”, etj.

-Shqipëria është vend kandidat për anëtarësimin në BE.

-Politikat e qeverisë në mbështetjen e Arsimit të Lartë.

-Donacione nga BE dhe subjekte private.

-Parashikueshmëria e rrezikut shëndetësor dhe pasojave në sistemin mësimor universitar.

-Rrjeti i marrëdhënieve dhe i komunikimeve ndërmjet institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.

-Sistemi i Arsimit të Lartë dhe ai shëndetësor, në përmirësim gradual.

-Shtrirja në territor e rrjetit informatik.

-Ndërgjegjësimi i opinionit publik dhe i institucioneve politikbërëse mbi problemet e shkaktuara nga pandemia në sistemin arsimor të lartë.

-Rrezikshmëria dhe agresiviteti i përhapjes të pandemisë COVID-19 dhe mungesa e informacionit.

-Kuahër ligjor i papërshtatshëm për mundësimin e mësimit online dhe financimin në kushte pandemie, pas miratimit të Ligjit “Për Arsimin e Lartë”.

-Kuahër rregullator jo i plotë për mungesë të një strategjie kombëtare për menaxhimin e gjendjeve të pandemisë në sistemin e arsimit të lartë.

-Koordinim jo i mirë ndërinstitucional, ndërmjet MSHMS, MASR dhe IAL.

-Mungesa e kapaciteteve profesionale, infrastrukturës dhe logjistikës së nevojshme.

-Mungesa e kordinimit për unifikimin në përdorimin e platformave elektronike dhe përzgjedhje e tyre jo në përputhje me nevojat e mësimdhënies dhe gjenerimit të statistikave dhe vlerësimeve.

-Alokim i pamjaftueshëm fondesh dhe mungesë financimi nga shteti për situatën e fatkeqësisë.

-Ngrirja e menjëhershme e marrëdhënieve me institucionet ku zhvillohen një pjesë e praktikave mësimore dhe mungesa

S W
O T

-Kërkime dhe studime mbi aktivitetin e universitetit kushte pandemie, përvoja e vendeve të tjera.

-Përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të Arsimit të Lartë dhe i ndërveprimit me institucionet shëndetësore.

-Strategji dhe plane masash (veprimi) të unifikuara për zhvillim e aktiviteteve mesimore në kushte pandemie.

-Përvoja e maturuar nga IAL – et.

-Rritja e mëtejshme e vetëdijes kolektive mbi bashkëjetesën, “arsimim dhe pandemi”.

-Mosnjohja e rrethanave që shkaktojnë pandemi dhe situata të fatkeqësive.

-Gjendja ekonomike e përgjithëshme dhe studentëve në nevojë.

-Përkimi i pandemive me situata të tjera paralele emergjence dhe impakti i gërshetuar në jetën social ekonomike të vendit.

-Rreziku i lartë i korrupsionit në të gjitha nivelet në situata të jashtëzakonshme.

-Klima politike e trazuar dhe ndërhyrja e saj në aktivitetin

Tabela: Kategorizimi i Riskut strategjik, financiar, juridik, operacional

1	Mungesa e parashikimit, agresiviteti i përhapjes të pandemisë COVID-19 dhe mungesa e informacionit.	Risk Strategjik	Lartë
2	Kuadër ligjor i papërshtatshëm për mundësimin e mësimit online, pas miratimit të Ligjit “Për Arsimin e Lartë”.	Risk Juridik	Lartë
3	Kuadër rregullator jo i plotë për mungesë të një strategjie kombëtare për menaxhimin e gjendjeve të pandemisë e fatkeqësisë në sistemin e arsimit të lartë.	Risk Juridik	Mesëm
4	Koordinim jo i mirë ndërinstitutional, ndërmjet MSHMS, MASR dhe IAL.	Risk Operacional	Lartë
5	Mungesa e kapaciteteve profesionale, infrastrukturës dhe logjistikës së nevojshme në kushtet e reja.	Risk Operacional	Lartë
6	Mungesa e familjaritetit dhe unifikimit në përdorimin e platformave elektronike, përzgjedhje e tyre jo në përputhje me kërkesat e mësimdhënies dhe gjenerimit të statistikave dhe vlerësimeve të përfitimit të dijeve në IAL-e.	Risk Operacional	Lartë
7	Alokimi i pamjaftueshëm fondesh dhe mos pasje burime të reja financiare.	Risk Financiar	Lartë
8	Ngrirja e menjëhëshme e marrëdhënieve me institucionet ku zhvillohen një pjesë e praktikave mësimore dhe mungesa e zgjidhjeve alternative në kushte fatkeqësie.	Risk Operacional	Mesëm
9	Kapacitetet hapësinore të pamjaftueshme për zhvillimin e aktivitetit mësimor dhe mungesa e pajisjeve të istaluara.	Risk Operacional	Mesëm
10	Mungesa lehtësirash për studentët me shërbime plotësuese, në mungesë të mësimave në auditore.	Risk Financiar & Risk Operacional	Mesëm


Burimi: Përpunoi grupi i auditimit

3.2 OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

Auditimi me temë “*Performanca e Universiteteve Publike gjatë periudhës së pandemisë*” ka për qëllim analizën e efektivitetit të institucioneve subjekt auditimi, përgjegjëse për menaxhimin e arsimit të lartë, me synim garantimin e vijimit me cilësi të procesit mësimor, kërkimor dhe shkencor në gjendjen e pandemisë, duke siguruar edhe kushte sigurie shëndetësore për trupën e studentëve, pedagogëve dhe kërkuesve shkencorë.

Ky auditim synon të vlerësojë dhe ofrojë një tablo të qartë mbi cilësinë dhe sigurinë e sistemit.

3.3 PYETJET E AUDITIMIT



Punoi: Grupi i auditimit të KLSH

3.4 FUSHËVEPRIMI I AUDITIMIT

Fushëveprimi i auditimit lidhur me efektivitetin e masave të marra nga universitetet publike gjatë periudhës së pandemisë për periudhën Janar 2020 – Dhjetor 2021 u konsiderua e nevojshme për të gjykuar mbi funksionalitetin e zinxhirit të aktiviteteve dhe masave të marra nga institucionet përgjegjëse. Subjektet kryesore të cilat u përfshinë në këtë auditim janë: MASR Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT), Universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit (UE), Universiteti “Ismail Qemali”, i Vlorës (UV), Universiteti “Eqerem Çabej”, i Gjirokastrës (UGJ), Universiteti “Fan S. Noli”, i Korçës (UNIKO). Përcaktimi i fushëveprimit të auditimit, është vendosur bazuar në intervistat dhe pyetësorët e kryer me përfaqësuesit e subjekteve në auditim, gjatë fazës studimore.

4. SHTJELLIMI I PYETJEVE DHE NËNPYETJEVE

A kanë rezultuar efektive politikat dhe masat e marra për menaxhimin e situatës pandemike Covid 19 për mësimdhënie dhe kërkim shkencor, mbrojtjen e shëndetit të studentëve dhe stafit akademik për periudhën 2020-2021?

Mesazhi i auditimit

Institucionet e arsimit të lartë (IAL) për t’iu përgjigjur situatës së krijuar nga pandemia Covid 19 dhe pamundësisë së krijuar nga zbatimi i kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 për përjashtimin e formës së studimeve në distancë, u ballafaquan me nevojën për përdorimin efektiv të platformave elektronike dhe familjarizimin e thelluar me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), me qëllim realizimin me sukses dhe pa pengesa të proceseve mësimore on-line. Mospërdorimi i mëparshëm i kësaj forme studimi në distancë, e ka vendosur arsimin tonë të lartë jo në linjë me standartet mësimore ndërkombëtare të e-learning. Mungesa e këshillave studentorë në ndonjë IAL, apo pasiviteti i tyre në IAL-et e tjerë, i la studentët pa një përfaqësim të zëshëm të shqetësimeve dhe problemeve me të cilat ata u ndeshën gjatë pandemisë.

Procesi mësimor on-line shfaqti mangësi në drejtim të pamundësisë për t’u monitoruar dhe si pasojë për t’u matur saktësisht edhe cilësia e tij. Në asnjë rast nuk u hartua dhe miratua rrjedha e dokumentuar e aktiviteteve nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to, sa i takon procesit mësimor on-line. Konkretisht, monitorimi i oreve të mësimi, u bazua **tek vetëdeklarimi** i secilit pedagog pas zhvillimit të procesit mësimor. Mungesa e gjurmëve të auditimit për zhvillimin e procesit mësimor on-line, nuk arriti të sigurojë dokumentimin e plotë të operacioneve në formë të tillë që t’u mundësonte audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptonin mjedisin e kontrollit në universitete. Për përzgjedhjen e platformës on-line, nuk u bë asnjë analizë nevojash që të niste nga departamentet respektive, në lidhje me kapacitetet që duhet të kishin klasat virtuale; nevojës ose jo për punë laboratorike; volumit të detyrave, etj. Si pasojë e sa më sipër, rezultoi se universitetet aplikuan disa platforma (shpesh të perzgjedhura individualisht nga pedagogët) si Google-classroom, Teams dhe Zoom, të cilat nisur edhe nga përgjigjet e pyetësorëve paraqitën vazhdimisht problematika teknike.

Universitetet nuk arritën të prioritarizonin buxhetet në funksion të orientimit të fondeve karshi nevojave që diktoi pandemia, duke bërë që rreth 20-30% e fondeve buxhetore të tyre, të “digjeshin” dhe të mos përdorreshin.

4.1. A KA QENË I PLOTË DHE EFEKTIV KUADRI RREGULLATOR PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS SË KRIJUAR PREJ PANDEMISË COVID 19?

4.1.1. A janë zbatuar politikat, aktet ligjore dhe nënligjore të dala, si dhe udhëzimet e Komitetit të ekspertëve?

Sikurse të gjithë sektorët e jetës në vendin tonë, edhe Arsimi i Lartë ndjeu nga afër trazimin e krijuar nga situata e pandemisë të shkaktuar nga Covid 19. Ballafaqimi me këtë situatë të pazakontë, krijoi probleme jo të vogla lidhur me përshtatjen e nevojave didaktiko – mësimore të studentëve dhe stafit

akademik, si dhe ato të kërkimit shkencor për studjuesit, duke patur parasysh se këto aktivitete duheshin zhvilluar në kushte sigurie shëndetësore sipas rregullave të vendosura nga Komiteti i Ekspertëve pranë MSHMS dhe me ekspozim sa më të ulët, ndaj rrezikut të infektimit.

Në datën 9 Mars 2020 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë(MASR), nisur nga situata e krijuar nga pandemia Covid 19, si në vijim të Urdhërit të MSHMS - së nr. 135, datë 09.03.2020, nxori Urdhërin nr. 91 “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jo publike”. Në këtë dokument urdhërohej: “Mbyllja e institucioneve arsimore publike dhe jopublike për një periudhë dyjavore nga hyrja në fuqi e urdhërit”⁹.

Menjëherë pas këtij Urdhëri, universitetet ndërprenë procesin mësimor. Ndërpreja e procesit mësimor u shoqërua me sfida të shumta të aplikimit të mësimin alternativ online. Por kjo lloj qasjeje i gjeti institucionet e arsimit të lartë dhe familjet shqiptare të papërgatitura sa i përket efektivitetit dhe cilësisë së shërbimeve që ofrojnë IAL – et publike.

Pak ditë pas daljes të Aktit Normativ Nr. 3, datë 15.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, me e miratimin e VKM - së Nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Arsimi i Lartë u fut në një regjim administrimi të jashtëzakonshëm, prej situatës së krijuar. Kushtet e reja diktonin që: “Institucionet publike:

- të realizojnë plane masash organizative dhe administrative për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore;
- të përdorin burimet financiare të parashikuara në buxhetin vjetor, si dhe të rivlerësojnë buxhetin e tyre vjetor, në përputhje me kryerjen e shpenzimeve shtesë të parashikuara;
- të vënë në dispozicion burimet njerëzore e logjistike;
- të kufizojnë aksesin në ambiente publike, të cilat kanë një frekuentim të gjerë;
- të ndalojnë tubimet, manifestimet dhe grevat;
- të kufizojnë aktivitetet në minimumin e domosdoshëm për të gjitha organet publike;
- të vendosin në karantinë të gjithë personat e konfirmuar ose të dyshuar se janë të prekur nga COVID-19”¹⁰.

Shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore me këtë VKM, u bë në zbatim të parashikimeve të germës ç, të nenit 18: “*Këshilli i Ministrave miraton dhe siguron zbatimin e politikave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në Republikën e Shqipërisë dhe ka këto përgjegjësi: mund të vendosë për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e vendit*”; të pikës 1, të nenit 19: “Për çdo rast të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, sipas këtij ligji, Këshilli i Ministrave krijon Komitetin Ndërmintor të Emergjencave Civile (KNEC) dhe cakton kryetarin, i cili mund të jetë Kryeministri, Zëvendëskryeministri ose një ministër, në varësi të llojit të fatkeqësisë. ”; dhe të pikës 1, të nenit 39: “*Këshilli i Ministrave mund të vendosë, për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë, gjendjen e fatkeqësisë natyrore në një pjesë ose në të gjithë territorin e vendit*”, të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, meqë “Fatkeqësi natyrore” janë fatkeqësitë që shkaktohen....., nga sëmundjet infektive massive....”¹¹.

Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” inkuadron në përmbajtjen e tij koncepte moderne, gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me terminologjinë evropiane e botërore, duke synuar zbatimin më efektiv të masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, ndaj dhe me qëllim marrjen edhe të një shembulli të një ligji të ngjashëm të një vendi anëtar të BE-së, por edhe me karakteristika të ngjashme me Shqipërinë, është shfrytëzuar ligji slloven “Mbi mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera” .

Sa i përket, parashikimeve të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, të cilat janë të shumta, sikurse rezultoi nga auditimi, një pjesë e tyre rezultoi e papërmbyshur “ante factum”(para faktit) në raport me situatën e fatkeqësisë natyrore të shpallur, duke e vënë aktivitetin e IAL – ve në vështirësi.

Miratimi i Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, duke patur si qëllim të vetin zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe realizimin e mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile, synon të sigurojë përshtatjen e sistemit të mbrojtjes civile me

⁹ Urdhëri i MASR nr. 91 “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jo publike”, pika 1.

¹⁰ VKM Nr.243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, neni 6.1, geramat: a, b, c, d, dh, e, ë.

¹¹ Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 3, pika 9.

standardet evropiane¹², në përputhje edhe me prioritetet e kuadrit “Sendai” (*Sendai Framework for Disaster Risk Reduction (2015-2030)*)¹³.

Ky akt i miratuar nga shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara më 15 mars 2015 gjatë “Konferencës Botërore për zvogëlimin e reziqeve nga fatkeqësitë” i mbajtur në Sendai të Japonisë dhe i aprovuar nga Asambleja e Përgjithëshme e Kombeve të Bashkuara në qershor 2015, parashikonte në njërin nga shtatë objektivat (objektivi i pestë) e vet global: “*Të rritet ndjeshëm numri i vendeve me strategji për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë kombëtare dhe lokale brenda 2020*”. Ndaj, objektivi i këtij ligji mbetet integrimi i prioritetëve, i qëllimeve dhe i objektivave të kuadrit “Sendai” për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive, në politikat e qeverisjes në të gjitha nivelet, veçanërisht nëpërmjet hartimit dhe implementimit të Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, vlerësimeve të riskut nga fatkeqësitë dhe planeve të emergjencave civile në nivel qendror, në të gjitha nivelet, si dhe masave të tjera.

Referuar Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, datë 18.07.2019, neni 10, pika 1, nga po i njëjti ligj sanksionohet se ky miratim, duhet të bëhet brenda 2 viteve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Gjetje nga auditimi:

1. Nga verifikimi i dokumentave dhe akteve, lidhur me politikat në fushën e mbrojtjes civile dhe zbatimin e tyre, u konstatua se *nuk është miratuar një Strategji Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, në shkellje të nenit 10, pika 1, i cili përcakton se: “Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë është dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë që përcakton politikat e aktiviteteve të institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit”* edhe pse është në zbatim Ligji Nr. 45/2019.

Mungesa e strategjisë është në kundërshtim me objektivin e pestë të kuadrit SENDAI¹⁴ të reduktimit të riskut të fatkeqësive: “Rritja në mënyrë thelbësore e numrit të vendeve me strategji të reduktimit të riskut kombëtar dhe lokal të fatkeqësive deri në vitin 2020”.

Mungesa e strategjisë evidentohet si një mangësi në gjetjet e njëpasnjëshme të raporteve të progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, përfshirë edhe raportin e progresit të fundit për vitin 2018¹⁵. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion prej MAS, rezulton se në PPAP (planifikimi i proceseve të aktiviteteve të programuar) 2022 të Ministrisë së Mbrojtjes, është parashikuar miratimi i Strategjisë, në katërmujorin III të vitit 2022. Bazuar në Urdhrin të Kryeministrit nr. 57, datë 29.06.2021 (nr. prot. 3664, datë 29.06.2021, protokoll të Ministrisë) “Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për përgatitjen e projektit të Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë”, ka filluar puna për hartimin e saj dhe referuar pikës 2, germa dh, të njëjtut urdhër, anëtar i Grupit Ndërinstitucional të punës, në përfaqësim të MASR, është Zëvendësministri i këtij dikasteri.

2. Po ashtu, u konstatua se edhe pse është në zbatim Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, datë 18.07.2019, nuk është miratuar ende një Plan Kombëtar për Emergjencat Civile. Duke qenë se Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 14, pika 4, parashikon se: “Plani Kombëtar për Emergjencat Civile miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit”¹⁶, atëherë shtrohet nevoja përgatitjes dhe miratimit të tij, sapo të jetë miratuar Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.

3. Konstatohet se MAS, në zbatim të Ligjit Nr. 8756, datë 26.03.2001, ka miratuar më datë 08.08.2019, me nr. 7856 prot., “Rregulloren për parandalimin e gjendjes së fatkeqësive natyrore, ose të fatkeqësive të tjera dhe masat e jashtëzakonshme”¹⁷. Kjo ministri, ka detyrim, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, datë 18.07.2019, neni 22, pika 2, germa a, të hartojë, miratojë dhe përditësojë planin për emergjencat civile, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore dhe ta dërgojë atë në

¹² <https://parlament.al/Files/ProjektLigje/20190610101549RELACION%20%20MBROJTA%20CIVILE.pdf>

¹³ https://it.wikipedia.org/wiki/Quadro_di_riferimento_di_Sendai_per_la_riduzione_del_rischio_di_disastri#cite_note-unisdr1-5

¹⁴ Sendai është një qytet prej një million banorësh në Japoni, ku më 15 mars 2015, shtetet anëtare të OKB - së u mbledhën në Konferencën Botërore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, ku u miratua dokumenti i njohur si Kuadri i Sendait, më pas i aprovuar nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara në qershor 2015

¹⁵ <https://parlament.al/Files/ProjektLigje/20190610101549RELACION%20%20MBROJTA%20CIVILE.pdf>

¹⁶ Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 14, pika 4.

¹⁷ Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 22, paragrafi 1 dhe 2, germa a. dhe b.

Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllime analize dhe planifikimi, ndërkohë që akoma nuk e ka miratuara një dokument të tillë, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, datë 18.07.2019.

Konkluzione:

1. Mungesa e miratimit të Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, i cili është dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë, ka penguar përgatitjen e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile. Përgatitja dhe miratimi i Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, është parakusht për përgatitjen dhe miratimin e planeve të veprimit ante factum, të cilat do mund të përgatiteshin nga subjektet, që para shfaqjes së situatës së fatkeqësisë natyrore, sikurse ishte dhe pandemia e shkaktuar nga Covid 19, duke i gjetur për pasojë Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve dhe IAL-et të papërgatitur me rrethanat e krijuara. Ndërvlerësitë e përgatitjes dhe miratimit të këtyre dokumenteve, kanë prodhuar një efekt domino, ku mosmiratimi i Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë ka penguar përgatitjet dhe miratimet e dokumenteve në nivele të tjera.

Rekomandime:

1. Ministria e Arsimit dhe Sporteve nëpërmjet përfaqësuesit të saj, të kontribojë pranë Grupit Ndërinstitucional dhe Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës për përgatitjen e projektit të Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimin të Riskut nga Fatkeqësitë, duke pasuruar me përvojat dhe nevojat e shfaqura edhe gjatë periudhës së pandemisë nga Covid 19 në IAL – e përmbajtjen e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Të sensibilizojë të gjithë mekanizmat politikëbërës dhe vendimarrës për miratimin sa më të shpejtë të saj. Ministria e Arsimit dhe Sporteve pas miratimit të Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, të përgatisë dhe ndjekë miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.

Menjëherë e në vijimësi

2. Ministria e Arsimit dhe Sporteve të miratojë dhe përditësojë planin për emergjencat civile, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore të ngarkuar, sapo të jenë miratuar Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Planit Kombëtar për Emergjencat Civile.

Në vijimësi

Sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit dërguar me shkresën nr. 103/13 prot., datë 30.06.2022 të KLSH dhe protokolluar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), me shkresën nr. 2079/1 prot., datë 04.07.2022 nga subjekti i audituar MAS është paraqitur nëpërmjet e-mailit të datës 01.08.2022 dhe shkresë nr. 2079/3 prot., datë 01.08.2022 të MAS dhe protokolluar në KLSH me nr.103/18 prot., datë 03.08.2022, observacioni sa më poshtë:

“Me vendimin nr. 923, datë 25.11.2020 të Këshillit të Ministrave “Për funksionimin e organizimit e Komitetit të Mbrojtjes Civile edhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile” është përcaktuar se Ministrinë hartojnë plane, programe e dokumente të tjera që kanë për qëllim zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sipas llojit të veprimitarisë e përgjegjësisë së tyre. Pjesë e Komitetit të Mbrojtjes Civile është edhe një përfaqësues i MAS.

Në vijim MAS ka miratuar rregulloren nr. 7856 prot., datë 8.8.2019, “Për parandalimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore ose të fatkeqësive të tjera dhe masat e jashtëzakonshme”.

Me urdhrin nr. 144, datë 16.12.2021 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit” është krijuar një strukturë e re, një sektor i veçantë për emergjencat civile me 3 punonjës (1+2).

Sektori për emergjencat civile do të ketë përgjegjësinë e hartimit, miratimit dhe përditësimit të planit për emergjencat civile”.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Me një lexim të vëmendshëm të materialit, do konstatohej lehtësisht edhe nga subjekti, se sikurse nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga MAS, duhet patur parasysh se, më datë 08.08.2019, MASR (sot MAS) ka miratuar, me nr. 7856 prot., “Rregulloren për parandalimin e gjendjes së fatkeqësive natyrore, ose të fatkeqësive të tjera dhe masat e jashtëzakonshme”, sikurse shprehet edhe në nenin 1 të saj, “duke u mbështetur në Ligjin Nr. 8756, datë 26.03.2001, “Për Emergjencat Civile”...”, duke e bazuar pra ligjshmërinë e këtij dokumenti, mbi një ligj të shfuqizuar tashmë, meqë ndërkohë më datë 18.07.2019, ishte miratuar Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, i cili në nenin 22, pika 2, germa a,

ngarkon me përgjegjësi secilën ministri, përfshirë dhe MASR (sot MAS), që të hartojë, miratojë dhe përditësojë planin për emergjencat civile, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore dhe ta dërgojë atë në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllime analize dhe planifikimi, gjë që akoma nuk është dokument të bërë nga MAS.

“Rregullorja për parandalimin e gjendjes së fatkeqësive natyrore, ose të fatkeqësive të tjera dhe masat e jashtëzakonshme”, e miratuar më datë 08.08.2019, nga MASR (sot MAS), me nr. 7856 prot., ka qenë që ditën e hyrjes së saj në fuqi, në shkelje të ligjit, referuar nenit 1 të saj.

Sa parashtruar nga MAS dhe faktet e paraqitura, nuk sjellin prova dhe fakte të reja për t’u rimarrë në konsideratë dhe për t’u ritrajtuar dhe reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Një organizëm i rëndësishëm të cilit Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” i ngarkon përgjegjësi të posaçme në administrimin e situatave të fatkeqësive dhe mbrojtjes civile, është dhe Komiteti i Mbrojtjes Civile.

- Nga auditimi i akteve, se “Komiteti i Mbrojtjes Civile si organi më i lartë, i përhershëm, përgjegjës për zbatimin e politikave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në Republikën e Shqipërisë”¹⁸, ku dhe MAS ka përfaqësuesin e vet anëtar¹⁹ i cili duhej ngritur brenda një viti nga miratimi i Ligjit Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, me Vendim të Këshillit të Ministrave, u krijua me vonesë dhe përtej afatit një vjeçar, vetëm me miratimin e VKM - së Nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimit të Komitetit të Mbrojtjes Civile edhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”, pra dhe disa muaj nga fillimi i pandemisë Covid 19. - Lidhur me detyrimin e sanksionuar nga Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 22, pika 4.i cili parashikon: “Çdo ministri ka pozicione pune deri në nivel sektori për mbrojtjen civile, përbërja dhe detyrat e të cilëve miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.”²⁰, konstatohet se MAS deri në muajin dhjetor 2021, nuk ka patur të miratuar në strukturën e vet një sektor për mbrojtjen civile, e cila duhej të përmbushej si detyrim, brenda dy viteve nga miratimi i ligjit të lartpërmendur.

Përtej afatit ligjor të parashikuar, dhe pas më shumë se një viti e gjysëm nga fillimi i pandemisë shkaktuar nga Covid 19, me daljen e Urdhërit të Kryeministrit Nr. 144, datë 16.12.2021, për “Miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, u parashikua në strukturën e re, krijimi i një sektori të veçantë për emergjencat civile me 3 punonjës (1+2), si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme.

Ballafaqimi i Arsimit të Lartë me situatën e pandemisë shkaktuar nga Covid 19, vuri në provë IAL – et dhe praktikat e ndjekura prej tyre, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Në vlerësimin e nismëtarëve të Reformës në Arsimin e Lartë, e miratuar në vitin 2015, krahasuar me ligjin e mëparshëm: “Ndryshimet e propozuara (ndr. në Ligjin 80/2015) u fokusuan në:

- krijimin e premisave për një arsim të lartë që t’u përgjigjet nevojave të tregut të punës si dhe drejtimeve të zhvillimit strategjik të vendit;
- unifikimin dhe standardizimin e sistemit të arsimit të lartë në vend, si një prej qëllimeve më afatgjata;
- krijimin e bazave financiare të qëndrueshme, për t’i bërë ballë ndryshimeve dhe cikleve ekonomike;
- krijimin e mekanizmave të qëndrueshme të kontrollit, brenda IAL-ve dhe atyre të jashtëm, në mënyrë që të sigurohen standarde evropiane për sistemin e arsimit të lartë”²¹.

Ligji Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që i paraprinte ligjit aktual (Ligji 80/2015), lidhur me format e studimeve parashikonte;

“1. Format e studimeve në institucionet e arsimit të lartë janë:

1. studime me kohë të plotë;
2. studime me kohë të pjesshme;
3. studime në distancë.

¹⁸ Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 20, pika 1.

¹⁹ Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 16, germa f.

²⁰ Ligji Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 22, pika 4.

²¹ https://parlament.al/Files/ProjektLigje/relacion_arsimi_i_larte_21943_1.pdf

2. Aplikimi dhe zbatimi i çdonjërës nga format e studimit, të parashikuara në këtë nen, bëhet me miratim të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës”²².

Me hyrjen në fuqi të Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, krahasuar me ligjin pararendës, format e studimeve, që ishin që më parë ishin tre, tani reduktohen në vetëm dy:

“Format e studimeve dhe pranimi në institucionet e arsimit të lartë

1. Në institucionet e arsimit të lartë janë:

a) studime me kohë të plotë;

b) studime me kohë të zgjatur”²³.

Ky reduktim i formave të studimit me miratimin e Reformës në Arsimin e Lartë dhe listimi i këtyre formave, në mënyrë të tillë që nuk lë hapësirë për një interpretim fleksibël të ligjit, nuk u ka dhënë IAL–ve mundësi që të zhvillojnë sipas vlerësimit të tyre, procese mësimdhënieje online. Me njohjen taksative dhe listimin hermetik të vetëm dy formave të studimeve: studime me kohë të plotë dhe studime me kohë të zgjatur, lirisë akademike i viheshin kufinj të qartë.

Meqë Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” sanksionon se: “Institucionet e arsimit të lartë gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit, në përputhje me legjislacionin në fuqi”²⁴ dhe se: “*Liria akademike garantohej nëpërmjet së drejtës: për të organizuar veprimtaritë e mësim-dhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese*”²⁵, qartësisht kuptohet se kësaj lirie akademike të ripohuar nga ky ligj, po i njëjti ligj i vendos kufinj me format e studimeve, që nuk mund t’u linin hapësirë IAL – ve të praktikonin nga viti i 2015, e më pas, procese mësimdhënieje nëpërmjet platformave online.

Kjo tkurrje e formave të studimeve në realitetin e arsimit të lartë në vendin tonë, me përjashtimin e formës së studimeve në distancë ka ndodhur, në një kohë, kur si në shumë të tjerë, edhe në një realitet universitar fqinj, si ai italian, parashikohet dhe praktikohet, si një ndër format e studimeve, ai në distancë, nëpërmjet universitetit telematik.

Sa i përket procesit të mësimdhënies “Nuk ekziston një formulë standard, përderisa çdo universitet dhe cikël studimesh, në bazë të preferencave dhe metodave të mësimdhënies së docentit, parashikon mënyra të ndryshme, të cilat gjithësesi përfshijnë videokonferenca të disponueshme në çdo moment, të cilave u shtohen materiale studimi që mund të aksesohen online dhe shkarkohen. E gjitha kjo mundëson një qasje krejtësisht ndryshe sa i takon përshkallëzimit të procesit të mësimi, meqë lë hapësirë për regjistrimin e studentëve në çdo moment të vitit, pa lindur nevoja që të ndiqet ngurtësisht kalendari akademik i universiteteve fizike”²⁶.

Kemi kërkuar një përkufizim të asaj se ç’është forma e studimeve në distancë, por ligji i mëparshëm Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk e parashikonte një përkufizim të tillë.

Ndërkaq nga sa cituar pak më lart, sa i përket procesit të mësimdhënies të formës së studimit në distancë, e ligjëruar në arsimin e lartë italian, nëpërmjet universiteteve telematike, esenciale mbeten për këtë qasje: “videokonferenca të disponueshme në çdo moment, të cilave u shtohen materiale studimi që mund të aksesohen online dhe të shkarkohen”²⁷.

Po të vizitojmë faqen e Universitetit Telematik IUL (Italian University Line), sa i përket formave të mësimi dhe zhvillimit të provimeve thuhet: “*Aktivitetet didaktike të Universitetit Telematik IUL, përfitojnë ekskluzivisht online dhe bazohen në një model formativ të zhvilluar mbi përvojat e panoramës evropiane të e – learning evropian*. Figura çelës janë tutorët që zhvillojnë një detyrë operative në administrimin e laboratorëve dhe të aktiviteteve në sinkron, sikurse dhe mbështetjeje të moduleve disiplinorë. Për çdo lëndë parashikohet një provim përfundimtar, në prani ose nëpërmjet videokonferencës, në një prej selive të Universitetit”²⁸.

Të tillë universitete telematike të liçencuar nga MIUR - Ministria e Arsimit, Universitetit dhe Kërkimit (ndr. nërkuptohet, Kërkimit Shkencor), arsimi i lartë italian ka 11, si më poshtë paraqitur në tabelën 1:

²² Ligji Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 24, pika 1, germa a), b), c) dhe pika 2.

²³ Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, pika 1, germa a) dhe b).

²⁴ Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 1.

²⁵ Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2, germa a).

²⁶ <https://www.skuola.net/orientamento-universitario/universita-telematiche-online-riconosciute-costi-opinioni.html>

²⁷ <https://www.skuola.net/orientamento-universitario/universita-telematiche-online-riconosciute-costi-opinioni.html>

²⁸ <https://unitelematiche.it/universita/iul/>

Tabela 1

	UNIVERSITETI TELEMATIK	SELIA QENDRORE	NR. I STUDENTËVE
1	"Pegaso"	Napoli	39.979
2	"Niccolò Cusano"	Roma	24.526
3	"UniNettuno"	Roma	13.664
4	"e-Campus"	Novedrate	15.697
5	"Guglielmo Marconi"	Roma	9.902
6	"San Raffaele"	Roma	5.619
7	"UNITELMA Sapienza"	Roma	2.635
8	"Giustino Fortunato"	Benevento	946
9	"Universitas Mercatorum"	Roma	3.559
10	"Leonardo da Vinci"	Torrevecchi a Teatina	87
11	"Italian University Line"	Firenze	286

Të dhëna të përpunuara nga Grupi i Autitimit mbi bazën e të dhënave, marrë në faqen²⁹, me linkun e cituar në fusnotë.

Këto 11 universitete telematike kanë me dhjetra seli filialesh të dyta, ndërkohë që Universiteti telematik "San Raffaele" selinë dytësore³⁰ në Giulianova të Abruzzo-s e çeli në periudhën e valës më agresive të pandemisë shkaktuar nga Covid 19, më datë 25 Shtator 2020.

Sikurse vënë në dukje dhe pak më sipër, kur iu referuam Universitetit Telematik IUL, sa i përket formave të mësimi dhe zhvillimit të provimeve, nënvizohej se: "Aktivitetet didaktike të Universitetit Telematik IUL, përfitohen ekskluzivisht online dhe bazohen në një model formativ të zhvilluar mbi përvojat e panoramës evropiane të e – learning evropian"³¹.

Proceset mësimore të organizuar online, duke përdorur Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK), kanë terhequr vëmendjen e politikëbërësve të arsimit evropian, për të gjitha nivelet e tij, parauniversitar dhe universitar, dhe janë bërë objekt takimesh, diskutimesh dhe rezolutash, të cilat e kanë promovuar këtë qasje të re mësimore, në përputhje me risitë dhe potencialet e TIK.

E tillë është dhe Rezoluta³² 2001/C 204/02 e miratuar nga Këshilli i Ministrave të Arsimit të vendeve anëtare të BE më 13 Korrik 2001 e quajtur ndryshe edhe *Rezoluta mbi e-learning*, që duke patur parasysht konkluzionet e Këshillit Evropian të Lisbonës³³ të 23 dhe 24 mars 2000, të cilat përcaktojnë objektivin strategjik të krijimit të një ekonomie konkurruese dhe dinamike, si dhe objektiva specifike lidhur me teknologjinë e informacionit e të komunikimit (TIK) dhe arsimin, sikurse dhe konkluzionet e Këshillit Evropian të Stokholmit³⁴, të 23 dhe 24 mars 2001, në paragrafin 9 të saj, i ftoi shtetet anëtare që të kishin parasysht, sa më poshtë:

- i.** të këmbëngulin në përpjekjet për një integrim efektiv të TIK me sistemet e arsimit dhe të formimit....;
- ii.** të shfrytëzojnë plotësisht potencialet e internetit dhe të mjediseve multimediale dhe të mësimnxënies virtuale për një realizim më të mirë dhe të shpejtë të edukimit të vazhdueshëm si parim edukativ bazë dhe për t'iu dhënë të gjithëve mundësi aksesit në arsimim dhe formim, në veçanti atyre që kanë probleme aksesit për motive sociale, ekonomike gjeografike ose të llojit tjetër;
- iii.** të promovojnë mundësitë e nevojshme për nxënien e TIK në kontekstin e sistemeve të arsimit dhe formimit duke përsheptuar integrimin e TIK me rishikimin e programeve të shkollorë dhe universitare në të gjithë sektorët përkatës....;
- iv.** të këmbëngulin në përpjekjet lidhur me formimin fillestar dhe vijues të mësimdhënësve dhe formuesve sa i përket përdorimit të TIK për qëllime pedagogjike, duke patur parasysht ekzigjencën për të zgjeruar kulturën digjitale si element esencial të kompetencave të mësimdhënësve...;
- v.** të inkurajojnë përgjigjësit e institucioneve arsimore dhe të formimit, sikurse dhe të atyre në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, si dhe të operatorëve të tjerë të interesuar, që të kuptojnë potencialet e ofruara nga TIK, për të eksploruar udhë të tjera të mësimdhënies dhe zhvillimit pedagogjik, me qëllim integrimin dhe përdorimin efikas të TIK;
- vi.** të përsheptojnë blerjen e pajisjeve dhe infrastrukturës cilësore për arsimin dhe formimin, duke patur parasysht progreset teknike, të hardëare-ve, softëare-ve dhe të aksesit në internet të institucioneve të arsimit dhe formimit, si dhe burimet njerzore përkatëse, për të siguruar shërbimet e asistencës, mbështetjes dhe mirëmbajtjes;

²⁹ https://it.wikipedia.org/wiki/Universit%C3%A0_telematica#cite_note-5

³⁰ <https://www.iltempo.it/attualita/2020/09/25/news/giulianova-universita-telematica-san-raffaele-abruzzo-palazzo-kursaal-24661892/>

³¹ <https://unitelematiche.it/universita/iul/>

³² <https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2001:204:0003:0005:EN:PDF>

³³ https://www.europarl.europa.eu/summits/lis1_en.htm

³⁴ https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/ec/00100-r1.%20ann-r1.en1.html

- vii.** të stimulojnë zhvillimin e materialeve digjitale të cilësisë të lartë për mësimdhënien dhe mësimnxënien me synim për të garantuar cilësinë e ofertave online....;
- viii.** të përfitojnë nga mundësitë që ofrojnë digjitalizimi dhe standartizimi i dokumentave, për të lehtësuar aksesin në burimet kulturore publike, si librari, muzeume, dhe arkiva, me synim që të shfrytëzohen më mirë për qëllime edukuese dhe formuese;
- ix.** të mbështesin zhvillimin dhe përshtatjen e një pedagogjije inovative e cila integron përdorimin e teknologjive në kontekstin e një sistemi të gjërë programesh.....;
- xi.** të mbështesin dhe nxisin vendet e takimeve virtuale për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacioneve, përvojave dhe praktikave të mira, duke mbajtur parasysh sistemet e reja pedagogjike dhe format e reja të bashkëpunimit mes mësimnxënësve, mësimdhënësve dhe formatorëve, për të nxitur ndërlidhjen në rrjet evropian në të gjitha nivelet në sektorëve të multimedive të arsimit...;
- xiv.** të thellojnë kërkimin në kontekstin e e – learning në veçanti për të përcaktuar se si të përmirësohen shërbimet e mësimnxënies nëpërmjet TIK, zhvillimit pedagogjik, implikimeve të mësimdhënies dhe mësimnxënies të bazuar në TIK dhe të nxisin bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë rrafsh;
- xv.** të promovojnë partneritetin ndërmjet sektorit publik dhe sektorit privat për të kontribuar në zhvillimin e e – learning...”.

U citua një pjesë e qenësishme e kësaj rezolute, meqë problemet e dala gjatë periudhës së pandemisë, lidhur me aplikimin e mësimi online dhe përdorimin e platformave elektronike janë pikërisht ato problematika, që ky dokument i para dy dekadave, i miratuar nga Ministri e Arsimit të vendeve të BE – së, i bën objekt rekomandimesh.

Pyetjes së grupit të auditimit: “A vlerësoni se këto rekomandime nëse do ishin të përthithura nga legjislacioni shqiptar do kishin krijuar kushte të një kapërcimi më të lehtë të vështirësive të ndeshura gjatë procesit mësimor dhe praktik në IAL – e, gjatë periudhës së pandemisë?”, UPT i është përgjigjur: “Sikurse është sqaruar më sipër, kjo formë studimi ka qenë aplikuar më parë në Universitetin Politeknik të Tiranës..... Pas ndërprerjes së formës së mësimi në distancë, kjo platformë (ndr. Microsoft Teams) nuk u përdor për zhvillimin e mësimi online, deri në momentin e diktimit nga gjendja e fatkeqësisë natyrore.”³⁵. Të njëjtit Pyetsor UPT, në një pyetje tjetër, i pergjigjej: “Përpara miratimit të ligjit në fuqi për arsimin e lartë, një nga format e studimit të mësimdhënies në UPT ka qenë dhe mësimi në distancë”. Problemet e ndeshura nga IAL – et në përshtatjen e tyre me proceset mësimore online, sikurse më tutje do bëhen objekt trajtimi, po i përmendim shkurtimisht duke i listuar si më poshtë:

- Integrimi jo i plotë i studentëve në orën e mësimi online, për shkak të mungesës së plotë të njohurive didaktike, që përfshijn mësimdhënia online;
- Mungesa e pajisjeve si, kompjutera, telefona etj. dhe e linjës së internet;
- Trajnimi i stafit në moshë në lidhje me përdorimin e TIK në mësimdhënie;
- Krijimi i një formati unik të regjistrimit elektronik të frekuentimit dhe vlerësimit të vazhduar të studentëve, i aksesueshëm nga stafi akademik dhe stafi vendimmarrës;
- Ndërtimi i laboratorëve virtualë, në funksion të orëve praktike të laboratorit, për disa prej profileve;
- Platformat e trajnimeve online për modulet e të nxënës gjatë gjithë jetës, si forma të edukimit të vazhduar;
- Krijimi i hapësirave të dedikuara për dhënien e leksioneve nga ana e pedagogëve;
- Mungesa e një repertori audioviziv të pasur, të realizuar para pandemisë, etj.

Fillimi i mësimi online në IAL – et shqiptare dhe masat e nevojshme për të garantuar këtë proces, nuk u shoqërua me miratimin e ndonjë akti formal nga Kuvendi, Qeveria apo MASR, por vetëm u porosit me datë 16 mars 2020, nëpërmjet një e-mail – i, me objekt: “Në lidhje me opsionin e mësimi në distancë”, dërguar nga zv. Ministri i MASR, të gjithë rektorëve dhe dekanëve të IAL – ve, ku vihej në dukje: “Çdo universitet dhe çdo fakultet duhet të gjejë zgjidhje sa më të shpejta për të siguruar alternativën e mësimi online..... Ka shumë platforma të mësimi online që përdoren aktualisht në botë, duke nisur nga platforma falas, sikundër dhe platforma të ndryshme me pagesë.

Sidoqoftë, nuk ka shumë kohë për të humbur dhe çdo fakultet/universitet duhet të fillojë që të realizojë sa më shpejt këto masa....”³⁶.

³⁵ Përgjigje dhënë pyetsorit të GA nga UPT, më datë 14.04.2022

³⁶ E-mail – i, i datës 16 mars 2020, me objekt: “Në lidhje me opsionin e mësimi në distancë”, dërguar nga zv. Ministri i MASR, , të gjithë rektorëve dhe dekanëve të IAL – ve.

Mësimi online njihet si formë studimi në distancë edhe nga Strategjia Kombëtare e Arsimit të Lartë 2021- 2026, kur nënvizon: “Mungesë e programeve të studimit nga distanca dhe programeve të të nxëniet të kombinuar (“blended learning”). *Për momentin, në Shqipëri nuk ekziston asnjë program mësimor i arsimit të lartë që ofrohet nga distanca ose në formë të kombinuar. Ndërkaq, mësimi nga distanca gjatë vitit 2020 është realizuar në formë plotësisht sinkrone, nëpërmjet leksioneve në kohë reale.*”³⁷.

Gjetja nga auditimi

4. Përfundimi i formës së studimeve në distancë, në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë u ka pamundësuar IAL–ve, duke filluar nga viti 2015, përdorimin e platformave elektronike dhe familjarizimin e thelluar me TIK, në funksion të shfrytëzimit të tyre, për realizimin me sukses dhe pa pengesa të proceseve mësimore online, në kushte normale, sikurse dhe në kushtet e jashtëzakonshme, si ato gjatë periudhës së pandemisë. Kjo e vendos arsimin e lartë jashtë standarteve mësimore ndërkombëtare të përparuara të e – learning.

Konkluzioni:

2. Pamundësia që IAL–et të përdornin platformat elektronike dhe të familjarizonin thellësisht me TIK, në funksion të shfrytëzimit të tyre për realizimin me sukses dhe pa pengesa të proceseve mësimore online gjatë periudhës së pandemisë, lidhet me kufizimin e formave të studimit me Ligjin 80/2015, i cili e përjashton mësimin në distancë.

Rekomandimi:

3. Ministria e Arsimit dhe Sporteve si institucioni përgjegjës për arsimin, të formulojë dhe propozojë një amendim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, duke parashikuar dhe përfshirë mundësisë e zhvillimit të proceseve mësimore online, nëpërmjet rikthimit të formës së studimeve në distancë, ose duke ua atribuar haptazi IAL–ve, në lirinë e tyre akademike dhe organizative, zgjedhjen dhe vlerësimin që t’a aktivizojnë, sipas nevojave dhe specifikave përkatëse.

Deri në muajin Mars 2023

Sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit dërguar me shkresën nr. 103/13 prot., datë 30.06.2022 të KLSH dhe protokolluar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), me shkresën nr. 2079/1 prot., datë 04.07.2022 nga subjekti i audituar MAS është paraqitur nëpërmjet e-mailit të datës 01.08.2022 dhe shkresë nr. 2079/3 prot., datë 01.08.2022 të MAS dhe protokolluar në KLSH me nr.103/18 prot., datë 03.08.2022, observacioni sa më poshtë:

“Ministria përgjegjëse për arsimin, gjatë situatës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, ka bashkëpunuar me disa institucione, me qëllim rivendosjen sa më të shpejtë të kushteve për funksionimin normal të procesit mësimor. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (sot Ministria e Arsimit dhe Sportit) si institucioni përgjegjës për hartimin e politikave në fushën e arsimit të lartë, në zbatim të pikës 7, të nenit 57 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ka kërkuar të merren masa nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë, për procese të ndryshme akademike, lidhur me respektimin e akteve rregullatore për zbatimin e masave dhe protokolleve higjienosanitare mbi parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid-19, por njëkohësisht duke mos cenuar lirinë akademike, autonominë financiare dhe organizative të parashikuar në nenin 3 të ligjit nr. 80/2015, në përputhje me standardet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.

Në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia e shkaktuar nga virusi Covid-19, procesi mësimdhënës online u pa nga IAL-të, si e vetmja mënyrë për vijimin e ofrimit të shërbimit arsimor, në pamundësi për të qenë pjesë e auditorëve.

Nga ana tjetër, duhet sqaruar se në bazë të nenit 69 të ligjit nr. 80/2015 njihen format e studimeve në institucionet e arsimit të lartë që janë:

- a) Studime me kohë të plotë;
- b) Studime me kohë të zgjatur.

Por mënyra se si mund të ndiqet procesi i mësimdhënies/mësimnxënies si metodologji e realizimit të procesit mësimor është edhe metoda online apo e kombinuar, për më tepër në kushtet e shpalljes së

fatkeqësisë natyrore, gjendjeve të jashtëzakonshme apo të urgjencës, si dhe referuar faktit të rritjes së kompetencave digjitale për të gjithë aktorët e interesit dhe pajisjes me mjetet e nevojshme digjitale, që e bëjnë të mundur ofrimin në pamundësi të një alternative tjetër të të ofruarit të procesit mësimdhënës edhe online apo të kombinuar. Theksojmë se metodologjia e të ofruarit të procesit mësimdhënës përkohësisht online (siç është operuar gjatë periudhës së pandemisë edhe në shumë vende të botës, të ndodhur përpara së njëjtës situatë të papritur si vendi ynë), për shkak të gjendjes që e ka diktuar atë, në përputhje të plotë me parimin e proporcionalitetit, nuk do të thotë që të jetë cenuar neni 69 i ligjit nr. 80/2015 mbi format e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

Ligji nr. 80/2015 nuk ndalon zhvillimin e procesit mësimor online si metodë mësimdhënie që aplikohet në raste të veçanta si efekte të fatkeqësive natyrore, pandemie, konflikteve të armatosura etj.

Mësimi në distancë u organizua gjatë pandemisë COVID-19 në formë të leksioneve, si metodologji e realizimit të procesit mësimor.

Për sa më sipër shtimi në ligj i formës së studimit në distancë nuk jep zgjidhje për ata studentë që janë pranuar dhe vijojnë studimet në programe me kohë të plotë ose me kohë të zgjatur.

Transferimi nga një formë studimi në një tjetër cenon parimin e sigurisë juridike për çdo student, parim i cili në thelb, garanton individin se shteti nuk do të përkeqësojë në mënyrë arbitrare pozitën e tij ligjore.

Ky parim, përbën një ndër bazat e shtetit të së drejtës. Si standarde formale kryesore të tij konsiderohen saktësia, qartësia, dhe qëndrueshmëria në tërësi e të gjithë rendit juridik të një shteti të caktuar.

Nga ana tjetër, si standarde kryesore në kuptimin material të parimit të sigurisë juridike, konsiderohen mos cenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi.

Doktrina e së drejtës kushtetuese ka pranuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Kjo siguri presupozon veç të tjerave besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara.

Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur nëpërmjet akteve të mëparshme. Ndërkohë që mënyra/metodologjia e zhvillimit të veprimtarive mësimore është element i cili mund të parashikohet për secilën nga këto forma në funksion të zhvillimit të procesit sipas kushtëzimeve që lindin për efekte të fatkeqësive natyrore, pandemie, konflikteve të armatosura etj.

Për sa më lart, nga ana e MAS nuk vlerësohet se jemi në kushtet e ndryshimit të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Së pari, Ligji Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që i paraprinte ligjit aktual (Ligji 80/2015), nuk e përkufizon formën e studimit “Studime në distancë”, ndërkohë që Ligji aktual 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, e përjashton kategorikisht, duke parashikuar dy forma studimesh, atë, të “studimeve me kohë të plotë” dhe atë të “studimeve me kohë të zgjatur”. të cilat presupozojnë ndjekjen e proceseve mësimore në auditorë, nga ana e studentëve.

Së dyti, sikurse vënë në dukje nga GA në Projekt Raport, nisma e ndërmarrë për aktivizimin e mësimin online, nuk u ndërmor kryesisht nga IAL –et, të cilat nuk e kishin aplikuar këtë formë studimi që me miratimin e Reformës në Arsim, sikurse me lart pohonte edhe UPT, por menjëherë pas dërgimit më datë 16 mars 2020, nëpërmjet një e-mail – i, me objekt: “Në lidhje me opsionin e mësimin në distancë”, dërguar nga zv. Ministri i MASR, z. Oltion Rrumbullaku., të gjithë rektorëve dhe dekanëve të IAL –ve, ku udhëzohej që: “Çdo universitet dhe çdo fakultet duhet të gjejë zgjidhje sa më të shpejta për të siguruar alternativën e mësimin online..”. Pra kjo për sa kohë, IAL –et, të pajisura me liri akademike, organizative dhe financiare, nuk kanë mundësi të optojnë për forma studimesh, sikurse mësimi online, që ligji 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” i përjashton.

Adaptimi mësimin online si një formë e ligjësuar studimi (studim në distancë) është veç të tjerash edhe kërkesë e drejtëpërdrejtë e IAL –ve, sikurse nga vlerësimi i tyre i vënë dukje në fokus grupet e organizuara me to.

Së treti, nën dritën e përvojave dhe nevojave të reja, me synim avancimin paralel me to të proceseve mësimore në universitetet shqiptare, Qeveria Shqiptare me Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë 2021- 2026, miratuar me Vendimin nr. 621, datë 27.10.2021 e Këshillit të Ministrave, nënvizon se ka: “Mungesë e programeve të studimit nga distanca dhe programeve të të nxëniet të kombinuar (“blended learning”). Për momentin, në Shqipëri nuk ekziston asnjë program mësimor i arsimit të lartë që ofrohet nga distanca ose në formë të kombinuar. Ndërkaq, mësimi nga distanca gjatë vitit 2020 është realizuar në formë plotësisht sinkrone, nëpërmjet leksioneve në kohë reale.” Ndaj në nënobjektivin C7.2.1. të saj shtron nevojën: “Sigurimi i aksesit në ndonjë nga platformat LMS për IAL-të publike. Rrjeti Akademik Shqiptar do të krijojë mundësitë për akses në ndonjë nga platformat LMS për IAL-të publike, duke krijuar kushte për organizimin e mësimi në distancë”, duke evokuar krijimin e premisave për perspektivën e mësimi në distancë, nëpërmjet mësimi online.

Së katërti, formulimi dhe propozimi i një amendimi të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, duke parashikuar qartazi ligjërimin e mundësisë për zhvillimin e proceseve mësimore online, ose nëpërmjet rikthimit të formës së studimeve në distancë, ose duke ua atribuar haptazi IAL – ve, në lirinë e tyre akademike, vlerësimin që të aktivizojnë ose jo këtë mënyrë mësimdhënieje, nuk presupozon domosdoshmërisht “Transferimin nga një formë studimi në një tjetër i cili cenon parimin e sigurisë juridike për çdo student, parim i cili në thelb, garanton individin se shteti nuk do të përkeqësojë në mënyrë arbitrare pozitën e tij ligjore”, mëqë mund të përvijojnë paralel për të njëjtin program studimi të dyja format e studimit, sipas vlerësimit të rastit, në përputhje me nevojat e studentëve dhe pedagogëve, por presupozon zbatimin më përmbajtësor të një parimi iluminist, i receiptuar integralisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, atë që: “Kushdo ka të drejtën për arsimim”³⁸.

Sa parashtruar nga MAS dhe faktet e paraqitura, nuk sjellin prova dhe fakte të reja për t’u rimarrë në konsideratë dhe për tu ritrajtuar dhe reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Pas kësaj mungese shumëvjeçare, me miratimin e VKM – së Nr. 621, datë 27.10.2021, “Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026”, Arsimit të Lartë iu mundësia të ketë një strategji të vetëm në zbatim të SKZHI II.

Rekomandimi i lënë për përmirësimin ligjor, të Ligjit Nr. 80/2015, i cili duhet të parashikojë qartazi mundësinë e zhvillimit të proceseve mësimore online, merr vlerë edhe në kuadër të zbatimit të ligjshëm të “Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026”, të miratuar me Vendimin nr. 621, datë 27.10.2021 të Këshillit të Ministrave.

Një nga objektivat specifik (Objektivi specifik C7: Shërbimet digjitale), i kësaj strategjie për arsimin e lartë është edhe avancimi i infrastrukturës së TIK-ut dhe i shërbimeve digjitale për IAL-të publike.

Tek “Produkti C7.2. Nxitja e IAL-ve për të organizuar mësimin në distancë dhe të nxëniet të kombinuar”, nënobjektivi C7.2.1. i Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 parashikon: “Sigurimi i aksesit në ndonjë nga platformat LMS për IAL-të publike. Rrjeti Akademik Shqiptar do të krijojë mundësitë për akses në ndonjë nga platformat LMS për IAL-të publike, duke krijuar kushte për organizimin e mësimi në distancë”³⁹, kur tek sfidat kryesore lidhur me objektivin specifik C7, kjo Strategji vë në dukje se ka: “Mungesë e programeve të studimit nga distanca dhe programeve të të nxëniet të kombinuar (“blended learning”). Për momentin, në Shqipëri nuk ekziston asnjë program mësimor i arsimit të lartë që ofrohet nga distanca ose në formë të kombinuar. Ndërkaq, mësimi nga distanca gjatë vitit 2020 është realizuar në formë plotësisht sinkrone, nëpërmjet leksioneve në kohë reale.”⁴⁰.

Pra vetë Strategjia pranon mungesën e ligjerimit të mësimi në distancë, ndërkohë që pranon se gjatë gjithë vitit 2020 mësimi nga distanca është realizuar në formë plotësisht sinkrone.

Duke trajtuar problematikat e përfshirjes së Teknologjisë Informative të Komunikimit(TIK) në proceset mësimore, grupi i auditimit u drejtoi IAL – ve pyetjen, nëse kishin informacion lidhur me rekomandimet e lëna nga Rezoluta 2001/C 204/02, e njohur si Rezoluta mbi e – learning, e miratuar nga Këshilli i Ministrave të Arsimit të vendeve anëtare të BE më 13 Korrik 2001, në vijim të konkluzioneve të Këshillit Evropian të Lisbonës të 23 dhe 24 mars 2000.

Në përgjigje të Pyetsorit asnjëri nga IAL – et, nuk u shpreh të kishte informacion.

³⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 57, pika 1.

³⁹ Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026, faqe 102

⁴⁰ Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026, faqe 101

Kjo Rezolutë në mënyrë të padiferencuar i referohet të gjitha niveleve të arsimit, pa e përjashtuar atë universitarë (shih rekomandimin iii.) duke e bërë të qartë si qëllim strategjik, ka atë të krijimit të një ekonomie konkurruese, dinamike dhe të bazuar në njohuri, si dhe objektiva specifike në lidhje me teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe arsimin, duke kërkuar integrimin efektiv të TIK-ut në sistemet e arsimit.

Ky akt ka një rëndësi të veçantë në historinë e përpjekjeve të arsimit evropian për të përqafuar dhe integruar TIK në praktikën e veta të mësimdhënies, të njohura si e-learning.

Gjetja nga auditimi:

5. IAL-et duke mos njohur Rezolutën 2001/C 204/02, e njohur si Rezoluta mbi e-learning, e miratuar nga Këshilli i Ministrave të Arsimit të vendeve anëtare të BE më 13 Korrik 2001 mbi e-learning, dëshmojnë se kanë mangësi lidhur me informacionin që lidhet me praktikën e e-learning, të rekomanduar që para disa dekadave në vendet e BE - së.

Konkluzioni:

3. Mosnjohja e dokumentave të rëndësishëm të BE-së lidhur me e-learning, përfaqëson një arsye të mosnjohjes së rekomandimeve dhe praktikave të BE-së, të cilat duhet të bëhen pjesë integrale e proceseve edhe në arsimin shqiptar në të gjitha nivelet, përfshirë arsimin e lartë. Mosnjohja dhe moszbatimin i këtyre rekomandimeve dhe praktikave në situatën e gjendjes së jashtëzakonshme, krijoi vështirësi në përzgjedhjen dhe përdorimin e platformave elektronike të mesimdhënies.

Rekomandimi:

4. IAL-et të thellojnë njohuritë e veta mbi dokumentet dhe praktikën e mira të e-learning, me qëllim reflektimin e tyre në proceset e tyre mësimore.

Në vijimësi

Në datën 9 Mars 2020 Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në vijim të Urdhërit të MSHMS - së nr. 135, datë 09.03.2020, nxori Urdhërin nr. 91 “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jo publike”, ku urdhërohej: “Mbyllja e institucioneve arsimore publike dhe jopublike për një periudhë dyjavore nga hyrja në fuqi e urdhërit”⁴¹.

Pak ditë pas daljes të Aktit Normativ (me fuqi ligji) Nr. 3, datë 15.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, me e miratimin e VKM-së Nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Arsimi i Lartë u fut në një regjim administrimi të jashtëzakonshëm, prej situatës së krijuar.

Duke patur parasysh, që Kushtetuta e RSH - së, në nenin 170, paragrafi përcakton, se: “Ligji duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve që vijnë si rezultat i kufizimit të të drejtave dhe lirive gjatë marrjes së masave të jashtëzakonshme”⁴², ndërkohë, që akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”, parashikon: “Institucionet arsimore, çerdhet dhe kopshtet, publike dhe jopublike, që nuk mbyllin aktivitetin e tyre për periudhën e përcaktuar nga autoritetet kompetente, dënohen me...”⁴³. nuk parashikon dhe nuk përcakton aspak se studimi në auditor, zëvendësohet me formën e studimit në distancë, nëpërmjet platformave elektronike online, duke e bërë të diskutueshëm nga pikëpamja e ligjshmërisë, këtë formë studimi në distancë, sikurse është mësimi online, i aplikuar edhe në IAL – e, gjatë gjendjes së pandemisë.

Ndaj MASR e cila në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 7, pika 2, germa b: “harton dhe propozon bazën ligjore në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor” dhe në zbatim të nenit 7, pika 2, germa e: “kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi” do duhej të kishte ushtruar kompetencat e sanksionuara nga Ligji Nr. 80/2015, duke kërkuar parashikimin në ligj, të formës së studimeve online, pra në distancë, si zgjidhje të përshtatshme në rrethanat e reja të krijuara nga gjendja e jashtëzakonshme, meqë kufizimi i të drejtave dhe lirive gjatë marrjes së masave të jashtëzakonshme, sikurse është dhe ajo e arsimimit (që realizohet vetëm në auditorë), meqë mënyra e kompensimit të humbjeve që vijnë si rezultat i kufizimit të të drejtave dhe lirive, vetëm me një akt ligjor, mundet të përcaktohet.

⁴¹ Urdhëri i MASR nr. 91 “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jo publike”, pika 1.

⁴² Kushtetuta e RSH në nenin 170, paragrafi 3

⁴³ Akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, neni 3, paragrafi 5.

MASR shprehet se: “Zhvillimi i procesit mësimor *online*, është një masë e marrë nga IAL-të, në zbatim të autonomisë së tyre, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”⁴⁴, ndërkohë që kjo masë e marrë nga IAL-et, nuk është marrë kryesisht, por e udhëzuar nga MASR, nëpërmjet komunikimit me e-mail, të Zv. Ministrit më datë 16.03.2020 (sikurse theksuar më lart edhe vetë Zv. Ministri i referohet mësimin online si “... opsionin e mësimin në distancë”), vetëm një ditë pas miratimit të Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19”.

Nga ana e saj MAS e ka justifikuar ndërprejren e mësimin në format e parashikuara nga Ligji 80/2015, pra kufizimin e mësimin në auditor dhe zëvendësimin tij me mësimin online, një formë tjetër studimi, krahasuar me atë që parashikon ligji i lartpërmendur, si më poshtë: “Në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia e shkaktuar nga virusi Covid-19, mësimi *online* u pa nga IAL-të si e vetmja mënyrë për vijimin e ofrimit të shërbimit arsimor, në pamundësi për të qenë pjesë e auditoreve.

Nga ana tjetër, duhet sqaruar se në bazë të nenit 69 të ligjit nr. 80/2015 njihen format e studimeve në institucionet e arsimit të lartë që janë:

- a) Studime me kohë të plotë;
- b) Studime me kohë të zgjatur.

Por mënyra se si do të ndiqet procesi i mësimdhënies/mësimnxënies si metodologji e realizimit të procesit mësimor mund të përdoret edhe metoda *online* apo e kombinuar, për më tepër në kushtet e shpalljes së fatkeqësisë natyrore, gjendjeve të jashtëzakonshme apo të urgjencës, si dhe referuar faktit të rritjes së kompetencave digjitale për të gjithë aktorët e interesit dhe pajiajes me mjetet e nevojshme digjitale, që e bëjnë të mundur ofrimin në pamundësi të një alternative tjetër të të ofruarit të procesit mësimdhënës edhe *online* apo të kombinuar. Theksojmë se metodologjia e të ofruarit të procesit mësimdhënës përkohësisht *online* (siç është operuar gjatë periudhës së pandemisë edhe në shumë vende të botës, të ndodhur përpara së njëjtës situatë të papritur si vendi ynë), për shkak të gjendjes që e ka diktuar atë, në pëputhje të plotë me parimin e proporcionalitetit, nuk do të thotë që të jetë cenuar neni 69 i ligjit nr. 80/2015 mbi format e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

Mësimi në distancë u organizua gjatë pandemisë COVID-19 në formë të leksioneve.”⁴⁵.

Gjetje nga auditimi:

6. Mësimi online, si formë mësimi që zëvendësonte dhe kompensonte mësimin në auditor, nuk u parashikua nëpërmjet një përcaktimi të qartë ligjor, sikurse parashikohet në Kushtetutën e RSH-së, neni 170, paragrafi 3, ku nënvizohet se: “Ligji duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve që vijnë si rezultat i kufizimit të të drejtave dhe lirive gjatë marrjes së masave të jashtëzakonshme”⁴⁶, por MASR është mjaftuar me dërgimin e një e-maili, ku u kërkohej IAL-ve që: “Çdo universitet dhe çdo fakultet duhet të gjejë zgjidhje sa më të shpejta për të siguruar alternativën e mësimin online.....”⁴⁷.

Konkluzioni:

4. Mosparashikimi nëpërmjet një përcaktimi të qartë ligjor, i mësimin online, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, si formë mësimi që kompensonte mësimin në auditor, është bërë në shkelje të detyrimit të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 170, paragrafi 3, ku thuhet: “Ligji duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve që vijnë si rezultat i kufizimit të të drejtave dhe lirive gjatë marrjes së masave të jashtëzakonshme”⁴⁸.

Rekomandimi:

5. Ministria e Arsimit dhe Sporteve të hartojë dhe dërgojë për miratim rishikimet ligjore, duke përcaktuar parimet dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve apo kufizimit të të drejtave për arsimim në situata të jashtëzakonshme, përfshirë dhe format e studimit dhe praktika e ndjekur për zhvillimin e mësimin online dhe jo në auditor.

Në vijimësi

⁴⁴ Përgjigje dhënë pyetsorit të GA nga MAS, më datë 19.04.2022

⁴⁵ Përgjigje dhënë pyetsorit të GA nga MAS, më datë 19.04.2022

⁴⁶ Kushtetuta e RSH në nenin 170, paragrafi 3

⁴⁷ E-mail – i, i datës 16 mars 2020, me objekt: “Në lidhje me opsionin e mësimin në distancë”, dërguar nga zv. Ministri i MASR, të gjithë rektorëve dhe dekanëve të IAL – ve.

⁴⁸ Kushtetuta e RSH në nenin 170, paragrafi 3

Sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit dërguar me shkresën nr. 103/13 prot., datë 30.06.2022 të KLSH dhe protokolluar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), me shkresën nr. 2079/1 prot., datë 04.07.2022 nga subjekti i audituar MAS është paraqitur nëpërmjet e-mailit të datës 01.08.2022 dhe shkresë nr. 2079/3 prot., datë 01.08.2022 të MAS dhe protokolluar në KLSH me nr.103/18 prot., datë 03.08.2022, observacioni sa më poshtë:

“Në lidhje me këtë gjetje MAS shpjegon se është sqaruar sa më lart”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Sa parashtruar nga MAS, nuk sjell prova dhe fakte të reja për t’u rimarrë në konsideratë dhe për tu ritrajtuar dhe reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

4.1.2. A i ka shërbyer ky kuadër arritjes së objektivave të mësimëdhënies, kërkimit shkencor dhe mbrojtjes së shëndetit të studentëve dhe stafit akademik?

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si institucioni përgjegjës për hartimin e politikave në fushën e arsimit të lartë, në zbatim të pikës 7, të nenit 57 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ka kërkuar të merren masa nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë, për procese të ndryshme akademike, lidhur me respektimin e akteve rregullatore për zbatimin e masave dhe protokolleve higjieno-sanitare mbi parandalimin e përhapjes së infeksionit Covid-19.

Me miratimin e Urdhërit Nr. 135 nga MSHMS, datë 09.03.2020 “Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së Covid-19”, nga ana e saj MASR ka miratuar dhe u ka dërguar IAL – ve, Urdhërin Nr. 91 i MASR, datë 09.03.2020 “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike”, ku urdhëron: “Ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike për një periudhë 2 javore, nga hyrja në fuqi e këtij urdhëri, me qëllim parandalimin e përhapjes së COVID 19, sipas udhërit të Ministrit të MSHMS, Nr. 135, datë 09.03.2020.”⁴⁹.

Më datë 15.03.2020 u miratua Akti Normativ Nr. 3, me fuqi ligji, për “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”. Ky Akt Normativ kishte për qëllim “përcaktimin dhe forcimin e zbatimit të rregullave, të vendimeve, të urdhrave dhe të udhëzimeve të nxjerra nga organet kompetente, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për parandalimin dhe luftimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”⁵⁰.

Sikurse parashikuar në përmbajtjen e këtij Akti Normativ, “Ky akt normativ ka karakter të përkohshëm dhe zbatohet për aq kohë sa zgjat periudha e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.”⁵¹ dhe “Zbatimi i këtij akti normativ, për kohëzgjatjen e periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, ka përparësi ndaj dispozitave të akteve të tjera lidhur me masat administrative.”⁵².

Me VKM Nr .243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, propozuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe nga Ministrit i Shtetit për Rindërtimin, në mbështetje të neneve 100, 170, 174, pika 1, e 175, pika 2, të Kushtetutës, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 18, të pikës 1, të nenit 19, dhe të pikës 1, të nenit 39, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile” Këshilli i Ministrave, vendosi: “Shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.”⁵³. Kjo VKM përcakton se; “Instituti i Shëndetit Publik caktohet në rolin e Sekretariatit Teknik të KNEC-së (ndr. Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, i ngritur me vendimin nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave), për çështje të fatkeqësisë natyrore të shpallur për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.”⁵⁴.

Sikurse është parashikuar në VKM – në Nr. 243, datë 24.3.2020, për përballimin dhe lehtësimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, institucionet publike, ngarkohen: “... të realizojnë plane masash organizative dhe administrative për përballimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore...”⁵⁵ dhe “...të

⁴⁹ Urdhëri Nr. 91 i MASR, datë 09.03.2020 “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike”, pika 1.

⁵⁰ Akti Normativ Nr. 3, me fuqi ligji, miratuar më datë 15.03.2020, për “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, neni 2.

⁵¹ Akti Normativ Nr. 3, me fuqi ligji, miratuar më datë 15.03.2020, për “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, neni 6, pika 1.

⁵² Akti Normativ Nr. 3, me fuqi ligji, miratuar më datë 15.03.2020, për “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, neni 6, pika 2.

⁵³ VKM Nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, pika 1.

⁵⁴ VKM Nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, pika 5.

⁵⁵ VKM Nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, pika 6.1, germa a.

kufizojnë aksesin në ambiente publike, të cilat kanë një frekuentim të gjerë...”⁵⁶. Po ashtu ky Vendim i Këshillit të Ministrave, nënvizon se: “Të gjitha të drejtat dhe liritë e kufizuara me akte, të dala në zbatim të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, dhe me aktin normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar, mbeten në fuqi.”⁵⁷.

Më datë 23.04.2020, një muaj pas miratimit VKM Nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Kuvendi i Shqipërisë, miratoi Vendimin Nr. 18/2020 “Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, deri në datën 23.6.2020.

Ky Vendim i propozuar nga Këshilli i Ministrave, u miratua në zbatim të përcaktimeve të Ligjit Nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, ku parashikohet detyrimi, se KM: “informon Kuvendin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet ministrit për situatën e krijuar, rreziqet që paraqiten dhe masat e marra për menaxhimin e situatës, si dhe kërkon miratimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë përtej 30 ditëve.”⁵⁸.

Ndërkohë, MASR me Urdhërin Nr. 104, të datës 30.04.2020, “Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019 - 2020 nga institucionet e arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e Covid-19”, dërguar të gjitha IAL – ve, urdhëron: “Institucionet publike të arsimit të lartë, për mbylljen e vitit akademik 2019-2020, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia COVID 19, të marrin masa për:

Prioritizimin e punës për studentët e të gjitha cikleve të studimit që diplomohen në vitin akademik 2019-2020, për kthimin në auditor të studentëve për përsëritjen e leksioneve, seminareve, apo punëve laboratorike, brenda muajit qershor të vitit 2020, për një periudhë jomë pak se tre javë: si dhe “vijimin e mësimdhënies on-line për mbylljen e planeve mësimore në çdo program studimi”⁵⁹. Në germën “g” të pikës 1, të këtij Urdhëri, nga MASR u kërkohej IAL – ve, miratimi i rregulloreve të brendshme nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë, për sjelljen e studentëve në institucion, si dhe higjienizimin dhe dezinfektimin e rregullt të ambienteve, mbi bazën e rregullores së miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Instituti i Shëndetit Publik, duke përcaktuar më poshtë datën 15 maj 2020, si afatin brenda të cilit IAL–et, duhej të hartonin dhe paraqisnin në MASR, planin e masave organizative dhe administrative, me qëllim garantimin e distancimit social të studentëve dhe stafit akademik, pjesëmarrjen në procesin e mësimdhënies online dhe format si është zhvilluar mësimdhënia online.

- IAL–et kanë zbatuar përpikmërisht këtë urdhër sa kërkuar për marrjen e masave dhe duke miratuar nga ana tyre sa më poshtë:

- Vendim Rektorati Nr. 223, datë 13.05.2020, “Për propozimin e ndryshimeve në strukturën e vitit akademik 2019-2020 në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë, si dhe Vendimi i Senatit Akademik Nr. 226, datë 14.05.2020 “Për miratimin e disa ndryshimeve në strukturën e vitit akademik 2019-2020”:

- Vendim Rektorati Nr. 06, datë 07.05.2020 “Për zhvillimin e procesit mësimor edhe në auditore”, në Universitetin “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë dhe Vendimi i Senatit Akademik Nr. 19, datë 15.05.2020, “Për miratimin e rregullores për masat higjieno - sanitare, organizative dhe administrative mbi minimizimin e riskut nga Covid 19 dhe miratimin e strukturës së zhvillimit të procesit mësimor për periudhën Qershor – Tetor 2020”:

- Vendim Nr. 61, datë 08.05.2020 i Rektoratit të Universitetit Politeknik të Tiranës “Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019 – 2020 për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e covid-2019 në Universitetin Politeknik të Tiranës”;

- Vendim Rektorati Nr. 51, datë 05.05.2020 “Për organizimin e procesit mësimor dhe përfundimin e vitit akademik 2019-2020 në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

- Me shkresën Nr. 2604 prot., datë 08.05.2020, me lëndë: “Mbi kthimin e studentëve dhe të personelit në institucionet e arsimit të lartë”, MASR i drejtohet MSHMS – së, duke vënë në dukje dhe kërkuar sa më poshtë: “Duke ndjekur zhvillimet e fundit të pandemisë në vend dhe nga vlerësimi i të dhënave të kësaj situate, jemi njohur me strategjinë e rihapje graduale dhe të kujdesshme për popullatën dhe shërbimet esenciale nga ana e Komitetit Teknik të Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe

⁵⁶ VKM Nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, pika 6.1, germa d.

⁵⁷ VKM Nr. 243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, pika 7.

⁵⁸ Ligji Nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, neni 18, germa d.

⁵⁹ Urdhëri i MASR, Nr. 104, të datës 30.04.2020, “Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020 nga institucionet e arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e Covid-19”, pika 1, germa a dhe c.

Mbrojtjes Sociale (MSHMS), nga ana e *Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë është miratuar Urdhëri nr. 104, datë 30.04.2020* “Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019 - 2020 nga institucionet e arsimit të lartë, për shkak të gjendjes të fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e Covid-19”, i cili parashikon kthimin e personelit dhe të studentëve në institucionet e arsimit të lartë.

Për sa më sipër, kërkojmë miratimin tuaj, për kthimin e personelit dhe studentëve në institucionet e arsimit të lartë, sipas kushteve dhe protokolleve të miratuara nga ana juaj.”⁶⁰.

Kjo kërkesë iu përçoll MSHMS – së, nga MASR, një ditë, pasi MASR, me datë 07.05.2020, u dërgoi IAL – ve, shkresën Nr. 2586, prot., me lëndë: “Dërgohet për zbatim urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, ku bashkëlidhur gjendej *Urdhëri Nr. 289, datë 04.05. 2020 i MSHMS “Për miratimin e udhëzuesit për masat ndaj Covid-19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore”*.

Me këtë akt, MSHMS, në zbatim edhe të Udhëzimit nr. 496/12, datë 29.04.2020 të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni COVID 19, urdhëronte:

“1. Miratimin e Udhëzuesit për “Masat ndaj Covid 19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhëri.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet e qeverisjes vendore.”⁶¹.

Bashkëlidhur urdhërit të MSHMS është dërguar edhe rregullorja mbi masat sanitare për minimizimin e riskut nga COVID-19, përgatitur nga Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, e cila përcaktonte gjurmën dhe kriteret mbi të cilat duhet të hartoheshin dhe miratoheshin Udhëzuesit për masat ndaj Covid-19 që duhej të ndërmerrin institucionet arsimore, përfshirë IAL – et e RSH – së.

IAL – et janë aktivizuar në zbatim të këtij urdhëri duke miratuar përkatësisht:

Vendimi i Senatit Akademik Nr. 224, datë **14.05.2020** “Për miratimin e Rregullores mbi masat sanitare për minimizimin e riskut nga Covid 19 në Universitetin “Fan S. Noli”, Korçë;

Vendim Rektorati, Nr. 08, datë 13.07.2020, “Për masat mbi minimizimin e riskut të përhapjes së infeksionit respirator Covid 19”, në Universitetin “Eqrem Qabej”, Gjirokastrë;

Vendim Nr. 63, datë 13.05.2020 i Rektoratit të Universitetit Politeknik të Tiranës “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së infeksionit covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë akademike dhe administrative në UPT”;

Vendim Rektorati Nr. 01 datë 26.06.2020 “Për mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, për vitin akademik 2020-2021.

Në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe të ndalimit të grumbullimeve, nga MASR u miratua dhe iu përçoll IAL – ve Urdhëri nr. 108, datë 08.05.2020 i MASR “Për shtyrjen e datës së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e Covid 19, gjë që solli pezullimin e procesit, deri në miratimin e Urdhërit Nr. 175, datë 30.06.2020 i MASR, “Për zhvillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese të institucioneve publike të arsimit të lartë”.

Me miratimin e Ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Këshillat e studentëve kanë një rol të parashikuar dhe rregulluar në mënyrë të drejtpërdrejtë, nga ky akt, meqë studentët, si faktor i qenësishëm në jetën dhe aktivitetin e IAL–ve, kanë të drejtë të organizohen në këta këshilla në nivel njësie kryesore, institucioni të arsimit të lartë, si edhe në nivel kombëtar.

Duke qenë organizime të pavarura të studentëve në institucionet e arsimit të lartë, Këshillat e studentëve nuk zhvillojnë veprimtari politike e ekonomike dhe modalitetet e procedurat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e tyre përcaktohen në statutet dhe rregulloret e institucioneve të arsimit të lartë, në përputhje me Ligjin 80/2015 dhe propozimet e vetë studentëve.

Duke qenë studentët përfitues të drejtpërdrejtë të shërbimeve të IAL – ve dhe kontribues ekonomik të rëndësishëm, nëpërmjet pagesave të tarifave, grupi i auditimit, vlerësoi të interesohej për aktivitetin e këshillave studentor, duke shtruar pyetjen, se: “Si janë mbështetur këshillat e studentëve nga IAL–et, në periudhën Mars 2020 – Dhjetor 2021 dhe sa janë mbështetur mendimet dhe propozimet e tyre, për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucioneve të arsimit të lartë, me fokus të veçantë vështirësitë e krijuara nga pandemia”⁶².

⁶⁰ Shkresa e MASR, Nr. 2604 prot., datë 08.05.2020, me lëndë: “Mbi kthimin e studentëve dhe të personelit në institucionet e arsimit të lartë”, drejtuar MSHMS – së.

⁶¹ Urdhëri Nr. 289, datë 04.05. 2020 i MSHMS “Për miratimin e udhëzuesit për masat ndaj Covid-19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore”

⁶² Pyetësi i Grupit të Auditimit, dërguar IAL – ve dhe MAS, më datë 30.03.2022.

Meqë “Këshillat e studentëve shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucioneve të arsimit të lartë, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.”⁶³, “Institucionet e arsimit të lartë mbështetin këshillat e studentëve dhe financojnë veprimtari të tyre.”⁶⁴.

Përgjigjet e ardhura nga IAL – et, ishin sa më poshtë:

Universiteti “Eqrem Çabej” i Gjirokastrës, vë në dukje, se “Këshillat studentorë nuk kanë qenë aktivë gjatë periudhës së Pandemisë Covid 19”.

Ndërkaq Universiteti “Fan Noli” i Korçës, nuk është shprehur për këshillat studentorë, por ka vënë dukje se, “Studentët janë përfshirë në procesin e vlerësimit të mësimdhënies online nëpërmjet pyetësorëve dhe kërkesat e tyre janë raportuar nga Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë”.

Universiteti Politeknik i Tiranës në përgjigjen e vet shprehet, se: “Për periudhën 2020 – 2021 nga grupet studentore, nuk ka patur kërkesa specifike për mbështetje financiare në realizimin e procesit të mësimin online. Megjithatë, si çdo vit paraardhës, edhe për periudhën 2020-2021 në zërin 602 janë planifikuar rreth 2.000 mijë lekë (deri në 2% të buxhetit vjetor të shpenzimeve operative) të ndarë zipas zërave dhe natyrës si shpenzime për aktivitete shkencore, sportive dhe sociale, pjesëmarrje në konferenca, e të tjera aktivitete, që mund të organizohen nga grupimet studentore.

Gjatë kësaj periudhe është realizuar kërkesa për botimin e guidave studentore në shumen 107.5 mijë lekë për vitin 2020 dhe në shumën 108 mijë për vitin 2021 (5 % të buxhetit të parashikuar).” Kurse Universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit, duke mos trajtuar problematikën e këshillave studentorë, u përgjigj: “Në zyrën e protokollit të UNIEL nuk është depozituar asnjë kërkesë/ankesë e studentëve lidhur me vështirësitë e krijuara nga pandemia.”.

Ndërsa Universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës, ka referuar sa më poshtë: “Këshillat studentorë të UV janë zgjedhur në 20 Qershor 2019 me vendim të Rektorit Nr.32 dt.19.04.2019, që caktoi datën 10 qershor 2019. Me vendim Nr.41, të 10.06.2019, shtyhet data e votimit në 20 Qershor 2019.

Këshilli studentor i UV ka funksionuar deri në dhjetor 2019 dhe më pas nuk ka ushtruar funksion për arsye të dorëheqjeve të anëtarëve dhe zëvendësimin e njëpasnjëshëm të tyre, dhe për shkak të frekuentimit online të studentëve.

Shkresa më e fundit e Këshillit studentor i perket caktimit të një studenteje për në Grupin e punës së UV për Vlerësimin e Brendshëm me Nr.1603/2 prot datë 05.12.2019.”.

Gjetje nga auditimi:

6. Mësimi online, si formë mësimi që zëvendësonte dhe kompensonte mësimin në auditor, nuk u parashikua nëpërmjet një përcaktimi të qartë ligjor, sikurse parashikohet në Kushtetutën e RSH–së, neni 170, paragrafi 3, ku nënvizohet se: “Ligji duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve që vijnë si rezultat i kufizimit të të drejtave dhe lirive gjatë marrjes së masave të jashtëzakonshme”⁶⁵, por MASR është mjaftuar me dërgimin e një e-maili, ku u kërkohej IAL–ve që: “Çdo universitet dhe çdo fakultet duhet të gjejë zgjidhje sa më të shpejta për të siguruar alternativën e mësimin online.....”⁶⁶.

Konkluzioni:

4. Mosparashikimi nëpërmjet një përcaktimi të qartë ligjor, i mësimin online, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, si formë mësimi që kompensonte mësimin në auditor, është bërë në shkelje të detyrimit të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 170, paragrafi 3, ku thuhet: “Ligji duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve që vijnë si rezultat i kufizimit të të drejtave dhe lirive gjatë marrjes së masave të jashtëzakonshme”⁶⁷.

Rekomandimi:

5. Ministria e Arsimit dhe Sporteve të hartojë dhe dërgojë për miratim rishikimet ligjore, duke përcaktuar parimet dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve apo kufizimit të të drejtave për arsimin

⁶³ Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 99, pika 5.

⁶⁴ Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 99, pika 6.

⁶⁵ Kushtetuta e RSH në nenin 170, paragrafi 3

⁶⁶ E-mail – i, i datës 16 mars 2020, me objekt: “Në lidhje me opsionin e mësimin në distancë”, dërguar nga zv. Ministri i MASR, z. O. Rr., të gjithë rektorëve dhe dekanëve të IAL – ve.

⁶⁷ Kushtetuta e RSH në nenin 170, paragrafi 3

në situata të jashtëzakonshme, përfshirë dhe format e studimit dhe praktika e ndjekur për zhvillimin e mësimi online dhe jo në auditor.

Në vijimësi

Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, u njeh studentëve të institucioneve publike e private të arsimit të lartë të drejtën e pajisjes me *kartën e studentit*. “Studentët e institucioneve publike e private të arsimit të lartë pajisen me kartën e studentit, e cila është dokument unik. Me anë të saj, studentët përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara.”⁶⁸. Po ashtu, ky ligj përcakton, se: “Përfitimet e studentëve nga përdorimi i kartës së studentit përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të ministrisë përkatëse që mbulon institucionin e arsimit të lartë ose njërive të qeverisjes vendore që mbulojnë shërbimet e ofruara ndaj studentëve.”⁶⁹.

Më datë 17.04.2019 është miratuar VKM Nr. 226, “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”.

Ky akt parashikon se: “Shërbimet që ofrohen nga entet shtetërore në fushën e artit dhe të kulturës, të shëndetësisë dhe të mbrojtjes sociale, arsimit, sportit dhe rinisë, transportit, turizmit dhe mjedisit, ekonomisë, financave, punësimit dhe trajnimit dhe ato të mbrojtjes përfitohen nga studentët me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit, si një dokument unik i çdo studenti.”⁷⁰. Po ashtu, VKM Nr. 226, shton, se: “Ministrat, sipas fushës së përgjegjësisë përkatëse, miratojnë, me urdhër të përbashkët me ministrinë përgjegjëse për arsimin, listën e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara për studentët. Në urdhrin e përbashkët përcaktohen çmimet e reduktuara për shërbimet që do të ofrohen. Efektet financiare nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxheti i secilës ministri, ofruese e shërbimit për studentët, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore.”⁷¹.

Referuar kësaj risie të reformës në arsimin e lartë, duke patur parasysh edhe strukturën e re të nevojave të lindura për shkak të situatës së pandemisë, si nevojat e studentëve, për shërbime interneti, telefonash, kompjuterash, për shkak të mësimi tashmë online, shërbime kopisterie, iu kërkua informacion *MAS – it dhe IAL – ve* të cilat, lidhur me kartën e studentit dhe shërbimet me çmime të reduktuara, *informuan dhe vunë në dispozicion*⁷², sa më poshtë:

Universiteti “Eqrem Çabej” i Gjirokastrës, vë në dukje, se: “... Bashkia Gjirokastrë në bashkëpunim me Postën Shqiptare kanë bërë promovimin në mjediset e universitetit për dhënien e kartave të studentit. Universiteti në bashkëpunim me Postën Shqiptare dhe Bashkinë Gjirokastrë, kanë bërë promovimin në mjediset e universitetit, për dhënien e kartave të studentit ku edhe Bashkia Gjirokastrë nëpërmjet shkresës Nr 8181 prot., datë 24.10.2019 protokolluar pranë Universitetit me Nr 1390 Prot datë 25.10.2019, ka paraqitur shërbimet të cilat ofron kjo bashki për studentët që ndjekin studimet në Universitetin Gjirokastrë.”.

Pasi u auditua dokumentacioni i dërguar nga Universiteti “Eqrem Çabej” i Gjirokastrës u konstatua se lista e shërbimeve që ofrohet nga Bashkia Gjirokastrë, nuk përfshin nevojat e lindura nga pandemia, për shërbime me reduktim çmimi.

Ndërkaq, Universiteti “F.Noli” i Korçës ka vënë dukje, se: “Për periudhën në fjalë, Karta e Studentit nuk ishte shërbim që ofrohej.”.

UPT në përgjigjen e vet shprehet, se: “Studenti është pajisur me kartën e studentit mbasi ka marrë numrin e matrikullimit dhe nuk ka patur ndonjë problematikë të adresuar. Evidenca janë e-maillet nga bashkia dhe tabela me oraret”.

Kurse UNIEL u përgjigj: “Në UNIEL, procesi i pajisjes me kartën e studentit ka filluar në tetor të 2019..... UNIEL nuk disponon të dhëna për numrin e studentëve të pajisur me kartën e studentit...”

Ndërsa UNI Vlora, ka referuar sa më poshtë: “Karta e studentit është menaxhuar nga Bashkia e Qytetit”. Nga ana e vet MAS ka nëshkruar marrëveshje me subjekte të ndryshme, për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit, si dhe delegimin dhe administrimin e kartës së studentit dhe konkretisht:

⁶⁸ Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në R. Shqipërisë”, neni 100, pika 1.

⁶⁹ Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në R. Shqipërisë”, neni 100, pika 3.

⁷⁰ VKM Nr. 226, e datës 17.04.2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, pika 1.

⁷¹ VKM Nr. 226, e datës 17.04.2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, pika 2.

⁷² Pyetori i Grupit të Auditimit, dërguar IAL – ve dhe MAS, më datë 30.03.2022.

Marrëveshjen me Bashkinë e Tiranës, “Për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara oër përfituesit e kartës së studentit, si dhe delegimin dhe administrimin e kartës së studentit nga Bashkia Tiranë”; Memorandumin e bashkëpunimit me Postën Shqiptare sh.a. “Për delegimin e prodhimit dhe administrimin e kartës së studentit, si dhe ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara nga “Posta Shqiptare” për përfituesit e kartës së studentit”;

- Urdhër i përbashkët nr. 440, datë 11.09.2019 i MASR dhe MTM “Për përcaktimin e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit, në fushën e turizmit dhe mjedisit”;

- Urdhër i përbashkët nr. 418, datë 30.7.2019 i MASR dhe MK “Për përcaktimin e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit në fushën e artit dhe kulturës” etj;

- Urdhër i përbashkët nr. 1242, datë 14.08.2019 i MASR dhe MM “Për miratimin e listës së shërbimeve që do të ofrohen nga strukturat e vartëse të Ministrisë së Mbrojtjes, me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”.⁷³

Gjetja nga auditimi:

8. Procesi auditues evidentoi se: IAL—et ose nuk kanë informacion mbi ecurinë e procesit të pajisjes me kartë studenti, ose në marrëveshjet që kanë nënshkruar me njësitë e vetëqeverisjes vendore, nuk kanë të përfshira shërbime me çmime të reduktuara për nevojat e lindura në periudhën e pandemisë. Po ashtu, IAL—et, nuk kanë nënshkruar “...marrëveshje me subjekte ...private, për ofrimin e shërbimeve të ndryshme,me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit.”⁷⁴, në mungesë të zbatimit të VKM - së Nr. 226, e datës 17.04.2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, pika 6.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve të gjitha marrëveshjet i ka lidhur deri në vitin 2019 dhe asnjë në vitet 2020 dhe 2021, duke mos përfshirë në gamën e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara, objekt marrëveshjes, asnjë shërbim të lidhur me nevojat e krijuara nga situata e pandemisë.

Ministria e Arsimit dhe Sporteve ka nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Brendshme, por nuk ka nënshkruar marrëveshje për shërbimet që: “..ofrohen nga entet shtetërore në fushën..., e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, arsimit, sportit dhe rinisë, transportit,..., ekonomisë, financave, punësimit dhe trajnimit... “që përfitohen nga studentët me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit.”⁷⁵, në kundërshtim me VKM—në Nr. 226, datë 17.04.2019, në pikën 1.

IAL—et objekt auditimi dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve nuk kanë bërë inventarizim nevojash të studentëve gjatë periudhës së pandemisë, mbi bazën e të cilave të orientonin veprimtarinë e tyre në mbështetje me promovimin e përfitimin e shërbimeve me çmime të reduktuara nëpërmjet kartës së studentit.

Konkluzioni:

6. Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe IAL—et, së bashku me entet shtetërore të fushave të ndryshme, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe operatorët e sektorit privat, gjatë periudhës së pandemisë do duhej të kishin gjetur format e bashkëpunimit, me synimin jetësimin dhe materializimin konkret të shërbimeve me çmime të reduktuara për studentët, në kuadër të kartës së studentit dhe në përgjigje të nevojave të reja të krijuara nga situata e jashtëzakonshme Covid 19.

Rekomandimi:

7. Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe IAL – et, në bashkëpunim me entet shtetërore të fushave të ndryshme, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe operatorët e sektorit privat, të përditësojnë dhe pasurojnë spektrin e marrëveshjeve për shërbimet që përfitojnë studentët me çmim të reduktuar, në përputhje me situatat dhe nevojat e lindura.

Në vijimësi

Sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit dërguar me shkresën nr. 103/13 prot., datë 30.06.2022 të KLSH dhe protokolluar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), me shkresën nr. 2079/1 prot., datë 04.07.2022 nga subjekti i audituar MAS është paraqitur nëpërmjet e-mailit të datës 01.08.2022

⁷³ Përgjigje dhënë Pyetësorit të Grupit të Auditimit, dërguar IAL – ve dhe MAS, të datës 30.03.2022.

⁷⁴ VKM Nr. 226, e datës 17.04.2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, pika 6.

⁷⁵ VKM Nr. 226, e datës 17.04.2019 “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, pika 1.

dhe shkresë nr. 2079/3 prot., datë 01.08.2022 të MAS dhe protokolluar në KLSH me nr.103/18 prot., datë 03.08.2022, observacioni sa më poshtë:

“Në zbatim të pikës 4, të nenit 100 të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ministria përgjegjëse për arsimin, që është institucioni që realizon programin qeverisës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, hartoi dhe propozoi në Këshillin e Ministrave projektvendimin “Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen më çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, i cili kishte për qëllim ofrimin e disa kategorive të shërbimit me kosto të reduktuar ose tarifë zero, të cilat do të ofrohen nga entet shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjekte të tjera publike dhe private për studentët. Në Këshillin e Ministrave u miratua vendimi nr. 226, datë 17.04.2019.

Vendimi ka për qëllim përcaktimin e shërbimeve në fushën e artit dhe kulturës, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, arsimit, sportit dhe rinisë, transportit, turizmit, mjedisit, ekonomisë, financave, punësimit, trajnimit dhe ato të mbrojtjes, të cilat do të përfitohen nga studentët me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit, si një dokument unik. Në lidhje me përfitimet, shërbimet që do të ofrohen nga entet shtetërore në nivel qendror dhe vendore si dhe subjektet e tjera publike apo private, si dhe vetë institucionet e arsimit të lartë (IAL) krijojnë mundësinë studentëve që të kenë avantazhe të ndryshme financiare, në veprimtari të ndryshme, me anë të përdorimit të Kartës së Studentit, si dokument unik për të gjitha llojet e shërbimeve.

Qëllim tjetër i vendimit është lehtësimi i përfitimit të shërbimeve më çmime të reduktuara dhe në vendet e Bashkimit Evropian. Karta e studentit mund të bëhet pjesë e projekteve ndërkombëtare, përmes marrëveshjeve që lidhen nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe organizatat ndërkombëtare që administrojnë projektet ndërkombëtare.

Ky projektvendim ka për qëllim plotësimin e bazës ligjore për ofrimin e shërbimeve për studentët nëpërmjet Kartës së Studentit, si dokument unik për përfitimin e shërbimeve.

MAS ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me Ministrinë e Kulturës dhe Ministrinë e Brendshme.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi është miratuar nga MASR udhëzimi nr. 14, datë 27.05.2019 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit”.

Për pajisjen me kartën e studentit, MAS, na zbatim të vendimit të sipërcituar, ka nënshkruar marrëveshje me subjekte të ndryshme, për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit, si dhe delegimin dhe administrimin e kartës së studentit. Konkretisht:

Marrëveshjen me Bashkinë e Tiranës, “Për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit, si dhe delegimin dhe administrimin e kartës së studentit nga Bashkia Tiranë”.

Memorandumin e bashkëpunimit me Postën Shqiptare sh.a. “Për delegimin e prodhimit dhe administrimin e kartës së studentit, si dhe ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara nga “Posta Shqiptare” për përfituesit e kartës së studentit”.

Urdhër i përbashkët nr. 440, datë 11.09.2019 i MASR dhe MTM “Për përcaktimin e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit, në fushën e turizmit dhe mjedisit”.

Urdhër i përbashkët nr. 418, datë 30.7.2019 i MASR dhe MK “Për përcaktimin e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit në fushën e artit dhe kulturës” etj.

Urdhër i përbashkët nr. 1242, datë 14.08.2019 i MASR dhe MB “Për miratimin e listës së shërbimeve që do të ofrohen nga strukturat e vartëse të Ministrisë së Mbrojtjes, me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”.

Me shkresën nr. 11071, datë 22.10.2018 MAS u ka kërkuar të gjitha bashkive në vend që në kuadër të hartimit të projekt akteve për pajisjen e studentëve me kartë studenti për përfitimin e shërbimeve në fusha të ndryshme me çmim të reduktuar, të ofrojnë bashkëpunimin e tyre për të paraqitur informacion të detajuar lidhur me shërbimet që do të ofrohen për studentët me tarifa të reduktuara dhe deri në cilën masë mund të reduktohen këto tarifa.”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Edhe me sa observuar nga MAS, konstatohet lehtësisht se gjatë periudhës së pandemisë shkaktuar nga Covid 19, nuk është ndërmarrë asnjë masë shtesë në përgjigje të nevojave të reja.

Periudha e pandemisë i ekspozoi studentët e Arsimit të Lartë dhe familjet e tyre, jo vetëm ndaj një presioni psikologjik, por edhe ndaj vështirësive materiale e financiare, jo lehtësisht të përballueshme. Të interesuar lidhur me konkretizimin e parashikimit në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, **mbi kredinë studentore (edhe kjo një risi e reformës në arsimin e lartë)**, Grupi i Auditimit kërkoi informacion dhe dokumentacion lidhur me zbatimin e sa më lart, si MAS – it, ashtu dhe IAL – eve, duke qenë se “Ministria përgjegjëse për arsimin ndërmjetëson kreditimin e studentëve, me qëllim mbështetjen financiare për përballimin e kostos së studimeve”⁷⁶, dhe se “Kredia studentore është e hapur për aplikim për të gjithë studentët që fitojnë të drejtën për studime në programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë”⁷⁷. Ligji parashikon gjithashtu, se: “Skema e kreditimit studentor përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave”⁷⁸.

Lidhur me ecurinë e kreditimit studentor, Grupi i Auditimit mori informacionet dhe përgjigjet⁷⁹ nga IAL – et dhe MAS, si më poshtë:

Universiteti “E. Çabej” i Gjirokastrës, vë në dukje, se: “Nuk kemi informacion”.

Ndërkaq Universiteti “F.Noli” i Korçës, pohon, se: “Për periudhën në fjalë, Kredia Studentore nuk ishte shërbim që ofrohej.”.

UPT, në përgjigjen e vet shprehet, se: “...Nga hyrja në fuqi e ligjit për arsimin e lartë e deri më sot, nuk rezulton të jetë miratuar ndonjë akt nënligjor lidhur me skemën e kreditimit studentor. Lidhur me promovimin e MARS për këtë çështje, nuk kemi informacion konkret për aktivitetet e kryera nga ministria në këtë drejtim.”.

Kurse UNIEL, jep një përgjigje, që nuk lidhet me objektin e pyetjes.

Ndërsa Universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës, ka referuar, sa më poshtë: “Këshilli i Ministrave nuk ka miratuar ndonjë VKM për skemën e kreditimit studentor në periudhën e pandemisë.”

Nga ana e saj MAS ka referuar vështirësitë e ndeshura për avancimin e kësaj problematike drejt zgjidhjes. MAS, nënvizon se: “Në lidhje me projektvendimin “Për kushtet që duhen plotësuar për aplikim për kredi në institucionet publike të arsimit të lartë” sqarohet se në vitin 2018 është hartuar një draft i projektvendimit dhe është dërguar për mendim të ministritë e linjës nëpërmjet sistemit e-aktet. MFE në fazën e mendimeve të këtij projektakti ka dërguar qëndrimin e saj si vijon: “.....nuk shprehemi dakord pasi e konsiderojmë të parakohshëm si iniciativë në një kohë që të ardhurat e veta të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë zënë një përpjesë të ulët ndaj totalit të financimit të tyre vjetor, përpjesë e cila do të zvogëlohet më tej me iniciativën për reduktimin e tarifave të shkollimit dhe të studimit në dy ciklet e para të studimeve universitare (“Bachelor” dhe “Master”). Për këtë arsye, ky projektvendim nuk u propozua për miratim në KM.

Gjetja nga auditimi:

9. Rezulton se akoma nuk është miratuar VKM - ja “Për skemën e kreditimit studentor, si dhe kushtet që duhet të plotësojë studenti për aplikim për kredi”, në moszbatim të Ligjit Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 114, pika 3. Nismat e marra në kuadër të Paktit për Universitetin, janë të para vitit 2020, të cilat u realizuan në përgjigje të nevojave të studentëve në situatë të zakonshme. Ndërkohë skema e kreditimit studentor, si një instrument i parashikuar nga ligji, mbeti e pa miratuar edhe gjatë periudhës së pandemisë, ku studentët dhe familjet u ballafaquan me vështirësi shtesë.

Konkluzioni:

7. Mungesa e miratimit të VKM - së “Për skemën e kreditimit studentor, si dhe kushtet që duhet të plotësojë studenti për aplikim për kredi”, në kushtet e pandemisë, përfaqëson një mungesë më shumë në gamën e instrumentave me të cilat Qeveria do duhej të kishte ndërhyrë në zbatim të një detyrimi ligjor, të projektuar në kushte gjendjeje normale dhe në përgjigje të një mase vështirësish dhe nevojash të lindura në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të shkaktuar nga pandemia Covid 19.

⁷⁶ Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në R.Shqipërisë”, neni 114, pika 1.

⁷⁷ Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në R.Shqipërisë”, neni 114, pika 2.

⁷⁸ Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në R. Shqipërisë”, neni 114, pika 3.

⁷⁹ Përgjigje dhënë Pyetësorit të Grupit të Auditimit, dërguar IAL – ve dhe MAS, të datës 30.03.2022.

Rekomandimi:

8. Ministria e Arsimit dhe Sporteve si institucioni përgjegjës për arsimin, të marrë masa për hartimin, të sensibilizojë, të nxisë dhe të ndjekë miratimin e VKM - së “Për skemën e kreditimit studentor, si dhe kushtet që duhet të plotësojë studenti për aplikim për kredi”.

Menjëherë

Sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit dërguar me shkresën nr. 103/13 prot., datë 30.06.2022 të KLSH dhe protokolluar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), me shkresën nr. 2079/1 prot., datë 04.07.2022 nga subjekti i audituar MAS është paraqitur nëpërmjet e-mailit të datës 01.08.2022 dhe shkresë nr. 2079/3 prot., datë 01.08.2022 të MAS dhe protokolluar në KLSH me nr.103/18 prot., datë 03.08.2022, observacioni sa më poshtë:

“Në lidhje me këtë projektvendim sqarohet se në kushtet e Paktit për Universitetin, kur shteti merr përsipër të subvencionojë 50% të tarifës së shkollimit, të përjashtojë kategori të caktuara nga tarifa e shkollimit, si dhe duke i mbështetur me bursa, nuk është konsideruar efektive që të miratohet ky projektvendim.

Për këtë arsye ky projektvendim nuk është propozuar për miratim në KM.

Megjithatë në rivlerësim të situatës dhe në zbatim të nenit 114, pika 3 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, për hartimin e projektaktit “Për skemën e kreditimit studentor, si dhe kushtet që duhet të plotësojë studenti për aplikim për kredi” është ngritur me urdhër grupi i punës, i cili po punon me hartimin e projektaktit që pritet të miratohet brenda muajit nëntor 2022”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Miratimi i VKM - së “Për skemën e kreditimit studentor, si dhe kushtet që duhet të plotësojë studenti për aplikim për kredi”, mbetet një parashikim ligjor taksativ dhe i paanashkalueshëm. parashikuar në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Sa parashtruar nga MAS dhe faktet e paraqitura, nuk sjellin prova dhe fakte të reja për t’u rimarrë në konsideratë dhe për tu ritrajtuar dhe reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 87, pika 3, parashikon se: “Frekuentimi i procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimdhënëse në auditor, dhe ciklit të studimit, është i detyrueshëm në një masë të caktuar, e cila përcaktohet bazuar në Kodin e Cilësisë dhe udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin.”⁸⁰ Pra masa e detyrueshme e frekuentimit të procesit mësimor, përcaktohet nga këto dy kriterë ligjore, të cilat mbeten kriterë kumulative.

Çështjes se: “Si e kanë verifikuar dhe siguruar IAL – et zbatimin e detyrimit të frekuentimit të procesit mësimor në kushtet e pandemisë Covid 19, në periudhën mars 2020 – dhjetor 2021?”⁸¹, MAS i ka dhënë këtë vlerësim dhe përgjigje Pyetsorit: “Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë është dokumenti kryesor për të gjitha proceset dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë (IAL). Ai përcakton standardet shtetërore të cilësisë, të detyrueshme për zbatim prej institucioneve të arsimit të lartë.

Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë, i miratuar me VKM - në Nr.824, datë 24.12.2021, në pikën 3 ka shfuqizuar VKM Nr. 531, datë 11.09.2018, që miratonte Kodin e mëparshëm të Cilësisë.

Bazuar edhe në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, frekuentimi i procesit mësimor përcaktohet drejtpërdrejt në rregulloret e programeve të studimit të miratuara nga IAL-et, në kuadër të lirisë akademike dhe autonomisë së këtyre institucioneve. Në nenin 3 të ligjit nr. 80/2015 përcaktohet se: “Liria akademike garantohej nëpërmjet së drejtës: a) për të organizuar veprimtaritë e mësim-dhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese; b) për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore;”.

Për sa më sipër IAL-të kanë vepruar në bazë të legjislacionit në fuqi të sipërcituar.”.

Gjithashtu MAS, pa e përmendur faktin se që nga viti 2018, nga titullari i këtij institucioni mungon miratimi i një Udhëzimi “Mbi frekuentimin e procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimdhënëse në auditor, dhe ciklit të studimit”, vë në dukje se: “MAS ka ngritur grupin e punës me

⁸⁰ Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 87, pika 3.

⁸¹ Pyetsori i Grupit të Auditimit, dërguar IAL – ve dhe MAS, më datë 30.03.2022.

urdhërin nr. 189, datë 06.04.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projekt-udhëzimit “Mbi frekuentimin e procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimdhënëse në auditor dhe ciklit të studimit”, i cili do të hartohet brenda muajit prill 2022, duke u bazuar në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjatë periudhës së pandemisë, në mungesë të miratimit të Udhëzimit nga ana e Ministrit të MASR (sot MAS) “Mbi frekuentimin e procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimdhënëse në auditor, dhe ciklit të studimit”, paralelisht me këtë mospërbushje, konstatohet në disa raste, se nga ana e Ministrit të MASR u rekomandohet IAL – ve, që: “Mungesat e studentëve në leksionet apo seminarët “online” të mos i penalizojnë studentët për pjesëmarrje në provime, duke vlerësuar vështirësitë objektive që mund të kenë pasur një pjesë e studentëve gjatë kësaj periudhe”⁸². Ky rekomandim i Ministrit të MASR, citohet nga shkresa Nr. 749/25 prot., datë 11.02.2021, me lëndë: “Mbi zhvillimin e disa prej provimeve të lëndëve specifike në auditorë” drejtuar rektorëve të IA –ve, pika 4.

Por po i njëjti rekomandim, lihet nga Ministri i MASR, edhe në shkresën Nr. 2661/1 prot., datë 10.05.2021, (që shoqëronte Urdhërin nr. 89 prot., datë 10.05.2021, me lëndë: “Për marrjen e masave nga institucione e arsimit të lartë për mbarimin e vitit akademik 2020-2021”), ku në pikën 2 të saj, njësoj si tek shkresa e para tre muajve, thuhet përpikmërisht: “Mungesat e studentëve në leksionet apo seminarët “online” të mos i penalizojnë studentët për pjesëmarrje në provime, duke vlerësuar vështirësitë objektive që mund të kenë pasur një pjesë e studentëve gjatë kësaj periudhe”⁸³. Vlerësimi i këtyre “vështirësive objektive” gjatë periudhës së pandemisë, u është ngarkuar pedagogëve, të cilët pavarësisht se çertifikojnë praninë ose jo në procesin mësimor të studentit, nuk kanë tagër dhe as detyrim, të hetojnë apo vlerësojnë mbi arsyet e mungesave të studentëve.

Sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit dërguar me shkresën nr. 103/13 prot., datë 30.06.2022 të KLSH dhe protokolluar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), me shkresën nr. 2079/1 prot., datë 04.07.2022 nga subjekti i audituar MAS është paraqitur nëpërmjet e-mailit të datës 01.08.2022 dhe shkresë nr. 2079/3 prot., datë 01.08.2022 të MAS dhe protokolluar në KLSH me nr.103/18 prot., datë 03.08.2022, observacioni sa më poshtë:

“....Me miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë me VKM nr. 824, datë 24.12.2021, Ministria e Arsimit dhe Sportit vijoi me miratimin e udhëzimit nr. 13, datë 20.06.2022, “Për frekuentimin e procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimore në auditor dhe ciklit të studimit”, i cili u është dërguar për njohje dhe zbatim të gjitha IAL-ve”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Sa parashtruar nga MAS dhe fakti i paraqitur, provon miratimin nga ana e MAS të Udhëzimit Nr. 13. “Mbi frekuentimin e procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimdhënëse në auditor, dhe ciklit të studimit”, me datë 20.06.2022, afro 6 muaj përtej afatit të përfundimit të periudhës në fokus auditimi dhe pas përfundimit të fazës së terrenit të këtij auditimi.

Ky fakt merret në konsideratë nga GA dhe për këtë gjetje nuk mund të japim rekomandim, pasi nuk ka fushë zbatimi.

- Që nga viti 2018 dhe gjatë gjithë periudhës së pandemisë, Ministri i MASR – MAS nuk ka miratuar një Udhëzim “Mbi frekuentimin e procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimdhënëse në auditor, dhe ciklit të studimit”, sikurse është detyrim ligjor i parashikuar në Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenin 87, pika 3. Më datë 20.06.2022, afro 6 muaj përtej afatit të përfundimit të periudhës në fokus auditimi dhe pas përfundimit të fazës së terrenit të këtij auditimi, nga MAS u miratua udhëzimi nr. 13, datë 20.06.2022, “Për frekuentimin e procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimore në auditor dhe ciklit të studimit”, i cili u është dërguar për njohje dhe zbatim të gjitha IAL-ve”.

Sa i përket bashkëpunimit të aktivizuar midis IAL – ve, dhe institucioneve vendore të ngarkuara për shërbimet shëndetësore, në funksion të zbatimit të planeve të masave higjieno – sanitare për parandalimin e përhapjes së Covid 19, konstatohet se përgjithësisht ky ndërveprim ka qenë korrekt dhe efikas, dhe

⁸² Shkresa e MASR, Nr. 749/25 prot., datë 11.02.2021, me lëndë: “Mbi zhvillimin e disa prej provimeve të lëndëve specifike në auditorë” drejtuar rektorëve të IAL – ve, pika 4.

⁸³ Shkresa Nr. 2661/1 prot., datë 10.05.2021, (që shoqëronte Urdhërin nr. 89 prot., datë 10.05.2021, me lëndë: “Për marrjen e masave nga institucione e arsimit të lartë për mbarimin e vitit akademik 2020-2021”), pika 2.

vetëm në disa raste, IAL – et nuk kanë marrë përgjigjet e pritshme, nga këto njësi shëndetësore, apo nuk është vlerësuar nga ndonjë IAL i nevojshëm ky asistim nga Shërbimi Shëndetësor Rajonal.

Referuar Pyetsorit⁸⁴ të Grupit të Auditimit IAL – et vunë në dispozicion dokumentacion të bollshëm, lidhur me me certifikimin e këtij bashkëpunimi dhe dhanë përgjigjet si më poshtë vijon:

UNIGJI, vë në dukje, se: “Universiteti është asistuar nga Njësia Vendore të Kujdesit Shëndetësor. Çdo ditë ka qenë prezent përfaqësuesi i Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor.... Gjithashtu kemi bashkërenduar punën me Inspektoriatin Shtetëror Shëndetësor - Dega Rajonale Qarku Gjirokastrë dhe jemi mbikqyrur sipas Akt Ekspertimit, si më poshtë.....”. Grupi i Auditimit verifikoi akt-ekspertimet e vëna në dispozicion dhe proces verbalet ditore, të cilat ndodhen në dosjen e përcjellë.

Ndërkaq UNIKO, pohon, se: “Kërkesat për vënien në dispozicion të stafit mjekësor të nevojshëm për zbatimin e masave sipas udhëzimeve të MSHMS, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë, Korçë, janë adresuar në kohë reale dhe me personel të mjaftueshëm e të specializuar nga kjo Drejtori.”. Edhe bashkëpunimi midis Universitetit “Fan Noli” të Korçës dhe Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë, Korçë rezultoi i dokumentuar me plotësi informacioni, sikurse pasqyruar me: shkresën e Rektorit me Nr. 692 prot, datë **20.05.2020**, “Kërkesë për vënien në dispozicion të stafit mjekësor të nevojshëm për zbatimin e masave që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore” drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë, Korçë (sipas Urdhrit Nr. 289, datë 04.05.2020, “Për miratimin e udhëzuesit për masat ndaj Covid-19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore” të MSHMS); shkresën e NJVKSHK nr. 258, datë 28.05.2020 “Kthim Përgjigjeje”; shkresën e Rektorit dhe Administratorit me Nr. 329 prot, datë 15.02.2021 “Kërkesë për vënien në dispozicion të stafit mjekësor të nevojshëm për zbatimin e masave që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore” drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë, Korçë (bazuar në Urdhrin Nr. 289, datë 04.05.2020 të MSHMS “Për miratimin e udhëzuesit për Masat ndaj Covid-19); shkresë e NJVKSHK nr. 99/1, datë 18.02.2021 “Kthim përgjigjeje”.

UNIVlorë, duke vënë në dispozicion mbështetës, ka referuar sa më poshtë: “Gjatë periudhës mars 2020-dhjetor 2021 ka patur kontrole të vazhdueshme, si këshillimore, ashtu dhe zyrtare, nga institucionet përgjegjëse të Shërbimit Shëndetësor Rajonal.”.

UNIEL. dha këtë përgjigje: “Në UNIEL nuk ka patur kërkesë drejtuar Shërbimeve Shëndetësore Rajonale”. Ky universitet nuk e ka patur të nevojshëm asistimin nga Shërbimet Shëndetësore Rajonale, meqë ka ekspertizën dhe burimet e nevojshme profesionale, për shkak të ekzistencës së Fakultetit të Infermierisë, në strukturën e vet.

UPT, nga ana e tij, në përgjigjen e dhënë, ka vënë në dukje, mosreagimin e shërbimeve shëndetësore, lidhur me sa më poshtë: “Universiteti Politeknik i Tiranës, me shkresën nr. 525 prot, datë 22.05.2020, si institucion publik i arsimit të lartë, i kategorizuar si aktivitet me risk të lartë për përhapjen e infeksionit COVID-19, ka kërkuar nga institucionet përgjegjëse, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vënien në dispozicion të personelit shëndetësor (mjek, infermier), me qëllim trajnimin dhe asistimin e personelit të UPT, për të trajnuar dhe asistuar personelin e UPT për evidentimin e simptomave të shkaktuara nga COVID-19. Nga këto institucione nuk është vepruar lidhur me kërkesën e UPT.”. Më tej, edhe ky universitet, duke vënë në dispozicion dokumentacionin e plotë, shprehet, se: “Lidhur me zbatimin e masave higjeno-sanitare, në fakultetet e UPT ka patur kontrole të vazhdueshme nga Instituti i Higjenës për zbatimin e këtyre masave.”.

Referuar shkresës Nr. 525 prot., e datës 22.05.2020, që mban firmën e Administratorit të Universitetit Politeknik të Tiranës, me lëndë: “Kërkesë për bashkëpunim”, drejtuar: Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor; Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor-Tiranë, UPT parashtroi sa më poshtë: “Siç mund të jeni në dijeni, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka miratuar urdhrin nr. 104, datë 30.04.2020 të *“Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019 – 2020 nga institucionet e arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia COVID – 19*. Bazuar në urdhërin e sipërcituar, është parashikuar rikthimi i studentëve në auditore nga data 1 qershor deri në datën 7 gusht 2020, si dhe nga data 25 gusht deri në 30 tetor 2020.

Në zbatim të urdhrin të sipërcituar, si dhe bazuar në urdhrin nr. 289, datë 04.05.2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për miratimin e udhëzuesit për “Masat ndaj COVID – 19 që duhet të ndërmarrin institucionet arsimore”, Universiteti Politeknik i Tiranës me vendimin nr. 63, datë 13.05.2020 të Rektoratit, ka miratuar rregulloren “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes

⁸⁴ Pyetsori i Grupit të Auditimit, dërguar IAL – ve dhe MAS, më datë 30.03.2022.

së infeksionit COVID – 19, gjatë ushtrimit të veprimtarisë akademike dhe administrative në Universitetin Politeknik të Tiranës” në të cilën janë parashikuar një plan masash organizative si dhe një sërë rregullash që duhet të zbatojnë studentët dhe personeli i UPT – së, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit COVID – 19 në ambientet e tij.

Për sa më sipër, duke qenë se aktiviteti arsimor është kategorizuar si aktivitet me rrezik të lartë në planin kombëtar për përhapjen e infeksionit COVID – 19, si dhe duke qenë se Universiteti Politeknik i Tiranës nuk ka punonjës të kualifikuar apo trajnuar për të evidentuar simptomat e shkaktuara nga virusi COVID – 19, për zbatimin sa më eficient të masave të ndërmarra nga institucioni, kërkojmë bashkëpunimin Tuaj për vënien në dispozicion të personelit mjekësor (mjek apo infermier) në 5 (pesë) godinat ku ushtron veprimtarinë Universiteti Politeknik i Tiranës, për një afat të arsyeshëm kohor, me qëllim asistimin dhe trajnimin e personelit të UPT – së, për evidentimin e simptomave të shkaktuara nga virusi COVID – 19 si dhe identifikimin e rasteve të të infektuarve.”⁸⁵.

Institucionet të cilave iu adresua UPT, nuk iu përgjigjën pozitivisht kërkesës së bërë, për bashkëpunim me synim asistimin dhe trajnimin e personelit.

Gjetja nga auditimi:

10. Kërkesa për vënien në dispozicion të personelit mjekësor (mjek apo infermier), për asistimin dhe trajnimin e personelit të Universitetit Politeknik të Tiranës është bërë në zbatim të masave të përcaktuara në Urdhërin Nr. 289 prot., datë, 04.05.2020, të Ministrit të Ministrisë Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, urdhër i cili në pikën 2 të tij, parashikon: “*Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri, Inspektorati Shëndetësor, ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet e qeverisjes vendore.*”⁸⁶. Institucionet e shërbimeve shëndetësore, të cilave iu adresua problematika, nuk u treguan aktivë dhe nuk ofruan bashkëpunimin e kërkuar nga Universiteti Politeknik Tiranë.

Konkluzioni:

8. Mungesa e vënies në dispozicion nga institucionet shëndetësore, të personelit mjekësor (mjek apo infermier), për asistimin dhe trajnimin e personelit të Universitetit Politeknik të Tiranës, pas kërkesës së bërë, nuk i ka shërbyer zbatimit eficient të masave të ndërmarra nga stafi menaxherial i këtij IAL-i.

Rekomandimi:

9. Ministria e Arsimit dhe Sporteve në bashkëpunim me IAL-et, të marrë masa dhe të bashkëpunojë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të përgjegjësuar institucionet shëndetësore që të reagojnë me gatishmëri e dhënien e shërbimeve të kërkuara në situata të gjendjes jashtëzakonshme, në zbatim të detyrimeve të tyre funksionale dhe në përgjigje të nevojave të IAL – ve, si institucione me impakt të lartë social.

Në vijimësi

Një ndër drejtimet kryesore ku adresohet veprimtaria e institucioneve shëndetësore, lidhur me politikat e mbrojtjes së shëndetit publik, është edhe procesi i vaksinimit, meqë kjo formë garanton imunizimin e qytetarit në kontakt me të gjitha burimet e infeksionit. Duke qenë se institucionet publike të arsimit të lartë, kategorizohen si subjekte me aktivitet me risk të lartë për përhapjen e infeksionit COVID-19, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka miratuar dhe përcjellë të gjitha IAL – ve, Urdhërin Nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”, ku në pikën 4, përcaktohej se: “*Për studentët që nuk paraqesin Certifikatën e Vaksinimit Covid-19 apo kartën e vaksinimit, drejtuesit e Institucioneve të Arsimit të Universitar të marrin masa për ofrimin e studimit në platforma alternative, duke filluar nga 11.10.2021.*”⁸⁷.

Vetëm tre ditë më pas, Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nxori për zbatim Urdhërin Nr. 413/1, të datës 27.09.2021 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”, ku pika 4 ndryshonte, si më poshtë vijon: “*Studentët duhet të paraqesin certifikatën e vaksinimit covid-19*

⁸⁵ Shkresa e Universitetit Politeknik të Tiranës, Nr. 525 prot., e datës 22.05.2020, me lëndë: “Kërkesë për bashkëpunim”, drejtuar: Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor; Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor-Tiranë

⁸⁶ Urdhëri Nr. 289 prot., datë, 04.05.2020, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për miratimin e Udhëzuesit për “Masat ndaj Covid 19 që duhet të ndërmarrin institucionet e arsimit”, pika 2.

⁸⁷ Urdhëri i MSHMS Nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”, pika 4.

apo kartën e vaksinimit, për të hyrë në institucionet e arsimit të lartë, duke filluar nga data 11.10.2021”⁸⁸.

“Ky urdhër i përcillet ministrisë përgjegjëse për arsim”⁸⁹, thuhet në Urdhërin Nr. 413/1, të datës 27.09.2021.

Të dy këta urdhëra u miratuan nga MSHMS, në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri Nr. 3614 prot., datë 30.8.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19.

Kjo masë, pavarësisht rënies së numrit të të infektuarve, konsiderohej si politika dhe masa e duhur në stadin aktual të pandemisë së Covid 19.

Lidhur me zbatimin edhe të të këtyre dy urdhërave, MAS u ka përcjellur IAL – ve shkresën Nr. 5378, datë **01.10.2021** “Për zbatimin e akteve rregullatore për marrjen e masave për fillimin e vitit akademik 2021-2022 nga institucionet e arsimit të lartë”.

Urdhëri Nr. 166 datë 17.06.2021 i MAS: “Për caktimin e datës së fillimit dhe mbarimit të vitit akademik 2021 – 2022 në institucionet e arsimit të lartë”, përcaktonte që procesi mësimor i vitit akademik në institucionet e arsimit të lartë, të fillonte në datë 11 Tetor 2021.

Në zbatim të Urdhërit Nr. 395 datë 06.10.2021 të MAS, “Një ndryshim në Urdhërin nr. 166, datë 17.06.2021, “Për caktimin e datës së fillimit dhe mbarimit të vitit akademik 2021 – 2022 në institucionet e arsimit të lartë”” fillimi i procesit mësimor për vitin akademik në institucionet e arsimit të lartë, u shty, duke u njoftuar të fillojë në datë 18 Tetor 2021.

Ndryshimi i urdhërit nr. 166, datë 17.06.2021 u bë “bazuar në propozimin e Konferencës së Rektorëve të datës 05.10.2021.”⁹⁰.

Me shkresën nr. 5447/2 prot., e MAS, me lëndë: “Për marrjen e masave për realizimin e procesit të vaksinimit të studentëve dhe personelit të institucioneve të arsimit të lartë nga personeli mjekësor.”, dërguar IAL – ve, e cila u përcillte për njohje IAL – ve Urdhërin Nr. 395, datë 06.10.2021 të MAS, u kërkohej “të gjitha institucioneve të arsimit të lartë, që krahas marrjes së masave, për fillimin e vitit akademik 2021 – 2022, të merren gjithashtu masa edhe për të krijuar kushtet e nevojshme, ambjente të përshtatshme dhe personel administrativ, për kryerjen e procesit të vaksinimit të studentëve nga personeli mjekësor, që do të paraqitet pranë institucioneve të arsimit të lartë në datat 11-18 tetor 2021, duke respektuar aktet rregullatore lidhur me masat dhe protokollet higjieniko – sanitare mbi parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid 19.”.

Edhe “Shtyrja e datës së fillimit të vitit akademik në institucionet e arsimit të lartë, vlerësohet se do t’i shërbejë të gjitha IAL – ve të marrin masat e nevojshme për fillimin normal të këtij viti akademik....”⁹¹, gjë e cila përcaktonte fillimin e mësimin në auditor, pa alternativën e mësimin online.

Zbatimi i dy urdhërave të mësipërm, nr. 413 dhe nr. 413/1, ka ndeshur në kundërshtinë e një pjese jo të vogël të studentëve, duke vënë IAL – et në vështirësi, sa i takon përmbushjes së detyrimeve që burojnë prej tyre.

Nga informacioni i përcjellë me e – mail, më datë 29.04.2022 prej UNIGJI, konstatohet se nuk ka asnjë evidencë lidhur me numrin e studentëve të vaksinuar as të ditëve, që i paraprinin datës së fillimit të procesit mësimor, 18.10.2021, dhe as të më pas. Ndërsa evidencat e personave të vaksinuar, pjesë e stafit të njësive kryesore, më e fundit prej tyre, shkresa nr. 905/1, datë 30.07.2021 (të dhëna më të vona nuk ka), përcjellë Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Gjirokastër, vë në pah se një pjesë e personelit ishte e pavaksinuar, qoftë edhe me një dozë. Pra Urdhërat 413 dhe 413/1 konsiderohen të pazbatuar plotësisht nga UNIGJI.

Ndërkaq UNIKO, bën me dije në informacionin e mbërritur me e – mail Grupi të Auditimit, më datë 26.04, se: “Në përgjigje të Kërkesës për informacion, në zbatim të Urdhërit 413 dt.24.09.2021 dhe 413/1 27.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid-19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët” dhe Urdhërit nr. 413/1, datë 27.09.2021 “Për një ndryshim në

⁸⁸ Urdhëri Nr. 413/1, po të MSHMS – së, datë 27.09.2021 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”, pika 1, që ka ndryshuar pikën 4 të urdhërit Nr. 413.

⁸⁹ Urdhëri Nr. 413/1, po të MSHMS – së, datë 27.09.2021 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”, pika 2.

⁹⁰ Urdhëri Nr. 395 datë 06.10.2021 të MAS, “Një ndryshim në Urdhërin nr. 166, datë 17.06.2021, “Për caktimin e datës së fillimit dhe mbarimit të vitit akademik 2021 – 2022 në institucionet e arsimit të lartë””, pika 1.

⁹¹ Shkresa nr. 5447/2 prot., e MAS, me lëndë: “Për marrjen e masave për realizimin e procesit të vaksinimit të studentëve dhe personelit të institucioneve të arsimit të lartë nga personeli mjekësor.”, dërguar IAL – ve.

urdhërin nr. 413, datë 24.09.2021 ju informojme se nga ana jonë vijoi vazhdimi i procesit mësimor pa marrë parasysh Urdhërin e mësipërm, ndërkohë vijonte procesi i vaksinimit. Ne muajin janar 2022 ne Universitetin "Fan Noli" sipas raportimit të bërë dhe ne Ministrinë e Arsimit, vaksinimi ka qenë për stafin akademik 98%-99%, dhe studentët 90%.”. Duke mos dashur të penalizojë studentët e pavaksinuar, për të ndjekur rregullisht procesin mësimor në auditore, ky universitet nuk e ka marrë parasysh Urdhërin 413.

Kurse UNIVlorë, duke mos vënë në dispozicion asnjë evidencë a dokument, lidhur me ecurinë e procesit të vaksinimit, për efekt të detyrimit për të zbatuar dy urdhërat Nr. 413 dhe Nr. 413/1, dëshmon se nuk i ka zbatuar.

UNIEL, me e – mailin e datës 27.04.2022, ka përcjellë dokumentacion mbi procesin e vaksinimit dhe raportimeve të bëra pranë MAS. Dy muaj pas fillimit të vitit akademik 2021-2022, në e – mailin e datës 15.12.2021, “Dërgohet informacion lidhur me studentët e vaksinuar në UE”, që ky universitet i përcjell Drejtorisë së Arsimit të Lartë në MAS, komunikohet: “.... ju informojmë se % e studentëve të vaksinuar në Universitetin e Elbasanit, është si më poshtë:

Fakulteti i Shkencave të Edukimit	30%
Fakulteti Ekonomik	20%
Fakulteti i Shkencave Humane	10%
Fakulteti i Shkencave të Natyrës	50%
Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike	40%” ⁹²

UPT, nga ana e tij, nga të dhënat e përcjella nga dy fakultete, ai i Inxhinierisë Mekanike dhe ai Inxhinierisë së Ndërtimit (), nga të cilët kërkuam informacion të mbështetur në dokumentacion certifikues, nuk ka patur një ecuri ndryshe nga institucionet e tjera të arsimit të lartë të audituar.

FIM, në e – mailin e datës 27.04.2022, përcjellë Grupit të Auditimit, për informacion bënte me dije se: “... Problematikë në këtë proces ka qenë mundësia e kufizuar për të kontrolluar studentët që hynin në ambientet e fakultetit pasi hyrjet nuk janë të centralizuara.”⁹³.

Ndërkohë evidencat e përcjella, nuk provojnë zbatimin e plotë të dy urdhërave, nr. 413 dhe 413/1.

Ndërkaq FIN, në e – mailin e datës 27.04.2022, përcjellë Grupit të Auditimit, veç të tjerash vë në dukje se: “... Gjatë zbatimit të këtij procesi jo vetëm grupi i punës por edhe drejtuesit akademik dhe administrativ të FIN u përballen me disa problematika të cilat e bënë të vështirë monitorimin e këtij procesi deri në fund” në dukje. Disa problematika që u zgjidhen hap pas hapi ishin: Studentet e pavaksinuar krijojnë situata të vështira, deri në pjesëmarrjen në procesin mësimor, pamvarësisht pengimit të tyre nga grupi i punës monitorues i procesit.”⁹⁴.

Evidencat e dërguar nga FIN provon se një pjesë e madhe e studentëve të këtij fakulteti kanë ndjekur procesin mësimor pa qenë të vaksinuar.

Pra, edhe në UPT, dy urdhërat, nr. 413 dhe nr. 413/1, kanë gjetur zbatim të pjesshëm.

Kundërshtia e studentëve për t’iu nënshtruar procesit së vaksinimit lidhet me refraktaritetin ndaj idesë për t’iu nënshtruar urdhërave të MSHMS, duke patur frikë se vaksinat mund të sjellin pasoja aftgjata në shëndetin e tyre. “Veç kësaj, atyre nuk iu dha mundësia e zgjedhjes së vaksinës. Ndërkohë, ultimatumi i qeverisë se nuk do lejohen studentë apo pedagogë të pavaksinuar në auditore, duket se ka rënë. Vetë rektorët vendosën që pajisja me certifikatë vaksinimi nuk është kusht për praninë fizike të studentëve në auditore.”⁹⁵.

Gjetje nga auditimi:

11. Procesi i vaksinimit para fillimit të vitit akademik 2021 – 2022, i iniciuar në zbatim të Urdhrit të MSHMS – së, Nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët” dhe Urdhërit të MSHMS - së, Nr. 413/1, të datës 27.09.2021 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”, i cili ishte kusht për praninë e studentëve në auditore, nuk u përvijua nga IAL –et, në respekt të plotë të sa parashikuar në këto dy akte. Detyrimi i parashikuar në pikën 1, të Urdhërit Nr. 413/1, datë, datë

⁹² E – maili i datës 15.12.2021, “Dërgohet informacion lidhur me studentët e vaksinuar në UE”, dërguar nga Universiteti “Aleksandër Xhuvani” i Elbasanit, MAS – it.

⁹³ E – maili i datës 27.04.2022, dërguar nga FIM i Universitetit Politeknik të Tiranës Grupit të Auditimit.

⁹⁴ E – maili i datës 27.04.2022, dërguar nga FIN i Universitetit Politeknik të Tiranës Grupit të Auditimit.

⁹⁵ <https://faktoje.al/ministria-e-shendetesise-konfirmon-se-studentet-nuk-munden-te-zgjedhin-llojin-e-vaksines-anticovid/>

27.09.2021, që “Studentët duhet të paraqesin certifikatën e vaksinimit COVID-19 apo kartën e vaksinimit, për të hyrë në institucionet e arsimit të lartë, duke filluar nga data 11.10.2021”⁹⁶, nuk është respektuar dhe zbatuar nga IAL – et me rigorozitet dhe studentët kanë qenë të pranishëm në auditore pavarësisht mos vaksinimit të tyre, meqë edhe alternativa e mësimi online për të pavaksinuarit, u hoq pas ndryshimit të pikës 4 të Urdhërit nr. 413, me parashimin e pikës 1 të Urdhërit Nr. 413/1.

Konkluzioni:

9. Rreziku i infektimit nga Covid 19 për të pa vaksinuarit, është problem me ndikim të lartë në shëndetin personal të të infektuarve, por edhe problem për shëndetin publik, pasi nuk janë zbatuar e respektuar kërkesat e urdhërave nr. 413 dhe nr. 413/1 të Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Rekomandimi:

10. Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe IAL – et, të marrin masa dhe të bashkëpunojnë me institucionet që bëjnë politikat e shëndetit publik dhe sigurojnë zbatimin e tyre për rastet e fatkeqësive natyrore shkaktuar nga pandemitë, si dhe zbatimin e masave të urdhëruara si të detyrueshme, për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive, përfshirë edhe proceset e vaksinimit masiv.

Në vijimësi

Sa trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit dërguar me shkresën nr. 103/13 prot., datë 30.06.2022 të KLSH dhe protokolluar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS), me shkresën nr. 2079/1 prot., datë 04.07.2022 nga subjekti i audituar MAS është paraqitur nëpërmjet e-mailit të datës 01.08.2022 dhe shkresë nr. 2079/3 prot., datë 01.08.2022 të MAS dhe protokolluar në KLSH me nr.103/18 prot., datë 03.08.2022, observacioni sa më poshtë:

“Ministria përgjegjëse për arsimin dhe sportin, bazuar edhe në vendimin nr. 523, datë 22.9.2021 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit”, i ndryshuar, është institucioni që realizon programin qeverisës në fushën e arsimit parauniversitar, të lartë, kërkimit shkencor dhe sportit.

Ndërsa institucionet që bëjnë politikat e shëndetit publik dhe sigurojnë zbatimin e tyre janë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e saj të varësisë, për rrjedhim sqarojmë se është jashtë fushës së përgjegjësisë shtetërore të MAS hartimi dhe zbatimi i politikave të shëndetit publik.

Ndonëse sa më lart, sqarojmë se MAS ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme, siç janë shpjeguar më lart dhe do të vijojë të marrë masat të njoftojë dhe sensibilizojë të gjitha institucionet e arsimit të lartë me çdo vendimmarrje të strukturave përgjegjëse në fushën e shëndetësisë, duke respektuar legjislacionin në fuqi lidhur me lirinë akademike dhe autonominë institucionale të IAL-ve”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Ligji Nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenin 7, pikën 2, germën e), përcakton se: “Ministria përgjegjëse për arsimin (ndr. MAS)”... “kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi”.

Edhe zbatimi i urdhërave të autoriteteve shëndetësore, sikurse ato të vaksinimit, nga sistemi i arsimit të lartë, përbën një veprimtari të IAL – ve, pajtueshmëria e të cilit me aktet ligjore e nënligjore në fuqi duhet të kontrollohet edhe nga MAS, veç autoriteteve të tjera. Edhe për këtë arsye pranë MAS – it janë përcjellë nga IAL – et vijimësisht raporte periodike mbi ecurinë e procesit të vaksinimit, për sa kohë MAS mbart përgjegjësi solidare me autoritete të tjera.

Sa parashtruar nga MAS dhe faktet e paraqitura, nuk sjellin prova dhe fakte të reja për t’u rimarrë në konsideratë dhe për tu ritrajtuar dhe reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

PYETJA NR.2 A ËSHTË NGRITUR INFRASTRUKTURA E DUHUR PËR T’JU PËRGJIGJUR NË KOHË DHE ME EFEKTIVITET SITUATES SË KRIJUAR PREJ PANDEMISË COVID 19.

4.2.1. A janë ngritur dhe a kanë funksionuar në përmbushje të objektivave të reja, strukturat brenda IAL-eve?

- Nga auditimi ka rezultuar se departamentet nuk kanë bërë:

⁹⁶ Urdhëri i MSHMS - së, Nr. 413/1, të datës 27.09.2021 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”, pika 1.

- analizë të nevojave në lidhje me kapacitetet që duhet të kenë klasat virtuale, me qëllim funksionimin real dhe pa problem të tyre;
 - analizë në lidhje me nevojat për punët laboratorike;
 - studim apo analizë mbi gjendjen e infrastrukturës dixhitale për të njohur kapacitetin e nevojshëm për shkarkimin e leksioneve, detyrave të kursit, projekteve etj. Si pasojë e evidentimit të problematikave të mësipërme, rezultoi se universitetet objekt auditimi aplikuan disa platforma (shpesh të përzgjedhura individualisht nga pedagogët), si Google-classroom, Microsoft Teams dhe Zoom, të cilat nisur edhe nga përgjigjet e pyetësorëve paraqitën problematika teknike, që lidhen me internetin dhe aksesimin e platformave.
 - Studentët dhe pedagogët kanë paraqitur paqartësi në lidhje me adresimin e ankesave gjatë periudhës së pandemisë dhe në asnjë rast nuk u hartua gjurma e auditimit për trajtimin e ankesave.
 - Në asnjë rast nuk është hartuar dhe miratuar rrjedha e dokumentuar e aktiviteteve (nga fillimi deri në përfundim të tyre) sa i takon procesit mësimor online(distancë) dhe auditor në periudhën e pandemisë 2020-2021, që synon të ripërshkruaj të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to (gjurma e auditimit). Konkretisht, monitorimi i orëve të mësim, u bazua tek vetdeklarimi i secilit pedagog pas zhvillimit të procesit mësimor, që raportohej çdo javë pranë Drejtorisë së Kurrikulave të IAL-eve, informacion të cilin e kanë përcjellur në MASR.
 - Mungesa e gjurmëve të auditimit për zhvillimin e një procesi mësimor, duke mos siguruar dokumentimin e operacioneve në formë të tillë, që t'u mundësojë audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, kjo në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.
 - Asnjë nga IAL-et nuk ka evidenca se sa është frekuentimi i bibliotekës dixhitale gjatë pandemisë nga studentët, të cilët mund të aksesonin në bibliotekën dixhitale vetëm me anë të acauntit(llogarisë) të mundësuar nga fakultetit përkatës, ardhur nga mungesa e aksesit të IAL-ve në sistemin digital.
 - Asnjë nga IAL-et në fillim të vitit akademik 2021-2022, nuk u ka ofruar mundësinë e kryerjes së testit PCR falas studentëve të cilët kanë qënë të pavaksinuar, dhe sipas Urdhërit Nr. 395 datë 06.10.2021 i MAS dhe Urdhërit Nr. 413 datë 24.09.2021, Udhërit 413/1 datë 27.09.2021 i MSHMS në auditor, do të lejohen vetëm studentët me certifikatë vaksinimi, testin PCR negativ ose vërtetim nga mjeku për pamundësi të kryerjes së vaksinës, këta studentë nuk lejohej të hynin në auditor.
- Nisur nga sa më sipër, e kemi të pamundur të japim siguri të arsyeshme, mbi efektivitetin e orëve të mësim, për sa kohë që sistemet e kontrollit që duhej të ngriheshin për këto procese, të gjeneruara nga platformat e përdorura, nuk janë ngritur.**

- Në fillimin e pandemisë Covid - 19, që përkon me vitin akademik 2019-2020, Universitetet publike u përballën me një sfidë të vështirë për sa i përket ngritjes së infrastrukturës së nevojshme për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të studentëve dhe të personelit akademik si dhe vazhdimin e procesit mësimor në kushtet e reja të krijuara si pasojë e pandemisë Covid 19 nga data 9 Mars 2020 deri më datën 31 Dhjetor 2021, që është edhe periudha objekt auditimi i grupit të KLSH-it. Situata e krijuar, izolimi dhe kushtet e reja që u krijuan si rezultat i pandemisë Covid-19, si dhe vendimet e marra nga Komiteti i Ekspertëve pranë MSHMS, ngritur për këtë qëllim, krijuan nevojën e formimit të një infrastrukture të re dhe të panjohur më parë nga stafet menaxhuese dhe akademike të IAL-eve, duke patur si qëllim kryesor mbrojtjen e jetës së studentëve dhe të personelit akademik, për të krijuar kushte sa më të sigurta higjieno-sanitare. Përveç infrastrukturës së re, ka lindur nevoja e vazhdimin të procesit mësimor në distancë (online), praktikë kjo e pazbatuar më parë. IAL-et janë mbështetur në përvojat më të mira të sjella nga stafet akademike, si dhe nevojat për mënyra të reja mësimdhënie, duke marrë masa të menjëhershme për zhvillimin e mësimin nëpërmjet platformave të mësimin online. Në fillim të këtij procesi janë përdorur lloje të ndryshme platformash si pasojë e gjendjes së papërgatitur dhe nevojës së menjëhershme për mësim online, konkretisht: platforma Office 365 for Education, Google Classroom, Edumet dhe Moodle, të cilat kanë shërbyer për të mbështetur mësimdhënien online nëpërmjet krijimit të klasave virtuale për zhvillimin e video konferencave, dizenuar dhe zhvilluar nga Google.
- Pas periudhës së parë të zhvillimit të mësimin online (semestri i dytë i vitit akademik 2019- 2020), nga IAL-et janë marrë masa për zbatimin e një platforme të unifikuar për të gjithë stafin akademik përpara fillimit të vitit të ri akademik 2020-2021. Në disa IAL-e janë zhvilluar trajnime për mundësitë që ofron paketa Microsoft Office 365 në të cilën përfshihet edhe platforma Microsoft Teams. I gjithë viti akademik është zhvilluar mbi bazën e kësaj platforme, që mund të përdoret edhe në vazhdim, duke

mundësuar abonimin në bibliotekën online dhe duke vënë në zbatim projektin “Cleanscore” si një format vlerësimi online për studentët.

Me shpërthimin e situatës pandemike procesi mësimor në auditor u ndërpre, për një periudhë 2-javore, me qëllim parandalimin e përhapjes së pandemisë, sipas urdhrit të MSHMS nr.135, datë 09.03.2020. Listimi i këtyre akteve për çdo IAL është trajtuar gjërësisht në pyetjen 1 të këtij Raporti Përfundimtar të auditimit dhe nga grupi i auditimit administrohen të gjitha praktikën e këtyre akteve .

2.2.1 A janë ngritur dhe a kanë funksionuar në përmbushje të objektivave të reja, strukturat brenda IAL-eve?

Nga universitetet objekt auditimi me fillimin e situatës së pandemisë Mars 2020-Dhjetor 2021, periudhë që përkon me periudhën e auditimit nga ana jonë, rezultoi se IAL-et kanë marrë masa, duke ngritur grupe pune dhe riorganizuar strukturat e tyre në funksion të përmbushjes së objektivave për zhvillimin e procesit mësimor në distancë (online) dhe në auditor, pas kthimit të studentëve, bazuar kjo në vendimet e Komitetit të Ekspertëve pranë MSHMS-së, duke hartuar dhe dokumentacionin administrativ dhe tekniko-metodik në zbatim të të gjithë akteve ligjore dhe normative dhe udhëzimeve e Urdhërave nga MASR dhe institucioneve të tjera, që kishin kompetenca vendimmarrje dhe detyruese për zbatim (institucione shëndetësore e higjieno- sanitare, organet e rendit, etj.) Në auditimin e kryer në IAL-et, u konstatua se për veç disa problematikave që janë evidentuar nga grupi i auditimit të KLSH-it, nga IAL-et ka patur vlerësim emergjent, duke plotësuar paketën ligjore e administrative për çdo vendimmarrje nga Senati, Bordi i Administrimit ashtu dhe nga Rektori e Konferenca e Rektorëve (praktikat e këtyre dokumenteve për çdo IAL janë administruar nga grupi i auditimit dhe sipas Universiteteve, llojeve të akteve e numër. Konkretisht, në lidhje me përdorimin e platformave dhe përgatitjen e stafeve sipas mundësive ekzistuese të IAL-eve, ka rezultuar se janë marrë masa për përdorimin e platformave online, që ishin Google Meet+Google Classroom si dhe Zoom Software (trajtuar për tre universitetet në vijim, më poshtë). Nëpërmjet këtyre platformave u synua krijimi i klasave virtuale të leksionit dhe të seminarit, për t'i dërguar materialet online studentëve, si dhe për komunikimin online me ta, duke shpjeguar leksionet, seminarët, të cilat janë zhvilluar sipas orarit mësimor të miratuar për mësimin në auditorët e fakultetit. Procesi i monitorimit u bazua tek vetëdeklarimi i secilit pedagog, pas zhvillimit të procesit mësimor, gjë kjo që sjell pamundësinë e dhënies së një vlerësimi të saktë , pasi informacioni është i njëanshëm. Ky vetëdeklarim është raportuar çdo javë në Drejtorinë e Zhvillimit Kurrikular të IAL-eve, të cilat informacionin e kanë përcjellë në MASR(pas muajit Shtator 2021 MAS), Pra, është konstatuar se ka munguar ngritja e një sistemi të mirëfilltë kontrolli për këtë proces, duke u mjaftuar me vetedeklarimin dhe nuk janë ngritur sisteme kontrolli mbi zhvillimin e procesit mësimor në kushtet e mësimin në distancë (online).

Për unifikimin e platformës elektronike për zhvillimin e procesit online, grupi i punës i ngritur me Urdhër të Rektorit të UPT-së nr. 85, datë 16.09.2020. për “Ngritjen e grupit të punës i cili do të ndjekë procesin e unifikimit të platformës online të Universitetit Politeknik të Tiranës, pas diskutimeve të zhvilluara në takimet e punës, ka hartuar më datë12.10.2020, Raportin Teknik për unifikimin e platformës online në UPT, në të cilin sqarohej se nga vlerësimi i treguesve specifikë, si në raport me kapacitetin ashtu dhe ndërveprimin që ka ofruar pedagogut dhe ndërmjet studentit, platforma më e përshtatshme rezultoi ajo e ofruar nga Microsoft Office 365, e cila u ofrohet pa pagesë Universiteteve. Ndërsa Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës ka kërkuar përdorimin e platformës së personalizuar E-learning-FAU. Nga verifikimi në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU) u evidentua se mënyra (modeli) e zhvillimit të lëndës nga platforma e-learning FAU është kombinuar me platformën Zoom. Kështu është vepruar edhe me modelin Google classroom që është kombinuar me platformën Zoom. Siç e trajtuam, zgjedhja e kësaj platforme është bërë pas vlerësimit të nevojave që janë paraqitur, të diktuar nga situata e pandemisë si dhe bazuar në shkallën e njohurive fillestare që kishin stafet akademike, por nuk dokumentohet asnjë analizë nevojash që të nis nga departamentet respektive mbi kapacitetet që duhet të kenë klasat virtuale, në mënyrë që të funksionojnë pa problem; nëse kanë nevojë apo jo për punë laboratorike; kapaciteti i nevojshëm që platformat duhet të kenë për të shkarkuar detyra kursi; etj.. Nga grupet e punës nuk ka patur specifikime konkrete dhe në asnjë IAL nuk është parashikuar se si do të bëhej kontrolli apo mbikqyrja e këtij procesi. Pra, nuk është kërkuar dhe programuar asnjë gjurmë kontrolli (auditimi).

- Në Universitetin Fan NOLI (UNIKO)

Situata e pandemisë solli si nevojë zhvillimin e mësimi online nëpërmjet platformave. Ky proces nuk ishte kryer ndonjëherë nga IAL-et deri në shfaqjen e pandemisë (përdorimi i ndonjëres prej tyre ishte kryer vetëm për dërgimin e detyrave të kursit dhe materialeve shtesë të leksioneve, si për projekte, punë laboratorike të filmuara, etj.) Në fillim të emergjencës (situatës së jashtëzakonshme të pandemisë), gjatë muajve Mars-Prill 2020, mësimi është zhvilluar me disa platforma. Platforma kryesore ishte Google-classroom, e cila i krijonte pedagogut mundësinë e regjistrimit për vlerësimin e studentëve. Disa nga pedagogët, nuk janë përshtatur mjaftueshëm me platformën Google-classroom për shkak të moshës së tyre. Nga analiza e kryer nga grupi i auditimit, bazuar në informacionet e grumbulluara, intervistat e kryera dhe takimet Fokus grup, rezultoi se IAL-et i janë nënshtruar situatës emergjente dhe kohës së pamjaftueshme për të kryer studimin apo vlerësimin e llojeve të platformave. Kjo, për shkakun se informacionet e vlerësuara kanë qenë të kufizuara (private) dhe nuk ka asnjë llogaritje apo vlerësim të nevojave që kanë patur, gjë që pasqyrohet edhe në treguesin specifik të tyre për nevojat e krijuara.

Me fillimin e vitit akademik 2020-2021, i gjithë procesi i mësimdhënies është kryer nëpërmjet platformës Microsoft Teams. Së bashku me të është përgatitur rregullorja e përdorimit dhe manuali udhëzues se si mund të aksesonin në Platformën Teams. Që në fillim ka patur një angazhim të ndërsjelltë me departamentin e IT-së të IAL. Është evidentuar se në këtë proces, shqetësim ka qenë përshtatja e grupmoshave të pedagogëve, të cilët kishin vështirësi të përshtateshin menjëherë me këtë platformë. Konstatohet se rreth 70% e pedagogëve janë përshtatur mirë dhe kanë punuar me këtë platformë. Nga auditimi i procesit të të dhënave që pedagogët kanë mbajtur në mënyrë periodike, në lidhje me prezencën dhe aktivizimin e studentëve gjatë leksioneve, seminareve apo dhe orëve laboratorike u konstatua se, për ruajtjen e tyre ata mbanin një regjister fizik në të cilin regjistronin manualisht vlerësimet e studentëve gjatë vitit akademik.

Me fillimin e zhvillimit të mësimi online duke filluar nga muaji Mars 2020, u mundësua krijimi dhe funksionimi i regjistrimit elektronik nëpërmjet platformës Microsoft Teams, përzgjedhur nga Universitetet, sipas të cilit vlerësimi i studentëve kryhet 30% sipas ecurisë gjatë leksioneve dhe 70% në bazë të vlerësimit përfundimtar.

Raportimi nga pedagogët për pjesëmarrjen e studentëve në mësimin online, është bërë për çdo javë në % dhe jo në numër studentësh pranë përgjegjësit të departamentit në mënyrë manuale, por të dhënat statistikore, nuk kanë gjeneruar nga platforma elektronike.

Është konstatuar se regjistri elektronik nuk u përdor nga stafi akademik i universitetit Fan Noli, Korçë, dhe pse platforma Microsoft Teams e mundësonte funksionimin e regjistrimit elektronik,.

Është konstatuar se gjatë mësimdhënies online nuk janë kryer orët e praktikave mësimore, pasi shumë programe studimi siç janë, programi i infermierisë, programet e bujqësisë, programet biologji-kimi, fizika, kanë punë laboratorike.

-Në Universitetin Ismail Qemali (UNI Vlora)

Në UNI Vlora mësimi online ka filluar më datë 21 Mars 2020 përmes platformën google-classroom. Pedagogëve dhe studentëve në fillimet e përdorimit të platformës, u është vënë në dispozicion udhëzuesi i përdorimit të platformës online "Google classroom" për mësimdhënien online.

Stafi akademik duke respektuar rregullat e vendosura nga MSHMS ka realizuar trajnim në lidhje me përdorimin e kësaj platforme nga stafi i IT të këtij Universitetit. Kapaciteti për këtë platformë përfshin 100 usera në klasën virtuale dhe kohazgjatja e orëve të mësimi është 60 minuta.

Gjatë asaj kohe në marketingun e produkteve të zhvillimit të programeve që përdoren, ka patur dhe platforma të tjera të mësimi online me pagesë si dhe platforma falas, siç ishte rasti platformës Microsoft Teams e 365 nga UPT, UElbasan, UNIKO e UEGJ dhe UNIVLORA Google classroom. UPT ka bërë një marrëveshje dhe e ka përfituar falas. Kështu kanë bërë edhe universitetet e tjera të cilat bëjnë pjesë në kërkimin shkencor. Atyre u mundësohet përdorimin falas i platformës në fjalë. Platforma Google-Classroom, për të cilën ka një historik përdorimi prej 10-vitesh në univlora.edu.al. Bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të auditimit gjendet korrespondenca e UPT me kompaninë Microsoft Teams, ku është evidentuar dhënia e shërbimit pa pagesë.

Gjatë periudhës Mars-Qershor 2020 është mbajtur manualisht listëprezenca e çdo studenti pjesëmarrës në seminare si dhe e orëve laboratorike gjatë mësimdhënies.

Organizimi i mësimi online është bërë në nivel qendror nga IT-ja e Universitetit. Mësimi online është vendosur të zhvillohej nëpërmjet platformës Google-Classroom. IT-të kanë përshtatur platformën duke u dhënë akses me adresat zyrtare në uni.edu.al. Nga verifikimi i kryer në dokumentacionin e paraqitur dhe në të dhënat e platformës, rezultoi se, organizimi ka qenë: pedagogu gjeneron klasën në google

classroom me adresën personale, invitelecter(thirrje ose njoftim, e ka platforma) i drejtoheshe shëfës së departamentit dhe asistentes së dekanit. Më pas u dërgoheshin ftesa studentëve në adresën univlora.edu.al. Mirëpo, problem ka qenë fakti që një pjesë e studentëve kanë aksesuar me adresat e tyre personale, pasi këta studentë përdornin celularët (Android) si mjet pune, dhe në celularët Android adresa zyrtare ishte shumë e vështirë të hapej. Shëfja e Departamentit dhe asistentja e dekanit për çdo fakultet përkatësisht kanë qenë (mbikqyrës), si pjesë e të gjitha leksioneve dhe në përfundim të simestrit, tek invitelecter janë dërguar të gjitha leksionet e regjistruara. IT e çdo fakultetit disponon të gjitha arkivat digjitale të leksioneve. Grupi i auditimit me zgjedhje auditoi checklist-at e pjesëmarrjeve të studentëve në leksoine, seminare, dhe dorëzimeve të detyrave të kursit si dhe orëve të punës laboratorike, pranë Fakultetit të Shkencave Humane të Natyrës, në lëndën e shëndetit publik. Konkretisht, janë marrë evidencat e datave 22, 25 Prill dhe 21, 28, 29 Maj të cilat u gjeneruan nga vetë grupi i auditimit në platformë.

-Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT). Gjatë fazës së parë pandemike Mars – Qershor 2020 për periudhën akademike 2019-2020, në mënyrë specifike, Fakulteti i Arkitekturës së UPT-së, ka kryer testimin e platformave Google-classroom, Microsoft Teams dhe Zoom nga data 9 Mars- 21 Mars 2020. Në datë 30 Mars 2020 ka iniciuar mësimin online. Java e parë e muajit Prill ka qenë periudhë testi e këtyre platformave. Kështu ka lindur nevoja për çeljen e llogarive në FAU për çdo student në uni.edu.al gjatë Shtatorit të po këtij viti. Gjatë kësaj faze rezultoi se platformat Google classroom dhe Zoom ishin më të përshtatshme për realizimin e mësimin online sipas programeve mësimore që ky fakultet ofron.

Gjatë muajit Gusht-Shtator 2020 është vendosur që të realizohej përmbushja e programit mësimor dhe rikuperimi i pikëve ose orëve të pa realizuara për pedagogët, të cilët nuk kishin mundësi për të kryer mësimdhënien në platformat online për shkaqe specifike, e cila u përmbush duke zbatuar Urdhërin Nr. 104 datë 30.04.2020 të MASR “Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020 nga institucionet e arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqsisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e covid-19”.

Platforma E-learning filloi implementimin në Shtator 2020, ku pjesëmarrja në leksione gjatë simestrit të parë për vitin akademik 2020-2021 ka qenë e ulët, ndërsa në seminare pjesëmarrja ka qenë e plotë, pasi vetë specifika e lëndës e detyron studentin të jetë prezent në punët laboratorike dhe detyrat e kursit.

Për periudhën Mars-Qershor 2020, njësitë bazë kanë punuar kryesisht me udhëzime të mbërritura pranë tyre në rrugë elektronike nga MASR/rektori/dekani. Për vitin akademik 2020-2021, njësitë bazë të fakultetit e kanë realizuar mësimin online në formë më të unifikuar nga pikëpamja organizative dhe në zbatim të udhëzimeve/rregulloreve të posaçme të miratuara nga organet kolegjiale (rektorat, senat) dhe vendimet e dekanatit.

- Gjatë periudhës së pandemisë pjesa më e madhe e studentëve e zotëronin Kartën e studentit, por është konstatuar se nuk kanë patur asnjë lehtësi apo përfitim konkret gjatë periudhës së pandemisë Covid 19. Kjo është përgjegjësi e pushtetit vendor dhe MASR, si palë iniciuese dhe realizuese në zbatim të politikave të arsimit të lartë, IAL-et etj.).

Gjetje nga auditimi:

12. Procesi i vaksinimit para fillimit të vitit akademik 2021–2022, i iniciuar në zbatim të Urdhrit të MSHMS – së, Nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët” dhe Urdhërit të MSHMS - së, Nr. 413/1, të datës 27.09.2021 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”, i cili ishte kusht për praninë e studentëve në auditore, nuk u përvijua nga IAL –et, në respekt të plotë të sa parashikuar në këto dy akte. Detyrimi i parashikuar në pikën 1, të Urdhërit Nr. 413/1, datë, datë 27.09.2021, që “Studentët duhet të paraqesin certifikatën e vaksinimit COVID-19 apo kartën e vaksinimit, për të hyrë në institucionet e arsimit të lartë, duke filluar nga data 11.10.2021”⁹⁷, nuk është respektuar dhe zbatuar nga IAL – et me rigorozitet dhe studentët kanë qenë të pranishëm në auditore pavarësisht mos vaksinimit të tyre, meqë edhe alternativa e mësimin online për të pavaksinuarit, u hoq pas ndryshimit të pikës 4 të Urdhërit nr. 413, me parashimin e pikës 1 të Urdhërit Nr. 413/1.

⁹⁷ Urdhëri i MSHMS - së, Nr. 413/1, të datës 27.09.2021 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 413, datë 24.09.2021 “Për marrjen e masave për parandalimin e infeksionit covid -19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët”, pika 1.

Konkluzioni:

9. Rreziku i infektimit nga Covid 19 për të pa vaksinuarit, është problem me ndikim të lartë në shëndetin personal të të infektuarve, por edhe problem për shëndetin publik, pasi nuk janë zbatuar e respektuar kërkesat e urdhërave nr. 413 dhe nr. 413/1 të Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Rekomandimi:

10. Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe IAL – et, të marrin masa dhe të bashkëpunojnë me institucionet që bëjnë politikat e shëndetit publik dhe sigurojnë zbatimin e tyre për rastet e fatkeqësive natyrore shkaktuar nga pandemitë, si dhe zbatimin e masave të urdhëruara si të detyrueshme, për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive, përfshirë edhe proceset e vaksinimit masiv.

Në vijimësi

- Numri i studentëve për dy vitet 2020-2021 krahasuar me vitin akademik paraardhës 2019-2020, paraqitet me ndryshime të vogla, këto të pasqyruara në tabelat përkatëse për të 5 IAL-et objekt auditimi. Konkretisht kemi:

- UNI Korçë

Numri i studentëve për vitin akademik 2020-2021 ka pasur një rënie prej % në krahasim me vitin akademik paraardhës 2019-2020, ndërsa përsa i përket numrit të pedagogëve ky numër ka një rënie në përputhje me numrin të studentëve.

-UP Tiranë

Numri total i studentëve të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë sipas viteve është:

Viti akademik 2018-2019: 14 575 studentë;

Viti akademik 2019-2020: 14 983 studentë;

Viti akademik 2020-2021: 14 316 studentë;

Viti akademik 2021-2022: 15,285 studentë, siç shikohet kemi rritje të numrit të studentëve në masën +6.7% në krahasim me vitin paardhës, ndërsa në krahasim me vitin akademik 2019-2020 kemi një ulje prej -9.5% në vitin akademik 2020-2021, kryesisht e ndikuar nga situata pandemike.

UNI Vlorë dhe UNIEL në vlerësimin e grupit të auditimit, studentët dhe stafi kanë patur një sinkronizim me ndryshimin në rritje dhe zbritje të numrit të studentëve dhe pedagogëve dhe u konstatua se gjatë kohës së pandemisë nuk kanë patur punësime në rritje të numrit përgjithshëm dhe për punësimet e kryera janë kryer procedurat e plota sipas kërkesave ligjore.

Tabela 1 përmbledhëse për numrin total të studentëve, pedagogëve me kohë të plotë, sipas IAL-ve:

Nr.	Universiteti	Numri i studentëve		Pedagogë me kohë të plotë	
	Viti akademik	2019-2020	2020-2021	2019-2020	2020-2021
1	"Fan Noli" Korçë	4549	3629	156	161
2	"Eqerem Çabej" Gjirokastrë	1501	1489	172	185
3	"Politeknik" Tiranë	14983	14316	371	369
4	"Ismail Qemali" Vlorë	4851	4415	305	274
5	"Aleksandër Xhuvani" Elbasan	13.160	13.905	224	230
	Totali	39044	37754	1228	1219

Burimi: IAL-et dhe punoi grupi i auditimit të KLSH

Personeli i institucioneve të arsimit të lartë është i punësuar me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar ose të caktuar, si edhe me angazhim, konkretisht:

Tabela 2 me pasqyrimet e rekrutimeve të pedagogëve me kohë të plotë dhe të pjesëshme

Universiteti	"Fan Noli" Korçë		"Eqerem Çabej" Gjirokastrë		"Politeknik" Tiranë		"Ismail Qemali" Vlorë		"Aleksander Xhuvani" Elbasan	
Vitet	2019-2020	2020-2021	2019-2020	2020-2021	2019-2020	2020-2021	2019-2020	2020-2021	2019-2020	2020-2021
Rekrutimeve me kohë të plotë	6		34		31		21		12	
Rekrutime me kohë të pjesëshme	127	130	36	96	626	579	75	59	440	415

Burimi: Të dhënat IAL-et, punoi Grupi i KLSH

Në zbatim të Urdhërit Nr. 395 datë 06.10.2021 i MAS dhe Urdhërit Nr. 413 datë 24.09.2021, Udhërit 413/1 datë 27.09.2021 i MSHMS për vitin akademik 2021- 2022 është vendosur se në auditor do të lejohen vetëm studentët me certifikatë vaksinimi, testin PCR negativ ose vërtetim nga mjeku për pamundësi të kryerjes së vaksinës. Nga auditimi për monitorimin e numrit të studentëve që kanë qënë të vaksinuar dhe studentëve të pavaksinuar konsatojmë se, për ardhjen në ndihmë të studentëve të pavaksinuar, të gjithë IAL-et kanë kërkuar mbështetje nga strukturat përgjegjëse, me qëllim vendosjen e një stende për kryerjen e vaksinës në ambientet e institucioneve. Konstatohet se, studentëve të cilët nuk kanë qënë të vaksinuar dhe duhej të kryenin testin e PCR, nuk u është mundësuar kjo gjë. Shtojmë dhe neglizhimin e urdhërit të MAS dhe të MSHMS nga Universitetet, duke lejuar hyrjen e studentëve në auditor pa paraqitjen e dokumentacionit vërtetues të kryerjes së testit PCR. Bazuar në intervistën me drejtoreshën e Kurrikulave në UPT dhe Dekanen e FSHH-në UNI Vlora me personelin ata janë shprehur se: “Nuk rezulton të ketë patur raste të penalizimit të studentëve si rezultat i mos kryerjes së vaksinës dhe të testit PCR”.

Asnjë nga IAL-et në fillim të viti akademik 2021-2022, nuk u ka ofruar mundësinë e kryerjes së testit PCR falas studentëve të cilët kanë qënë të pavaksinuar, dhe sipas Urdhërit Nr. 395 datë 06.10.2021 i MAS dhe Urdhërit Nr. 413 datë 24.09.2021, Udhërit 413/1 datë 27.09.2021 i MSHMS në auditor do të lejoheshin vetëm studentët me certifikatë vaksinimi, testin PCR negativ ose vërtetim nga mjeku për pamundësi të kryerjes së vaksinës, ndërsa studentë që nuk i paraqisnin nuk do të lejoheshin të hynin në auditor.

Në bazë të Urdhërit Nr. 91, datë 09.03.2020, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për ndërprerjen e procesit mësimor në të gjitha institucionet arsimore publike dhe jopublike”. Urdhërit Nr.135, datë 9.3.2020, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për mbylljen e institucioneve arsimore për parandalimin e përhapjes së COVID-19” dhe IAL-et, si gjithë institucionet e tjera arsimore në vend morën masat për mbarëvajtjen e mësimi sipas kushteve të reja të cilat diktonin zhvillimin e mësimi online. Jo të gjitha IAL-et startuan mësidhënien në të njëjtën kohë. Pati një vonesë kohore prej dy javësh nga njëri universitet tek tjetri. Më poshtë po paraqitet koha e fillimit të mësidhënies online nga IAL-et në fjalë. Konkretisht:

-Në UNI Korçë mësimi online ka filluar bazuar në Vendim Nr. 180, datë 16.03.2020 të Senatit Akademik “Për rifillimin e procesit mësimor online në Universitetin “Fan S. Noli”, i cili miratoi propozimin e Rektorit për rifillimin e mësimi online në datën 17.03.2020.

-Në UEL, mësimi online ka filluar më 17.03.2022, bazuar në Vendimin e Rektoratit Nr. 48 datë 16.03.2020 “Për zhvillimin e procesit mësimor online në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

-Në Univeristetin Politeknik të Tiranës, bazuar në Urdhërin nr. 31, datë 23.03.2020 te Rektorit të UPT “Mbi zhvillimin e procesit mësimor online në Universitetin Politeknik të Tiranës”. Aktiviteti mësimor online filloi në 30.03.2020.

-Në universitetin “Eqrem Çabej”, mësimi online ka filluar zyrtarisht në datën 24 Mars 2020, bazuar në Urdhërin Nr. 17 datë 18.03.2020 të Rektorit për platformën e mësimi online i cili është nxjerrë pas komunikimit zyrtar me MASR në datën 20 Mars 2020 nëpërmjet zv/ Ministrit.

-Në UNI Vlora, pas Vendimit Nr. 71, datë 29.04.2020 të nxjerrë nga Senati Akademik "Për organizimin, funksionimin dhe administrimin e procesit mësimor online në UV, në kushtet e pandemisë Covid 19", ka filluar me datë 20 mars 2020.

-Aksesi në bibliotekën online nga studentët në kohë pandemie.

-Në UNI Korçë i vetmi format aksesi për burime literature online që UNIKO ka vënë në dispozicion të studentëve, ka qënë Biblioteka JSTORE. Ky akses është mundësuar nga Projekti CLEANSCORE-AADF. Studentët mund ta aksesonin këtë bibliotekë pa pagesë nëpërmjet llogarisë së tyre në Sistemin ESSE-3. UNIKO nuk disponon të dhëna të frekuentimit për periudhën në fjalë (sepse nuk e menaxhonin këtë platformë).

-Në UNI Gjirokastër disponon informacion të detajuar për frekuentimin në ambientet e bibliotekës. Gjithashtu, një listë me emrat e përdoruesve të rinj të U – library përpilohet çdo vit të ri akademik;

-Në UP Tiranë, biblioteka shkencore ka menaxhuar të gjithë procesin për regjistrimin e të gjithë studentëve dhe personelit akademik të UPT si përdorues të bibliotekës digjitale U-Library përmes operatorit EBSCO nga RASH. Adresat elektronike janë bërë të vlefshme në Mars të 2021 dhe të gjithë studentët dhe personeli akademik, të regjistruar, kanë akses në platformën digjitale U-Library.

-Në UNI Vlorë në periudhën 2020-2021, studentët kanë përdorur bibliotekën online të mundësuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit; <https://ulibrary.rash.al/>. Pra, biblioteka online mundësohet nga RASH. Krijimi i profileve të studentëve i dërgohet në format excel RASH dhe Universitetet nuk kanë patur akses për të bërë një monitorim.

-Në UNI Elbasan studentëve iu është mundësuar akses në bibliotekën online, përmes dy platformave: Biblioteka Online “U-Library” dhe Libraria JSTORE.

-Asnjë nga IAL-et nuk ka evidenca se sa është frekuentimi i bibliotekës dixhitale gjatë pandemisë nga studentët, të cilët mund të aksesonin në bibliotekën dixhitale vetëm me anë të llogarisë të mundësuar nga fakultetit përkatës.

- Nga auditimi dhe intervistimi dhe takimi Fokus grup që kemi kryer në IAL, për sa kemi kërkuar informacion e kryer verifikime, ka rezultuar se:

Kriteret dhe kuotat e pranimit për regjistrimet për studentët e rinj miratohen nga Senati Akademik, në fillim të vitit kalendarit pavarësisht gjendjes së pandemisë. Në totalin e kuotave të parashikuara 10% të kuotave e zënë kategoritë e veçanta (personat me aftësi të kufizuar me statusin e jetimit nga Komuniteti Rom/Egjiptian dhe personat nga Trojet shqiptare, të cilët janë trajtuar sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, duke përfutur nga përjashtimi i tarifës, apo përgjysmimi i saj. Konkretisht, sipas numërit të studenteve dhe fondeve të përdorura, situata parqitet në tabelat përkatëse sipas universiteteve:

-Universitetin “E.Çabej Gjirokastrë.

Studentë të përjashtuar nga tarifat e shkollimit

Nr	Viti akademik	Totali i studenteve	Bachelor	Master profesional	Master shkencor	Shuma lekë
1	2019-2020	208	169	39	0	4.400.000
2	2020-2021	197	160	37	0	3.577.234

Burimi: UEGJ

-UP Tiranë

Pasqyra e realizimit të kuotave për vitet akademike 2019-2020 dhe 2020-2021 të tyre.

Tabela 20.1 Kuotat, Regjistrimet dhe Realizimet e kuotave,

UPT	Kuota		Realizimi i kuotave		Realizimi i kuotave ne %	
	Gjithsej	Kryesore	Gjithsej	Kryesore	Gjithsej	
<i>A. Viti akademik 2019-2020</i>						
Totali 2019-2020	3707	2786	2634	2564	71	92
<i>B. Viti akademik 2020-2021</i>						
Totali 2020-2021	4072	2925	2533	2536	62.2	86.7

Burimi : UPT

Siç shikohet nga pasqyra e regjistrimit të studentëve në UPT, ku paraqitet numri i kuotave në dy vitet akademike 2019-2020 dhe 2020-2021, rezulton se planifikimi i kuotave ka ardhur në rritje, por realizimi i tyre është në rënie, kjo dhe për shkak të pandemisë, por edhe prej emigrimit të të rinjve.

Për vitin akademik 2020-2021 nga Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, ishin planifikuar gjithsej 3782 kuota për pranimet e reja në studimet e Ciklit I dhe II të studimeve. 1776 kuota për Ciklin e parë të studimeve, 260 për PINT, 1566 kuota për studime të Ciklit të dytë të studimeve dhe 180 kuota për studime profesionale 2-vjeçare.

-UNI Elbasan

UNIEL ka marrë vendimet për miratimin e kuotave të pranimit për çdo vit akademik, të cilat janë realizuar sipas cikleve të studimit dhe në total janë, si më poshtë:

Tabela 3 Niveli regjistrimeve programe profesionale

Nr	Universiteti	Vitet								
		2018 - 2019			2019 - 2020			2020 - 2021		
		Kuota	Realz.	%	Kuota	Realizim	%	Kuota	Realizim	%
	UEL	460	337	73.26	570	467	81.93	532	398	74.81
	Total UEL	6103	2807	45.99	5957	2604	43.71	5003	2573	51.43

Burimi: UEL

Në zbatim të Vendimeve të Bordit të Administrimit strukturat ekzekutuese kanë kaluar në llogaritë e

studentëve të ciklit të parë të studimeve, për program të parë studimi, bursat financiare për studentët me rezultate të larta dhe studentët në nevojë (kriteret e tjera), si më poshtë;

Studentët e Ciklit të parë përfitues të bursës financiare							
Nr	Fakulteti	Vitet 2020-2021					
		Bursa me rezultate		Bursa në nevojë		Totali	
		Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera lekë
	UE	123	11,070,000	1,296	112,140,000	1,419	123,210,000

Përfitimi i bursave financiare nga UEL paraqitet në tabelë:

Studentët e Cilit të parë përfitues të bursës financiare							
Nr	Fakulteti	Vitet 2019-2020					
		Bursa me rezultate		Bursa në nevojë		Totali	
		Nr	Vlera	Nr	Vlera	Nr	Vlera lekë
	UE	105	8,830,968	1,388	114,712,178	1,493	123,543,146

Burimi: UEL

Në zbatim të Vendimeve të Bordit të Administrimit strukturat ekzekutuese, kanë vepruar për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve të ciklit të parë të studimeve dhe ulje nga tarifa vjetore e shkollimit për studentët e ciklit të dytë të studimeve (për kështin e dytë të vitit akademik).

Tabela 4 Studentët që përfitojnë përjashtim dhe ulje tarife vjetore shkollimi vitet 2019-2021					
Nr	Kriteri	2019-2020		2020-2021	
		Nr.st	Fonde	Nr.st	Fonde
	Total Cikli I	1,598	39,950,000	1,606	40,265,000
	Total Cikli II	301	9,738,000	296	9,588,000
	Total UE	1,899	49,688,000	1,902	49,853,000

Burimi: UEL

➤ *Zgjedhja e platformave nga IAL-et për mësimin online? Mbi ç'bazë janë përzgjedhur ato dhe si janë caktuar kriteret e përzgjedhjes dhe specifikimet në rastin e blerjes së tyre? Konkretisht:*

▪ UNI Korçë

- Në periudhën Mars-Qershor 2020, mësimdhënia e ofruar nëpërmjet platformave të ndryshme si ZOOM, Google Classroom, Skype, Edumeet, Moodle, të cilat nuk kërkonin pagesë specifike për numrin e përdoruesve të nevojshëm për orët mësimore në programet tona të studimit.

Duke filluar nga muaji Qershor 2020, UNIKO ka aplikuar platformën Microsoft Teams; pjesë e paketës Office 365 e cila u realizua nëpërmjet projektit: “Instalimi i platformës “office 365 for education”⁹⁸ dhe “upgrade i shërbimit të postës elektronike” për stafin akademik dhe studentët”. Qëllimi i këtij projekti është përdorimi i paketës “Office 365 for Education”, për 4250 përdorues (staf akademik, joakademik, ndihmësmësimor, studentë). Aplikacionet e paketës “Office 365 for Education” i kanë dhënë mundësi gjithë stafit akademik, joakademik, ndihmësakademik dhe studentëve që nëpërmjet shërbimit të internetit, pavarësisht se ku ndodhen, të përdorin dhe të kenë akses nëpërmjet pajisjeve desktop, laptop, Ipad, Iphone, Android, në çdo kohë, në platformat më bashkëkohore për didaktikën dhe komunikimin online. Krijimi i klasave virtuale, komunikimi audio dhe video dhe mësimdhënia online nëpërmjet aplikacionit Teams. Zgjidhja teknike në lidhje me ngritjen e infrastrukturës së “Office 365”, si instalimi dhe konfigurimi i platformës “Office 365” u realizua nëpërmjet bashkëpunimit me kompaninë “T. A.” shpk. Nga grupi i auditimit u trajtua UNI Korçë, si rast në procedurat e përzgjedhjes dhe përshtatjes së platformës për mësimin në distancë (online) në periudhën e pandemisë 2020-2021, theksojmë se dhe universitetet e tjera kanë kryer procedura përshtatje të platformave, duke shfrytëzuar përfitimin e tyre pa pagesë, bazuar në marrëveshjet e mëparshme si stafe akademike dhe kërkimi shkencor. Universitetet e tjera e kanë kryer përshtatjen duke kryer dhe trajnime nga stafi i IT, ndërsa UTP ka patur asistencë të vazhdueshme nga Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit. Më poshtë po trajtojmë vetëm problematikën specifike që kanë patur IAL-et objekt auditimi.

▪ UNI Gjirokastrë

Universiteti “Eqrem Çabej”, ka orientuar stafin akademik dhe studentët për periudhën e pandemisë(Mars-Qershor 2020) implementimin dhe përdorimin e platformës Classroom dhe EDUMEET nga RASH.

Është evidentuar se ky universitet ka patur mungesë të bazës materiale, informatike, etj. Në vitin

⁹⁸ Shtojca 20.1 Instalimi i platformës OFFICE 365

akademik 2020-2021, mësimi ka vijuar pa prezencë fizike, dhe platforma e përdorur për këtë vit ka qenë TEAMS – Microsoft Office 365 Kjo platformë është implementuar duke u bazuar në përvojën fillestare të disa universiteteve brenda vendit dhe orientimit nga MASR, për efekt të përshtatjes midis të gjithë IAL-ve, duke ndjekur edhe modelet e disa universiteteve jashtë vendit.

Procedura e implementimit dhe trajnimit për përdorimin e platformës online, është trajtuar me urdhër shpenzimi nr 362 datë 25.11.2020, në vlerën prej 117.600 lekë.

▪ *UP Tiranë*

Për periudhën e pandemisë, UPT ka përdorur disa platforma, për vetë specifikat që ka patur. Do i trajtojmë më poshtë dhe në mënyrë të përmblendhur platformat e përdorura për dy periudhat e mësimdhënies online: semestri i dytë për vitin akademik 2019-2020 dhe vitin akademik 2020-2021⁹⁹.

Tabela 5

Fakulteti	Platforma e Përdorur (Mars 2020 – Shtator 2020)	Platforma e Përdorur (V.A 2020-2021)
Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	- Google Meet - Google Classroom	Për zhvillimin e mësimit online përmes implementimit të platformës TEAMS është bërë i mundur unifikimi i këtij procesi bazuar në treguesit e evidentuar (anët pozitive e negative dhe nevojën e plotësimit të kërkesave për mësimin online) në semestrin e dytë të vitit 2019-2020. Për këtë janë krijuar adresa institucionale për të gjithë pedagogët dhe studentët (sipas formatit emer@fim.edu.al).
Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	Janë regjistruar në Camtasia/Snagit të shoqëruara me audio të gjitha leksionet, seminarët, punët e laboratorit në formën e laboratorëve virtuale, të cilat janë ngarkuar në Google Classroom Platform, të shoqëruar me materialet didaktike përkatëse. Me platformën Zoom janë kryer konsultimet me studentët në lidhje me tematikat e leksioneve, kontrollat me detyra ushtrimore dhe përvetësimin e tematikave të seminareve.	U ngritën klasat në platformën TEAMS, ku një punë shumë të mirë bëri grupi I punës i ngritur me urdhër të Dekanit posaçërisht për platformën.
Fakulteti i Teknologjisë Informacionit	Microsoft Teams (Janë hartuar manualët e përdorimit)	Procesi mësimor është zhvilluar tërësisht online bazuar në platformën Microsoft Teams, sipas Rregullores së mësimit online.
Fakulteti i Inxhinierisë Ndërtimit	- Microsoft Teams - ZOOM - Google Classroom	Platforma e miratuar dhe e përdorur ishte Microsoft Teams, për të cilën nga ana e Dekanatit FIN janë krijuar klasat me kodet përkatëse për çdo grup të programeve të studimit.
Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	Në FAU, për shkak të specifikave sidomos të lëndëve projektuale, ka rezultuar e suksesshme platforma ZOOM. Departamenti i Urbanistikës pas vlerësimit të situatës dhe treguesve të evidentuar në fillimin e mësimit online, është angazhuar me ngritjen e një platforme për organizimin, informimin dhe dorëzimin e materialeve, sikurse dhe mundësimin e kryerjes së procesit të vlerësimit (https://fau.easy-web.cloud/).	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, në bashkëpunim me IT ka ngritur dhe po punon aktualisht një platformë të tijën në shqip, të dedikuar për mësimin online, e cila u shërben për organizimin e seancave të mësimit (leksion, seminar), informimin dhe dorëzimin e materialeve, sikurse dhe mundësimin e kryerjes së procesit të vlerësimit (platforma ElearningFAU: https://fau.easy-web.cloud/).
Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	Mësimdhënia online është kryer duke përdorur platformat Google Classroom dhe Zoom.	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave ka zhvilluar mësimin online në platformën Google Classroom të administruar nga Zv. Dekani për mësimin.
Fakulteti i Inxh, Matematikës dhe Inxh. Fizike	Platformat online e përdorura në FIMIF, ka qenë Google Meet+Google Classroom si dhe Zoom Software dhe Google Classroom.	Procesi mësimor në FIMIF është zhvilluar online, nëpërmjet platformës elektronike Microsoft Teams 365.

Burimi: UPT, përpunuar Grupi i auditimit

Nga verifikimi i kryer nuk rezulton se janë kryer pagesa financiare nga Rektorati ashtu dhe nga administrata e fakulteteve të UPT për Platformat online të përdorura, pasi kanë qenë me sponsorizim

⁹⁹ Pyetja 21, shtojca 1. 1 Shkëputur nga raporti analizës mësimore 2020 - 2021

nga Microsoft Teams 365 dhe.

▪ *UNI Vlorë*

Universiteti i Vlorës ka përdorur platformën G-Suite për mësimdhënien on-line. Kjo platformë u është ofruar universiteteve pa pagesë(falas) nga GOOGLE. Në këtë universitet, kjo platformë është përdorur rreth 10 vjet nga UNIVlora, para se të fillonte pandemia, duke sjellë një njohje paraprake të kësaj platforme nga stafi akademik dhe administrativ, studentët dhe pedagogët. Nuk janë kryer blerje të platformave, por janë përdorur platforma të lira, të mundësuar nga Google apo aplikacione të tjera, si Google Meet në kombinim me Google classroom apo aplikacioni zoom.

▪ *UNI Elbasan*

Platforma e përzgjedhur për mësimin online gjatë periudhës së pandemisë është “Office 365 A1 for Education” dhe sistemi “Microsoft Teams”.

Ky produkt i jep mundësinë përdoruesve online që programet aplikative të bëhen aktive edhe nëse nuk janë të licencuara, duke përfshirë edhe sistemin Windows. Blerja e licencave të sistemit Windows apo paketave Office (Word, Excel, Powerpoint, etj.) është tepër e kushtueshme për Universitetin apo kompjuterat personal të studentëve. Ky produkt jepet me pagesë me 3\$/ në muaj për edukim (nxënës, studentë, personeli i IAL) dhe me 6.2\$/ në muaj për individë. Nëse krijohen lidhje si universitet me distributorin e saj për Europën, në Bullgari, ky shërbim ofrohet free nga kompania Microsoft. Për të mundësuar lidhjen me këtë distributor kërkohet të bëhet pagesa fillestare deri në 120 mijë lekë.

Për këtë procedurë është ndjekur praktika e blerjes nën 100 mijë lekë pa TVSH, e drejtëpërdrejte. Subjekti fitues Tiranë, i cili ka eskuzivitetin e linkut me distributorin për Europën në Bullgari. Ky subjekt ofroi abonimin e kësaj pakete “Microsoft Office 365 A1 for Education” me vlerën **59,510 lekë**, për të gjithë përdoruesit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dhe është likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 361 datë 17.11.2020 në vlerën 59,510 lekë.

Si konkluzion: Nga auditimi rezultoi se me gjithë përpjekjet e bëra dhe nga gjendja e pandemisë që i gjeti të papërgatitur IAL-et, të cilët nuk kanë bërë asnjë analizë nevojash që të nis nga departamentet respektive e fakultetet, mbi kapacitetet që duhet të kenë klasat virtuale për të dy periudhat Mars-Qershor 2020(semestri i II-të) dhe Vitin akademik 2020-2021, në mënyrë që të funksionojnë pa problem; nëse kanë nevojë apo jo për punë laboratorike; kapaciteti i nevojshëm për të shkarkuar detyra kursi; etj. Sa më sipër, rezultoi se universitetet aplikuan disa platforma (shpesh të përzgjedhura individualisht nga pedagogët ose fakultetet), si “Microsoft Office 365 A1, Google-classroom, Teams dhe Zoom, etj. të cilat nisur edhe nga përgjigjet e pyetësorëve paraqiten edhe problematika teknike, që lidhen me internetin dhe aksesimin e platformave.

- Në lidhje me nevojën e asistencës teknike (IT) dhe mbështetjen e pedagogëve për përshtatjen e literaturës së duhur në funksion të mësimdhënies online, ka rezultuar se në universitetet objekt auditimi është dhënë asistencë, kryer Work-shop, trajnim e përgatitur dhe përdorur manuale përdorimi e udhëzues. Konkretisht në:

▪ *UNI Korçë*

Në vijim të planifikimit të veprimit për zbatimin e projektit “Instalimi i Platformës “Office 365 for Education” dhe zgjerimi i shërbimit të postës elektronike për stafin dhe studentët” i ndjekur nga Plani i veprimit për zbatimin e projektit “Instalimi i platformës Office 365 for education” dalë me Nr. 855 prot., dt. 30/06/2020, është hartuar “Raport mbi zbatimin e projektit “Instalimi i platformës Office 365 for education” si dhe zgjerimi i shërbimit të postës elektronike për stafin dhe studentët” dhe për përdorimin e mjeteve të matjes së cilësisë së mësimdhënies dhe aktivizimit të stafit dhe studentëve.¹⁰⁰

▪ *UNI Gjirokastrë*

Gjatë periudhës mars –prill 2020 zyra e IT në bashkëpunim me stafin akademik kanë vlerësuar e krahasuar disa platforma për mësimin online, për të gjetur alternativën më të përshtatshme për studentët dhe stafin akademik, duke zgjedhur si më të përshtatshme platformën Classroom, që është ofruar në gmail. Për video konferenca një pjesë e pedagogëve kanë kryer komunikim me Zoom.

Në të njëjtën kohë është vazhduar me komunikimin me RASH (Rrjetin Akademik Shqiptar) i cili ka bashkëpunim me sistemin e sekretarisë mësimore, Esse3. Në likun e ngritur nga RASH <https://www.vuni.rash.al>, janë:

- Moodle Sistemi i menaxhimit të mësimi bazë.
- Edumeet Platformë per video konferenca.

¹⁰⁰ Shtojca 21.2 Të dhëna mbi zhvillimin e procesit mësimor

▪ UP Tiranë

Viti akademik 2019-2020, periudha 30 Mars 2020 – 20 Qershor 2020

- Me ndërprejen e mësimit me prezencë në klasa sipas Urdhrit Nr. 104 datë, 30.04.2020, fakultetet e UPT kanë marrë masa për zhvillimin e mësimit on-line, duke përdorur platformat sipas mundësive dhe kapaciteteve që zotëronin. Po ashtu janë përgatitur manuale të përdorimit të platformës MS Teams¹⁰¹ të cilat janë publikuar në faqen eeb dhe janë shpërndarë me email.

-Viti akademik 2020-2021

Për përdorimin e platformës elektronike Microsoft Teams 365 janë përgatitur nga pedagogët e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, udhëzuesit përkatës për përdorim, si për personelin akademik ashtu edhe për studentët.

▪ UNI Vlorë

Stafi IT ka afruar mbështetje teknike duke i konfiguruar këto platforma në pajisjet elektronike (telefona smart, tablet, kompjutera) të përdoruesve, në mënyrë që të mund ti përdorin këto platforma gjatë gjithë kohës.

UNI Elbasan

Po, në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik janë vendosur manualët përkatës, të publikuara edhe në faqen Web Guida:

https://uniel.edu.al/images/zona_padagogjike/UNIEL_MS_Teams_teacher_manual_AL.pdf

[https://uniel.edu.al/images/zona_e_studentit/njoftime/ Guida_regjistrimit_per_sezonin_e_vjeshtes.pdf](https://uniel.edu.al/images/zona_e_studentit/njoftime/Guida_regjistrimit_per_sezonin_e_vjeshtes.pdf)
për studentët dhe regjistrimin e provimeve.

- Mësimi në distancë (online) në universitete ka filluar me datë 17-20.03.2020 dhe UPT ka filluar me 30.03.2022), me vendime përkatëse të Senatit Akademik, bazuar dhe në emailin e dërguar nga MASR me datë 16.03.2020.

Nga data 24 Mars 2020 deri në përfundim të semestrit të dytë të vitit akademik 2019- 2020, është bërë raportim ditor dhe javor për zhvillimin e mësimit online pranë MASR-së.

Komunikimi zyrtar dhe raportimet për zhvillimin e mësimit online i janë përcjellë grupit të auditimit.

-UP Tiranë ka realizuar mësimin online për:

Vitin akademik 2019-2020, semestri i dytë¹⁰²aktiviteti mësimor ka filluar në 30.03.2020 për programet e studimit të ciklit të parë, programet e integruara të studimit të ciklit të dytë dhe programet e ciklit të dytë. Për vitin akademik 2020-2021, mësimi është realizuar online¹⁰³ aktiviteti mësimor ka filluar në 02.11.2020 për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit të ciklit të dytë. Për programet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional” aktiviteti mësimor filloi me 16.11.2020.

Po kështu, siç e theksuam dhe më sipër UNI Vlora ka filluar mësimin online me datë 20.03.2020 dhe UNI Elbasan e ka filluar më 17.03.2022.

❖ *Monitorimi i platformave me objekt pjesëmarrjen e studentëve në platforma dhe në rastet kur ka qenë numri i kufizuar nga sistemi i IT për efekt të mungesës së kapacitetit të platformës sipas nevojës, shkaqe të ndryshme, etj. dhe dokumentacioni i hartuar apo gjeneruar nga sistemi, janë evidentuar nga grupi i auditimit dhe po i trajtojmë sipas IAL-ve më poshtë:*

- Në Universitetin “F.S.Noli” Korçë gjatë zhvillimit të mësimdhënies online, çdo pedagog ka raportuar në një periudhë 1-javore mbi ecurinë e mësimdhënies, frekuentimin e studentëve dhe/ose probleme të hasura në komunikim me ta.

Sektori i Kurrikulave në bashkëpunim me Dekanët e njësive kryesore, ka kryer monitorim rastësor të listprezencave të shkarkuara nga pedagogët në përfundim të orëve të mësimit, dhe pasqyrimin e tyre në regjistrat e pedagogut Shkresë Nr.13 Prot., dt. 07.01.2021 i Rektorit “Monitorimi i mësimdhënies online në të gjitha programet e studimit”) (Shkrese Nr. 13/1 Prot. Dt. 26.01.2021 e Drejtorisë së Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional “Relacion për kontrollin e mësimdhënies online për të gjitha programet e studimit”. Është konstatuar se ka patur dhe anketime online të studentëve mbi ecurinë e procesit, nga ku janë marrë dhe masa përmirësuese për problematikat e dala.

- Në Universitetin “E. Çabej” Gjirokastrë, procesi i monitorimit të përdorimit të platformave online nga

¹⁰¹ Pyetja 22, shtojca 1.2 Tutorial të përdorimit të platformës

¹⁰² Pyetja nr. 23 Shtojca 1.1 Struktura mësimore 2019 - 2020

¹⁰³ Pyetja nr. 23, shtojca 1.2 Struktura mësimore 2020 - 2021

stafi akademik dhe studentët është përshtatur sipas mundësive që i ka lejuar platforma përkatëse.

Në periudhën Mars 2020 deri në Qershor 2020, kur është përdorur kryesisht platforma Google Classroom, Edumeet, Zoom dhe Moodle, monitorimi konsistonte në mbledhjen e informacioneve nga përgjegjësat e njësive bazë për stafet akademike përkatëse, dhe raportimi i këtyre informacioneve në zyrën e Kurrikulave.

Në periudhën Dhjetor 2020-Qershor 2021, gjatë të cilës është përdorur platforma Teams, nga stafet akademike dhe nga studentët, procesi i monitorimit përfshin informacionin e ofruar nga platforma dhe përpunimet statistikore përkatëse. Platforma teams jep mundësinë e aksesimit të të dhënave të mësipërme brenda një periudhe 90 ditore. Mbi bazën e këtyre të dhënave janë hartuar statistika përshkruese për periudha 3-mujore, në lidhje me përdorimin e platformës TEAMS.

Nuk ka pasur problematika në lidhje me kapacitetin e sistemit IT dhe monitorimi i platformave është bërë nga zyra e IT-së. Rezulton se nuk ka të shënuar apo gjeneruar nga platforma asnjë problematikë në kapacitetin e platformave të përdorura.

- Në UP Tiranë, duke filluar nga muaji Prill e deri në muajin Qershor 2020, për çdo javë është bërë raportimi në MASR-në i pjesëmarrjes së studentëve në mësimin on-line. Komunikimi bëhej me e-mail. Informacioni i marrë nga fakultetet është përpunuar në një format të vetëm për UPT që i dërgohej MASR¹⁰⁴.

Në UNI Vlora monitorimi është bërë mbi treguesit e platformës së përdorur dhe klasat online të hapura në platformën Google Classroom nuk merrnin më shumë se 100 studentë të rregjistruar, por ky kapacitet nuk ka penguar zhvillimin normal të mësimin online, pasi edhe kapacitetet e klasave të leksionit në fakultet, kanë qenë me më pak se 100 studentë.

https://docs.google.com/spreadsheets/d/1W3_Q8TCDKrDIg0kT0WvQ2YoL0Tn5tL0Y3rQ2AWa4SpU/edit?usp=sharing), si dhe raportimeve në dekanat (format raportimi i përdorur: https://docs.google.com/document/d/1OeinKxucr6reslgQbhYfE_osCl47rDi0v9l_SUZE5U/edit?usp=sharing). Ky proces është audituar nga ana jonë dhe me zgjedhje kemi evidentuar në letrat e punës hapat e kryer për këto monitorime dhe administrojmë me screenshet dokumentacionin e përzgjedhur. Mbikqyrja e çdo pedagogu nga drejtuesi i departamentit si bashkëpedagog {co-oteacher}. Në përfundim të ciklit të leksioneve, pedagogët kanë raportuar në departament të dhënat për mësimin online, të zhvilluar prej tyre.

Në letrat e punës së grupit të auditimit gjenden i skanuar dokumentacioni i sipërmëndur i gjeneruar për këtë periudhë.

Njëkohësisht, studentët ashtu sikurse në kohë normale, janë rregjistruar në Sistemin e Univlora.edu.al, sipas adresës elektronike që ju është vënë në dispozicion në fillim të studimeve, në një program studimi të caktuar. Ata kanë patur dhe kanë mundësi të marrin vlerësimin paraprak në kohë reale, për provimet e pjeshme, provimet finale etj

Si konkluzion: Studentët dhe pedagogët kanë paraqitur paqartësi në lidhje me adresimin e ankesave, gjatë periudhës së pandemisë, kjo pasi në asnjë rast nuk u hartua gjurma e auditimit për trajtimin e ankesave.

- Në asnjë rast nuk është hartuar dhe miratuar rrjedha e dokumentuar e aktiviteteve nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to (gjurma e auditimit), sa i takon procesit mësimor. Konkretisht, monitorimi i orëve të mësimin, u bazua tek vetdeklarimi i secilit pedagog pas zhvillimit të procesit mësimor, që raportohej çdo javë në Drejtorinë e Zhvillimit Kurrikular të universiteteve objekt auditimi, informacion të cilin e kanë përcjellë në MASR.

Mungesa e gjurmëve të auditimit për zhvillimin e një procesi mësimor, nuk ka siguruar dokumentimin e operacioneve në formë të tillë që t'u mundësojë audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, në kundërshtim kjo me nenin 16, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

Nisur nga sa më sipër, e kemi të pamundur të japim siguri të arsyeshme, mbi efektivitetin e orëve të mësimin, për sa kohë që sistemet e kontrollit që duhej të ngriheshin për këto procese, nuk janë ngritur.

Gjetja nga auditimi

13. Në asnjë rast nuk është hartuar dhe miratuar rrjedha e dokumentuar e aktiviteteve (nga fillimi deri

¹⁰⁴ Pyetja nr. 24, shtojca 1.1 Modele të raportimit të pjesëmarrjes

në përfundim të tyre) që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to, sa i takon procesit mësimor online (distancë) dhe auditor në periudhën e pandemisë 2020-2021, konkretisht:

- monitorimi i orëve të mësimi, është bazuar tek vetdeklarimi i secilit pedagog pas zhvillimit të procesit mësimor, që raportohej çdo javë pranë Drejtorisë së Kurrikulave të IAL-eve, informacion të cilin e kanë përcjellë në MASR.

- u konstatuan paqartësi nga studentët dhe pedagogët në lidhje me adresimin e ankesave gjatë periudhës së pandemisë dhe në asnjë rast nuk është hartuar gjurma e auditimit për trajtimin e ankesave, kjo në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Konkluzioni:

11. Nuk ka patur gjurmë auditimi për zhvillimin e një procesi mësimor, e cila ka sjellur pasojë mungesën e dokumentimit të operacioneve në formë të tillë, që t’u mundësojë audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit dhe ka krijuar vështirësi në dhënien e një sigurie objektive dhe të bazuar në të dhënat e procesit mësimor.

Rekomandimi:

12. Rektorati dhe Senati akademik të (IAL-eve) të marrin masa për hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditimit për monitorimin e mësimi dhe trajtimin e ankesave, dhe dokumentacioni dhe të dhënat të jenë në formë të tillë që t’u mundësojë audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit e të japin siguri objektive mbi auditimin e kryer.

Menjëherë e në vijimësi

❖ *Si e kanë verifikuar dhe siguruar IAL – et, zbatimin e detyrimit të frekuentimit të procesit mësimor, i cili është i detyrueshëm në një masë të caktuar, që përcaktohet bazuar në Kodin e Cilësisë dhe udhëzimin e ministrise përgjegjëse për arsimin, në kushtet e pandemisë Covid 19, në periudhën Mars 2020 – Dhjetor 2021?*

Grupi i auditimit në trajtimin e kësaj çështje është bazuar në informacionet e marra në mënyrë shkresore dhe nëpërmjet intervistave në plotësimin e pyetësorëve të dërguar nga ana jonë në subjektet objekt auditimi.

-UNI Korçë

Rregullorja e organizimit të studimeve dhe kërkimit shkencor UNIKO, neni 93 përcakton se në përputhje me veçoritë e lëndës, çdo pedagog, me miratimin e përgjegjës të departamentit, mund të përcaktojë peshën specifike të frekuentimit të leksioneve, ndërkohë që frekuentimi i seminareve është i detyrueshëm deri në masën 75%.

- UNI Gjirokastrë

Secili pedagog, në procesin mësimdhënies online, ka evidentuar frekuentimin nga ana e studentëve. Për mësimin online të periudhës së semestrit të dytë për vitin akademik 2019-2020, pjesa e mos frekuentimit gjatë procesit mësimor online është kompesuar me procesin në auditor të mësimi përsëritë/plotësues, e pasqyruar në strukturat mësimore dhe oraret e posacme për këtë qëllim, zhvilluar dhe në zbatim të rregullores për masat higjieno sanitare e Covid19.

- UP Tiranë

Bazuar në Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në Universitetin Politeknik të Tiranës, neni 29, studenti duhet të ndjekë të gjitha format e mësimdhënies së disiplinave të përcaktuara në planin mësimor. Masa e detyrueshme e frekuentimit të tyre ndryshon në funksion të tipit të aktivitetit mësimor që realizohet, duke i klasifikuar pjesërisht të detyrueshme dhe plotësisht të detyrueshme:

- *frekuentimi i leksioneve është i këshillueshëm;*

- *frekuentimi i seminareve dhe ushtrimeve është i detyrueshëm në masën jo më pak se 75% të numrit të seancave të zhvilluara;*

- *frekuentimi i punëve laboratorike, punëve praktike dhe praktikave mësimore është plotësisht i detyrueshëm në masën 100%.*

Përdorimi i platformave përkatëse për zhvillimin e procesit mësimor online, krijonte të gjitha mundësitë për verifikimin e ndjekjes së procesit mësimor online nga pedagogët e lëndës.

Frekuentimi i seminareve/ushtimeve nga studentët është monitoruar nëpërmjet platformave on-line të përdorura për zhvillimin e mësimdhënies. Lista e pjesëmarrjes mund të shkarkohet dhe të ruhet në formën e një regjistri frekuentimi. Dorëzimi i detyrimeve është kryer on-line.

Marrja e njohurive praktike në laborator ka qenë problem shqetësues, por IAL-et kanë zhvilluar programe të veçanta pune laboratorit dhe praktika mësimore sipas planeve mësimore, pas kthimit në auditor (pjesërisht) në muajin Korrik 2020 dhe Shtator 2020.

Megjithatë, nisur nga situata e jashtëzakonshme dhe pamundësia për një kategori të caktuar të studentëve për të ndjekur procesin mësimor online, si dhe bazuar në shkresën¹⁰⁵ nr. 749/25, datë 11.02.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve “Mbi zhvillimin e disa provimeve të lëndëve specifike në auditor”, drejtuar të gjitha institucioneve të arsimit të lartë, me anë të së cilës është udhëzuar: “*Mungesat e studentëve në leksione apo seminarët “online” të mos i penalizojnë studentët për pjesëmarrje në provime, duke vlerësuar vështirësitë objektive që mund të kenë pasur një pjesë e studentëve gjatë kësaj periudhe*”, është vendosur pranimi i studentëve në provime, pavarësisht plotësimit të masës së frekuentimit sipas përcaktimeve në aktet e brendshme rregullatore, veprim ky i MASR që nga grupi i auditimit, vlerësohet në kundërshtim me ligjin 80/2015 “Për arsimin e Lartë” dhe ka krijuar pabarazi trajtimi e vlerësimi tek studentët, megjithëse nga stafet akademike nuk pranohet që është zbatuar drejtpërdrejt ky udhëzim.

- *UNI Vlorë*

Verifikimi është kryer nga secili pedagog përmes Google classroom dhe opsioneve për evidentimin e frekuentimit që platforma ofron. Kurse në nivel njësie bazë, është kryer nga përgjegjësi i departamentit duke aksesuar klasat online përmes opsionit ‘co-teach’ nga adresa e njësisë bazë ose adresa e tij/saj në Univlora. Për të siguruar detyrimin e frekuentimit, studentëve u janë ofruar edhe mundësi alternative, si regjistrimi i orës së mësimi dhe ngarkimi i tij në classroom si dhe gjurmimi i ndjekjes së mësimi të regjistruar, sërish përmes opsionit të frekuentimit, si dhe është hartuar një kalendar i posaçëm, i pjesshëm, në fund të semestrit për konsultime me studentët të cilët nuk kanë mundur të kenë akses të plotë online.

- *UNI Elbasan*

Për përballimin e situatës pandemike dhe kryerjen e mësimi në distancë(online), në çdo njësi kryesore, në këtë IAL janë ngritur grupet e punës, të cilët janë ngarkuar me ndjekjen dhe zhvillimin e këtij procesi. Secila njësi kryesore ka hartuar udhëzimet përkatëse dhe procedurat janë publikuar në faqen Web të institucionit, sipas link-eve, si psh.:Për Fakultetin e Shkencave të Edukimit: [www.<http://www.uniel.edu.al/index.php/al/shkenca-edukimi-njoftime>](http://www.uniel.edu.al/index.php/al/shkenca-edukimi-njoftime)

Procesi mësimor online ka të integruar modalitetet e prezantimit të leksioneve me PPT, të organizimit të debatit në Google Classroom, dhe të dërgimit të indikacioneve me format audio dhe video. Ndërkohë, secili pedagog, në mënyrë periodike, referuar edhe orarit respektiv ka plotësuar modelin e evidencës mbi mësimdhënien online.

Për vitin akademik 2020-2021, mbështetur në propozimet e secilit fakultet, procesi mësimor në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” është zhvilluar i kombinuar në auditor dhe online në platformën Microsoft TEAMS.

Gjatë kësaj periudhe, me që procesi mësimor online është realizuar me platformat online të ofruara pa pagesë nga interneti si Google Meet+Google Classroom, Zoom Software + Google Classroom, për aksesimin e këtyre platformave, janë përdorur adresat e tyre elektronike në gmail (shumica e studentëve kanë qenë përdorues të adresave në gmail).

Njëkohësisht, janë krijuar manuale në format dokumenti dhe video dhe publikuar në faqen web-i të universitetit si psh. univlora.edu.al (<https://univlora.edu.al/manuale/>), që të mund të aksesoheshin nga përdoruesit, nga çdo pajisje elektronike që suporton internet.

Për studentët e rinj në vitin akademik 2020-2021, janë organizuar ditë orientimi në fillim të vitit akademik me program të posaçëm nga njësia kryesore dhe njësitë bazë, njoftimi i studentëve për regjistrimin në Classroom me kodet përkatëse për çdo student; njoftim për aktivizimin dhe kodet përkatëse për emailin zyrtar Univlora.edu.al; njoftim mbi procedurat e regjistrimit të studentëve në platformat Meet për mësimin në distancë; program i orientimit online të studentëve.

Në referencë të Raportit të Pyetësorit të zhvilluar nga UNIKO për mësimin online me shkresë nr.129 prot, dt. 20.01.2021¹⁰⁶:

- Në listimin e problematikave, në lidhje me mësimin online 24% e studentëve janë shprehur se kanë

¹⁰⁵ Pyetja nr. 25, shtojca 1.1 Shkrese e Mars Nr. 749/25, Datë 11.02.2021

¹⁰⁶ Shtojca 26.1 Raport për pyetësorët lidhur me ecurinë e procesit mësimor f.8 dhe f.9

pasur probleme me internetin dhe rrjetin si: shkëputje apo pamundësi për të pasur akses në internet për një kohë të gjatë. Pavarësisht problemeve, vetëm 8% e tyre e kanë listuar mungesën e internetit, si arsye për mos pjesëmarrje në mësimin online.

- Studentë janë të paqartë plotësisht (nga 30.8 deri 45% e studentëve) mbi zhvillimin e mësimin në kohë normale.Referuar rezultateve të përftuara nga pyetësi i pedagogëve (kryer nga UPT) pyetjes; “Mendoni se mësimdhënia online duhet të jetë një opsion gjithmonë prezent (edhe në situata normale) me qëllim lehtësimin e komunikimit dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies?” përgjigjet janë si më poshtë: 30.8% e tyre janë dakord dhe 24.2% nuk janë dakord që të zhvillohet në vazhdimësi, ndërsa 44.9% janë me mendimin “Ndoshta”. Po kështu për pyetjen “Mësimdhënia online mund të zhvillohet edhe në situata normale në lëndë të caktuar, pa cënuar cilësinë e mësimdhënies.” 45% e studenteve shprehen dakord dhe 37 % nuk janë dakord. Ndërsa17% nuk kanë mendim (po ose jo).

Nga ana e grupit të auditimit janë kryer verifikime me zgjedhje, në 3 Universitete (UEGJ, UPT, UNIVLORA), ku u auditua procedura e raportimit dhe sistemet e ngritura nga gjenerimi i platformave përkatëse. Procedurat e raportimit në vlerësimin e grupit të auditimit ishin të plota në mënyrë hierarkike, nga poshtë lartë.

Në funksion të vlerësimit të funksionimit të kontrollit të treguesve të zhvillimit të procesit mësimor e didaktik, grupi i auditimit nuk jep siguri, pasi treguesit e gjeneruar nga sistemi dhe manualisht nga stafi janë të njëanshme. Duke vlerësuar treguesit e paraqitur nga stafet didaktike dhe mësimdhënies, pohojmë që ne kemi rezerva, pasi konstatojmë se treguesit e cilësisë së vlerësimit të kalueshmërisë, si kriter kryesor i matshëm ka një rënie të vogël, por në gjykimin tonë ky tregues nuk pasqyron realitetin e të nxëniet të studentëve gjatë pandemisë.

- *UNI Tirana*

Konstatohet se me ndjekjen e mësimin online ka patur disa problematika në lidhje me:

- Mungesës së internetit (kostoja e lartë e internetit nga kompanitë celulare dhe ngarkesa e madhe në rrjet);

- Mungesës së mjeteve si laptop ose kompjuter (një pjesë e studentëve kanë patur vetëm mjetet e telefonisë, si mjet të vetëm për mësimin online);

- Nga ana tjetër një pjesë e studentëve nuk kanë qenë të disponueshëm/shkëputeshin shpesh në takimet live në Zoom, për shkak të mungesës së shërbimeve cilesore të internetit.

Duke marrë parasysh problematikën e mësipërme, si dhe duke qenë se i gjithë semestri i dytë (v.a. 2019 - 2020) është zhvilluar online dhe ndërkohë, për të kompensuar të gjitha mangësitë në realizimin e programit të lëndëve, ku janë nevojitur konsultime detyra/projekte, për kryerjen e punëve laboratorike, praktikave profesionale, realizimin i konsultimeve të shkurtëra në lidhje me tematikat e lëndës, etj., është caktuar një periudhë kohore 3 javore(periudhë jo e mjaftueshme në një situatë pandemie) para fillimit të sezonit të provimeve në verë, si dhe u janë vënë në dispozicion studenteve leksionet e regjistruara. Për studentët e viteve të para dhe/ose të viteve të ndërmjetëm, përmbyllja e procesit mësimor është zhvendosur në muajin Shtator – Tetor 2020, periudhë gjatë së cilës është bërë realizimi i programit të lëndëve me pjesëmarrje në auditor të studentëve (laboratorë, detyrat, projektet/praktikë mësimore, etj.). Sezioni i provimeve të verës, sezoni i provimeve të vjeshtës dhe sezoni i diplomimit janë zhvilluar brenda të njëjtës periudhë kohore.

Për vitin akademik 2020-2021 sesionet e provimeve janë kryer në auditor, në përputhje të plotë me rregullat në fuqi, për parandalimin dhe mbrojtjen nga Covid – 19¹⁰⁷.

Në disa IAL-e janë realizuar pyetësorë me studentët(UNIVlora) për të marrë një pamje më të plotë në lidhje me këto çështje, në dy periudha të ndryshme. Pyetësi i parë është realizuar nga departamenti i Gjuhëve të Huaja në periudhën e parë të pandemisë gjatë muajit Prill 2020, dhe të dhënat e përftuara mund të aksesohen në

(<https://docs.google.com/spreadsheets/d/1Gul-5cZTQ9hOSTxdrUzlZnc59z73iQbXgr-Oh-qFf10/edit?usp=sharing>).

Me vendim dekanati, Pyetësi i dytë është realizuar në nivel fakulteti, në periudhën Dhjetor 2020. Bashkëlidhur evidenca (vendimi i dekanatit), si dhe linku i të dhënave të pyetësit.

(<https://docs.google.com/spreadsheets/d/1rl-1pF1qXGbwSOIqPQE97hI-oaxrjVabeQZihUgg> A9g/edit?usp=sharing). Po kështu, është realizuar në vitin 2021 një studim në lidhje me perceptimet e studentëve të vitit të parë në lidhje me mësimin online, gjatë periudhës së pandemisë, ku është evidentuar

¹⁰⁷ Pyetja nr. 27, shtojca 1.1 Materiale të shkëputura nga raportet e analizës mësimore

se 79.3% e studentëve të përfshirë në studim, si mjet kryesor për komunikimin dhe ndjekjen e mësimi online kishin përdorur celularin, si dhe 40.2% e tyre kishin përdorur wifi në ambjentet e shtëpisë, 35.5% e tyre kishin përdorur si Wifi, ashtu dhe ofertat mujore të internetit në aparatet e tyre celular. Pjesa tjetër kishte shfrytëzuar ofertat mujore të internetit në celular. (ref. Buletin Shkencor të UV nr. 4, Vol. 1 2021 <https://univlori.edu.al/ep-content/uploads/2021/04/Buletini-SHKENCOR-Nr.-4-Vol.-1-2021.pdf>).

-UP Tiranë

Ka patur ankesa nga studentët për problematika që mund të kenë hasur në përdorimin e acauntit të tyre zyrtar. Kanë komunikuar elektronikisht me pedagogun – tutor të grupit. Në faqen e internetit të fakultetit në fillim të vitit akademik, paraqiten grupet mësimore për çdo cikël, si dhe pedagogët-tutor të grupeve (emër, mbiemër dhe adresat e tyre elektronike), të cilët ia kanë përcjellë elektronikisht problematikën e dala punonjësit të IT së fakultetit. Janë evidentuar raste kur studentët kanë komunikuar elektronikisht me punonjësin e IT së fakultetit, për ti paraqitur problematikën e tyre, e cila në çdo rast është zgjidhur menjëherë. Ka patur kërkesa edhe për email-in në lidhje me passwordin. Ata u kanë dërguar email shëfave të departamenteve, sipas udhëzimit që kanë patur në web dhe problemi është zgjidhur në kohë nga profesori i ngarkuar për hapjen e adresave email.

Në lidhje me këto ankesa, nuk nuk ka pasur asnjë procedurë dokumentimi, për t'iu përgjigjur nevojave/ankesave të studentëve, si pasojë as nuk mund të dokumentohet puna e kryer nga administrata e universiteteve në këtë drejtim. Por nisur nga përgjigjet e pyetësorëve të studentëve, konkludua se ka patur ankesa kryesisht teknike, si dhe pamundësi të adresimit, ndikuar nga distanca në rrethe. Megjithatë, rreth 90 % e studentëve pranojnë se i kanë zgjidhur problemet me pedagogun përkatës në kohë, në shumicën e rasteve me komunikim online ose verbalisht me telefon.

❖ **Mbi efikasitetin e marrjes së silabus-it (tërësia e materialeve të marra nga studentët për studim) nga studentët në kohën e pandemisë, në vijim të vlerësimit të pyetësorit të UNIKO, studentët kanë vlerësuar në masën 80%, se marrja apo përthithja e materialeve mësimore, kanë qenë në nivel shumë të mirë, në lidhje me studentët pjesëmarrës.**

Në UPT, në lidhje me aksesueshmërinë e materialeve nuk gjurmohet siguri. Në klasat virtuale të krijuara të leksionit/seminarit apo të laboratorit, studentëve u janë dërguar elektronikisht materialet në forma të ndryshme si PDF, Word, Power Point, video të regjistruara (Camtasia/Snagit të shoqëruara me audio), të cilat janë shpjeguar nëpërmjet komunikimit online me platformën Microsoft Teams 365, duke respektuar orarin mësimor¹⁰⁸.

Në UNI Vlorë, ka patur një praktikë të konsoliduar prej vitesh në lidhje me vendosjen në dispozicion të studentëve të syllabuseve të lëndëve dhe çdo pedagog në klasat e tij online ka ngarkuar syllabusin përkatës dhe dorëzuar në kohë sipas formatit përkatës dhe postime në classroom.

Në UNI Elbasan, për vitin akademik 2019-2020 studentëve në fillim të vitit akademik u janë dhënë syllabuset e lëndëve. Për sa i takon literaturës bazë dhe asaj shtesë pedagogu i lëndës nga komunikimet që ka patur me studentët ka përcaktuar marrjen e materialeve. Njëkohësisht materialet dhe leksionet janë dhënë dhe prezantuar në power point.

- Në UNIKO, frekuentimi i mësimi në kushtet normale për vitin akademik 2018-2019 sipas universiteteve objekt auditimi, rezulton se ka qenë 98% për Uniko, frekuentimi është ulur -1% në vitin akademik 2019-2020 dhe në masën -23% në vitin akademik 2020-2021, siç paraqitet e detajuar sipas fakulteteve në tabelë :

Tabela 7 Frekuentimi për vitin akademik 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021

Fakulteti	2018-2019	2019-2020	2020-2021
FSHNH	98%	97%	75%
FE	97%	96%	74%
FEF	99%	99%	76%
FB	96%	95%	73%
GJITHSEJ UNI Korçë	98%	97%	75%

Burimi: UNIKO dhe Grupi i auditimit

UNI Gjirokastrë

Kalueshmëria për vitin akademik 2019-2020 është sipas informacioneve të marra nga zyra e Statistikes dhe Informacionit, është si më poshtë:

¹⁰⁸ Pyetja 29, shtojca 1.1 Material i shkëputur nga raporti i analizës mësimore 2019 - 2020

Kalueshmëria në Programin Bachelor 74%
Kalueshmëria në Programin Master Profesional 87.6 %
Kalueshmëria në Programin Master shkencor 73 %
Kalueshmëria në Programin 2-vjecar 72.5%
Kalueshmëria si Universitet 76%

- UNI Tirana

Viti akademik 2019-2020¹⁰⁹

Per vitin akademik 2019-2020, në regjistra figurojnë të regjistruar në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, 14802 studentë, nga të cilët 8506 ishin studentë aktivë (7710 studentë që kishin paguar tarifën e shkollimit për atë vit dhe 796 studentë që kishin vetëm diplomën). Nga këto tregues, konstatohet se numri i studentëve që ndjekin rregullisht studimet përbën vetëm 57.47% të numrit të përgjithshëm të regjistruar në UPT. Për vitin akademik 2020-2021, në regjistra figurojnë të regjistruar në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve 14218 studentë, nga të cilët 7957 ishin studentë aktivë. Nga këto shifra konstatohet se numri i studentëve që ndjekin rregullisht studimet përbëjnë 55.96% të numrit të përgjithshëm të regjistruar në UPT.

- UNI Elbasan

Për vitin akademik 2018-2019 në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, në të gjitha programet e studimit, në regjistrat themeltar janë gjithsej 14115 studentë (në kohë normale dhe studentë të padiplomuar në vite). Nga raportimi në pasqyrën statistikore dërguar MASR, rezulton se për vitin akademik 2018-2019 duhet të vijonin mësimet në kohë normale, në auditor me 10445 studentë. Kanë frekuentuar mësimet në auditor 9650 studentë ose 92.3% e studentëve.

Për vitin akademik 2019-2020 në të gjitha programet e studimit, në regjistrat themeltar janë gjithsej 13905 studentë (në kohë normale dhe studentë të padiplomuar në vite). Nga raportimi në pasqyrën statistikore dërguar MASR, rezulton se për vitin akademik 2019-2020 duhet të vijonin mësimet në kohë normale në auditor me 10145 studentë. Kanë frekuentuar mësimet në auditor dhe online deri në 9147 studentë ose nga 74 deri 92.3% e studentëve.

Për vitin akademik 2020-2021 në të gjitha programet e studimit, janë gjithsej 11500 studentë (në kohë normale dhe studentë të padiplomuar në vite). Nga raportimi në pasqyrën statistikore dërguar MASR, rezulton se për vitin akademik 2020-2021 duhet të vijonin mësimet në kohë normale në auditor me 9155 studentë. Kanë frekuentuar mësimet në auditor dhe online deri në 8599 studentë ose nga 74 deri 90.9% e studentëve.

- UNI Korçë

Në Udhëzimin e Rektorit nr. 181, datë 16.03.2020 “Për mënyrat dhe mjetet e zhvillimit të procesit mësimor online”¹¹⁰, janë përcaktuar për:

- UNI Gjirokastrë

Gjatë periudhës së mësimet online, në kushtet e emergjencës dhe të mosfunksionimit të mësimet në auditore, zyra që monitoronte përdorimin e platformës dhe zhvillimin e mësimet online është zyra e IT, duke respektuar lirinë akademike të stafit akademik, zyrë e cila ka patur akses në informacione të tilla si: numri i përdoruesve, numri i orëve të mësimet të zhvilluar me audio/video, numri i dokumentave të shkëmbyera mes palëve, etj.

- UP Tiranë

Në përgjithësi në të gjithë fakultet, përgjegjësi kryesor për monitorimin e mësimet online ka qenë dekanati. Bazuar tek Udhëzuesit e UPT-së për Zhvillimin e mësimet në distancë, secili pedagog në përfundim të javës kalendarike, ka dërguar elektronikisht tek drejtuesi i departamentit evidencën mbi zhvillimin e mësimet në distancë dhe listëprezencën e gjeneruar nga platforma, dhe tek sekretaria mësimore e fakultetit listëprezencën e gjeneruar nga platforma.

- UNI Vlorë

Struktura përgjegjëse ka qenë njësi bazë. Çdo njësi bazë për periudhën Mars-Qershor 2020 ka raportuar rregullisht çdo javë në lidhje me monitorimin e ndjekjes së mësimet online. Për vitin e ri akademik, ky raportim është bërë i organizuar nga fakulteti përmes adresave cloud të njësive bazë dhe raportimeve në google doc të posaçme, periodikisht (https://docs.google.com/document/d/1OeinKxucr6reslgQ-bhYfE_osCl47rDi0v9l_SUZE5U/edit?usp=sharing)

¹⁰⁹ Pyetja 30, shtojca 1.1 dhe 1.2 Shkëputur nga raporti i analizës mësimore

¹¹⁰ Shtojca 7.2 Udhëzim i rektorit, nr. 181, datë 16.03.2020, “Për mënyrat e zhvillimit të Procesit mësimor online”

❖ *Në lidhje me mundësitë e studentëve për përdorimin e literaturës nëpërmjet bibliotekës, gjendja sipas Universiteteve është:*

- I vetmi format aksesit për burime literature online që UNIKO ka vënë në dispozicion të studentëve, ka qenë Biblioteka JSTORE, akses ky i mundësuar nga Projekti CLEANSORE-AADF. Studentët mund ta aksesojnë këtë bibliotekë pa pagesë përmes llogarisë së tyre në Sistemin ESSE-3. UNIKO nuk dispononte të dhëna të frekuentimit për periudhën e pandemisë 2020-2021, për arsye se nuk ka patur akses menaxhimi në këtë platformë.

- Studentët e UNI Vlorë Në periudhën 2020-2021, kanë përdorur bibliotekën online të mundësuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, <https://ulibrary.rash.al/>. Pra, biblioteka online mundësohet nga rrjeti akademik shqiptar (RASH, por është evidentuar se Universiteti nuk ka patur akses për të realizuar një monitorim.

- Monitorimi i orëve të mësimdhënies nga pedagogët është kryer bazuar në planin vjetor të Drejtorisë së Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional, duke bërë edhe verifikimin e dokumenteve të realizimit të kohës vjetore të punës, sipas ngarkesës vjetore, që lidhet me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe kontributin për institucionin.

❖ Nga auditimi i kryer me objekt diplomimin dhe vlerësimin, për nivelin e studentëve në kohë pandemie, krahasuar me numrin e diplomimeve, si dhe nivelin e vlerësimit në kushte normale për vitet 2019-2020-2022, u konstatua se nga vlerësimi i treguesve të paraqitur, universitetet tregojnë se numri i diplomimeve në vitin akademik 2019-2020, krahasuar me vitin parardhës 2018-2019, ka pësuar rënie në masën -11 %, ndërsa për vitin akademik 2020-2021 krahasuar me vitin 2019-2020, ka një rënie prej -10 %.

Niveli i performancës së vlerësimit nuk ka ndryshim nga viti akademik në vitin tjetër dhe **ne si grup nuk kemi tregues të matshëm dhe të verifikueshëm për të dhënë një siguri të arsyeshme mbi vlerësimet e kryera në periudhën e pandemisë 2020-2021.** Kjo gjë ilustron me treguesit e për pesë universitetet objekt auditimi, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 8 Mesatare për vitin akademik 2018-2019, 2019-2020, 2020-2021 sipas Universiteteve

Nr.	Viti akademik	2018-2019		2019-2020		2020-2021	
		St të diplom	Nota mes	St diplom të	Nota mesatare	St të diplom	Nota mesatare
1	Univ."F.Noli" Korçë	1413	6,5	1341	6,7	1117	6,8
2	Univ."E.Çabej"Gjirokastrë	630	7,8	531	7,9	607	8
3	Univ.Politeknik Tiranë	2038	6,7	2175	7,1	1849	7
4	Univ. "I.Qemali" Vlorë	2295	6,8	1509	7	1322	6,7
5	Univ."A.Xhuvani" Elbasan	2861	6,3	2687	6,7	2498	6,8
	Totali	9237		8243		7393	

Burimi: IAL-e dhe punoi Grupi i auditimit të KLSH

❖ Në periudhën e pandemisë 2020-2021 nga IAL-et është bërë monitorimi i orëve të laboratorit dhe praktikës mësimore të cilat nuk u zhvilluan online. Stafet akademike në fakultete kanë marrë masa që këto orë të zhvillohen në auditor gjatë periudhës 1-12 Qershor 2020, periudhë që ka përkruar me kthimin e pjesshëm të studentëve në auditorë (konsultime). Në semestrin e parë të vitit akademik 2020-2021, nga pedagogët janë bërë regjistrime të punëve të laboratorit ose demonstrime të tyre dhe studentët i kanë ndjekur ato online. Kjo është pasqyruar në strukturat mësimore dhe në oraret përkatëse të hartuara nga njësitë bazë, duke respektuar distancimin fizik nëpërmjet grupimit të studentëve sipas kapacitetit të auditorëve.

- Në UPT pjesa më e madhe e lëndëve, janë zhvilluar punë laboratorit online, sepse është mundësuar nga teknologjia (me video të regjistruar demonstruese për mënyrën e zhvillimit të laboratorit, si dhe video ilustruese nga interneti) dhe monitorimi i orëve të laboratorit është bërë nga dekanati. Lëndët të cilat laboratorët i kanë më specifike si p.sh laboratorët e kimisë (për degët që e kanë pjesë të syllabuseve të tyre) janë zhvilluar në mënyrë të kombinuar: në auditor (gjatë fazës së rikuperimit të procesit mësimor 25.08.2020-20.09.2020) dhe on-line (me video të regjistruar paraprakisht për mënyrën e zhvillimit të laboratorit). Sipas verifikimeve të kryera nga grupi i auditimit, evidentohet se nuk ka pasur ankesa nga studentët për vështirësi në përshtatje apo në ndjekje të tyre. Një pjesë e laboratorëve që e kanë patur të domosdoshme realizimin në laborator fizikisht, e kanë zhvilluar gjatë periudhës së kthimit në Qershor 2020, duke zbatuar rregullat anticovid.

- Orët e laboratorit dhe praktikat në UNI Elbasan janë realizuar nëpërmjet grupimit të tyre dhe zhvillimit në një periudhë të caktuar, referuar Vendimit nr. 51 atë 05.05.2020 “Për organizimin e procesit mësimor dhe përfundimin e vitit akademik 2019-2020”. Praktikrat në terren janë zhvendosur për periudhën pas 20 Qershorit 2020 (për programet e master profesional -60 ECTS) dhe në Shtator 2020 për programet e mësuesisë.

- Rektorati i UGJ-së në periudhën 11-17 tetor 2021, i ka ofruar studentëve mundësinë e vaksinimit pranë mjediseve të UGJ-së, në bashkëpunim me Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor. Numri i studentëve të vaksinuar është raportuar në MASR në korrespondencën përkatëse. Në periudhën kur është mundësuar kthimi në auditorë, çdo ditë është kryer kontrolli i gjendjes shëndetësore (temperaturës) i të gjithë studentëve që merrnin pjesë në procesin mësimor, si dhe të stafit akademik dhe administrativ nga përfaqësuesi i dërguar nga Autoriteti Rajonal Shëndetësor Gjirokastrë. Gjithashtu në bazë të rregullores anti Covid është respektuar distancimi fizik sipas kapaciteteve të auditorëve, përdorimi i maskës, desinfektimi i mjediseve, etj.

- Në UP Tiranë, për ardhjen në ndihmë të studentëve të pavaksinuar, është kërkuar mbështetje nga strukturat përgjegjëse, me qëllim vendosjen e një stende për kryerjen e vaksinës në ambientet e institucionit. Stenda është vendosur në godinën e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit dhe ka qëndruar e hapur gjatë gjithë orarit zyrtar për 1 muaj, duke krijuar lehtësi për studentët për marrjen e vaksinës anticovid.

-Në UNI Elbasan për studentët, stafin akademik dhe ate administrativ, është mundësuar fushata e vaksinimit, publikuar në: <https://uniel.edu.al/njoftime-uniel/1177-fushata-e-vaksinimit-anti-covid-ne-universitetin-e-elbasanit-aleksander-xhuvani>

- Përballimi i situatës COVID është vlerësuar pozitivisht në UPT, kjo e pasqyruar në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të hartuar nga ekspertët vendas dhe të huaj të ASCAL për procesin e akreditimit. Në vijim është shkëputur një pjese nga Raporti i Vlerësimit të Jashtëm, lidhur me mësimin online, ku është e cituar: *“UPT-ja është e angazhuar me zhvillimin e infrastrukturës së saj digjitale në mbështetje të mësimnxënies së studentëve dhe zhvillimit profesional të stafit akademik. Kështu, shumica e veprimtarive institucionale janë të disponueshme në formë elektronike, duke përfshirë shërbimet e protokollit dhe arkivimit, sistemet e bibliotekave dhe një platformë e-Learning e krijuar për të lehtësuar mësimin në distancë”*.

Gjatë periudhës së pandemisë Universiteti Politeknik i Tiranës ka punuar për akreditimin institucional, në përfundim të këtij procesi, ka arritur të marrë akreditimin e institucionit për një periudhë 6 vjetecare.

➤ **Mbi takimet Fokus grup të organizuara në tre Universitete.**

Nga grupi i auditimit është vlerësuar në kryerjen e këtij auditimi kontributi i stafit akademik të IAL-ve objekt auditimi, gjithpërfshirja si një kontribut për një auditim cilësor dhe me mirëkuptim me stafet e menaxhimit dhe ato akademik, për të cilët u mendua dhe u krye në 3 IAL-e (UPT datë 20.04.2022, UEL datë 21.04.2021 dhe UNI Vlorë datë 28.04.2022) takime Fokus grup, në të cilën morën pjesë zv/Rektorët, Dekanët e fakulteteve ,të cilët me diskutimet dhe propozimet e tyre në këto takime, sollën disa shqetësime e propozime të cilat u vlerësuan shumë pozitivisht nga grupi i auditimit dhe u thelluan në verifikimin e tyre e konkludimin në rekomandime që do ndikojnë në përmirësimin e procesit mësimor online dhe në auditor.

Të gjitha propozimet e marra dhe ato të dala nga diskutimet në takimet Fokus grup, janë trajtuar me përgjegjësi në tërësinë e materialit.

Këto takime i shërbyen shumë njohjes së problematikave të sjella nga pjesëmarrësit dhe verifikimi në auditim për probleme të veçanta, ka ndikuar që ky auditim të ketë gjithëpërfshirje dhe pjesëmarrje aktive të subjektit të auditimit.

❖ *Analizë mbi matricat e kryera me treguesit e maturuar dhe grafikët përkatës për intervistat(me shkrim) të kryera me studentët në Universitetet objekt auditimi, mbi problematikat dhe shqetësimet e tyre në mësimin në distancë(online).*

- Grupi i auditimit duke vlerësuar impaktin social-ekonomik që ka tema e trajtuar me objekt; “Performanca e Universiteteve publike gjatë periudhës së pandemisë” për periudhën 2020-2021, pas administrimit të dokumenteve dhe informacioneve, u konkludua se është e nevojshme kryerja e intervistave me grupe studentësh(me zgjedhje të rastësishme) dhe përpunimi i tyre për të marrur direkt nga studentët si pjesa që mbart të gjithë finalizimin e procesit mësimor online e auditor dhe zbatimi i


qëllimit të këtij procesi, që është të nxënit në të mësuar dhe rritja e cilësisë së mësimit në kushte pandemie. Në kryerjen e intervistave grupeve të studentëve ju vu në dispozicion pyetsori me format të hartuar nga grupi i auditimit të KLSH me 9 pyetje të cilat preknin problematikat dhe shqetësimet e tyre, ku formati i pyetsorit është paraqitur në Projektraportin e auditimit të paraqitur.

Intervistat u organizuan me nëngrupe brenda grupit të auditimit dhe u krye në total në 249 studentë të ndarë 12 grupe(klasa) nga këta: UPT 4 grupe, UEL 2 grupe, UNIKO 2 grupe, UGJ 2 grupe dhe UNI Vlorë 2 grupe), ku në bashkëpunim me stafin akademik të IAL-eve dhe prezencën tonë u plotësuan pyetsorët pa u ndikuar nga persona të tjerë apo faktorë të tjerë ndikues.

Përgjigjet e marra nga studentët u vlerësuan maksimalisht nga grupi i auditimit dhe jo vetëm morëm feedback, por edhe konfirmuam një pjesë të problemeve apo shqetësimeve të realizimit të procesit mësimit online e në auditor në kushte pandemie, të evidentuara e trajtuar nga ana jonë në Projektraportin e auditimit.


Grupi i auditimit punoi dhe përgatiti matricën dhe në mënyrë grafike treguesit e përgjigjeve të marra nga studentët, konkretisht po shtjellojmë shkurtimisht disa nga pyetjet që i kemi vlerësuar më të rëndësishme dhe paraqiten me matricë(këto si modeli i pyetje nr.1 administrohen nga grupi i auditimit) dhe grafikisht: **Pyetja nr.1** Cili është vlerësimi juaj për zhvillimin e mësimit online? Për këtë pyetje janë përgjigjur 249 studentë nga të cilët: Mësimin online e pëlqejnë 30% “Kënaqshëm” dhe mirë 39%, të pakënaqur 11% dhe shumë mire 20%, pra siç shikohet **89 % studentëve të intervistuar e pëlqejnë mësimin online.** Në matricë dhe grafikisht përgjigjet si më poshtë:

Roë Labels	1.Cili është vlerësimi juaj për zhvillimin e mësimit online?	Count of Universiteti
UNIELBASAN	Kënaqshëm	15
UNIELBASAN	Mirë	17
UNIELBASAN	Shumë mire	1
UNIGjirokastr	Kënaqshëm	6
UNIGjirokastr	Mirë	19
UNIGjirokastr	Pakënaqshëm	1
UNIGjirokastr	Shumë mire	18
UNIKORCA	Kënaqshëm	17
UNIKORCA	Mirë	14
UNIKORCA	Pakënaqshëm	2
UNIKORCA	Shumë mire	7
UNIVLORA	Kënaqshëm	18
UNIVLORA	Mirë	23
UNIVLORA	Pakënaqshëm	5
UNIVLORA	Shumë mire	13
UPT-FAU	Kënaqshëm	5
UPT-FAU	Mirë	6
UPT-FAU	Pakënaqshëm	8
UPT-FAU	Shumë mire	1
UPT-FGJM	Kënaqshëm	8
UPT-FGJM	Mirë	2
UPT-FGJM	Pakënaqshëm	5
UPT-FGJM	Shumë mire	1
UPT-FIN	Kënaqshëm	3
UPT-FIN	Mirë	6
UPT-FIN	Pakënaqshëm	8
UPT-FIN	Shumë mire	2
UPT-FTI	Kënaqshëm	4
UPT-FTI	Mirë	10
UPT-FTI	Shumë mire	4
Grand Total		249




Pyetja nr.2. A keni patur ankesa për procesin e zhvillimit të mësimit online (nëpërmjet platformave)? Nëse po, ku i keni adresuar ankesat dhe cila ka qenë arsyeja? Për këtë pyetje kemi marrë përgjigje që nuk kemi patur ankesa dhe nëse gjatë mësimit online ka patur shqetësime, ato janë zgjidhur me pedagogun e lëndës dhe sektorin e TI-së.

Pyetja nr.3. Gjatë mësimit online, si e vlerësoni efektivitetin e të nxënës (përfitim tuaj nga mësime të ndryshme)? Të 249 intervistuarit në lidhje me të nxënës, kjanë shprehur se ; të nxënës ka qenë i dobët në masën 32.5%, dhe mendojnë mirë 56.6 % dhe shumë mire 10.8 % e tyre, pra ata mendojnë se të nxënës ka qenë i duhur në masën 67.4 %. Në matricën e administruar nga grupi i auditimit të KLSH dhe treguesit janë grafiksht është si më poshtë:




Pyetja nr. 4. Gjatë procesit të mësimit online, a keni patur mbivendosje të lëndëve në të njëjtin orar? Nëse po, në sa raste? A kërkuat zgjidhje? Përkrahjet tuaj ndaj zgjidhjeve. Për këtë pyetje, studentët janë përgjigjur se 44.1 % e tyre u janë zgjidhur në mënyrë të menjëhershme mbivendosjet e orareve, ndërsa 24.9 % e tyre kanë hasur në mosvlerësim dhe nuk kanë marrë zgjidhje dhe 30.9 % e tyre mendojnë se nuk u janë zgjidhur (ankesat)kërkesat për mbivendosje orari, ky tregues është jo i kënaqshëm për punën e stafit akademik. Në matricën e administruar nga grupi i auditimit të KLSH dhe treguesit janë grafiksht është si më poshtë:




Pyetja nr.5 A keni patur ankesa për mungesë komunikimi dhe të shkëmbimit të informacionit të drejtpërdrejtë, pedagog/student (nuk ju është dërguar materiali i punuar në platformë, moskomunikim për shkaqe që lidhen me IT, etj.)?

Nëse po, listojini ato duke dhënë dhe vlerësimin tuaj për komunikimet me pedagogët?

Nga 249 studentë të intervistuar 18 % e tyre e vlerësojnë “Dobët” komunikimin me pedagogët, ndërsa 56.6% e tyre mendojnë se komunikimi ka qenë “Mirë” dhe 25.4 % mendojnë shumë mire, pra ky tregues fletë për marrëdhënie të mira në masën 82% pedagog/student. Në mënyrë grafike dhe me tregues sipas IAL-ve është më poshtë:




Pyetja nr.6 Gjatë periudhës së pandemisë, me kthimin e mësimit në auditor, a ishin marrë masa për mbrojtjen e shëndetit tuaj dhe stafit akademik? Jepni vlerësimin tuaj. Studentët në lidhje me masat e marra për mbrojtjen e shëndetit 38.5 % mendojnë se kanë qenë “Shumë mirë” dhe 39.7 % mendojnë mire, ndërsa 22% e tyre mendojnë se masat e marra kanë qenë “Dobët”. Në mënyrë grafike dhe me tregues sipas IAL-ve është më poshtë:




Pyetja nr.7 Me rikthimin në auditor, a kërkuat ndihmë për kryerjen e Testit Covid 19? Nëse po, kujt iu drejtuat dhe cili ishte reagimi? Me kthimin në auditor studentëve u kërkuar që të kryenin Testin e Covid

19 dhe për këtë 79.2 % e studentëve mendoj pozitivisht për masat e marra si vendet e vaksinimit në godinat e IAL-eve , por edhe në mirëkuptimin e stafit administartiv dhe akademik.Studentët që mendojnë negativisht janë 20.6% , nga të cilët 15.5 % vjanë përballur me mosvlerësim nga stafet e IAL-eve dhe 5.1% mendojnë negativ për vaksinimin. Në mënyrë grafike dhe me tregues sipas IAL-ve është më poshtë:




Pyetja nr.8 A keni kërkuar ndihmë për pajisjen me logjistikë IT (internet, kompjuter, tabletë dhe shërbime të tjera), gjatë periudhës së pandemisë dhe kujt i jeni drejtuar? Cili është vlerësimi juaj për kontributin e Universitetit, lidhur me trajtimin e kërkesave tuaja? Kjo pyetje si një pyetje shumë e rëndësishme dhe që ka patur një impact të madh tek të intervistuarit kemi marrë se 6.6% e tyre e vlerësojnë “Dobët” kontributin e Universitetit dhe 48% mendojnë “Mirë” dhe vetëm 45.4 % mendojnë “Sh. Mirë”. Situata kjo që tregon se Universiteti duhet të bashkëpunojë më shumë me Njësitë e Vetëqeverisjes vendore, kompani private internet, telefonie celulare, kompani shërbimesh etj., që ndikojnë në përmirësimin e kushteve të mësimin online dhe në auditor të studentëve. Në mënyrë grafike dhe me tregues sipas IAL-ve është më poshtë:



Pyetja nr.9 A keni patur ankesa për vlerësimin nga pedagogët, për nivelin e përgatitjes tuaj në procesin mësimor gjatë pandemisë? Përshkruani rastet nëse keni patur! Ku i keni adresuar ankesat dhe sa u janë marrë në konsideratë?

Si e gjykoni vlerësimin e marrë gjatë kësaj periudhe?

Në lidhje me këtë pyetje që ka të bëjë me vlerësimin e studentëve për të përvetësimin e mësimdhënies dhe cilësinë e vlerësimit nga pedagogët dhe zgjidhja e ankesave , ka rezultuar se 71.5% e tyre kanë një perceptim të mirë dhe pëlqejnë vlerësimin objektiv të pedagogëve, dhe 23.7% e vlerësojnë shumë miirë vlerësimin nga pedagogët, ndërsa vetëm 4.8% e vlerësojnë aspak objektiv vlerësimin që kanë marrë nga pedagogët. Në mënyrë grafike dhe me tregues sipas IAL-ve është më poshtë:



Për sa kemi pasqyruar më sipër; shihet qartë se studentët kanë dhënë përgjigje objektive dhe të pa ndikuara nga persona apo faktorë të ndryshëm. Mbi këto përgjigje Grupi i auditimit të KLSH-it, ka iniciuar thellimin e punës audituese për të vlerësuar e trajtuar profesionalisht këto shqetësime, të cilat mendojmë se do të shmangen nga stafi administrativ e akademik të IAL-eve. Ky është një test i kryer në kuadrin e gjithëpërfshirjes në këtë auditim dhe feedback i marrë ka ndihmuar audituesit e jashtëm publik për konkluzione e rekomandime objektive e në përafrim me realitetin e kryerjes së mësimin online dhe në auditor në periudhën e pandemisë 2020-2021, por në asnjë mënyrë nuk ka ndikuar drejtperdrejtë dhe nuk është baza e auditimit të kryer në IAL-e.

Gjetja nga auditimi:

14. Nga auditimi u konstata se departamentet e IAL-ve nuk kanë bërë analiza të nevojave në lidhje me kapacitetet që duhet të kenë klasat virtuale, me qëllim funksionimin real dhe pa problem të tyre, për nevojat lidhur për punët laboratorike si dhe studim apo analizë mbi gjendjen e infrastrukturës dixhitale për të njohur kapacitetin e nevojshëm për shkarkimin e leksioneve, detyrave të kursit, projekteve, etj. Mungesa e evidentimit të problematikave të mësipërme, ka sjellë si pasojë aplikimin nga universitetet objekt auditimi të disa platformave (shpesh të përzgjedhura individualisht nga pedagogët), si Google-classroom, Microsoft Teams dhe Zoom, të cilat nisur edhe nga përgjigjet e pyetësorëve paraqitën problematika teknike në lidhje me internetin dhe aksesimin e këtyre platformave.

Konkluzioni:

12. Nga strukturat e IAL-ve nuk janë vlerësuar objektivisht nevojat dhe u ka munguar analizat e nevojave dhe mundësive që kanë patur nga gjendja e infrastrukturës së IT për të përballuar situatën pandemike Covid 19.

Rekomandimi:

13. IAL-et të marrin masa dhe në periudha periodike të kryejnë me grup pune vlerësimin e gjendjes së infrastrukturës së IT, kapaciteteve dhe mundësive për situata të jashtëzakonshme dhe të pa parashikuara.

Menjëherë e në vijimësi


4.3.1 A kanë qenë të mjaftueshme burimet financiare të përdorura për përballimin e situatës së pandemisë?

Gjatë periudhës së Pandemisë Universitetet, objekt i këtij auditimi **nuk** kanë arritur t'i përdorin të gjitha fondet që kanë pasur në dispozicion, konkretisht:

- Për periudhën e pandemisë Mars 2020-Dhjetor 2021 nga Universiteti “Fan S.Noli” Korçë, nuk është kërkuar dhe kryer rialokim i fondeve për arsye se shpenzimet e kryera për përballimin e situatës së krijuar nga Covid-19, janë mbuluar me fondet e planifikuara sipas periudhës përkatëse. Gjatë vitit 2020, ky universitet ka shpenzuar 74,984 mijë lekë, nga 90,319 mijë lekë që ishin planifikuar, **ose realizuar buxheti në masën 83%.**
- Për Universitetin “A.Xhuvani” Elbasan, plan buxheti i vitit 2020 i çelur për përdorim (Plan Thesari) në vlerën 1,136,019 mijë lekë, është realizuar në vlerën 806,032 mijë lekë, **ose realizuar buxheti në**

masën 71.0 %

- c) Në Universitetin “E.Çabej” Gjirokastrë, plan buxheti i çelur për përdorim është në vlerën 332.767 lekë. Është realizuar në vlerën 295.568 mijë lekë, ose 88.8 %.
- d) Për vitin 2020 Universiteti Politeknik i Tiranës ka realizuar 1.485.684 mijë lekë nga 1,888,282 mijë lekë, që ishin planifikuar për vitin 2020 **ose realizuar buxheti vjetor në masën 79%.**
- e) Universiteti “I. Qemali” Vlorë, ka përdorur një buxhet total në vlerën 555,163 mijë lekë, nga plani që ka qenë në vlerën 627,684 mijë lekë **ose realizuar buxheti në masën 88.4 %.**



Vlera totale e shpenzimeve operative 5 Universitetet gjatë vitit 2020, ishte 2,814,742 mijë lekë, nga të cilat, shpenzime për Covid 19 në vlerën 47,236 mijë lekë (ose 1.6 % ndaj totalit të shpenzimeve), që tregon për mungesë prioritarizimi të buxhetit të tyre, ndaj nevojave të reja, të diktuar nga situata e krijuar prej pandemisë.

- Për vitin 2020 buxheti i detajuar për arsimin është mbështetur në Programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, si dhe në prioritetet e përcaktuara nga Qeveria për gjashtë programet buxhetore (ku bëjnë pjesë Programi “Arsimi i Lartë” dhe “Kërkimi shkencor”), ose niveleve arsimore ku janë mbajtur parasysh objektivat, qëllimi i synuar, përfituesit, në synim të objektivave të përcaktuara në strategjinë e arsimit dhe Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2013-2020, si dhe kërkesave për implementimin e ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Një nga qëllimet e reformës arsimore që kryhet në Shqipëri, është të vendosë Arsimin e Lartë mbi baza financiare të qëndrueshme për t’u bërë ballë ndryshimeve dhe cikleve ekonomike. Në këtë prizëm, larmia e financimit dhe autonomia institucionale e IAL-ve janë shumë të rëndësishme për maksimalizimin e të gjitha burimeve të financimit të arsimit të lartë që ekzistojnë në shoqërinë tonë.

Bazuar në ligjin nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019” për vitin 2019 i është akorduar Arsimit të Lartë dhe Kërkimit shkencor në Shqipëri një grant prej 40,007,043 mijë lekë në total për arsimin, nga kjo Arsimi i Lartë është financuar në vlerën 7,830,000 mijë lekë 19.6%. Në vitin 2020-2021 bazuar në ligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2020” të miratuar, janë financuar IAL-et e vendit në formë Granti me vlerë 9,730,000 mijë lekë ose 23% nga totali i shumës 41,979,763 mijë lekë të akorduar për arsimin dhe për vitin 2021 shuma e financuar në formë Granti ka vlerën prej 10,096,000 mijë lekë, ose 24% nga shuma totale 42,214,076 mijë lekë, të akorduara për arsimin në Shqipëri sipas ligjit përkatës për buxhetin e vitit 2021.

Buxheti i shtetit ka financuar Arsimin e Lartë me fonde “Grant për mësimdhënie” miratuar në zbatim të kritereve të përcaktuara në VKM nr. 75, datë 12.02.2018 në masën 9.5 miliard lekë, ku përfshijnë fondet për mbulimin e shpenzimeve të personelit, shpenzime të tjera e shërbime të domosdoshme, si dhe në shumën 8,25 miliard lekë si dhe fondet për mbështetje studentore në vlerën 1 miliard e 323 milion lekë, pra siç shikohet ka rritje të fondeve, por trendi i kësaj rritje është shumë i vogël, duke patur parasysh nevojat e mëdha që ka AL, veçanërisht për periudhën e pandemisë 2020-2021. Për periudhën e pandemisë, Qeveria nuk ka bërë asnjë financim shtesë për mbrojtjen e shëndetit të studentëve dhe stafit akademik e administrativ.

- Fondet e miratuara me ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020” për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë për vitin 2020, janë në shumën prej **41 miliard e 979 milion lekë**, krahasuar me shpenzimet publike fondet për arsimin për vitin 2020 arrijnë në **7.89%** dhe ndaj produktit të brendshëm bruto dhe për vitin 2020 janë në nivelin **2.34%**. Pas alokimeve me Akt normativ buxheti i arsimit është **40 miliard e 779 milion lekë**, shtuar dhe fondet grant të trashëguara nga viti 2019, për MASR për vitin 2020, arrin në shumën prej **41 miliard e 434.6 milion lekë**.

Tabela nr. 8_ Fondet e miratuara me ligjin nr.88/2019 “Për buxhetin e vitit 2020”, në 000/ lekë.

Kodi	Emertimi i Institucionit / Programit	Totali i Shp. Korrente	Shpenzimet Kapitale			Totali i Shpenzimeve Buxhetore
			Financim i Brendshëm	Financimi i Huaj	Totali i Shp. Kapitale	
11	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	38,058,763	3,705,000	216,000	3,921,000	41,979,763
09450	Arsimi Universitar	9,000,000	630,000	100,000	730,000	9,730,000
09770	Fonde për Shkencën	300,000	100,000	100,000	200,000	500,000
	Totali i Arsimit Lartë me Kerkimi Shkencor					10,230,000

Burimi: MASR dhe perpunuar grupi i auditimit

Realizimi për periudhën 12-mujore 2020 është në masën 95% e fondeve të planifikuara për 12-mujorin 2020, ose në shumën prej **39 miliard e 235 milion lekë dhe për programet e AL dhe Kërkimit shkencor është**

Tabela 8.1, Fondet buxhetore të realizuara sipas programeve buxhetore për vitin 2016-2017-2018-2019, plani 2020, i rishikuar se bashku me fondet e trashëguara në kapitullin 08 tek AL dhe Programi i kërkimit shkencor, si dhe realizimi për 12- mujorin e vitit 2020, në 000 lekë, si dhe në %. (pa të ardhurat e IAL)

Nr	Emri i programit	Fondet e buxheti 2020									
		Fakti 2016	Fakti 2017	Fakti 2018	Fakti 2019	Buxheti Mirat 2020	Buxheti rishikuar 2020+Fondet e trashëguar	Buxheti i rishikuar	Realizimi 12- M 2020	Struktura e fondeve për 12- mujorin 2020	Realizimi 12- mujor 2020
		(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	Ne %	Ne %
09450	Arsimi i lartë	6,198.5	6,687.0	7,204.0	8,766.5	9,730	10,124.9	10,024.9	8,812.5	24.3%	88%
09770	Kerkimi shkencor	283.0	325.6	318.2	364.0	500	680.2	680.2	614.9	1.6%	90%
	Totali AL+Kerk. Shkencor	6,481.5	7,012.6	7,522.2	9,130.5	10,230	10,805.1	10,705.1	9,427.4	25%	88 %
	Totali	34,507	35,329.3	37,485.4	39,923.7	41,979.8	41,602.105	41,434.6	39,235.0	100.0%	94.7%

Burimi: MASR dhe perpunuar grupi i auditimit

Fondet e rishikuar të buxhetit përfshirë fondet e miratuara me ligjin vjetor ligjin nr.88/2020 “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar më akte normative, si të ardhurat dytësore të IAL publike që kanë qenë në vlerën **2,736.1 mijë lekë** shtuar fonde grant të trashëguara nga viti 2019(për specifikat që ka në ndërthurjen me vitin arsimor 2019-2020), janë në tabelën e mëposhtme:

Tabela 8.2, Fondet buxhetore se bashku me të ardhurat sipas programeve buxhetore, realizimi për vitin 2016-2017-2018 si dhe fondet e planifikuara, ndryshuara dhe realizuara për vitin 2020, në 000 lekë, si dhe në %.

Fondet e buxheti 2020 se bashku me të ardhurat 2020											
Nr	Emri i programit	Fakti 2016	Fakti 2017	Fakti 2018	Fakti 2019	Buxheti Mirat 2020	Buxheti rishikuar	Buxheti i rishikuar + Te ardhurat për 12-M 2020	Buxheti Realizuar 12-M 2020+Te ardhurat	Struktura e fondeve për 12- mujorin 2020+Te ardhurat	Realizimi 12-mujor 2020
		(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	Ne %	Ne milion /lekë
5	Arsimi i lartë	9,530.9	9,719.2	10,506.9	11,616.6	9,730.0	10,024.9	12,761.0	11,548.7	27.4%	90%
6	Kerkimi shkencor	343.4	359.5	414.9	507.2	500.0	680.2	867.4	802.0	1.9%	92%
	Totali AL +K.Shkencor	9,874.3	10,078.7	10,921.8	12,123.8	10,230	10,705.1	13,628.4	12,350.7	29.2%	90.6%
	Totali MASR 2020	37,967.5	38,450.6	40,979.2	42,971.7	41,979.76	41,434.60	44,420.94	42,221.4	100.0%	95%


Burimi: MASR dhe përpunim GA situacioni realizimit të fondeve për vitin 2016-2017-2018 si dhe 12-mujori 2020

- Shuma e fondeve me destinacion financimin e bursave të studentëve është 996,08 milion lekë, ku kanë përfituar bursë 12704 studentë, kategori të caktuara të studentëve sipas rezultateve dhe studentëve nga kategoritë sociale në nevojë, të cilët nuk kanë mundësi financiare për të përballuar një pjesë të kostos të studimeve kostot e shkollimit, sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 903, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” i ndryshuar,ku realizimi vjetor është realizuar në masën 83% e në vlerë 830.5 milion lekë.¹¹¹

¹¹¹ Ligji i buxhetit nr.88, datw 18.12.2019


Ligji i buxhetit nr.137, datw 16.12.2020)

Në mënyrë grafike parashikimi dhe realizimi janë:



Për vitin 2021

Fondet e miratuara për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë për vitin 2021, me ligjin vjetor ligjin nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” të ndryshuar, sipas programeve buxhetore, **shtuar dhe fondet grant të trashëguara** nga viti 2020, arrin në shumën prej **42 miliard e 981.7 milion lekë**, së bashku me fondet grant të trashëguara nga vitit 2020 arrijnë në shumën prej **44 miliard e 373.4 milion lekë**. Realizimi për periudhën 12-mujore 2021 është në masën 90.8% e fondeve të planifikuara për 12-mujorin 2021, ose në shumën prej **27 miliard e 107 milion lekë**, ose 92% e planit të parashikuar për 12-mujorin 2021 me një strukturë buxhetore ku financimi nga buxheti i shtetit për AL dhe Kërkimin shkencor është 24% dhe realizim 22% dhe kërkimi shkencor planifikuar 1.6%, realizuar 0.9 %.



Punoi: Grupi i auditimit

Në formë tabelare dhe sipas vlerës buxhetit për AL dhe kërkimin shkencor si planifikim dhe realizim, ku të ardhurat totale nga AL është në vlerën 2,234.1mijë lekë (14010.1(AL 13,254.7 +KSH755.4) – 11,776 mijë lekë(10,096 +680) është në tabelën e mëposhtme:

Tabela 9.1, Fondet buxhetore të realizuara sipas programeve buxhetore për vitin 2019-2020, plani i miratuar për vitin 2021, plani i rishikuar me aktin Normativ Qershor 2021, së bashku me fondet e trashëguara në kapitullin 08 tek AL dhe Programi i kërkimit shkencor, si dhe realizimi për 12-mujorin e vitit 2021, në 000 lekë, si dhe në %.

Nr	Emri i programit	Fakti 2019	Buxheti Realizuar 12-M ar 12-M _2020+ Te	Buxheti Mirat 2021	Buxheti rishikuar + fonde grant te	Buxheti I rishik+ Gante te trasheguar	Buxheti realiz 12-M 2021+Grante te	Struktura e fondeve per 12-mujorin 2021	Buxheti Realizuar 12-M _2021	Realizimi 12-mujor 2021	Struktura sipas PB Realz,Ine % ndaj buxhetit
----	------------------	------------	--	--------------------	------------------------------------	---------------------------------------	------------------------------------	---	------------------------------	-------------------------	--

ardhura		trashëguara		per 12-M		trashëguara		te			
t		2021		2021		ra		rishikuar			
		(milion lekë)	Ne milion /lekë	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	(milion lekë)	Ne %	Ne milion /lekë	Ne %	Ne %
1	Planif. menaxhim administrim	753.9	616.7	722.0	739.0	739.0	724.4	1.7%	724.4	98%	1.7%
2	Arsimi baze	22,429.8	22,147.7	22,792.1	23,898.8	23,898.8	23,727.1	53.9%	23,727.1	99%	56.6%
3	Arsimi i mesëm përgjith	7,161.9	6,834.7	7,199.0	6,870.4	6,870.4	6,791.4	15.5%	6,791.4	99%	16.2%
5	Arsimi i lartë	8,766.5	8,812.5	10,096.0	11,040.5	11,040.5	9,188.8	24.9%	9,188.8	83%	21.9%
6	Kërkimi shkencor	364.0	614.9	680.0	702.0	702.0	388.6	1.6%	388.6	55%	0.9%
7	Zhvillim i Sportit	447.6	208.5	725.0	1,121.1	1,121.1	1,085.7	2.5%	1,085.7	97%	2.6%
	Totali MASR	39,923.7	39,235.0	42,214.1	44,371.789	44,371.79	41,906.0	100.0%	41,906.0	94.4%	100.0%
	Arsimi i lartë	11,616.6	11,548.7	10,096.0	13,254.7	13,254.7	11,403.0	25.8%	11,403.0	86%	25.8%
	Kërkimi shkencor	507.2	802.0	680.0	755.4	755.4	442.0	1.0%	442.0	59%	1.0%
	Totali AL+KSH+te ardhura 2020-2021	12,123.8	12,350.7	10,776	14,010.1	14,010.1	11,845	27%	11,845	84.5%	26.7%
	Totali MASR +te ardhurat AL e KSSH	42,971.7	42,221.4	42,214.08	46,704.740	46,704.74	44,239.0	100.0%	44,239.0	95%	100.0%

Burimi: MASR dhe përpunim GA situacioni realizimit të fondeve për 12-mujori 2021

-Shpenzime korente pjesë e fondeve grant për IAL publike për vitin 2021, kanë qenë planifikuar 9 miliard lekë, pas rimarrjes së fondeve grant të trashëguara nga viti 2020, fondet për IAL publike arritën në masën 10 miliard 114 milion lekë, janë kryesisht shpenzime personeli për IAL publike, ku realizimi si 12-mujor 2021 është në masën 8 miliard 907 milion, ose në 88.1% fondeve të planifikuara për 12-mujorin 2021.

-Shpenzimet për mbulimin e bursave financiare për studentët në kuadrin e “Paktit për Universitet”, me rreth 850 milion lekë, buxheti i rishikuar 2021, është në masën 1 miliard e 101 milion lekë, pas rimarrjes së fondeve të kursyera nga viti 2020, ku përfitues parashikohen të jenë 11 829 studentë, për periudhën 12-mujore 2021 realizimi është 990.8 milion lekë ose 90% ndaj planit 12-mujorit 2021.

Fonde grant, për të mbuluar shpenzimet e studentëve për akomodimin e studentëve në tetë “Shoqëritë e Trajtimit të studentëve në Tiranë dhe në Rrethe”, për vitin 2020 janë parashikuar të akomodohen rreth 6 mijë studentë, janë planifikuar 300 milion lekë në vit, realizimi është në masën 299 milion lekë ose në masën 100%. Për shkak të situatës COVID-19, akomodimi i studentëve për më shumë se 8 muaj për vitin 2021 është pezulluar.

Fondet për mbulimin e bursave financiare për studentëve ekselencë që ndjekin studimet në 15 universitetet më të mira, referuar renditjes së “Times Higher Education”, si dhe punonjësve të administratës publike, të cilët përfitojnë trajnime/kualifikime apo studime të ciklit të dytë dhe tretë në 300 universitet më të mira të botës; është në masën 201.2 milion lekë, realizimin planit 12-mujorti 2021 është në masën 197.4 milion lekë ose në masën 98.1%, e fondeve të parashikuara për 12-mujorin 2021.

Fonde për pjesëmarrjen në marrëveshjen kuadër “Horizont 2020”. Program i BE-së për Kërkim dhe Inovacion, pjesëmarrje e që premtim arritje të mëdha në kërkimin shkencor dhe synon sigurimin e konkurrueshmërisë së Europës në nivel global, për vitin 2021 janë parashikuar 50 milion lekë, për pagesa kuota anëtarësie transferta ndërkombëtare shuma prej 200 milion lekë, nga të cilat shuma prej 50 milion lekë, është planifikuar të paguhet me fonde grand nga buxheti si dhe 150 milion lekë nga rimbursimi i fondeve grand të BE, për këtë marrëveshje.

Siç shikohet, nga pasqyra e situatës buxhetore për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, ndonëse fondet kanë ardhur në trend rritje 2-3% nga viti 2019-2020 dhe 2021, vëmendja e Qeverisë ka qenë e pamjaftueshme dhe vlerësojmë se IAL-et janë ndër institucionet e veçanta që për periudhën e Pandemisë

Covid 19 (Mars 2020-Dhjetor 2021), nuk është financuar me asnjë vlerë financiare, si për mbrojtjen e shëndetit të studentëve dhe stafit akademik, por dhe asnjë financim për studentë e pedagogë për infrastrukturë IT si Laptop, tableta, apo ndihme me mbulimin e shpenzimeve për përdorim interneti nga studentët jashtë auditorëve me platformat e siguruar nga IAL-et për mësimin online.

- Në situatën e pandemisë 2020-2021, nga IAL-et objekt auditimi janë përdorur fonde nga buxheti nëpërmjet rialokimeve për mbrojtjen e shëndetit dhe zbatimin e kushteve higjeno-sanitare, ku buxheti i përdorur nga këto universitete është në përqindje fare të vogël nga buxheti në total i përdorur për periudhën e pandemisë. Sipas përqindjes dhe ndarjes që zë buxheti i përdorur për pandeminë (masat mbrojtëse higjeno sanitare), janë të detajuara në tabelën e mëposhtme:

Tabela10 Pesha në buxhet e fondeve përdorur për masat higjeno-sanitare (Covid 19) viti 2020-2021

000/lekë

N r	Univ. Viti	UP Tiranë			UNI Elbasan			UNI Korçë			UNI Vlora			UNI Gjirokastrë		
		Buxheti Totali	Buxh. perd, pand	% ze në bux h.to tal	Buxheti Totali I	Buxh. perd, pand	% ze në bux h.to tal	Buxheti Totali I	Bux h. perd, pand	% ze në bux h.to tal	Buxheti Totali I	Buxh . perd, pand	% ze në bux h.to tal	Buxheti Totali I	Buxh . perd, pand	% ze në bux h.to tal
1	v2020	1,224,102	22,494	1.8	751,877	13,070	1.74	436,040	862	0.2	555,162	1,484	0.27	283,603	556	0.2
2	v.2021	1,447,724	2,982	0.2	777,575	2,514	0.32	470,541	102	0.02	580,914	2,300	0.4	262,949	872	0.33
	Total	2,671,826	25,476	0.95	1,529,452	15,584	0.18	906,581	964	0.01	1,136,076	3,784	0.33	546,552	1,428	0.26

Burimi: Përpunimi grupi i auditimit KLSH.

Siç është paraqitur në tabelë, konstatohet se për të pesë Universitetet, objekt auditimi kanë patur buxhet total në vlerë 3,250,784 mijë lekë dhe kanë përdorur për shpenzime për masa higjeno-sanitare nëpërmjet rialokimeve buxhetore në vlerë 38,466 mijë lekë për vitin 2020 e cila zë mesatarisht 1.18 % të buxhetit, pra një shifër shumë e ulët. Ndërkohë, disa Universitete mund të kishin alokuar fonde nga shpenzime të tjera dhe të kryenin investime për infrastrukturën e studentëve sipas nevojave të paraqitura, siç është vepruar në vendet e tjera fqinjë Greqi, Itali etj. Universitetet objekt auditimi për për vitin 2021, kanë patur një buxhet total në vlerë 3,539,703 mijë lekë dhe kanë përdorur për shpenzime për masa higjeno-sanitare në periudhën e pandemisë, nëpërmjet rialokimeve buxhetore vlerën 8,770 mijë lekë e cila zë mesatarisht 0.25% të buxhetit total. Sipas IAL-eve pesha që zënë shpenzimet buxhetore të kryera për mbrojtjen e shëndetit dhe kushtet higjeno sanitare për periudhën e pandemisë Covid 19 (viti 2020-2021) në formë krahasimore, rezultojnë:

1. UPT ka përdorur fonde buxhetore në total 2,671,826 mijë lekë, nga këto përdorur për pandeminë vlara 25,476 mijë lekë ose 0.95% e buxhetit.
2. U Elbasan ka përdorur fonde buxhetore në total 1,529,452 mijë lekë, nga këto përdorur për pandeminë vlara 15,584 mijë lekë ose 0.18% e buxhetit.
3. U Korçë ka përdorur fonde buxhetore në total 906,581 mijë lekë, nga këto përdorur për pandeminë vlara 964 mijë lekë ose 0.01% e buxhetit.
4. U Vlorë ka përdorur fonde buxhetore në total 1,136,076 mijë lekë, nga këto përdorur për pandeminë vlara 3,784 mijë lekë ose 0.33% e buxhetit.
5. UPT ka përdorur fonde buxhetore në total 546,552 mijë lekë, nga këto përdorur për pandeminë vlara 1,428 mijë lekë ose 0.26% e buxhetit.

Në pamjen e përgjithshme në raport me fondet buxhetore të përdorura, pesha që kanë zënë shpenzimet e rialokuara dhe kryera për efekt të situatës pandemike në periudhën 2020-2021 rezulton se ato nuk kanë zënë as 1% të totalit, shifër kjo jo e kënaqëshme dhe e pranuar, pasi duhet të përdoret më shumë e përveç masave mbrojtëse higjeno-sanitare, IAL-et duhet të investonin në përmirësimin e infrastrukturës së komunikimit të mësimin online.

Gjetja nga auditimi:

15: Nga IAL-et objekt auditimi, janë përdorur fonde nga buxheti që kanë patur si burim rialokimet e kryera dhe buxheti i përdorur nga këto universitete, në përqindje fare të vogël, më pak se 1% nga buxheti total i përdorur në këtë periudhë pandemie për mbrojtjen e shëndetit dhe zbatimin e kushteve higjeno-sanitare të mësimdhënies studentëve (online/auditorë) dhe stafit akademik e administrativ në situatën e pandemisë në vitet 2020-2021. Nuk janë përdorur fondet në dispozicion që kishin IAL-et, për të alokuar

nga shpenzimet e tjera vlera më të mëdha me prioritet fondet për pandeminë në investime, infrastrukturën e IT dhe ndihmë për studentët, 20-30% e fondeve buxhetore të tyre, të “digjeshin” dhe të mos përdorëshin.

Konkluzioni:

13. Stafet menaxhuese të IAL-ve në periudhën e pandemisë, nuk kanë kryer një vlerësim të duhur të fondeve në dispozicion, për të kryer rialokime të nevojshme dhe rritjen e fondeve, duke mos bërë efektive buxhetet në funksion të orientimit të nevojave që diktoi situata e pandemisë.

Rekomandimi:

14. IAL-et të marrin masa e të bashkëpunojnë me Senatet Akademike e Bordet e Administrimit, për nevojat e vendimmarrjeve në vlerësimin e situatave që mund të paraqiten (veçanërisht në kushte të jashtëzakonshme), shfrytëzimin e të gjitha mundësive për rialokime fondesh, dhe të hartohen plane veprimi për përmirësimin dhe lehtësimin e mësimin në auditorë apo dhe në distancë nga studentët e stafit akademik.

Në vijimësi

Më hollësisht situatat financiare dhe buxhetore të IAL-eve objekt auditimi do trajtohen në vijim:

1. Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) ka përdorur fonde publike për vitin 2020, si më poshtë:

- Për ushtrimin e aktivitetit për periudhën 2020-2021 ky institucion i Arsimit të Lartë, ka përdorur fondet publike me burim financimi:

Tabela 11: Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura (mijë/lekë)

EM ËRTIMI	Vlera në vitin 2019	Vlera në vitin 2020	Vlera në vitin 2021
A Shpenzime nga Buxheti	1,124,532	1,072,536	1,164,601
SHUMA A	1,124,532	1,072,536	1,164,601
B Shpenzime nga të ardhurat	254,874	151,566	283,123
SHUMA B	254,874	151,566	283,123
C Garanci të vitit të trashëguara	5,845	54,745	15,158
TOTALI I SHPENZ.(A+B)	1,379,406	1,224,102	1,447,724

Burim: UPT, përpunuar Grupi i auditimit

Për vitin 2020, UPT ka përdorur një buxhet total në vlerën 1,888,282 mijë lekë, nga të cilat:

- Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta), Buxheti i brendshëm;
- (Grant mësimdhënie, Granti konkurrues, Kërkim shkencor nga buxheti) 1,235,282 mijë lekë;
- Projekte të huaja 71,806 mijë lekë;

Të ardhura të UPT (të vitit dhe të trashëguara nga një vit më parë) 220,284 mijë lekë.

Tabela 12: Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2020(mijë/lekë)

Nr	Emërtimi	Mbartur nga viti 2019	Financimi viti 2020	Buxheti viti 2020
1	Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta)	40,942	1,194,340	1,235,282
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	3,381	68,425	71,806
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuara	220,284	360,910	581,194
TOTALI		264,607	1,623,675	1,888,282

Burimi:UP Tiranë dhe grupi i auditimit të KLSH

Për vitin 2021 financimet paraqiten:

- Universiteti Politeknik i Tiranës ka përdorur për vitin 2021 një buxhet total në vlerën 2,219,833 mijë lekë, nga të cilat:

- Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie, Granti konkurrues, kërkimi shkencor nga buxheti) 1,337,213 mijë lekë;
- Projekte të huaja 95,842 mijë lekë;

Të ardhura të UPT (të vitit dhe të trashëguara nga një vit më parë) 786,778 mijë lekë.

Tabela 12.1: Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2021(mijë/lekë)

Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2020	Financimi viti 2021	Buxheti viti 2021
----	----------------------	-----------------------	---------------------	-------------------

1	Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferata)	134,164	1,203,048	1,337,213
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	28,009	67,833	95,842
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	429,629	357,149	786,778
TOTALI		591,802	1,628,030	2,219,833

Burimi: UPT dhe grupi i auditimit të KLSH

Shpenzimet dhe të ardhurat e vitit 2020 sipas realizimeve përkatëse treguesit e këtij buxheti janë më poshtë:

Tabela 12.2 Plan- Realizim i përdorimit të fondeve për vitin 2020 (mijë/lekë)

Nr	Emërtimi	Fonde nga granti (MASR, AKKSHI)		Fonde nga të ardhurat		Detyrime nga vitin 2020	Totali i fondeve		Në%
		Plan	Fakt	Plan	Fakt		Plan	Fakt	
	Totali	1.235.282	1.072.536	653.000	204.645	208.503	1.888.282	1.485.684	79

Burim: UPT, përpunuar Grupi i auditimit

Të ardhurat e disponueshme janë realizuar në vlerën 360,910 mijë lekë ose 115 % të krahasuara me planin vjetor të tyre, ndërsa nga viti 2019 janë trashëguar 220.284 mijë lekë. Pjesa e përdorur ka kaluar si të ardhura të trashëguara për vitin 2021.

Për vitin 2021 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën 2,219,833 mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Ndarë në artikuj dhe sipas realizimeve përkatëse treguesit e këtij buxheti janë në pasqyrat: “Të Ardhurat për viti 2021 - fakti”, “Realizimi i Buxhetit për vitin 2021 – Fakti”, bashkëngjitur Projektraportit të auditimit.

Tabela 12.3 Plan- Realizim i fondeve për vitin 2021 (mijë/ lekë)

Nr.	EMËRTIMI	Fonde nga Granti		Fonde nga të Ardhurat Dytësore		Detyrime nga viti 2021	Totali i Fondeve		Në %
		Plan	Fakt	Plan	Fakt		Plan	Fakt	
	Totali	1,337,213	1,164,598	850,683	315,061	10,512	2,187,896	1,490,171	69

Burim: UPT, përpunuar Grupi i auditimit

Të ardhurat e disponueshme për vitin 2021 janë realizuar në vlerën 357,154 mijë lekë ose 108 % të krahasuara me planin vjetor të tyre, ndërsa nga viti 2020 janë trashëguar 220.284 mijë lekë.

Universiteti Politeknik i Tiranës gjatë periudhës së pandemisë, si për mbrojtjen higjeno-sanitare dhe për ndryshimin e sistemit të mësimdhënies nga auditori në online për periudhën e pandemisë Mars 2020-Dhjetor 2021 ka kryer shpenzime sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 12.4 Shpenzime për materiale e shërbime Covid19 Mars 2020 - Dhjetor 2021

Nr	Objekti i Prokurimit	Lloji i procedurës së prokurimit /Minikontratë në kuadër të marrëveshjes kuadër/Amendament kontrate për nevojat e fillim viti	Vlera e kontratës së nënshkruar (lekë)
1	Blerje materiale dhe shërbim dezinfektimi për mbrojtje nga COVID - 19	Negocim pa shpallje Akti normativ nr.14, date 11.04.2020	4,939,920
2	F.V. Paisje Kompiuterike për nevoja të njesive UPT (Tabela, laptopë dhe Touch Pad)për pedagogët dhe studentët në auditor	Tender i Hapur	16,392,000
3	Printim materiale informuese për COVID - 19	Prokurim me vlerë të vogël	40,800
4	Platforme për mësimin online për konferencën në FIN	Prokurim me vlerë të vogël	240,000
5	F.V. e xhamave/ pexiglas për sekretarite në Godinat e UPT	Prokurim me vlerë të vogël	197,280
6	Blerje kamera e të tjera materiale për procesin e mësimin në distancë në UPT	Prokurim me vlerë të vogël	224,400
7	Shërbim dezinfektimi covid – 19	Pverbal emergjence (formulari standartart nr.4)	360,000
8	Blerje termometër infrared	Blerje nën vlerën 100 000 lekë	100,000
SHUMA 2020			22,494,400
1	Shërbim dezinfektimi për mbrojtje nga covid – 19, për njesitë e UPT	Kërkesë për propozim	2,028,600
2	Blerje materiale për pastrim, dezinfikim, njësive të UPT	Prokurim me vlerë të vogël	599,951
3	Blerje materiale për pastrim, dezinfikim, për njesitë e UPT	Prokurim me vlerë të vogël	353,400
SHUMA 2021			2,981,951

Burimi: UPT dhe grupi i auditimit KLSH

❖ *Trajtimi i çështjeve të rezultuara nga përgjigjet e pyetësorit datë 29.03.2022 dhe takimit Fokus grup me Dekanët e fakulteteve në UPT, ku u evidentuan këto problematika për fushën financiare në situatën e pandemisë Covid 19 në periudhën 2020-2021.*

- Universiteti Politeknik i Tiranës, si një universitet i profileve inxhinierike, siguron të ardhura nëpërmjet shërbimeve ndaj të tretëve, të tillë si: shërbimin e konsulencave, ekspertizave dhe studimeve, mbikqyrje dhe kolaudim në fushat e veprimit të tij, kryerjet e analizave laboratorike, vërtetimet sizmike, oponencat teknike, kurset pasuniversitare, etj.

E drejta për ofrimin e të tilla shërbimeve, procedurat për marrjen e lejlimeve, autorizimeve të nevojshme, akreditimet për lëshimin e certifikatave janë të rregulluara nga legjislacioni në fuqi.

UPT, për të gjitha financimet nga të ardhurat dytësore për shpërndarjen dhe përdorimin është bazuar në vendimarrjet e Bordit të Administrimit.

Lidhur me realizimin e të ardhurave gjatë pandemisë, në analizë në formë krahasimore midis IAL-ve, evidentohet fakti se vetëm UPT rezulton të jetë i vetmi IAL që gjatë periudhës së pandemisë ka realizuar të ardhura nga shërbimet, duke kompesuar të ardhurat e munguara nga vonesat e pagesave të tarifave, si dhe duke tejkaluar të ardhurat e planifikuara. Nga IAL-et e tjera objekt auditimi, nuk kanë krijuar të ardhura gjatë pandemisë dhe efektet kanë qenë direkte në vonesat e shërbimeve apo plotësimit të nevojave për mirëfunksionimin e procesit mësimor në distancë(online) dhe në auditor, kur evidentohet dhe fakti se për shkak të kufizimeve të pandemisë në realizimin e të ardhurave ka patur efekt negativ mbledhja me vonesë e tarifave të studentëve dhe jo në nivelet e planifikimeve buxhetore të IAL-ve.

Gjatë pandemisë në vitin 2020, nga IAL-et, nisur nga nevoja e kryerjes së shërbimeve ndaj studentëve në kohë dhe jashtë kohës normale të punës(kjo për shkak të kufizimeve të orarit lëvizjes dhe transportit nga rrethet)kanë angazhuar punonjësit e administratës në Fakultete që të punojnë mbi kohën normale, por kryerja e pagesave për këto punonjës(veçanërisht në UPT, pasi IAL-et e tjera nuk kanë patur këtë intensitet pune, kanë hasur vështirësi e pengesa në funksionimin me instiucionet qendrore si Ministria e Financave dhe dega e thesarit, në mos ekzekutimin e vendimarrjeve të Bordit të Administrimit.

Gjetja nga auditimi:

16. Universiteti Politeknik i Tiranës për periudhën e vitit të pandemisë 2020 në përmbushje të detyrimit për kryerjen e shërbimeve ndaj studentëve, ka evidentuar kohë pune jashtë kohës normale të punës për punonjësit e sekretarive arsimore, të cilët në kushte pandemie janë urdhëruar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve që të punojnë jashtë orarit për shkak të regjistrimeve të studentëve, ndërkohë që kjo pagesë është bllokuar nga Dega e Thesarit Tiranë me pretendimin se pagesa e orëve jashtë orarit të kryera nga punonjësit e Universitetit Politeknik të Tiranës apo institucioneve të pavarura, duhet të bëhet pas miratimit nga ministria përgjegjëse për financat. Bazuar në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe autonominë financiare e organizative, nuk duhet të pengohen për veprime financiare me të ardhurat konform procedurave ligjore.

Konkluzioni:

14. Gjatë periudhës së pandemisë stafi i Universiteti Politeknik i Tiranës ka realizuar orë pune jashtë orarit si nevojë e realizimit të regjistrimit të studentëve, me orare të zgjatura dhe në ditët e pushimit, ardhur si pasojë e situatës pandemike dhe mungesës së lëvizjes së studentëve nga rrethet dhe nuk janë paguar, pengesa këto që sjellur impakte sociale negative, veçanërisht në situata pandemie.

Rekomandimi:

15. Universiteti Politeknik i Tiranës, të marrë masa dhe nëpërmjet vendimarrjeve të strukturave drejtuese akademike dhe administrative, duke të bashkëpunojë me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve dhe Ministrinë e Financave, për të gjetur zgjidhjen e problemit dhe kryerjen e pagesave të papaguara, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Menjëherë

- Në fushën e administrimit të pasurisë luajtshme dhe të paluajtshme, ka cënim të autonomisë “pjesërisht”, pasi mbështetur në legjislacionin në fuqi UPT, ka të drejtën që të administrojë lirisht aktivet që zotëron, por kjo e drejtë nuk mundet të ushtrohet lirisht nga UPT, pasi mungon VKM për miratimin e listës së inventarit të pronave të këtij institucioni.

UPT ka në përgjegjësi administrimi me VKM të posaçme 2 (dy) prona, ndërsa 27 (njëzetë e shtatë) pronat e tjera i ka në përdorim bazuar në VKM Nr.215, datë 15.07.1991, “Për Riorganizimin e Universitetit të Tiranës”¹¹², kjo sipas akteve nënligjore të bashkimit të instituteve kërkimore që janë bërë pjesë e UPT-së dhe akteve shkresore të MASR(aktualisht MAS) që evidentojnë listën e inventarit fizik të objekteve të arsimit të lartë.

Që nga viti 2014 dhe në vijim UPT, ka përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për kalimin në përgjegjësi administrimi të të gjitha pronave, në të cilat ushtrohet aktiviteti institucional, në përputhje me specifikat e procesit akademik, kërkimor shkencor dhe administrativ dhe për zgjidhjen e kësaj problematike nuk ka patur vendimmarrje nga institucionet kompetente, ndërsa UPT ka detyrimin të ruajë dhe të mirëmbajë pronat në administrim.

Problematika e kapaciteteve infrastrukturore është përkeqësuar në kushtet e pandemisë së Covid – 19, duke marrë në konsideratë se për zhvillimin e lirshëm të aktivitetit institucional, ka lindur nevoja për dyfishin e kapaciteteve, nisur nga rregullat për distancimin social dhe shfrytëzimin e një pjese të ambienteve si qendra vaksinimi, por UPT nuk mund të kryejë ndëhyrje, pasi duhet marrë leje në institucionet përkatëse, ku kërkesa e parë është pronësia mbi objektin, të cilën UPT nuk e ka¹¹³.

UPT ka në inventar 27 pasuri të paluatshme të cilat **nuk i ka në pronësi** dhe ky fakt ka sjell pasiguri juridike në kryerjen e investimeve, përfshi faktin se dy prej pasurive të paluatshme kanë statusin monumente të kulturës të kategorisë së dytë, fakt i cili e detyron të përshtatet me kërkesa specifike dhe të sigurojë miratimin dhe lejet nga Drejtoria e Monumenteve dhe Ministria e Kulturës etj. Mungesa e VKM për të miratimin e listës së inventarit në pronësi ose përgjegjësi administrimi të objekteve aktualisht në përdorim është një nga faktorët ligjor që ka kufizuar zhvillimin e investimeve në këtë IAL.

Gjetja nga auditimi:

17. Nga auditimi është konstatuar se problematika e kapaciteteve infrastrukturore është përkeqësuar në kushtet e pandemisë së Covid–19, duke marrë në konsideratë se për zhvillimin e lirshëm të aktivitetit institucional, ka lindur nevoja për dyfishin e kapaciteteve, nisur nga rregullat për distancimin social dhe shfrytëzimin e një pjese të ambienteve si qendra vaksinimi etj., fakt i cili rezulton se e ka vënë në vështirësi UPT-në, i cili për shkak të problematikave të pronësisë dhe rrjedhimisht pasigurisë juridike të krijuar, ka hasur pengesa në marrjen e lejeve të nevojshme për kryerjen e investimeve në infrastrukturën ndërtimore. UPT gjatë periudhës së pandemisë ka patur probleme me kufizimin e sipërfaqes për auditorë, pra në disa fakultete si Arkitektura, Urbanistika, FTIE etj., nuk është respektuar distanca dhe masat e tjera të caktuara nga Komiteti i Ekspertëve, situatë kjo e shkaktuar nga dëmtimet e pësura në dy godina kryesore nga lëkundjet sizmike të vitit 2019, prej faktit se ky IAL ka qënë i kufizuar në kryerjen e investimeve. UPT **nuk i ka në pronësi 27 prona** dhe institucionet nuk lejojnë që të parashikojë apo ndërhyjë me investime apo përshtatje sipas kërkesave. Mungesa e VKM për të miratuar listën e inventarit dhe kalimin në pronësi të këtyre pronave pengon zhvillimin e aktivitetit të UPT-së. Kjo, bazuar në Ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar dhe sipas nenit 15 pika 1/3 e VKM-së nr. 408 dt. 13.05.2015 "Rregullorja e zhvillimit të territorit" në dokumente pika 2 kërkohej: “ *...Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet midis pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta...* ” nuk e lejon të kryhet investim nëse objektet nuk janë në pronësi.

Faktor tjetër ka qënë dhe mungesa e financimit nga buxheti i shtetit për objektet e dëmtuara nga tërmeti, në veçanti Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, ka sjellë vështirësi në plotësimin e hapësirave të nevojshme për studentët gjatë pandemisë dhe në vijim.

Konkluzioni:

15. Mungesa e VKM për të miratimin e listës së inventarit në pronësi ose përgjegjësi administrimi të objekteve aktualisht në përdorim, është një nga faktorët ligjor që ka kufizuar zhvillimin e investimeve në Universitetin Politeknik i Tiranës.

Rekomandimi:

16. Autoritetet dhe organet drejtuese të Universitetit Politeknik të Tiranës të marrin masa në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe institucione

¹¹² Pyetja 45, Shtojca 1.11 -VKM Nr. 215, datë 15.07.1991, “Për Riorganizimin e Universitetit të Tiranës”

¹¹³ Ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar dhe sipas nenit 15 pika 1/3 e VKM-së nr. 408 dt. 13.05.2015 "Rregullorja e zhvillimit të territorit" në dokumente pika 2

të tjera përgjegjëse, për përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm dhe propozimin për vendimmarrje në Këshillin e Ministrave dhe miratimin e “Listës së pronave ose përgjegjësi administrimi të Universitetit Politeknik të Tiranës”. Kjo situatë të adresohet në nivelet më të larta vendimmarrëse të qeverisë, e cila ka detyrimin ligjor të sigurojë fondet e nevojshme nga buxheti i shtetit për përmirësimin infrastrukturor dhe zhvillimin e pronave, të domosdoshme për zgjerimin dhe plotësimin e kapaciteteve infrastrukturore, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë për Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë

Universiteti Politeknik i Tiranës, si Institucion i Arsimit të Lartë, në përputhje me përcaktimet e Ligjit 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, gëzon autonomi të plotë në miratimin e numrit të personelit, në përcaktimin e kritereve si dhe procedurave për përzgjedhjen e personelit, ndërsa përcaktimi i pagave kushtëzohet nga aktet nënligjore në fuqi.

Për personelin akademik kushtëzohet nga VKM nr.329 datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik¹¹⁴, neni 17, citojmë: *“Pagat e personelit akademik të të gjitha kategorive përcaktohen nga Bordi i Administrimit, pasi ka marrë mendimin e Senatit Akademik por jo më shumë se kufijtë maksimale të pagës për funksion / titull, të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”.*

Për personelin administrativ në Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 67, përcaktohet, që pagat e personelit administrativ miratohen nga Bordi i Administrimit të institucionit të arsimit të lartë, sipas legjislacionit në fuqi.

Duke marrë si pikë referimi vitin 2015, si vit i hyrjes në fuqi të Ligjit të Arsimit të Lartë, është konstatuar se rritja e pagave është në nivele të ulëta për kategorinë e punonjësve akademik dhe administrative, ndërkohë që ka patur rritje për të gjithë punonjësit e administratës publike me VKM nr.268 datë 29.03.2017¹¹⁵, nr.187 datë 8.03.2017¹¹⁶ dhe nr.202 datë 15.03.2017¹¹⁷.

Për shkak të kufizimit që përcaktojnë aktet nënligjore me sipër përmenduar, për kufijtë maksimale të pagës, edhe pse parashikohet si risi në ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, **është e pamundur të ketë iniciativa për ndryshime të nivelit të pagave (me efekt rritës).**

❖ Mbi auditimin e brendshëm në UPT.

Për periudhën e auditimit 2020-2021 është konstatuar se sektori i Auditimit të Brendshëm në UPT, nuk ka patur një efikasitet të plotë të përdorimit të burimeve njerëzore në këtë sektor, ky sektor i rëndësishëm në strukturën menaxhuese administrativo-financiare, ku përveç situatës së pandemisë, nuk ka përmbushur programin e punës për auditime në vitin 2020-2021. Arsyea e mos vënies në efikasitet të plotë e veçanërisht në situatën e vështirë të pandemisë Covid 19, ku duhet të ishte në krah të titullarëve për auditimin e përdorimit të parasë publike dhe informimin e titullarëve mbi çfarë nuk shkon mirë në fondet e përdorura në këtë periudhë, por ka mbetur i pezulluar si aktivitet auditues? Konkretisht sipas dokumentacionit të administruar dhe audituar nga grupi i auditimit, është konstatuar se ky sektor nuk është në funksion të plotë sipas kërkesave të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Mbështetur në aktet nënligjore dhe statutit të UPT-së, sektori i auditit është në varësi të Bordit të Administrimit dhe programi miratohet prej tij. Procesi ka ngecur për shkak të mosvënies në dispozicion të dokumentacionit për praktikën e rekrutimit të personelit akademik dhe evidenca të orëve në këndveshtrimin e efekteve financiare, pasi autoritetet akademike medojnë se këto nuk duhet të auditohen nga audit i brendshëm, por nga sektori i brendshëm i cilësisë në IAL dhe KLSH. Kjo çështje nga SAB është adresuar në Bordin e administrimit i cili ka detyrimin të vendosë dhe ve në dijeni MAS për këtë ngërç, por aktualisht nuk është zgjidhur. Mos dakordësia ka ardhur nga kërkesa për auditim e plotësim me dokumente shtesë në auditimin e dokumentimit të zhvillimit të procesit mësimor mbi të

¹¹⁴ Pyetja 48, Shtojca 1.1 Vendimi nr. 329 datë 12.04.2017 të Këshillit të Ministrave “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik neni 17,

¹¹⁵ Pyetja 48, Shtojca 1.2 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.268 datë 29.03.2017

¹¹⁶ Pyetja 48, Shtojca 1.3 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.187 datë 08.03.2017

¹¹⁷ Pyetja 48, Shtojca 1.4 Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.202 datë 15.03.2017

cilat janë kryer pagesa financiare për personelin akademik dhe ligjshmërinë e rekrutimit të tyre. Gjatë auditimit në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Fizike, për shkak të mungesës së stafit të subjektit për arsye shëndetësore shkaktuar nga situata pandemike, me miratim të Bordit të Administrimit, sipas shkresës Nr. 597/1 Prot., datë 14.04.2021 dhe shkresës Nr. 390/5 prot., datë 11.05.2021, afati i auditimit në FIMIF u shty deri në datën 21.05.2021. Gjetjet dhe rekomandimet e auditimit në FIMIF nuk janë shqyrtuar akoma nga Bordi i Administrimit, pasi ky organ kolegjal në UPT, për shkak të riorganizimit nuk ka funksionuar nga muaj Gusht deri në muajin Nëntor 2021, referuar Urdhërit të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë me Nr. 298, datë 24.08.2021 “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”¹¹⁸ dhe Urdhërit të MAS Nr. 412 datë 22.10.2021 “Për emërimin në detyrë të anëtarëve të Bordit të Administrimit të UPT-së përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin”¹¹⁹, duke tejkaluar afatet e evadimit të materialeve të auditimit dhe humbjen e fushës së veprimit në kohë të rekomandimeve të përgatitura nga SAB në UPT.

Pas konstituimit të Bordit të Administrimit në UPT, Sektori i Auditimit të Brendshëm i është drejtuar Bordit me shkresën Nr.1312/1 prot., datë 21.12.2021 për angazhimin e auditimit të realizuar në FIMIF, por deri në kohën që po kryejmë auditimin (Maj 2022) nuk është bërë asnjë veprim apo zgjidhje e situatës. Dhe akoma nuk ka asnjë zgjidhje. Po kështu, megjithëse nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë MFE, është rekomanduar zgjidhja me shkresë nr.684/4 prot., datë 31.03.2021, me të cilën kanë dërguar Raportin përfundimtar dhe rekomandimet përkatëse, por deri më tani Maj 2022 nuk është zgjidhur asgjë.

Gjetja nga auditimi:

18. Konstatuam se sektori i Auditit të Brendshëm në Universitetin Politeknik Tiranë, nuk ka funksionuar sipas kërkesave ligjore dhe për qëllimin e krijuar, pasi: (i) ka munguar vendimmarrja dhe angazhimi i Bordit të Administrimit në monitorimin dhe në mbështetjen e veprimtarisë së këtij sektori; si dhe nuk janë zbatuar planet e auditimit të miratuara në fillim vitit 2020-2021 dhe nuk janë evaduar materialet sipas kërkesave të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Në UPT, nuk është bërë vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas nenit 20, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe nuk është krijuar mjedisi i duhur i kontrollit të brendshëm për vlerësim nga struktura e Auditit të Brendshëm në Universitetin Politeknik Tiranë.

Konkluzioni:

16. Për shkak të mungesës së vendimmarrjes dhe unifikimit të koepetencave struktura e Auditimit të brendshëm nuk ka funksionuar dhe moskryerja e evadimit të materialeve me rekomandimet përkatëse, ka çenuar menaxhimin e institucionit dhe ka patur paqartësi në zbatimin e kuadrit të brendshëm rregullator në veprimtarinë administrative të këtij institucioni.

Rekomandimi:

17. Bordi i Administrimit dhe autoritetet drejtuese Rektor/Administrator në Universitetin Politeknik të Tiranës, të marrin masa, të rrisin bashkëpunimin për të marrë vendimet e nevojshme sipas fushës së përgjegjësisë, për të kthyer në funksionimin normal të Sektorit të Auditimit të Brendshëm. Të miratojnë menjëherë planet vjetore dhe afatmesme të auditimit, si dhe të përcaktojnë mënyrën e raportimit dhe modalitetet administrative të koordinimit dhe informimit të dy autoriteteve drejtuese të IAL-së (Rektor/Administrator).

Menjëherë e në vijimësi

Në periudhën 2020-2021 shpenzimet e kryera për blerjen e bazës materiale (pajisje kompjuterike) janë në shumën **37,197 mijë lekë**, ku përfshihen pajisjet si: laptop, touch Pad dhe tabela interaktive për zhvillimin e mësimin online, sipas kërkesave të njësive të Universitetit Politeknik të Tiranës. Ky shpenzim është miratuar me Vendimin e Bordit të Administrimit Nr. 14, datë 24 Prill 2020¹²⁰ në shumën 38,188 mijë lekë dhe nuk ka qenë i nevojshëm alokimi me vendim të posaçëm i fondeve për realizimin e tij.

Gjendja në fakt e pajisjeve kompjuterike, audio vizuale në muajin Mars 2020 në Fakultetet e Universitetit Politeknik, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

¹¹⁸ Pyetja 50, Shtojca 1.4 Urdhërit të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë me Nr. 298, datë 24.08.2021

¹¹⁹ Pyetja 50, Shtojca 1.5 Urdhërit të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë me Nr. 412, datë 22.10.2021

¹²⁰ Pyetja 51, Shtojca 1 Vendimi i Bordit të Administrimit nr 14 date 26.04.2020

Nr.	Pershkrimi	Sasia ne copë	Vlera në 000/ lekë
1	Kompjuter, laptop	1,426	166,836
2	Videoprojektore	604	24,597
3	Tabela interaktive	15	1,015
4	Salla dixhitale	20	13,835

Burimi: UPT

Këto pajisje janë pjesë përbërëse e regjistrave të aktiveve, kartelave të inventareve të punonjësve në secilin fakultet si dhe gjejnë pasqyrim si vlera kontabile në pasqyrat financiare të vitit 2020.¹²¹

- Në periudhën 2020-2021 e në vazhdim Universiteti Politeknik i Tiranës **nuk ka administruar asnjë korespondence zyrtare me AKFAL**, për më tepër nuk ka përfituar fonde publike në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe menaxhimit akademik dhe administrativ nga kjo strukturë.

Të gjitha financimet publike janë kryer vetëm nga strukturat e MAS (ose MASR para muajit Shtator 2021) dhe nuk është konstatuar asnjë problematikë domethënëse si në vendimarrje ashtu edhe në aspektin procedural.

Edhe në fushën e kërkimit shkencor, financimi është kryer për projektet e shpalluar fituese nga AKKSHI dhe janë çelur nëpërmjet MAS sipas procedurave financiare në sistemin e thesarit.

Në këto kushte nuk mund të paraqesim mendim dhe nuk kemi siguri, pasi nuk ka informacion për këtë strukturë, por në çdo rast vlerësohet se ngritja e këtyre strukturave, duhet të marrë në konsideratë parimet e efikasitetit financiar, organizativ, transparencës, reduktimit të burokracisë administrative dhe mbi të gjitha të mos çenojë fondet e dedikuara për arsimin e lartë publik.

Në vitin 2020 dhe 2021, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi Universitetit Politeknik të Tiranës i janë akorduar fonde për dhënie burse studentëve të gjitha kategorive, vetëm nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Nga AKFAL nuk janë financuar me fonde për studentët e shkëlqyer apo studentë në nevojë.

Më poshtë tabela me të dhëna të detajuara:

Nr.	Viti akademik	Grant i alokuar nga MAS (në 000/ lekë)	Numri i studentëve bursiste	Vlera e shpenzuar (në 000/ lekë)
1	2019-2020	128,323	1,210	77,006
2	2020-2021	159,131	1,396	110,452

Numri i projekteve me financim të huaj të përfituara dhe vlera për periudhën 2020-2021 është:

Nr.	Emërtimi	Numri i Projekteve	Shuma e përfituar 000/leke
1	Viti 2020	13	71,806
2	Viti 2021	16	104,205

Numri i projekteve me financim të brendshëm të përfituar dhe vlera për periudhën 2020-2021:

Nr	Emërtimi	Numri i Projekteve	Shuma e përfituar (000/ leke)
1	Viti 2020	3	7,949
2	Viti 2021	11	43,839

Burim: UPT, përpunuar Grupi i auditimit

Për periudhën 2020-2021 në zërin 602 janë planifikuar rreth 2.000 mijë lekë (deri në 2% të buxhetit vjetor të shpenzimeve operative) të ndarë zipas zërave dhe natyrës si shpenzime për aktivitete shkencore, sportive dhe sociale, pjesëmarrje në konferenca e të tjera aktivitete, që mund të organizohen nga grupimet studentore. Për shkak të situatës së krijuar prej Covid-19 dhe akteve ligjore në fuqi për ndalimin e aktiviteteve sportive, sociale, grumbullimeve të personave, lëvizjes së kufizuar dhe zhvillimit të mësimin online, realizimi prej 5% në këtë zë përfshin botimin e guidave studentore në shumën 107.5 mijë lekë për vitin 2020 dhe në shumën 108 mijë për vitin 2021.

- Janë kryer pagesa për orët jashtë orarit në periudhën Mars-Korrik 2020, të cilat janë orët mësimore mbingarkesë të punonjësve efektive për vitin akademik 2019-2020

- Universiteti Politeknik i Tiranës ka përfituar të ardhura nga financimet e projekteve të huaja kerkimore shkencore si me poshtë vijon:

Tabela 14 Të dhëna për projektet e huaja kerkimore shkencore në vitin 2020

Nr.	Emertimi i Projektit	Total te ardhura	Total shpenzime	Gjendja ne fund te
-----	----------------------	------------------	-----------------	--------------------

¹²¹ Pyetja 52, Shtojca 1 Tabela e inventareve për kompjutera laptop, salla dixhitale sipas njesive perberese

				periudhes raportuse ne BND 31.12.2020
1	Integrated sea Storm Management Strategies-I-STORM	1,376,453	1,325,222	51,231
2	Projekt - UPT 192 Ëelcome	485,120	2,450	482,670
3	IT-GOVERNANCE FOR ALBANIAN ITG4AU	2,381,054	2,524	2,378,530
4	Reforming Doctoral Studies in Montenegro and Albania-Good Practice Pardigm	55,073	2,450	52,623
5	Projekt-H2020-Vissem	1,674	0	1,674
6	BESTSDI_ERASMUS+	215,513	214,789	724
7	GRADUA-ERASMUS+	808,527	325,870	482,657
8	Projekt-UPT 3D-IMP-ACT	927,539	344,299	583,240
9	Projekti ERASMUS+GEOBIZ	3,735,219	956,157	2,779,062
10	HERMES-UPT	7,228,527	1,505,216	5,723,311
11	BKSTONE	52,970,267	47,119,413	5,850,854
12	DRIVE	953,523	952,868	655
13	Euroëeb	378,935	40,988	337,947
Totali		71,806,903	53,081,726	18,725,177

Burim: UPT, përpunuar Grupi i auditimit

Tabela 14/1 Të dhëna për projektet e huaja kërkimore shkencore në vitin 2021

Nr.	Emertimi i Projektit	Total te ardhura	Total shpenzime	Gjendja ne fund te periudhes raportuse ne BND 31.12.2021
1	EM2-STEM,Elisa,EuroËEB+	321,486	7,180	314,306
2	Integrated sea Storm Management Strategies-I-STORM	5,137,646	3,000	5,134,646
3	Projekt - UPT 192 Ëelcome	5,023,628	3,000	5,020,628
4	IT-GOVERNANCE FOR ALBANIAN ITG4AU	2,542,728	2,538,264	4,464
5	Reforming Doctoral Studies in Montenegro and Albania-Good Practice Pardigm	2,767,452	96,598	2,670,854
6	BESTSDI_ERASMUS+	2,315,067	725	2,314,342
7	GRADUA-ERASMUS+	482,658	439,935	42,723
8	Projekt-UPT 3D-IMP-ACT	5,440,240	2,351,810	3,088,430
9	Projekti ERASMUS+GEOBIZ	3,387,512	3,384,538	2,974
10	HERMES-UPT	5,723,311	5,571,008	152,303
11	BKSTONE	5,850,854	4,616,280	1,234,574
12	DRIVE	8,132,195	7,396,904	735,291
13	REACH	2,943,578	2,033,104	910,474
14	CRISIS	4,821,369	1,862,031	2,959,338
15	ENGINE	45,291,649	38,936,446	6,355,202
16	KALCEA	4,024,216	682,772	3,341,444
Totali		104,205,592	69,923,495	34,281,997

Burim: UPT, përpunuar Grupi i auditimit

Punonjësit (personeli akademik/ndihmës akademik/administrativ), që janë angazhuar në grupet e punës për zbatimin e objektivave të projekteve kërkimore shkencore, kanë përfutur të ardhura sipas kushteve të përcaktuara në aktmarrëveshjet përkatëse (Grant Agreement, Partnership Agreement etj.)

- Universiteti Politeknik i Tiranës, për shkak të natyrës së tij teknike, në kuadër të paktit për universitetin dhe bazuar në aktet nënligjore të miratuara për këtë qëllim, ofron shërbime ndaj të tretëve, si studime, ekspertiza, konsulenca, oponenca teknike, projekte analiza laboratorike, etj, nga të cilat janë siguruar të ardhura në vlera të konsiderueshme, ku për vitin 2020, edhe pse të kufizuar nga pandemia, UPT ka kryer shërbime ndaj të tretëve, duke arkëtuar të ardhura në vlerën **42,037,928 lekë** nga kryerja e 108 oponencave teknike dhe 23,218,780 leke nga aktekspertiza e 20 projekteve të veprave inxhinierike (hapësirat që krijoj procesi i rindërtimit nga tërmeti Nëntor 2019). Në vitin 2021 janë arkëtuar të ardhura në vlerën **94,172,077 lekë** nga kryerja e 219 oponencave teknike dhe 27,151,763 lekë nga aktekspertiza e 17 projekteve të veprave inxhinierike.

- Buxheti i përdorur gjatë periudhës së pandemisë 2020-2021 për mbrojtjen e shëndetit të studentëve dhe stafit akademik e administrativ në UPT është 2% e totalit të buxhetit për shpenzime operative për vitin 2020 dhe 1% e totalit të buxhetit për shpenzime operative për vitin 2021.

Në UP Tiranë 98% e fakulteteve përdorin platformën e sponsorizuar Teams (Microsoft Teams dhe Google Drive), për të cilën kanë marrëveshje sponsorizimi.

- Gjatë periudhës së pandemisë Mars-Korrik 2020 janë prokuruar dhe lidhur kontratat e shërbimeve dhe blerjeve në funksion të situatës së krijuar nga epidemia Covid-19, për:

- Shërbim dezinfektimi për mbrojtje nga covid – 19 në shumën – 360 mijë lekë.

- Blerje materiale dhe shërbim dezinfektimi për mbrojtje nga COVID – 19 në shumën – 4,940 mijë lekë.

- Printim materiale informuese për COVID - 19 në shumën – 41 mijë lekë.

Shërbimi i dezinfektimit dhe blerja e materialeve të nevojshme për mbrojtje nga Covid – 19, është kryer sipas parashikimeve të Aktit Normativ nr.14, datë 11.04.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ nr.3 datë 15.03.2020 të KM, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID 19” i ndryshuar;¹²² Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 294 prot, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e listës së mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID -19”¹²³, Vendim nr.63 datë 13.05.2020 të Rektoratit të UPT “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë akademike dhe administrative në Universitetin Politeknik të Tiranës”,¹²⁴ si dhe planit të masave të paraqitura nga njësitë e UPT.

Kontratat sipërcituar, janë parashikuar në planin e detajuar të buxhetit të miratuar me vendim të Bordit të Administrimit Nr. 14, datë 24/04/2020¹²⁵ dhe nuk qenë e nevojshme rishikim i kontratave ekzistuese. Lidhur me domosdoshmërinë e kryerjes së këtyre shpenzimeve, realizimi i procedurave të mësipërme, ka patur rëndësi të vecantë për informimin dhe zbatimin e masave të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit të studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ, me qëllim shmangien e infektimit dhe përhapjes së epidemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19.

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2020, është kryer në kushtet e gjendjes së krijuar nga pandemia COVID-19, si dhe diktuar nga udhëzimet dhe aktet ligjore të nxjerra në kuadër të gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Gjatë periudhës Mars 2020 - Qershor 2020, kryerja e shpenzimeve ka qenë e kufizuar sipas parashikimeve dhe prioriteteve të përcaktuara në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.14 datë 24.03.2020 “Për procedurat e menaxhimit dhe monitorimit të zbatimit të buxhetit në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”.

2. Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (UEL) për ushtrimin e aktivitetit për periudhën 2020-2021 ky institucion i Arsimit të Lartë, ka përdorur fondet publike me burim financimi:

Tabela 15 Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2020 mijë/lekë

EM ËRTIMI	Vlera në vitin 2019	Vlera në vitin 2020	Vlera në vitin 2021
A Shpenzime nga Buxheti	620,687	669,018	703,606
SHUMA	620,687	669,018	703,606
B Shpenzime nga të ardhurat	226,487	82,859	73,969
SHUMA B	226,487	226,487	73,969
C Garanci të vitit të trashëguara	-	1,643	397
TOTALI SHPENZ.(A+B)	847,174	751,877	777,575

Burim: UEL, përpunuar Grupi i auditimit

Sipas burimit të financimit paraqitet si më poshtë:

Tabela 15.1 Pasqyra e burimit financimit

Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2019	Financimi viti 2020	Buxheti viti 2020
1	Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferata)	43,307	836,752	880,060
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	7,558	15,432	22,990
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	217,969	153,476	371,444
TOTALI		268,834	1,005,660	1,274,494

Burim: UEL, përpunuar Grupi i auditimit

¹²² Pyetja 65, Shtojca 1 Akti Normativ nr.14, datë 11.04.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ nr. 3 date 15.03.2020 të KM, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID 19”

¹²³ Pyetja 64, Shtojca 1.1 Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 294 prot, datë 06.05.2020 “Për përcaktimin e listës së mallrave dhe shërbimeve për përballimin e situatës së krijuar nga epidemia COVID -19

¹²⁴ Pyetja 64, Shtojca 1.2 Vendim nr.63 datë 13.05.2020 të Rektoratit të UPT “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë akademike dhe administrative në Universitetin Politeknik të Tiranës

¹²⁵ Pyetja 64, Shtojca 1.3 Vendim të Bordit të Administrimit Nr. 14, datë 24/04/2020 “Për miratimin e raportit për realizimin e buxhetit të vitit 2021 dhe detajimin e vitit 2022”

Për vitin 2020, UEL ka përdorur një buxhet total në vlerën 1,274,494 mijë lekë.

Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga një vit më parë) 371,444 mijë lekë, nga të cilat 3,999,743 lekë janë disbursim projekt i huaj nga Komisioni Evropian.

Për vitin 2021 financimet paraqiten:

Tabela 16 Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2021-Fakti (mijë/lekë)

Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2020	Financimi viti 2021	Buxheti viti 2021
1	Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferata)	168,500	914,814	1,083,314
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	11,359	6,256	17,615
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuara	288,585	147,091	435,675
TOTALI		468,444	1,068,161	1,536,605

Burimi: UELbasan dhe grupi i auditimit të KLSH

Efektet nga shpenzimet e kryera për periudhën e pandemisë Covid19 dhe pezullimi i aktivitetit në mjediset e dhëna me qira, si rezultat i mbylljes së procesit akademik në auditor, janë 10,597,350 lekë nga e cila:

-Shpenzimet e kontraktuara për shërbim dezinfektimi dhe blerje materiale për mbrojtjen personale në vlerën 9,604,794 lekë, nga të cilat janë likujduar furnizimet e kryera dhe shërbimet në vlerën 8,000,385 lekë, mbeten për tu realizuar shërbime e materiale në vlerën 1,604,410 lekë.

-Të ardhura të paarkëtuara nga pezullimi i aktivitetit të mjediseve të dhëna me qira në vlerën 807,679 lekë; për vitin 2020 në vlerën 454,575 lekë dhe për vitin 2021 janë në vlerën 353,104 mijë lekë.

▪ Shpenzimet e UEL:

Plan buxheti i vitit 2020 i çelur për përdorim (Plan Thesari) në vlerën 1,136,019 mijë lekë është realizuar në vlerën 806,032 mijë lekë, ose 71.0 %.

-Të ardhura dhe shpenzime viti 2021

Për vitin 2021 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën 1,536,605 mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit paraqitur në pasqyrën e mësipërme. Fondet e kushtëzuara – të ardhurat e UEL - së:

Të ardhurat e disponueshme janë realizuar në vlerën 435,675 mijë lekë ose 89 % të krahasuara me planin vjetor të tyre, ndërsa të ardhurat për tu grumbulluar në vitin 2021 janë realizuar në vlerën 147,091 mijë lekë ose 73 % të krahasuara me planin vjetor të tyre.

Shpenzimet e UNIEL - së: Gjatë të vitit 2021 shpenzimet gjithsej janë realizuar 59 % e financimit vjetor. Planbuxheti i çelur për përdorim (Plan Thesari) në vlerën 1,406,692 mijë lekë është realizuar në vlerën 820,902 mijë lekë ose 58 %

Tabela 17 Shpenzime për materiale e shërbime Covid19 Mars 2020 - Dhjetor 2021

në lekë

Nr	Objekti i Prokurimit	Vlera faturave (lekë)	Shërbimi dhe dalje
1	Blerje bandera në 5 godina në adezive COVID-19	395,000	Sipas kontratës
2	Materiale për mbrojtje personale ndaj COVID-19	2,676,600	Sipas fd plan shpërndarje
3	Shërbime të dezinfektimit të mjediseve (COVID-19)	4,869,275	Sipas kontratës
4	Shpenzime për plaformën "Abonime Office 365"	59,510	Sipas kontratës
Totali		8,000,385	

Burimi: UEL dhe grupi i auditimit KLSH

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” gjatë periudhës së pandemisë, si për mbrojtjen higjieno-sanitare dhe për ndryshimin e sistemit të mësimdhënies nga auditori në online për periudhën e pandemisë Mars 2020-Dhjetor 2021, ka kryer rialokime të fondeve nga granti për shpenzime korente brenda zërave buxhetor të planifikuar në fillim të vitit 2020 dhe planifikimin e tyre për vitin 2021.

Tabela 17.1 Shpenzimet përperiudhën e pandemisë Covid 19

Nr	Emërtimi	Fondi
1	Shërbime të dezinfektimit të mjediseve Covid19	1,884,000
2	Blerje materiale të nevojshme për mbrojtjen personale	3,066,000
Totali		4,950,000

Tabela 17.2 Fondi i rialokuar për periudhën e pandemisë Mars 2020-Dhjetor 2021

Nr	Vendime Bordi	Emërtimi	Vlera lekë
1	VBA nr. 12, datë 20.05.2020	Shërbime të dezinfektimit të mjediseve, COVID-19	1,884,000

2	VBA nr. 12, datë 20.05.2020	Blerje materiale të nevojshme për mbrojtjen personale	3,066,000
3	VBA nr. 23, datë 26.09.2020	"Shërbime për aksesimin online të produktit të Covid19 të Microsoft 'Office 365 A1 for Education'"	120,000
4	VBA nr. 46, datë 24.10.2020	"Shërbime të dezinfektimit të mjediseve, COVID-19"	8,000,000
5	VBA nr. 09, datë 06.03.2021	"Materiale për mbrojtje personale ndaj COVID-19"	2,514,040
Shuma			15,584,040

Burimi: UEL dhe grupi i auditimit

- Cilat platforma janë përzgjedhur për mësimin online? Mbi ç'bazë janë përzgjedhur ato dhe si janë caktuar kriteret e përzgjedhjes dhe specifikimet në rastin e blerjes së tyre? Vini në dispozicion çdo dokumentacion që i shërben këtij qëllimi (procedure blerje, f.hyrje e dalje, etj.).

UEL ka përzgjedhur për mësimin online gjatë periudhës së pandemisë është "Office 365 A1 for Education" dhe sistemi "Microsoft Teams" bazuar në VBA nr. 4, datë 12.02.2020 'Për miratimin e regjistrimit të prokurimeve publike për vitin 2020', i ndryshuar është parshikuar objekti "Shërbime për aksesimin online të produktit të Covid19 të Microsoft 'Office 365 A1 for Education' me vlerë 120,000 lekë. Nga auditimi rezultoj se për këtë procedurë është ndjekur praktika e blerjes nën 100 mijë lekë pa TVSH, e drejtëpërdrejtë. Subjekti fitues Tiranë, i cili ka eskuzivitetin e linkut me distributorin për Europën në Bullgari ka afuar abonimin e kësaj pakete "Microsoft Office 365 A1 for Education" me vlerën 59,510 lekë, për të gjithë përdoruesit në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" dhe është likuiduar me Urdhër shpenzimi nr. 361 datë 17.11.2020 në vlerën 59,510 lekë.

UEL ka në administrim (vlerë kontabël) 12 godina dhe është kryer procedura e kalimit në pronësi të universitetit dhe regjistrimi i tyre në ASHK (ZVRPP).

Është konstatuar se në UEL nuk ka njësi Auditimi të brendshëm në strukturën organizative, e cila ka sjellur mos auditimin e aktivitetit ekonomik financiar në këtë IAL që është kryer për vitin 2020-2021, veçanërisht në periudhën e pandemisë nuk kemi auditim të aktivitetit dhe asnjë dokumentim se si ka funksionuar kontrolli i brendshëm në strukturë vertikale dhe horizontale si për anën financiare por dhe në evidentimin e procesit mësimor gjatë periudhës së pandemisë, veprim ky që bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 3, germa "a", ku aktiviteti i kryer gjatë kësaj periudhe për vetë kushtet dhe specifikat ka rrisht të lartë. Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur që jep siguri objektive dhe ofron këshillim për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes¹²⁶.

Gjetja nga auditimi:

19. Në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" Elbasan u konstatua se nuk është ngritur struktura e auditimit të brendshëm siç e kërkon zbatimi i Ligji Nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 3, germa "a" dhe ka munguar kontributi i kësaj njësie auditimi në ofrimin e sigurisë së arsyeshme mbi efektivitetin e aktivitetit të vetë universitetit gjatë pandemisë.

Konkluzioni:

17. Nuk është ngritur struktura e auditimit të brendshëm , e cila ka sjellë dhe mungesën e vlerësimit të aktivitetit të këtij institucioni nga Njësia e Auditimit të Brendshëm dhe nuk është bërë vlerësim mbi funksionimin e sistemeve të kontrolleve të brendshme në këtë IAL.

Rekomandimi:

18. Universiteti "A. Xhuvani" Elbasan në bashkëpunim me Bordin e Administrimit dhe Senatin, të marrë masa për të filluar procedurat e rekrutimit dhe ngritjes së strukturës së auditimit të brendshëm dhe vënien sa më parë në efencë, duke hartuar e miratuar rregulloren e kësaj njësie auditimi dhe mënyrën e raportimit, modalitetet administrative të kordinimit dhe informimit të dy autoriteteve drejtuese të IAL-së (Rektor/Administrator), mbi problematikat dhe veprimtarinë e auditimit.

Brenda tremujorit IV të vitit 2022

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për periudhën e pandemisë 2020–2021 nuk ka kryer rialokim fondesh për blerje bazë materiale (kompjutera) për zhvillimin e mësimin online gjatë periudhës

¹²⁶ Ligji Nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" neni 2 e 3

së pandemisë. Blerja e pajisjeve kompjuterike për nevoja të institucionit është kryer me fondet e planifikuara nga të ardhurat e veta për periudhën 2020-2021 dhe nuk është kërkuar shtesë ose alokim tjetër fondesh.

UEL në periudhën Mars 2020 ka patur gjendje inventariale 18 laborator IT, 36 Salla video dhe 41 mjedise didaktike dhe pajisje:

Nr.	Emërtimi i projektit	Mars 2020	
		Sasia	Vlera (mijë lekë)
1	Servera	10	6,634
2	Kompjuterat	897	60,577
3	Laptop	63	6,971
4	Printera	121	6,203
5	Fotokopje	71	18,173
6	Videoprojektorë	89	9,263
	Shuma		107,822

Burim: UEL, përpunuar Grupi i auditimit

UEL nuk ka patur asnjë marrëdhënie me AKFAL-in në marrëdhëniet me përfitimin e fondeve publike në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe menaxhimit akademik dhe administrativ, por ato janë kryer nga MASR, pra ky institucion është inekzistent në marrëdhëniet financiare me IAL dhe në përmbushje të qëllimit të krijimit nga qeveria.

Në UEL për vitet 2020-2021 kanë përfituar bursa financiare studentët e shkëlqyer dhe studentët nga shtresa sociale në nevojë me fonde të akorduara nga MAS në fillim të çdo viti “Granti për bursat e studentëve”;

Kriteri	2019-2020		2020-2021	
	Nr.st	Fonde lekë	Nr.st	Fonde Lekë
Me rezultate	103	8,830,968	123	11,070,000
Në nevojë	1,390	114,772,178	1,296	108,980,000
Total	1,493	123,603,146	1,419	120,050,000

Burim: UEL, përpunuar Grupi i auditimit

Në vitin 2020 është aplikuar në AKKSHI për 3 projekte dhe është financuar projekti “Krijimi i Laboratorit Digital të Anatomisë” për vlerën 10,576 mijë lekë, ndërsa vlera 4,274 mijë lekë është financuar në vitin 2021.

Në vitin 2021 është aplikuar në AKKSHI në 8 projekte dhe janë financuar 5 projekte me vlerë 30,972 mijë lekë.

Për periudhën e pandemisë Mars-Korrik 2020 Senati dhe Bordi i Administrimit për periudhën e mësipërme 2020-2021. Janë paguar me paga fikse bazuar në VKM nr. 656, datë 31.10.2018 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësisë të qeverisjes qendrore”, ku për periudhën e pandemisë Mars-Korrik 2020 Senati akademik 9 herë (një mbledhje fizike e të tjerat elektronikisht).

Në Buxhetin e UEL për kërkimin shkencor për vitin 2020 janë realizuar projekte kërkimore gjithsej në vlerën 26,041 mijë lekë nga:

- Granti konkurrues për kërkim shkencor nga Buxheti i Shtetit vlera 14,850 mijë lekë.
- Fondet për kërkimin shkencor nga të ardhurat e institucionit janë parashikuar në vlerën 11,191 mijë lekë.

Për vitin 2021 janë realizuar projekte kërkimore gjithsej në vlerën 11,001 mijë lekë nga:

- Granti konkurrues për kërkim shkencor nga Buxheti i Shtetit vlera 526 mijë lekë
- Fondet për kërkimin shkencor nga të ardhurat e institucionit janë parashikuar në vlerën.

Nga UNIEL për periudhën e pandemisë Mars 2020 - Dhjetor 2021 nuk është kërkuar rialokim i fondeve për arsye se shpenzimet e kryera për përballimin e situatës së krijuar nga Covid-19 janë mbuluar me fondet e planifikuara sipas periudhës përkatëse.

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” gjatë periudhës së pandemisë, si për mbrojtjen higjieno-sanitare dhe për ndryshimin e sistemit të mësimdhënies nga auditori në online për periudhën e pandemisë Mars 2020-Dhjetor 2021, ka kryer shpenzime kapin vlerën 8,000,385 lekë, përafërsisht 3.7% të buxhetit të përdorur për mbulimin e shpenzimeve të përgjithshme për mallra dhe shpenzime, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 18 Shpenzime për materiale e shërbime Covid19 Mars 2020 - Dhjetor 2021			
Nr	Objekti i Prokurimit	Vlera	Burimi financimit
1	Blerje bandera në 5 godina dhe punime në adezive COVID-19	395,000	Të ardhurat
2	Materiale për mbrojtje personale ndaj COVID-19	2,676,600	Të ardhurat + Granti për shpenzime korente

3	Shërbime të dezinfektimit të mjediseve (COVID-19)	4,869,275	Granti për shpenzime korente
4	Shpenzime për "Abonime Office 365"	59,510	Të ardhurat
	Totali	8,000,385	

Burimi: UEL dhe përpunoi grupi i auditimit

Për plotësimin e nevojave për mësimdhënien online, platforma e në distancë janë kryer blerjet “Office 365 for Education” dhe “Upgrade i shërbimit të postës elektronike” për stafin akademik dhe studentët, administruar nga sektori i teknologjisë dhe informacionit, në vlerën totale prej 59,510 lekë me TVSH, financuar nga të ardhurat (kapitulli 06).

Gjatë periudhës së pandemisë Mars 2020- Korrik 2020, Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” nuk ka kontrata të rishikuara. Megjithatë për vetë shtrirjen e objekteve ku kryen aktivitetin ky IAL, pra në 12 objekte veçmas dhe pagesa e ruajtjes fizike në njëvitet është e lartë, Institucionet përgjegjëse si MF dhe MPB që e ka krijuar këtë shoqëri me kapital shtetëror, në kuadër masave që u morën për mbështetjen e e biznesit siç ishte garancia sovranë apo mekanizma të tjera financiare, duhet të kishin nxjerrë akte për subvencionimin e shpenzimeve të shoqërisë shtetërore për ruajtje fizike, me qëllim krijimin e mundësisë për rishikimin e çmimit të kontratave të shërbimit nga kjo shoqëri, duke reduktuar kostot për IAL-publike pa cenuar nivelin e shërbimit. Në këtë mënyrë IAL-et do të kishin në dispozicion më tepër fonde për të shpenzuar drejtpërdrejt në infrastrukturën IT, platformat online, pajisjet kompjuterike, pajisjet teknologjike të kontrollit dhe dizinfektimit automatik, tabletet interaktive, etj. në funksion të realizimit të procesit mësimor online dhe të kufizuar në auditor. Këto fonde mund të alokoheshin për lehtësimin e mësimin online të studentëve e krijimin e kushteve sa më të sigurta për mbrojtjen e shëndetit dhe stafit akademik..

Gjetja nga auditimi:

20. Nga auditimi i kryer në zbatimin e kontratave të shërbimeve nga të tretët për ruajtje fizike nga subjekti shtetëror të 12 objekteve me polici private, u konstatua se gjatë periudhës së pandemisë (si përgjatë “lockdown” Mars-Prill 2020) por dhe deri në Tetor 2020, nga Bordi i Administrimit në Universitetin e Elbasanit, nuk janë marrë vendime për rishikimin e kontratave referuar kushtit të vendosur në kontratë për gjendje të jashtëzakonshme, për rivlerësimin e kontratave me grupe pune me qëllim uljen e shpenzimeve të panevojshme dhe jo efektive deri në masë 1/3 e tyre dhe rialokimin e tyre me destinacion tjetër, në funksion të mbështetjes së studentëve dhe pedagogëve.

Konkluzioni:

18. Stafi menaxhues i këtij IAL-i (Bordi i Administrimit) duhet të kishte analizuar efektivitetin e përdorimit të fondeve për kontratat e shërbimeve nga të tretët me qëllimin uljen e shpenzimeve dhe përdorimin e këtyre fondeve në destinacione më të kërkuara nga studentët e stafi akademik.

Rekomandime:

19. IAL-et të merren masa dhe të ngrihet grup pune për të rishikuar kontratat për shërbime e sipërmarrje nga të tretët, duke vendosur “shtojcë” të drejtën e rishikimit për rastet e situatave të jashtëzakonshme, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike.

Menjëherë e në vijimësi

20. Bordi i Administrimit të marrë masa për ngritjen e një grupi pune të vecantë për të analizuar shkaqet e mos veprimit në rastin e pandemisë duke mos riparë kontratat e sigurisë fizike për reduktimin e shpenzimeve deri në masë 1/3 e tyre, me qëllim dhe evidentimin e përgjegjësisë dhe marrjen e masave në proporcion me shkeljet e konstatuara.

Menjëherë

4. Universiteti “Fan S Noli” Korçë për periudhën në vitet 2020-2021 në kushtet e periudhës së pandemisë Covid 19 dhe konstatohet se nga struktura administrative dhe akademike.

Në vitin 2020-2021, ky institucion ka patur në dispozicion një buxhet "Grant i Buxhetit" & "Të ardhurat e krijuara" në vlerë totale 910,687 mijë lekë, nga kjo: vlera 807,702 mijë lekë nga buxheti i shtetit dhe vlera 102,985 mijë lekë të ardhura nga pagesat e studentëve, rezulton se të ardhurat e veta zënë 11.3%, si tarifa studimi dhe të tjera. Realizimi i buxhetit për këto dy vite është përkatësisht në vitin 2020 masën 93% dhe në vitin 2021 masën 95%. Nuk ka patur asnjë shtesë financimi nga buxheti i shtetit, gjë kjo që tregon për një qasje jo mbështetëse nga Qeveria në këtë Universitet. Sipas pasqyrës përmbledhëse të përgatitur, shikohet se përdorimi i buxhetit në dy vitet e pandemisë nuk është përmbushur në 2-3 zëra, konkretisht në vitin 2020 kemi dy zëra shpenzimesh në llogarinë 602 e 606 në masë 37% dhe 76 %, pra siç shikohet me situatën pandemike janë ndaluar shërbimet e panevojshme imediate dhe në vitin 2021

kemi dy zëra shpenzimesh në llogarinë 602 e 606 në masë 62% dhe 86 %, ndërkohë që buxheti në vitin 2019 është realizuar 100 %. Sipas pasqyrës plani i vitit 2020 ka qenë në vlerën 416,889 mijë lekë dhe realizuar në fakt 388,097 mijë lekë ose 93%, ndërsa në vitin 2021 nga 434,397 mijë lekë që ka qenë plani janë përdorur 413,605 mijë lekë ose realizuar buxheti në masën 95 % të grantit të dhënë nga Qeveria.

Për zërin “Investime” në llogarinë 231, në të dy vitet 2020-2021 kanë përdorur vlerën 31,349 mijë lekë, nga kjo: në vitin 2020 për iAL vlerën 19,731 mijë lekë dhe 11,618 mijë lekë për Kërkimin shkencor.

Tabela 18 Pasqyra e planifikimit dhe realizimit të ardhurave për periudhën 2019-2021

000| lekë

N r.	Përshkrimi i të ardhurave	Totali 2019			Totali 2020			Totali 2021		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
	Realizimi	120,319	69,099	57%	90,319	74,984	83	122,747	70,736	58

Burimi: UNIV Korçë dhe grupi i auditimit të KLSH.

Pra, mungesa e ardhjes së studentëve të planifikuar me kuotat e caktuar, ka sjellur mungesën e realizimit të ardhurave, por mungesa ka ardhur dhe nga mos shtimi i projekteve dhe kërkimit shkencor, pasi ka një numër të kufizuar për një Universitet me traditë. Të ardhurat financiare janë realizuar 83 % në vitin 2020 dhe në masën 58% në vitin 2021 me diferencë në vlerë -52,011 mijë lekë, pra konstatohet se në kemi një mosrealizim me planit të ardhurave

Shpenzimet e kryera në vitin 2019 (për metodologji krahasimi) dhe dy vitet me situatë pandemike 2020-2021 (Analizë e hollësishme do bëhet në auditimin pas miratimit të Programit të auditimit), konkretisht:

Table 19: Pasqyra e shpenzimeve për periudhën 2019-2021(lekë)

EM ËRTIMI	Vlera në vitin2019	Vlera në vitin2020	Vlera në vitin 2021
A Shpenzime nga Buxheti	391,653,666	388,097,346	413,605,398
SHUMA	391,653,666	388,097,346	413,605,398
B Shpenzime nga të ardhurat	54,534,857	47,942,786	56,936,182
SHUMA B	54,534,857	47,942,786	56,936,182
C Garanci të vitit të trashëguara	3,113,819.89		
TOTALI I SHPENZ.(A+B)	449,302,343	436,040,132	470,541,580

Burimi: Univ. Korçë dhe Grupi i auditimit të KLSH

Shpenzimet gjatë periudhës së pandemisë Mars 2019- Dhjetor 2021 për mbrojtjen higjeno- sanitare dhe për ndryshimin e sistemit të mësimdhënies nga auditori në online, janë si më poshtë:

Tabela 19.1 Pasqyra e shpenzimeve higjeno sanitare për periudhën Mars 2020-Dhjetor 2021(lekë)

Nr.	Objekti i shpenzimit	Urdhër Prokurimi		Urdhër Shpenzimi		Vlera Lekë
		Nr	Datë	Nr	Datë	
1	Të tjera materiale e shërbime speciale	183	19.03.2020	94	29.04.2020	442,680
2	Shërbim Denzif. dhe higjenizim për Covid 19	391	31.08.2020	271	07.12.2020	60,000
3	Shërbim Denzif. dhe higjenizim për Covid 19			242	10.11.2020	60,000
4	Shërbim Denzif. dhe higjenizim për Covid 19			53	09.03.2021	60,000
5	Ëeb camera(platform online) për zhvillimin e proc. mësimor online	680	17.12.2020	14	27.01.2021	41,880
6	Shërbim Denzif. dhe higjenizim për Covid 19	219	12.05.2020	140	07.07.2020	160,966
7	Shërbim Denzif. dhe higjenizim për Covid 19			186	09.09.2020	42,794
8	Mat. e pajisje shërbimi (rifillimi i mësimi)	222	12.05.2020	123	16.06.2020	95,760
Totali						964,080

Burimi: Univ. Korçë dhe Grupi i auditimit të KLSH

Për periudhën e pandemisë Mars 2020-Dhjetor 2021 nga Universiteti “Fan S.Noli” Korçë,nuk është kërkuar dhe kryer rialokim i fondeve për arsye se shpenzimet e kryera për përballimin e situatës së krijuar nga Covid-19 janë mbuluar me fondet e planifikuara sipas periudhës përkatëse.

Përdorimi i këtyre materialeve higjeno sanitare, ka qenë plotësisht në funksion të studentëve dhe stafit akademik e administrativ të IAL.

Bazuar në intervistat dhe auditimin në terren të dokumentacionit të administruar nga grupi i auditimit dhe vlerësimit të përgjigjeve të pyetësorit organizuar për kto IAL-e, për vetë specifikat që ka çdo Universitet, ne do i trajtojmë veçmas në mënyrë të strukturuar sipas rënditjes së pyetësorit datë 30.03.2022, konkretisht:

Universiteti “Fan S.Noli”, Korçë ka të garantuar autonominë financiare dhe organizative dhe administron prona të paluajtshme 6 godina për ambiente mësimdhënie e laboratorë, nga të cilat 4 prej

tyre nuk janë të regjistruara pranë ASHK, Korçë, **për të cilën adminstratori duhet të ndjekë rrugët administrative për të kryer procesin e regjistrimit.**

UNIKO për blerje bazë materiale (kompjuter) për zhvillimin e mësimit online dhe krijimin e platformave gjatë periudhës së pandemisë, i ka mundësuar me fondet e planifikuara nga të ardhurat e veta për periudhën 2020-2021 dhe nuk është kërkuar shtesë ose alokim tjetër fondesh.

Në fillim të pandemisë UNIKO ka patur në gjendje pune 6 lloje pajisjesh me vlerë totale 74,453 mijë lekë sipas pasqyrës mëposhtme:

Tabela 19.3 Gjendja e inventarit në 30 Mars 2020

Tabella 2015 Gjykatja e Inventarit në 30 Mars 2016

Nr	Artikulli	Njësia	Sasia	Vlera në Lekë						
1	Kompjuter	copë	413	36,288,375						
2	Videoprojektor	copë	104	8,413,063						
3	Laptop- Minilaptop	copë	137	9,914,426						
4	Fotokopje	copë	43	4,703,089						
5	Printer	copë	113	5,425,541						
6	Pajisje te tjera elektronike	copë		9,708,224						
Totali				74,452,718						
Nr	Artikulli	Laboratore dhe salla dixhitale								
		Njësia	Rektorat	Edukimi	Gjuhët e huaja	Gjuhët e huaja	Bujqësia	Informatika 1	Informatika 2	Totali
1	Kompjuter	copë	23	12	34	24	11	41	25	170
2	Laptop	copë	3				2	1	1	7
3	Videoprojektor	copë	1	1	2	1				5
4	Fotokopje	copë	1	1						2
5	Printer laser	copë	1							1
6	Earphones	copë	17							17
7	Kufje mikrofon	copë			36					36
8	Scaner	copë					1			1

Burimi: Univ. Korçë dhe Grupi i auditimit të KLSH

Bursat e studimit financohen nga buxheti i shtetit për dy vitet 2020-2021.

Viti	Studente ekselente	Studente me mesatare 9-10	Studente ne nevojë	Gjithsej nr.i studenteve	Vlera
2020	19	55	495	569	41,713,500
2021	36	24	547	607	49,900,000

Burimi: Univ. Korçë dhe Grupi i auditimit të KLSH

Siç shikohet nga pasqyra e mësipërme, trendi i trajtimit të studentëve ka shkuar në rritje nga viti 2020 në vitin 2021 si vite pandemie, kjo e shoqëruar në progresion të drejtë dhe me fondet e financuara nga MASR(institucioni i AKFAL nuk ka asnjë gjurmë auditimi për funksionin e tij në financimin e UNIKO). Gjatë periudhës së pandemisë 2020-2021 Universiteti “Fan S.Noli”, Korçë ka aplikuar për 5 projekte, dhe ka fituar 3 prej tyre (detajimi në tabelën e mësipërme). AKSHI ka akorduar fonde për 2 prej tyre në universitetin tonë.

Forma e pagesës për Senatin Akademik (SA) dhe Bordin e Administrimit (BA) është pagesë mujore fikse, pavarësisht numrit të mbledhjeve. Në tabelat e mëposhtme gjendet informacion i detajuar në lidhje me numrin e mbledhjeve, pjesëmarrjen dhe pagesat e kryera të anëtarëve të brendshëm dhe të jashtëm të SA dhe BA për periudhën 2020-2021¹²⁷, ku për periudhën e pandemisë janë paguar me shkëputje, ku Senati akademik nuk është paguar në muajin Prill-Maj 2020, ndërsa Bordi i Administrimit anëtarët e brendshëm nuk janë paguar për tre muaj Mars-Maj 2020, ndërsa në mënyrë jo të drejtë dhe të pargumentuar janë paguar anëtarët e jashtëm në vlerë 250 mijë lekë. Ky veprim është në kundërshtim me VKM-në nr. 267, datë 31.3.2020 “Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të disa funksionarëve dhe nëpunësve të administratës shtetërore, gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga pandemia

¹²⁷ Bashkëngjitur listëprezencat, listëpagesat dhe Urdhër-Shpenzimet e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për periudhën Mars 2020 – Dhjetor 2021, si dhe shkresa e MASR-së.

Covid 19” për pagesat e anëtarëve të organeve kolegjiale. MASR me shkresë nr. 2191/1 Prot., datë 15.04.2020 me lëndë “Kthim përgjigje” ka sqaruar se i takon strukturave të IAL të marrin vendim në përputhje me dispozitat e kësaj VKM-je, në kuadër të së cilës përcaktohet se shpërblimin mujor përkatës nuk e përfitojnë anëtarët që janë nëpunës të administratës shtetërore sipas parashikimeve të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”.

Gjetja nga auditimi:

21. Është konstatuar se përcaktimi në VKM i pagesës së anëtareve të Senatit akademik është kryer si pagë mujore dhe jo në bazë të mbledhjeve, gjë e cila ka rënduar buxhetin e IAL-eve, pasi për shkak të numrit të lartë të anëtarëve të këtyre organeve në veçanti të Senatit akademik, shpenzimet për pagesën e tyre janë të konsiderueshme. Bordi i Administrimit të IAL-eve dhe stafi drejtues, nuk i kanë përdorur kompetencat që u jep ligji organik për autonominë finaciare dhe organizative për të rishikuar pagesat e senatit akademik si gjatë pandemisë, por dhe para saj për rishikimin e pagesave të anëtarëve të Senatit akademik sipas VKM nr. 656, datë 31.10.2018 “Për caktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësisë të qeverisjes qendrore”, pika 5, ku citohet: *“Kufiri maksimal i shpërblimit të anëtarëve në senatin akademik dhe bordin e administrimit në institucionet e arsimit të lartë publik është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj”*, pra të kishte një vlerësim në ulje dhe të vendosej Këto pagesa në kufirin maksimal prej 25,000 lekë/muaj, janë kryer në të pesë Universitetet objekt auditimi.

Konkluzioni:

19. Stafet menaxhuese të IAL-eve nuk kanë vendosur pagesë të ndryshueshme, por janë paguar me pagesa maksimale prej 25,000 lekë/muaj për anëtarët e Senatit akademik, edhe në periudhë pandemie (ku ka patur hapësirë për kryerjen nga 1 në 3 mbledhje/muaj). Këto fonde mund të ishin përdorur më mirë, nëse do t'i shërbenin mbështetjes së studentëve dhe pedagogëve gjatë periudhës së pandemisë.

Rekomandimi:

21. Strukturat drejtuese të IAL-eve bazuar në kompetencat që u njeh autonomia financiare dhe organizative, të rivlerësojnë dhe rishikojnë mundësitë e vendimmarrjes për pagesë më të ulët pagese, si dhe duke kufizuar numrin e mbledhjeve të pagueshme, në maksimalisht 9 mbledhje në vit.

Menjëherë e në vijimësi

UNIKO ka ndarë fonde për aktivitete të këshillave studentorë për periudhën 2020-2021 në vlerë 1.600,000 lekë, të cilat për shkak të situatës së krijuar nga pandemia nuk janë përdorur për shkak të pamundësisë së zhvillimit të aktiviteteve nga personeli dhe nga studentët, si dhe janë mbështetur dhe 4 konferenca studentore. Gjithashtu, gjatë vitit 2021 janë mbështetur aktivitetet studentore me karakter sportiv (volejboll, futboll) të zhvilluara në kuadër të Universiadës.

Për periudhën e pandemisë Mars 2020 - Dhjetor 2021 nga Universiteti “Fan S.Noli”, Korçë nuk është kërkuar dhe nuk ka kryer rialokim të fondeve, për arsye se shpenzimet e kryera për përballimin e situatës së krijuar nga Covid-19, janë mbuluar me fondet e planifikuara sipas periudhës përkatëse. Shpenzimet e kryera për mbrojtjen e shëndetit të studentëve dhe stafit akademik e administrativ gjatë periudhës së pandemisë 2020-2021, të cilat janë detajuar në tabelën e mëposhtme, kapin vlerën 964,080 lekë (treguar me pasqyrë më lartë), përafërsisht 1.39% të buxhetit të përdorur për mbulimin e shpenzimeve të përgjithshme për mallra dhe shpenzime.

Për plotësimin e nevojave për mësimdhënien online, platforma e në distancë janë kryer blerjet e listuara si më poshtë:

- Procedurë prokurimi me vlerë të vogël me objekt «Web camera për auditorët/zyrat për zhvillimin e procesit mësimor online (Mjete dhe pajisje të tjera teknike)», me Urdhër Prokurimi nr.680, datë 17.12.2020, realizuar në vlerën totale 41,880 lekë me TVSH financiar nga kapitulli 06.

- Instalimi i platformës “Office 365 for Education” dhe “Upgrade i shërbimit të postës elektronike” për stafin akademik dhe studentët, administruar nga sektori i teknologjisë dhe informacionit, në vlerën totale prej 59,592 lekë me TVSH, financiar nga kapitulli 06.

Gjatë periudhës së pandemisë Mars 2020- Korrik 2020, Universiteti «Fan S.Noli», Korçë nuk ka kontrata të rishikuara. Kontrata e prokuruar për periudhën Mars 2020 është lidhur kontratë me datë 23.04.2020 për «Sherbime të sigurimit të ruajtjes» me vlerë 17,476,174 lekë dhe siç është konstatuar dhe nga auditimi, Administrata nuk është rivlerësuar situata e ruajtjes në kushtet e lookdawun –it, ku derisa mungonin studentët në auditor duhet të reduktoheshin vendrojat pasi kanë qenë të panevojshme dhe do

të kurseheshin fonde dhe do ndihmoheshin studentet apo stafi me pajisje elektronike e veçanërisht studentët në nevojë’.

Nga subjekti UNIKO është dërguar observacion në përgjigje të shkresës Nr. 103/9 Prot, datë 30.06.2022, me lëndë “Projekt Raporti i auditimit “Performanca e Universiteteve Publike gjatë periudhës së pandemisë”, (forma online me email) datë 13.07.2022 ku është cituar në formë argumentimi pagesa për Senatit dhe sqarojnë mbi mënyrën e pagesave të kryera, për të cilën sqarojmë : Rekomandimi ynë është përgatitur në funksion të përmirësimit të mënyrës së kryerjes së pagesave për anëtarët e Bordit dhe Senatit, në funksion të numrit të mbledhjeve dhe pakësimit të numrit të tyre, pra mos të kryehen mbledhje pa një rend dite të plotë, dhe jemi dakord me pagesat poer rekomandojmë përmirësimin e menaxhimit në IAL.

Po kështu kanë observuar për pikën 4 të Projekt Raportit (fq. 117) nga ana jonë është trajtuar problemi i reduktimit të shpenzimeve të ruajtjes fizike, dhe sqaromë se jemi dakord, ku për shkak se vendndodhja e objekteve është në zona të ndryshme dhe përveç sipërfaqeve të godinave ka dhe ambjente të përbashkëta funksionale si parkim, lulishte, stola, ndricime, etj. UNIKO **nuk mund të reduktoje numrin e vendndodhjeve.** Grupi i auditimit ka rekomanduar që nëse nuk janë mundësitë për reduktim tani, rekomandimi ynë ka vlerë për situata të jashtëzakonshme e fatkeqësi natyrore, prandaj ne pranojmë observacionin, por rekomandimi mbetet për ta vlerësuar në situata të reja kur të ketë fushë zbatimi.

4. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë për ushtrimin e aktivitetit për periudhën 2020-2021 institucion ka përdorur fondet publike me burim financimi si më poshtë:

Tabela 20 Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2020(mijë/lekë)

EM ËRTIMI	Vlera në vitin 2019 (/000 lekë)	Vlera në vitin 2020 (/000 lekë)	Vlera në vitin 2021 (/000 lekë)
A Shpenzime nga Buxheti	402,153	459,496	466,714
SHUMA	402,153	459,496	466,714
B Shpenzime nga të ardhurat	171,010	95,666	104,258
SHUMA B	171,010	95,666	114,199
C Garanci të vitit të trashëguara	2,770	3,496	1,235
TOTALI I SHPENZ.(A+B)	573,163	555,162	580,914

Burimi: Univ. Korçë dhe Grupi i auditimit të KLSH

- Për vitin 2020 financimet paraqiten:

Është përdorur një buxhet total në vlerën 555,163 mijë lekë, nga plani që ka qenë në vlerën 627,684 mijë lekë ose përdorur buxheti në masë 88.4 % nga të cilat:

a.Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transfera), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie në vlerën 454,553 mijë lekë nga buxheti i planifikuar në vlerë 475,195 mijë lekë ose realizuar 95.6 % me një diferencë mosrealizimi -20,642 mijë lekë.

b.Të ardhura të institucionit të vitit 2020 janë përdorur në vlerën 100,610 mijë lekë nga plani në fillim të vitit në vlerë 152,489 mijë lekë ose realizimi i përdorimit të ardhurave në masën 66%, nga kjo të ardhura të trashëguara nga një vit më parë 2019) vlera 98,312 mijë lekë.

- Për vitin 2021 financimet paraqiten:

Është përdorur një buxhet total në vlerën 580,914 mijë lekë, nga plani që ka qenë në vlerën 784,342 mijë lekë ose përdorur buxheti në masë 74.5 % ose pa përdorur vlera – 203,408 mijë lekë, nga të cilat:

a.Nga Buxheti i Shtetit (Grante e transfera), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie në vlerën 462,757 mijë lekë nga buxheti i planifikuar në vlerë 538,323 mijë lekë ose realizuar 85 % me një diferencë mosrealizimi -75,566 mijë lekë.

b.Të ardhura të institucionit të vitit 2020 janë përdorur në vlerën 118,157 mijë lekë nga plani në fillim të vitit në vlerë 210,730 mijë lekë ose realizimi i përdorimit të ardhurave në masën 56%, nga kjo të ardhura të trashëguara nga një vit më parë 2020) vlera 120,755 mijë lekë.

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë gjatë periudhës së pandemisë, për mbrojtjen higjeno-sanitare dhe për ndryshimin e sistemit të mësimdhënies nga auditori në online për periudhën e pandemisë Mars 2020-Dhjetor 2021 ka përdorur një fond prej 2,299,882 lekë, përkatësisht:

Tabela 20.1 Pasqyra e shpenzimeve për pandeminë Viti 2020-2021

në lekë

U Shpenz. nr	Data	Vlera lekë	Përshkrimi
450	18.06.2020	115,000	Disinfektim

498	02.07.2020	75,360	Materiale për marrjen e masave ndaj Covid
568	20.07.2020	490,000	Material për pastrim disinfektim
594	03.08.2020	623,070	Pagesë trajnim Anti Covid
597	03.08.2020	78,905	Pagesë trajnim Anticovid
929	11.12.2020	101,547	Disinfektim I ambjenteve të UV
Totali viti 2020		1,483,882	
568	20.07.2021	312,000	Material për pastrim disinfektim
734	18.08.2021	240,000	Disinfektim dhe deratizim i ambjenteve të UV
883	27.10.2021	240,000	Disinfektim dhe deratizim i ambjenteve të UV
Totali viti 2021		816,000	
Totali 2020-2021		2,299,882	

Burimi: Universiteti Vlorë dhe grupi i auditimit.

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë ka funksionuar sipas parimit të autonomisë financiare dhe organizative të garantuar nga zbatimi i Ligjit nr. 80/2015 për t’u vetëqeverisur, pët të zgjedhur organizmat drejtues, për të organizuar strukturat dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të tyre të brendshme, të hartuara në përputhje me këtë ligj dhe me akte të tjera, ligjore e nënligjore në fuqi.

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” Neni 3 “Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë”, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë ka zbatuar autonominë financiare në caktimin e Tarifave të aplikimit, Tarifave të konkurimit, Tarifave të studimit (tarifa e regjistrimit+tarifa e shkollimit). Këto tarifa në zbatim të legjislacionit në fuqi në universitetin e Vlorës, janë propozuar nga Administratori dhe miratuar nga SA dhe BA. Audit i brendshëm në institucion zbaton programin e angazhimeve me plan pune çdo vit.

Për periudhën e pandemisë 2020-2021 në UVlorës nuk ka patur kërkesa nga studentët dhe fakultetet dhe nuk ka kryer alokim fondesh për blerje materiale (kompjutera) për studentët të kategorizuar, si shtresë në nevojë për tu ardhur në ndihmë për ndjekjen e orëve mësimore si edhe për plotësimin e nevojave të Fakulteteve për periudhën 2020-2021.

Në momentin e fillimit të pandemisë UNI Vlora në muajin Mars 2020, gjendja në inventar dhe fizikisht e pajisjeve të IT që i kanë shërbyer mësimin online dhe të gjithë stafit akademik ka qenë i pajisur me kompjuter Laptop, Videoprojektor, etj., gjendja inventariale është si më poshtë:

Tabela 20.2 UNI Vlora viti 2020

EMERTIMI	REKTORATI	F.EKONOMISË	F.SHKENC. E HUMANE	F.SHKC. TEK. NATYRORE	F.SHENDETIT	TOTALI
Kompjutera	70	85	71	211	35	472
Laptop	19	19	16	40	3	97
Video projektor	3	22	20	47	10	102
TOTALI	92	126	107	298	48	671

Burimi: Univ. Vlorë dhe Grupi i auditimit të KLSH

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë deri në këtë moment nuk ka patur bashkëpunim/marrdhënie me AKFAL për përfitimin e fondeve publike në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe menaxhimit akademik dhe administrativ. Studentet e UV nuk kanë përfituar nga bursat e AKFAL. UNIVlora është aktiv në aplikimin për përfitimin e fondeve nga AKKSHI me qëllim projekte kërkimore shkencore si dhe projekte zhvillimore për përmirësimin e infrastrukturës. Sipas treguesve të paraqitur e verifikuar nga grupi i auditimit të KLSH-it, UNI Vlora ka dhënë bursa nga buxheti i saj ku për vitin 2019-2020 gjithsej kanë përfituar bursa 363 studentë sipas kategorive të tabelës së mëposhtme, si edhe kanë përfituar përjashtim nga tarifa ose reduktim të tarifës në 50% gjithsej 515 studentë. Për vitin akademik 2020-2021, janë trajtuar gjithsej 353 studentë me bursë ,dhe 552 studentë kanë përfituar nga përjashtimi i tarifës dhe reduktimi i saj në 50%.

Në periudhën e pandemisë 2020-2021 UNIVlora nuk ka krijuar të ardhura nga kërkimi shkencor, por është financuar nga AKKSHI për kryerjen e projekteve, sipas pasqyrës së mëposhtme:

Tabela 21 Të ardhura nga kërkimi shkencor

Nr	Emertimi	Financuar për vitin 2020	Llogaria (kapitulli)	Realizimi	Statusi
	Kërkimi shkencor programi (09770)	ALL		ALL	
1	Qendër kërkimor Shkencore për Fakultetin e Shëndetit	4,955,500	231000 (1)	4,944,000	Mbyllur

A	Total	4,955,500			
	Kerkimi shknc progr. (09770) Viti 2021	ALL		ALL	
1	Projekti AKKSHI "Efikasiteti dhe prespektiva"	1,447,313	602000 (8)	0	Në proces
2	Projekti e AKKSHI "Zhvillimi i ekspertizës akademike"	2,000,000	602000 (8)	0	Në proces
3	Qendër digjtale simulatore për profesionistët e shëndetit	6,920,000	231000 (1)	0	Në proces
B	Total	10,367,313			
	TOTALI A+B	15,322,813			

Burimi: UNI Vlora dhe grupi i auditimit

Nga auditimi i kryer dhe verifikimi i dokumentacionit konstatohet se janë kryer pagesa fikse mujore për 30 persona anëtarë të Bordit dhe Senatit Akademik, ku për dy vitet 2020-2021 janë paguar në vlerën 16,392,000 lekë, ku vërehet se janë zhvilluar mesatarisht nga një mbledhje mujore. Kjo në zbatim të VKM nr. 656, datë 31.10.2018 “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore” dhe Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 8 datë 22.02.2019 për “Përcaktimin e masës së shpërblimit financiar të anëtarëve të Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik” ku përfshihet pagesa për 7 anëtarët e Bordit të Administrimit dhe 23 anëtar të Senatit Akademik, si më poshtë:

Emërtimi	Nr. Anëtarëve	Pagesa për vitin 2020	Pagesa për vitin 2021
Senati Akademik	23	6,096,000	6,096,000
Bordi Administrimit	7	2,100,000	2,100,000
Total	30	8,196,000	8,196,000

Burimi: Univ. Vlorë dhe Grupi i auditimit të KLSH

Për vitin 2020 UNI Vlora ka mbështetur kërkesat e Këshillit Studentor në krijimin e Estradës së Studentëve për zhvillimin “Shfaqjeve teatrale” në vlerën 500,000 Lekë, ndërsa për vitin 2021 janë parashikuar në buxhetin e vitit 2021 fondi për mbështetje të aktiviteteve Social-Kulturore për studentët në vlerën 1,000,000 lekë, por nuk janë përdorur pasi nuk ka patur kërkesa nga këshilli studentor gjatë vitit.

Për periudhën e pandemisë 2020-2021 nuk ka patur asnjë financim shtesë si për kushtet higjieno sanitre dhe për shtim të infrastrukturës IT për mësimin online.

❖ Në lidhje me pyetjen se sa përqind zë buxheti i përdorur gjatë periudhës së pandemisë 2020-2021 për mbrojtjen e shëndetit të studentëve dhe stafit akademik e administrativ në UNI Vlora, nga përgjigjia e ardhur dhe verifikimi jonë, konstatohet se janë kryer shpenzime për vitin 2020 në vlerë 1,483,882 lekë e zënë 0.26 % të buxhetit total dhe për vitin 2021 në vlerë 816,000 lekë ose 0.14% e buxhetit total, me burim financimi nga të ardhurat e veta.

- Për mësimdhënien online platforma në distancë në UNI Vlora nuk ka patur kërkesa gjatë periudhës së pandemisë për shpenzime pajisje IT si kompjutera, laptop, tablet, etj., pra ky universitet nuk ka kryer shpenzime shtesë gjatë periudhës së pandemisë.

- Gjatë periudhës së pandemisë Mars 2020 - Korrik 2020, nuk janë kryer rishikim kontratash për të ndaluar pjesërisht shërbime apo anulimin e tyre në tregues të matshëm që janë ndikuar nga situata e pandemisë, si shërbimi i ruajtjes së objekteve, reduktimi i vendrojeve dhe po ashtu dhe pezullimi i furnizimit me karburant, etj., duke mos patur ndonjë efekt financiar në bilancin e IAL-it. Janë lidhur dy, përkatësisht:

1. “Materiale për pastrim, dezinfektim me Nr.680/14 prot., datë 06.07.2020 me vlerë 1,388,700 lekë me tvsh”;
2. “Blerje libra - fond biblioteke me Nr.828/16 datë 24.07.2020 me vlerë 2,971,292 lekë me tvsh.” të cilat nuk i përkasin periudhës së lockdown-it.

5. Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë ka përdorur fonde publike :

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë(UEGJ)për ushtrimin e aktivitetit për periudhën 2020-2021 ky institucion i Arsimit të Lartë, ka përdorur fondet publike me burim financimi:

Tabela 22 Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2019-2021(mijë/lekë)

EM ËRTIMI	Vlera në vitin 2019	Vlera në vitin 2020	Vlera në vitin 2021
A Shpenzime nga Buxheti	202,653	215,508	188,053
SHUMA	202,653	215,508	188,053

B Shpenzime nga të ardhurat	75,256	68,095	74,896
SHUMAB	75,256	68,095	74,896
C Garanci të vitit të trashëguara	299	699	700
TOTALI SHPENZ. (A+B)	277,909	283,603	262,949

Burimi: Univ. Korçë dhe Grupi i auditimit të KLSH

- Për vitin 2020 financimet paraqiten:

Tabela 23 Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2020 (mijë/lekë)

Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2019 (1)	Financimi viti 2020 (2)	Buxheti viti 2020 3(1+2)
1	Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transfertat)	12,113	207,039	219,152
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	2,610	19,592	22,202
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	63,086	33,299	96,385
TOTALI		77,809	259,930	337,739

Burimi: Univ. Korçë dhe Grupi i auditimit të KLSH

Për vitin 2020

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë ka përdorur një buxhet total në vlerën 337,739 mijë lekë.

d. Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga një vit më parë) 96,385 mijë lekë,

▪ *Të ardhura dhe shpenzime viti 2020*

Për vitin 2020 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën 337,739 mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

a. Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transfertat), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie, Granti konkurrues, kërkimi shkencor nga buxheti) 219,152 mijë lekë.

b. Projekte të huaja 22.202 mijë lekë.

c. Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga një vit më parë) 96,385 mijë lekë.,

Fondet të kushtëzuar – të ardhurat e UGJ-së: Të ardhurat e disponueshme janë realizuar në vlerën 96,385 mijë lekë ose 28 % të krahasuara me planin vjetor, ndërsa të ardhurat për tu grumbulluar në vitin 2020 janë realizuar në vlerën 33,299 mijë lekë ose 48.6 % të krahasuara me planin vjetor të tyre. (Plani 68,480 dhe fakti 33,299) Këto të ardhura janë grumbulluar gjatë vitit 2020.

Tabela 23.1 Të Ardhurat për vitin 2020 – fakti(mijë/lekë)

Nr	Emërtimi	Plan	Fakt	%
A	Të ardhura të vitit	68,480	33,299	48,6
B	Të ardhura të trashëguara	63,086	63,086	100
1	Trashëguar nga viti 2019	63,086	63,086	100
Totali		131,566	96,385	73,26

Burimi: Univ. Gjirokastrë dhe Grupi i auditimit të KLSH

Realizimi prej 48.6 % është rezultat i grumbullimi i një pjese të tarifave të shkollimit të planifikuara për vitin 2020 në Tetor–Dhjetor 2019. Një pjesë e këtyre të ardhurave janë përdorur për shpenzimet e planifikuara për tu realizuar në vitin 2019. Pjesa e papërdorur ka kaluar si të ardhura të trashëguara për vitin 2020.

Shpenzimet e UGJ-së: Gjatë të vitit 2020 shpenzimet gjithsej janë realizuar 88.8 % e financimit vjetor. Plan buxheti i çelur për përdorim është në vlerën 332.767 lekë. Është realizuar në vlerën 295.568 mijë lekë, ose 88.8 %

- Për vitin 2021 financimet paraqiten:

Tabela 23.2 Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2021(mijë/lekë)

Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2020	Financimi viti 2021	Buxheti viti 2021
1	Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transfertat)	3,645	190,472	194,117
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	10,236	9,553	19,789
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	28,290	47,300	75,590
TOTALI		42,171	247,325	289,496

Burimi: U Gjirokastrë dhe grupi i auditimit të KLSH

Për vitin 2021 Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë një buxhet total në vlerën 289,496 mijë lekë, nga të cilat:

a. Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie, Granti konkurrues 183,647 mijë lekë, kërkimi shkencor 4,070 mijë lekë, rimbursim i tvsh 2,755 mijë lekë nga buxheti). Në total buxheti 194,117 mijë lekë.

b. Projekte të huaja 19,789 mijë lekë.

Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga një vitet e mëparëshme) 75,590 mijë lekë, (nga të cilat 1.814.672 lekë janë disbursim nga projekti me financim të huaj). Efektet nga shpenzimet e kryera për pandeminë Covid19, janë 2,647,455 lekë.

▪ *Të ardhura dhe shpenzime viti 2021*

Për vitin 2021 buxheti i akorduar e i çelur është në vlerën 289,496 mijë lekë, i cili vjen nga akordimet e fondeve në fillim të vitit, rialokimet e kryera gjatë vitit dhe grumbullimi i të ardhurave të institucionit. Detajimi sipas formës së financimit paraqitet:

Tabela 23.3 Fonde të mbartura, financim grante dhe të ardhura për vitin 2021(mijë/lekë)

Nr	Emërtimi i projektit	Mbartur nga viti 2020	Financimi viti 2021	Buxheti viti 2021
1	Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta)	3,645	190,472	194,117
2	Disbursimet nga projektet me financim të huaj	10,236	9,553	19,789
3	Të ardhura të institucionit – Fonde të kushtëzuar	28,290	47,300	75,590
TOTALI		42,171	247,325	289,496

Burimi:U Gjyrokastër dhe grupi i auditimit të KLSH

d. Financime nga Buxheti i Shtetit (Grante e transferta), Buxheti i brendshëm (Grant mësimdhënie, Granti konkurrues, kërkimi shkencor nga buxheti) 194,117 mijë lekë.

e. Projekte të huaja 19,789 mijë lekë,

f. Të ardhura të institucionit (të vitit dhe të trashëguara nga një vitet e mëparëshme) 75.590 mijë lekë.nga të cilat 1.814.672 lekë janë nga projektet me financim të huaj.

Tabela 23.4 Ardhurat për 12- mujorin viti 2021 – fakti (mijë lekë)

Nr	Emërtimi	Plan	Fakt	%
A	Të ardhura të vitit	40,072	47,300	118
B	Të ardhura të trashguara	28,290	28,290	100
1	Trashëguar nga viti 2020	28,290	28,290	100
Totali		68,362	75,590	110

Burimi:U Gjyrokastër dhe grupi i auditimit të KLSH

Planbuxheti i çelur për përdorim është në vlerën **289,496 mijë lekë**, realizuar në vlerën **278,181 mijë lekë**, ose 96 %.

Gjatë periudhës së pandemisë, si për mbrojtjen higjieno-sanitare dhe për ndryshimin e sistemit të mësimdhënies nga auditori në online për periudhën e pandemisë Mars 2020-Dhjetor 2021, ka kryer rialokime të fondeve vetëm nga të ardhurat për shpenzime korente brenda zërave buxhetor të planifikuar në fillim të vitit 2020 dhe planifikimin e tyre për vitin 2021. Në materialet e pastrimit në vlerën prej 555.600 lek si dhe materiale higjieno sanitare në vlerën prej 872,400 lekë.

Autonomia financiare në këtë Universitet është e garantuar nga ligji 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor”, neni 3, por konstatohet se ky institucion nuk administron në pronësi pasuritë e paluajtshme që ka, por ato janë në përdorim, gjë kjo që pengon investimet apo përshtatjet në funksion të përmirësimit të kushteve të mësimdhënies dhe studentëve sipas standardeve bashkëkohore. Mos regjistrimi i tyre, ka ardhur dhe si pasojë e mos përgatitjes dhe dërgimit të listës së inventarit të pasurive të paluajtshme të UNGjyrokastër nga Qeveria me VKM të veçantë, kjo do të ndryshonte formën e pronësisë dhe do ti hapte rrugë zhvillimit strategjik të këtij institucioni arsimor të rëndësishëm në Jugun e Shqipërisë, për vetë specifikat që ka vendodhja e këtij IAL-i. Kalimi në pronësi të Universitetit do të krijonte mundësi reale për një menaxhim më të mirë si dhe dhe krijimin e të ardhurave për institucionin nga vënia në funksion të plotë e përdorimi i tyre sipas ligjit.

Gjetja nga auditimi:

22. Universiteti “Eqerem Çabej” Gjyrokastër në kryerjen e aktivitetit të mësimdhënies, kërkimore-shkencore kualifikuese, inovative, si edhe praktikave mësimore e laboratorë në periudhën objekt auditimi 2020-2021, nuk administron pasuritë e paluajtshme në pronësi, por i ka ato në përdorim.

Konkluzioni:

20. Mungesa e administrimit të pasurive të paluajtshme, ka kufizuar kryerjen e investimeve kapitale, duke cënuar rregullat e sigurisë në auditorë e ambiente pune, veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë.

Rekomandime:

22. Drejtuesit e universitetit “Eqerem Çabej” Gjirrokastër në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të marrin masa dhe të përgatisin dokumentacionin e nevojshëm për të ndjekur procedurat ligjore për kalimin në pronësi të pasurive të paluajtshme që ky institucion ka në inventar.

Menjëherë

Nga UNIGJ është dërguar observacion datë 13.07.2022 nga znj. Marianthi Xha në formë online me email, ku citohet vlerësimi i këtij institucioni për zbatimin e rekomandimeve tona dhe informojnë grupin e KLSH për fillimin e zbatimit të rekomandimeve të dërguara me Projektraportin e auditimit, gjë që vlerësohet pozitivisht nga ana jonë. Observacioni shpreh pajtueshmërinë me rekomandimet tona dhe marrjen e masave për zbatimin e tyre.

Nuk ka patur alokime fondesh për blerje materiale për mësimin online e platformash posaçërisht për studentët të kategorizuar si shtresë në nevojë për tu ardhur në ndihmë për ndjekjen e orëve mësimore gjatë periudhës së pandemisë. Po ashtu për plotësimin e Fakulteteve për periudhën 2020-2021 nuk ka pasur rialokime fondesh, por fondet kanë qenë të planifikuara më parë, gjatë hartimit të buxhetit. Për këtë periudhë ky IAL ka patur pajisjeve dixhitale sipas inventarit që disponojnë të shpërndarë nëpër auditore, në laboratore mësimor ku në muajin Mars 2020 gjendja e tyre është sipas tabelës së më poshtme:

Pajisje	Sasia
Komputera	405
Videoprojektore	58

Për periudhën 2020-2021 UE Gjirrokastër nuk është audituar nga auditimi i brendshëm i MASR, ose auditimi i vetë UGJ-së, apo auditimi i jashtëm (KLSH, etj.).

IAL ka përfituar fonde publike, të pamjaftueshme në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe menaxhimit akademik dhe administrativ të institucionit.

Fondi i akorduar sipas viteve për bursa studentëve është i njëjtë për dy vitet në vlerë 2.401.060 lekë për secilin vit. Ky fond ka mbuluar vetëm 24 studentë në vit, ndërkohë që numri i studentëve që janë trajtuar me bursë është 158 studentë për vitin 2020 dhe 157 studentë dhe vitin 2021. Për vitin akademik 2019-2020 janë shtatë studentë ekselentë, nga të cilët janë paguar vetëm 3 studentë.

Për vitin akademik 2020-2021 janë 19 studentë ekselentë nga të cilët janë trajtuar 16 studentë.

Viti akademik	Totali i studentëve	Ekselentë	Nga shtresat sociale nevojë	Fondi nga AKFAL	Fonde të trashëguar	Fondi të rialokuar nga 602	Fonde të përdorura nga të ardhurat	Totali fondeve/fondi i përdorur
2019-2020	158	7	151	2,401,060	4.574.093	5,846,842		12,821,995/ 11.465,899
2020-2021	157	16	141	2,401,060	1.356.094		4,409,162	8.166,256/ 8,166,256

Burimi: UGJ dhe grupi i auditimit përpunim.

Për vitin akademik 2019-2020 janë trajtuar 158 studentë. Është akorduar fondi nga Buxheti i Shtetit në vlerën prej 2,401,060 lekë si dhe trashëguar fondi prej 4,574,093 lekë, e rialokuar nga fondet e trashëguara 5,846,842 lekë në total 12,821,995 lekë nga Buxheti i Shtetit, nga i cili është përdorur 11.465.899 lekë.

Për vitin akademik 2020-2021 janë trajtuar 157 studentë, është akorduar fondi nga Buxheti i Shtetit në vlerën prej 2.401.060 lekë si dhe trashëguar fondi prej 1.356.094 lekë. Vlera prej 4.409.162 lekë janë përdorur nga të ardhurat e krijuara nga Institucioni. Në total, është përdorur fondi prej 8.166.256 lekë sipas tabelës së mësipërme ku 3.757.094 lekë janë përdorur nga Buxheti i Shtetit dhe 4.409.162 lekë janë përdorur nga të ardhurat e krijuara nga Institucioni. Diferenca e realizimit në dy vite vjen si pasojë e aplikimit të studentëve në zbatim të VKM nr. 39 datë 23.01.2019.

Gjatë periudhës së pandemisë 2020-2021 marrëdhëniet me AKKSHI-n kanë qenë marrëdhënie institucionale. Fondet janë dhënë për të mbështetur projektet, si më poshtë:

Viti	Emërtimi i projektit	Fonde të akorduara	Fonde të përdorura	Fonde të papërdorura	Periudha e kryerjes	Burimi i financimit/buxheti i shtetit
2021	”(Blerje paisje laboratorike) ”Infrastruktura e kërkimit shkencor dhe mësimdhënies në FEUOGJ”	2,624,840	0	2,624,840	Tetor 2021	Buxheti i Shtetit
2021	Kërkime shkencore (Standardizimi i produkteve të blegtorisë në qarkun e Gjirrok dhe krij. i një marke tregetare	1,445,310	178,997	1,266,313	Tetor 2021	Buxheti i Shtetit

Burimi: U Gjirrokastër dhe grupi i auditimit të KLSH

Për periudhën e pandemisë Mars - Korrik 2020, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej", ka realizuar 5 (pesë) mbledhje.

- Pagesat kryhen me pagë fikse 15.000 lekë në muaj, në dy periudha 6 mujore dhe 3 mujore në vit.

Në veprimtaritë kërkimore shkencore për periudhën e auditimit 2020-2021 ka kryer 29 aktivitete shkencore dhe 5 projekte shkencore me fonde të përdorura në vlerë 625,114 lekë.

Situata e mësipërme me tregues në rënie në të gjithë zërat e kërkimit shkencor, për vitin 2020-2021 në krahasim me vitin 2019, argumentohet me kushtet specifike globale krijuar prej pandemisë Covid 19. Gjithësesi angazhimet e stafit për kualifikimin individual kanë vazhduar dhe në rrethanat e reja, duke ju bashkuar aktiviteteve shkencore të zhvilluara nëpërmjet platformave online.

Për periudhën e pandemisë 2020-2021 UGjirokastër ka parashikuar fonde për qeverinë studentore sipas tabelës më poshtë, por për arsye edhe të situatës nuk janë përdorur.

Viti	Emërtimi i aktivitetit	Fonde planifikuara	Fonde përdorura	Fonde papërdorura	Burimi financimit/
2020		3.000.000	0	3.000.000	Te ardhurat e institucionit
2021		3.500.000	0	3.500.000	Te ardhurat e institucionit

Burimi: U Gjirokastër dhe grupi i auditimit të KLSH

Megjithëse, Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër ka patur vështirësi financiare, për periudhën e pandemisë nuk është financuar asnjë vlerë financiare për të ndihmuar sado pak në sigurimin e kushteve normale higjieno-sanitare për zhvillimin e mësimin në auditor. Institucioni nuk është financuar me fonde shtesë për periudhën e pandemisë 2020-2021, përkundrazi kanë qenë vite të vështira financiare.

Në periudhën 2020-2021 janë krijuar të ardhura nga shërbimet kërkimore shkencore, në vlerën 257,000 lekë, vlerë kjo e papërfillshme në raport me nevojat që ka ky IAL.

Buxheti i përdorur gjatë periudhës së pandemisë 2020-2021 për mbrojtjen e shëndetit të studentëve dhe stafit akademik e administrativ në IAL-in Gjirokastër për vitin 2020 është 1% e buxhetit dhe për vitin 2021 është 0,42%.

3. PËRMBLEDHJA

- ✓ Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë është dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë që përcakton politikat e aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë, miratimi i saj, përbën parakusht në përgatitjen e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile, plan nga miratimi i të cilit, do hapet rruga e përgatitjes dhe miratimit të planeve të veprimit ante factum (planeve të masave), të cilat do mund të përgatiteshin nga subjektet, që para shfaqjes së situatës, që mund të përbëjë arsye të mjaftueshme për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, sikurse ishte edhe rasti i pandemisë në periudhën Mars 2020, që i gjeti MASR dhe IAL-et të papërgatitur. I gjithë ky zinxhir përgatijeje dokumentash dhe miratimit të tyre, është një proces ku mosmiratimi i njërit përbën pengesë për miratimin e dokumentit vijues.
- ✓ Pamundësia që IAL-et të përdornin platformat elektronike dhe të familjarizonin thellësisht me TIK, në funksion të shfrytëzimit të tyre për realizimin me sukses dhe pa pengesa të proceseve mësimore online gjatë periudhës së pandemisë, lidhet gjithashtu edhe me kufizimin e formave të studimit me Ligjin 80/2015, i cili e përjashton mësimin në distancë. Për këtë arsye ky kufizim, nëpërmjet një përmirësimi ligjor, duhet propozuar të hiqet.
- ✓ Ky përmirësim ligjor, qartazi duhet të parashikojë mundësinë që IAL-et, sipas nevojave dhe në varësi të programeve mësimore, të zhvillojnë mësim online, jo duke ia deleguar ushtrimin të lirisë akademike që u njihet në parim IAL-ve, por që për sanksionim të po këtij ligji, nuk mund të zhvillojnë forma studimesh në distancë, sikurse është edhe mësimi online.
- ✓ Mosnjohja e dokumentave të rëndësishëm të BE-së lidhur me "e-learning", përfaqëson një arsye të mos njohjes rekomadimeve dhe praktikave të BE-së, që duhet të frymëzojnë e nxisin progresin në arsimin shqiptar në të gjitha nivelet, përfshirë Arsimin e lartë.
- ✓ Mosparashikimi nëpërmjet një përcaktimi të qartë ligjor, i mësimin online, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, si formë mësimi që kompensonte mësimin në auditor, është bërë në shkelje të detyrimit të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 170, paragrafi 3, ku thuhet: "Ligji duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve që

vijnë si rezultat i kufizimit të të drejtave dhe lirive gjatë marrjes së masave të jashtëzakonshme”¹²⁸.

- ✓ Mungesa e këshillave studentorë në ndonjë IAL, apo inaktiviteti i tyre në IAL–të tjerë, ka lënë studentët pa një përfaqësim të zëshëm të shqetësimeve dhe problemeve me të cilat janë ndeshur gjatë periudhës së pandemisë, duke mos përçuar në forumet e IA –ve, mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të institucioneve të arsimit të lartë, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, veçanërisht në kushtet e vështirësive të krijuara nga pandemia, me të cilat është ndeshur kjo kategori.
- ✓ MAS dhe IAL–et, së bashku me Qeverinë, entet shtetërore të fushave të ndryshme, njësitë e vetqeverisjes vendore dhe operatorët e sektorit privat, duhej të kishin bashkëpunuar gjatë periudhës së pandemisë në jetësimin dhe materializimin konkret të shërbimeve me çmime të reduktuara, në përgjigje të nevojave të reja të krijuara nga situata e pazakontë.
- ✓ Mungesa e miratimit të VKM - së “Për skemën e kreditimit studentor, si dhe kushtet që duhet të plotësojë studenti për aplikim për kredi”, në kushtet e pandemisë, është një mungesë më shumë e instrumentave me të cilat Qeveria do duhej të kishte ndërhyrë, edhe në zbatim të një detyrimi ligjor, të projektuar në kushte gjendjeje normale, edhe në përgjigje të një mase vështirësishë dhe nevojash të lindura në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe situatës së pandemisë.
- ✓ Mosmiratimi prej shumë vitesh nga Ministri i MASR–MAS, i Udhëzimit “Mbi frekuentimin e procesit mësimor, sipas llojit të veprimtarive mësimdhënëse në auditor, dhe ciklit të studimit”, cënon një kriter qartazi përcaktuar nga Ligji 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 87, pikën 3.
- ✓ Mungesa dhe vënien në dispozicion nga institucionet shëndetësore të personelit mjekësor (mjek apo infermier), për asistimin dhe trajnimin e personelit të UPT–së, ka krijuar vështirësi në zbatimin sa më eficient të masave të ndërmarra nga UPT.
- ✓ Nga auditimi ka rezultuar se departamentet dhe IAL-et nuk kanë bërë:
 - analizë të nevojave në lidhje me kapacitetet që duhet të kenë klasat virtuale, me qëllim funksionimin real dhe pa problem të tyre;
 - analizë në lidhje me nevojat për punët laboratorike;
 - studim apo analizë mbi gjendjen e infrastrukturës dixhitale për të njohur kapacitetin e nevojshëm për shkarkimin e leksioneve, detyrave të kursit, projekteve etj. Si pasojë e evidentimit të problematikave të mësipërme, rezultoi se universitetet objekt auditimi aplikuan disa platforma (shpesh të përzgjedhura individualisht nga pedagogët), si Google-classroom, Microsoft Teams dhe Zoom, të cilat nisur edhe nga përgjigjet e pyetësorëve paraqitën problematika teknike, që lidhen me internetin dhe aksesimin e platformave.
- ✓ Studentët dhe pedagogët kanë paraqitur paqartësi në lidhje me adresimin e ankesave gjatë periudhës së pandemisë dhe në asnjë rast nuk u hartua gjurma e auditimit për trajtimin e ankesave.
- ✓ Në asnjë rast nuk është hartuar dhe miratuar rrjedha e dokumentuar e aktiviteteve (nga fillimi deri në përfundim të tyre) sa i takon procesit mësimor online (distancë) dhe auditor n periudhën e pandemisë 2020-2021, që synon të ripërshkruaj të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to (gjurma e auditimit). Konkretisht, monitorimi i orëve të mësimin, u bazua tek vetdeklarimi i secilit pedagog pas zhvillimit të procesit mësimor, që raportohej çdo javë pranë Drejtorisë së Kurrikulave të IAL-eve, informacion të cilin e kanë përcjellur në MASR.
- ✓ Mungesa e gjurmëve të auditimit për zhvillimin e një procesi mësimor, nuk ka siguruar dokumentimin e operacioneve në formë të tillë, që t’u mundësojë audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit, kjo në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Nisur nga sa më sipër, e kemi të pamundur të japim siguri të arsyeshme, mbi efektivitetin e orëve të mësimin, për sa kohë që sistemet e kontrollit që duhej të ngriheshin për këto procese, nuk janë ngritur.
- ✓ Asnjë nga IAL-et nuk ka evidenca se sa është frekuentimi i bibliotekës dixhitale gjatë pandemisë

¹²⁸ Kushtetuta e RSH në nenin 170, paragrafi 3

nga studentët, të cilët mund të aksesonin në bibliotekën dixhitale vetëm me anë të acauntit(llogarisë) të mundësuar nga fakultetit përkatës.

- ✓ Asnjë nga IAL-et në fillim të vitit akademik 2021-2022, nuk u ka ofruar mundësinë e kryerjes së testit PCR falas studentëve të cilët kanë qënë të pavaksinuar, dhe sipas Urdhërit Nr. 395 datë 06.10.2021 i MAS dhe Urdhërit Nr. 413 datë 24.09.2021, Udhërit 413/1 datë 27.09.2021 i MSHMS në auditor, do të lejohen vetëm studentët me certifikatë vaksinimi, testin PCR negativ ose vërtetim nga mjeku për pamundësi të kryerjes së vaksinës, këta studentë nuk lejohej të hynin në auditor.
- ✓ Universitetet nuk arritën të prioritarizonin buxhetet e tyre në funksion të orientimit të fondeve karshi nevojë që diktoi pandemia, duke bërë që rreth 20-30% e fondeve buxhetore të tyre, të “digjeshin” dhe të mos përdoren. Kryeson në mospërdorimin dhe si pasojë djegien e fondeve Universitetin” A.Xhuvani” Elbasan (29% mosrealizim) dhe me pas Universiteti Politeknik i Tiranës (21% mosrealizim).
- ✓ Në vijim të menaxhimit të buxheteve, konstatuam se është vijuar me kryerjen e pagesave fikse mujore prej 25,000 lekë/muaj për anëtarët e Senatit akademik, edhe në periudhë pandemie (ku ka hapësirë për kryerjen e 1-3 mbledhje/muaj). Këto fonde mund të ishin përdorur më mirë, nëse do t’i shërbenin mbështetjes së studentëve dhe pedagogëve gjatë periudhës së pandemisë.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT